LIGJ
Nr.9055, datë 24.4.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN MBI TË DREJTËN E DETIT" TË OKB-SË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën mbi të drejtën e detit" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3811, datë 8.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
E KOMBEVE TË BASHKUARA "MBI TË DREJTËN E DETIT"
FIRMOSUR NË MONTEGO BAY, JAMAICA 10 DHJETOR 1982

Hyrja në fuqi: 16 nëntor 1994
Shtetet Palë të kësaj Konvente:
të nisur nga dëshira për të zgjidhur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ligjin e detit, mbi bazën e frymës së mirëkuptimit e bashkëpunimit dhe duke marrë parasysh rëndësinë historike të kësaj Konvente, si një kontribut i rëndësishëm në ruajtjen e paqes, drejtësisë dhe progresit për të gjithë popujt e botës;
duke theksuar se zhvillimet që nga konferencat e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit të mbajtura në Gjeneva në vitin 1958 dhe 1960 kanë shpejtuar nevojën për nje Konventë të re dhe të pranueshme nga të gjithë, për të drejtën detare;
të bindur se problemet e hapësirës së oqeaneve janë të ndërvarura dhe nevojitet të konsiderohen si të njëjta;
duke njohur dëshirën e krijimit nëpërmjet kësaj Konvente, të një rregulli ligjor për të gjitha detërat dhe oqeanet, të cilat do të lehtësojnë komunikimin ndërkombëtar dhe do të nxisin përdorimin paqësor të detrave e oqeaneve, përdorimin e barabartë dhe efikas të burimeve të tyre, konservimin e burimeve të tyre gjallore dhe studimit, ruajtjes dhe rritjes të ambientit detar, duke pasur parasysh sovranitetin e të gjithë Shteteve,
Duke patur parasysh se arritjet e këtyre qëllimeve do të kontribuojnë në realizimin e nje rendi ekonomik ndërkombëtar të drejtë dhe të barabartë, i cili merr parasysh interesat dhe nevojat e shoqërisë njerëzore si e tërë, dhe në veçanti, interesat e nevojat e veçanta të zhvillimit përkatës të pozicioneve gjeografike të shteteve;
duke besuar se kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i ligjit të detit i arritur në këtë Konventë do të kontribuojë në forcimin e paqes, sigurisë, bashkëpunimit dhe marrëdhënieve miqësore ndërmjet Kombeve, do të nxisë përparimin ekonomik dhe social të të gjithë popujve të botës, në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtave të barabarta, si dhe në përputhje me qëllimet dhe parimet e

Kombeve të Bashkuara që janë formuluar në kartën e saj;

duke afirmuar që çështjet e parregulluara nga kjo Konventë do të vazhdojnë të rregullohen nga rregullat dhe parimet e legjislacionit ndërkombëtar të përgjithshëm,

ranë dakord si më poshtë:

PJESA I

HYRJE

Neni 1
Përdorimi i termave dhe qëllimi

1. Për qëllimet e kësaj Konvente:

(1) "Zonë" nënkupton shtratin e detit dhe të oqeanit, si dhe shtresat përtej kufijve të juridiksionit kombëtar.

(2) "Autoritet" nënkupton autoritetin ndërkombëtar të shtratit të detit.

(3) "Veprimtari në zonë" nënkupton të gjitha veprimtaritë e eksplorimit, për shfrytëzimin e burimeve të zonës.

(4) "Ndotje e ambientit detar" nënkupton hedhjen nga persona, direkt ose indirekt të substancave ose energjisë në ambientin detar, duke perfshirë dhe deltat e lumenjëve të cilat rezultojnë me efekte të dëmshme si demtim të burimeve gjallore dhe jetës detare, të rrezikshme për shëndetin e njeriut, pengimin e veprimtarive detare, duke përfshirë peshkimin dhe përdorime të tjera të ligjshme të detit, pengimin e cilësisë së perdorimit të ujrave të detit dhe kufizimin e karakteristikave.

(5) (a) "Hedhje" nënkupton:

(i) çdo hedhje të vetëdijshme të mbeturinave ose lëndëve të tjera nga anijet, hidroplanët, platformat ose strukturave të tjera detare të bëra nga njeriu;

(ii) çdo hedhje e vetëdijshme nga anijet, hidroplanët ose platformat ose struktura të tjera detare të bëra nga njeriu.

(b) "Hedhja " nuk përfshin:

(i) hedhjen e mbeturinave të lëndëve të tjera aksidentalisht ose që rrjedhin nga operimi normal i anijes, hidroplanëve, dhe nga platforma ose struktura të tjera detare të bëra nga njeriu, si dhe pajisjet e tyre, përveçse mbeturinave ose lëndëve të tjera të transportuara për/nga anijet, hidroplanët, platformat ose struktura të tjera detare të ndërtuara nga njeriu, që operojnë për qëllime hedhjeje të lëndëve të tilla ose që rrjedhin nga trajtimi i mbeturinave të tilla ose lëndëve të tjera në anije të tilla, hidroplane, platforma ose struktura;

(ii) vendosjen e lëndëve për një qëllim, përveçse hedhja e dukshme, me kusht që vendosja nuk është në kundërshtim me qëllimet e kësaj Konvente.

2. (1) "Shtetet Palë" nënkuptojmë shtetet të cilat kanë pranuar të zbatojnë këtë Konventë dhe për të cilat Konventa është në fuqi.

(2) Kjo Konventë zbatohet mutatis mutandis nga institucionet që referohen në nenin 305, paragrafi 1(b), (c), (d), (e) dhe (f), të cilat bëhen Palë të kësaj Konvente në përputhje me kushtet, të cilat kanë lidhje me secilën dhe mbi të cilat termi "Shtetet Palë" u referohet këtyre institucioneve.

PJESA II
UJËRAT TERRITORIALE DHE ZONA NË VAZHDIM
SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 2

Statusi ligjor i ujërave territoriale, të hapësirës ajrore mbi ujërat territoriale dhe shtratit e nënshtratit të tij

1. Sovraniteti i shtetit bregdetar shtrihet përtej territorit tokësor dhe ujërave të brendshme e në rastet e një shteti arqipelag, në ujërat e tij arqipelag dhe në drejtim të brezit të detit, të përshkruara si ujera territoriale.

2. Ky sovranitet shtrihet mbi hapësirën ajrore mbi ujërat territoriale, si dhe shtratit e nënshtratit të tij.

3. Sovraniteti mbi ujërat territoriale ushtrohet mbi bazën e kësaj Konvente dhe rregullave të tjera të legjislacionit ndërkombëtar.

SEKSIONI 2. KUFIJTË E UJËRAVE TERRITORIALE

Neni 3

Gjerësia e ujërave territoriale

Çdo shtet ka të drejtën e vendosjes së një gjerësie mbi ujërat territoriale deri në kufirin që nuk kalon 12 milje detare, të matur nga vija bazë e përcaktuar në përputhje me këtë Konventë.

Neni 4

Kufiri i jashtëm i ujërave territoriale

Kufiri i jashtëm i ujërave territoriale përbehet nga vija, pikat e së cilës janë në një distancë të barabartë, nga pika më e afërme e vijës bazë, e cila është e barabartë me gjerësinë e ujërave territoriale.

Neni 5

Vija bazë normale

Me përjashtim kur është shprehur ndryshe në këtë Konventë, vija bazë normale për matjen e gjerësisë së ujërave territoriale është vija e zbaticës gjatë bregdetit siç tregohet në hartat e shkallës së madhe të njohura zyrtarisht nga shteti bregdetar.

Neni 6

Shkëmbinjtë

Në rastet e ishujve të vendosur në cekina ose të ishujve që kanë bregdet të thepisur, vija bazë për matjen e gjerësisë së ujërave territoriale merret vija e zbaticës në drejtim të detit e shkëmbit, siç tregohet nga simbolet përkatëse në hartat e njohura zyrtarisht nga shteti bregdetar.

Neni 7

Vija bazë e drejtë

Në vendet, ku bregdeti është thellësisht i dhëmbëzuar dhe i prerë ose kur është një copëz ishulli gjatë bregdetit, në afërsi të tij, metoda e matjes së vijës bazë mund të shfrytëzohet me anën e bashkimit të pikave përkatëse dhe duke formuar vijën bazë nga e cila matet gjërësia e detit territorial.

Kur për shkak të prezencës së deltës ose kushteve të tjera natyrore bregdeti është shumë i paqëndrueshëm, pikat përkatëse mund të zgjidhen nga vija e zbaticës më e futur në det dhe duke marrë parasysh regresionin e vazhdueshëm e vijës së zbaticës, vija bazë e drejtë do të mbetet efektive për derisa të ndryshohet nga shteti bregdetar në përputhje me këtë Konventë.

Heqja e vijave të drejta bazë nuk duhet të niset nga zgjatime të dallueshme nga drejtimi i përgjithshëm i bregdetit dhe siperfaqet e detit që shtrihen brenda vijës, duhet që të jenë shumë të lidhura me tokën për të qenë subjekt i regjimit të ujërave territoriale.

Vijat e drejta bazë nuk duhet të hiqen për dhe nga ngritjet e zbaticës, përderisa në të jenë të

ndërtuara fenerë ose instalime të ngjashme, që janë të përhershëm mbi nivelin e detit ose me përjashtim të rasteve kur heqja e vijës së drejtë bazë për e nga lartësime të tilla, ka marrë njohje të përgjithshme ndërkombëtare.

Kur metoda e vijës së drejtë bazë është e zbatueshme sipas paragrafit 1, në përcaktimin e vijave bazë të veçanta mbi bazën e interesave ekonomike të rajonit në fjalë, mund të merret në konsideratë realiteti dhe rëndësia të cilat janë të evidentuara qartë prej përdorimit të gjatë.

Sistemi i vijave të drejta bazë mund të mos zbatohet nga shteti në mënyrë të tillë që të presë detin territorial të shtetit tjetër nga deti i hapur ose nga një zonë ekskluzive ekonomike.

Neni 8
Ujërat e brendshme

Me përjashtim të parashikimeve të Pjesës së IV, ujërat në anën e drejtimit të tokës të vijës bazë të detit territorial formojnë ujrat e brendshme të shtetit.

Kur krijimi i vijave të drejta bazë i bërë në përputhje me metodën e përmendur në nenin 7 ka efektin e konsiderimit si ujëra të brendshme në zona, të cilat përpara nuk kanë qenë konsideruara si të tilla, atëhere do të jetë e drejta e konsiderimit si ngushticë siç parashikohet në këtë konventë për këto ujëra.

Neni 9
Derdhjet e lumenjve

Në rast se një lumë derdhet direkt në det atëhere vija bazë do të jetë një vijë e drejtë gjatë derdhjes së lumit ndërmjet pikave që bashkojnë vijën e zbaticës të shtratit te tij.

Neni 10
Gjiret

Ky nen lidhet vetëm me gjiret brigjet e të cilit i përkasin vetëm nje shteti të vetëm.

Për qëllimet e kesaj Konvente, nje gji është nje shkallëzim i identifikuar mirë penetrimi i të cilit është në proporcion të tillë me gjërësinë e grykës së tij sa të përmbajë brënda ujëra të kufizuara nga toka dhe të përbëjë më shumë se një kurbë të butë në bregdet. Një shkallëzim nuk do të merret në konsideratë si gji, përvec se kur sipërfaqja e tij është me e madhe, ose aq e madhe, sa gjysma e rrethit, diametri i të cilit është një vijë e drejtë e hequr gjatazi grykës së këtij shkallëzimi.

Për qëllimin e matjes, sipërfaqja e një shkallëzimi është ajo që shtrihet mdërmjet shënjave të zbaticës përreth bregut te shkallëzuar dhe vijës që bashkon shënjën e zbaticës nga pika e hyrjes natyrale të saj. Kur për arësye të pranisë së nje ishulli, një shkallëzim ka më shumë se një grykë gjysma e rrethit duhet të krijohet me nje vije të gjatë sa shuma totale e gjatësisë së vijës së hequr gjatazi grykave të ndryshme. Ishujt brënda shkallëzimeve do të përfshihen sikur ato të ishin pjesë e zonës së ujit të shkallëzimit.

Në rast se distanca ndërmjet shënjave të zbaticës të pikës së hyrjes natyrale të një gjiu nuk kalon 24 miljet detare, një vijë mbyllëse mund të hiqet ndërmjet dy shënjave të zbaticës dhe ujrave të perfshira dhe si rrjedhim ato do të konsiderohen si ujëra të brendshëm.

Kur distanca ndërmjet shënjave të zbaticës dhe pikës së hyrjes natyrale të një gjiu kalon 24 miljet detare, duhet hequr një vijë e drejtë bazë prej 24 milje detare që mbyll ujërat e gjiut në në mënyrë të tillë që të përfshijë një sipërfaqe maksimale të mundëshme uji të barabartë me këtë gjatësi.

Parashikimet e mësipërme nuk zbatohen për të ashtuquajturat gjij " historik " ose në çdo rast kur është zbatuar sistemi i vijave bazë të drejta të parashikuara në nenin 7.

Neni 11
Portet

Për qëllimet e kufizimit të detit territorial, vepra portuale të vazhdueshme me përmasa të mëdha, që formojne një pjesë integrale të sistemit portual, konsiderohen sikur formojnë një pjesë të bregut. Pajisjet në det dhe ishujt artificial nuk do të konsiderohen si vepra portuale.

Neni 12
Radat

Vendqëndrimet e radave që përdoren normalisht për ngarkim, shkarkim dhe qëndrimin në spirancë të anijeve, dhe të cilat janë të vendosura pjesërisht ose komplet ne pjesën e jashtme të kufirit të jashtëm të detit territorial, janë të përfshira në detin territorial.

Neni 13
Lartësimet e zbaticës

Një lartësim zbatice është një sipërfaqe e formuar në mënyrë të natyrshme e tokës, e cila është e rrethuar nga dhe mbi ujrat e zbaticës, por e përmbytur në periudhën e baticës. Kur një lartësim zbatice është e vendosur pjesërisht ose komplet në një distancë që nuk kalon gjerësinë e detit territorial nga toka ose ishulli, kjo vijë zbatice mund të përdoret si vijë bazë për matjen e gjerësisë të detit territorial.

Kur një lartësim zbatice është komplet i vendosur në një distancë që kalon gjerësinë e detit territorial nga toka ose ishull,i atëhere nuk konsiderohet det territorial.

Neni 14
Kombinimi i metodave për përcaktimin e vijave bazë

Shtetet bregdetare mund të përcaktojnë vijat bazë kundrejt çdo metode të parashikuar në nenet e mëparshëm për të arritur kushte të caktuara.

Neni 15
Kufizimi i detit territorial ndërmjet shteteve që janë ballë për ballë ose fqinjë

Kur brigjet e dy shteteve janë ballë për ballë ose në afërsi me njëri-tjetrin asnjë nga dy shtetet nuk do të ketë të drejtën, përveç kur është bërë një marrëveshje ndërmjet tyre, për të zgjeruar detin territorial përtej vijave të mesme pikat e së cilës janë të barazlarguara nga pikat më të afërta të vijave bazë nga të cilat matet gjerësia e detit territorial të dy shteteve. Parashikimi i mësipërm nuk zbatohet, megjithatë, kur është e nevojshme në rastet e ndonjë titulli historik ose rrethana të tjera të veçanta për kufizimin e detit territorial ndërmjet të dy shteteve sipas mënyrave të mësipërme.

Neni 16
Harta dhe listat e koordinatave gjeografike

Vija bazë për matjen e gjerësisë së detit territorial e përcaktuar mbi bazën e neneve 7, 9 dhe 10 ose kufijtë që rrjedhin nga kjo, si dhe vijat e kufirit të hequra në përputhje me nenin 12 dhe 15 duhet të tregohen në harta me shkallë të përshtatshme për të përcaktuar pozicionin e tyre. Respektivisht, mund të zëvendësohet dhe lista e pikave të koordinatave gjeografike me specifikimet e të dhënave gjeodezike.

Shtetet bregdetare do të bëjnë publikimin e duhur të hartave ose listave të tilla të koordinatave gjeografike dhe do t'i depozitojnë një kopje të secilës prej hartave ose listave të tilla tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara,

SEKSIONI I TRETË, KALIMI PAQËSOR NË DETIN TERRITORIAL
PJESA A RREGULLA TË ZBATUESHME NGA TË GJITHA ANIJET

Neni 17
E Drejta e kalimit paqësor

Mbi bazën e kësaj Konvente, anijet e të gjitha shteteve, bregdetare ose jobregdetare, gëzojnë të drejtën e kalimit paqësor nëpërmjet detërave territoriale.

Neni 18
Kuptimi i kalimit

Kalim do të kuptojmë lundrimin nëpërmjet detërave territoriale për qëllimet e:

traversimit të detit pa hyrë në ujërat e brendshme ose prekur një qëndrim në radë ose pajisje të portit jashtë ujërave të brendshme;

vazhdimit drejt ose nga ujërat e brendshme ose prekjen e një vendqëndrimi në radë ose pajisje të portit.

2. Kalimi duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i shpejtë. Megjithatë kalimi përfshin ndalimin dhe ankorimin, por deri në atë rast që ai është i rastësishëm për lundrimin e zakonshëm ose bëhet i nevojshëm për arsye të forcës madhore ose rreziku ose për qëllime të dhënies së ndihmës për njerëzit, anijet ose aeroplanët në rrezik ose avari.

Neni 19
Kuptimi i kalimit paqësor

Kalimi është paqësor derisa ai nuk është paragjykues për paqen, rregullin e mirë ose sigurinë e shteteve bregdetare në qoftë se në detërat territoriale ai hyn në njërin nga aktivitetet e poshtëshënuara:

çdo kërcënim ose përdorim i forcës kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të shtetit bregdetar ose në çfarëdo mënyre tjetër në thyerjen e parimeve të ligjeve ndërkombëtare të shkruara në kartën e Kombeve të Bashkuara;

çdo ushtrim ose praktikim me armë të çdo lloji;

çdo akt që ka për qëllim mbledhjen e informatave me paramendim për mbrojtjen ose sigurinë e shtetit bregdetar.

çdo akt i propagandës me qëllim të ndërhyrjes në mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit bregdetar;

lëshimit, zbarkimit ose marrjes në bord të çdo aeroplani;

lëshimit, zbarkimit ose marrjes në bord të çdo pajisjeje ushtarake;

ngarkimit ose shkarkimit të çdo lloj malli, parash ose personash në kundërshtim me ligjet dhe rregullat e doganës, sistemit fiskal, kufirit dhe shëndetësisë të shtetit bregdetar;

çdo akti me dëshirë, ndotje serioze në kundërshtim me këtë Konvente;

çfarëdo aktiviteti peshkimi;

kryerjes së aktiviteteve kërkimore dhe vrojtuese;

çfarëdo akti me qëllim ndërhyrjeje me çdo sistem komunikimi ose çdo pajisje ose instalim tjetër të shtetit bregdetar;

çdo aktivitet tjetër që nuk ka lidhje direkte me kalimin.

Neni 20
Nëndetëset dhe mjetet e tjera nënujore

Në detin territorial nëndetëseve dhe mjeteve të tjera nënujore ju kërkohet të lundrojnë mbi ujë dhe të tregojnë flamurin e tyre.

Neni 21
Ligjet dhe rregullat e shtetit bregdetar ne lidhje me kalimin paqësor

1. Shteti bregdetar mund të adaptojë ligje dhe rregulla, në përputhje me parashikimet e kësaj Konvente dhe rregulla të tjera të ligjeve ndërkombëtare, në lidhje me kalimin paqësor nëpërmjet detit territorial, lidhur me të gjitha çështjet ose disa si më poshtë:

sigurinë e lundrimit dhe rregullat e trafikut detar;

mbrojtjes së pajisjeve ndihmëse të lundrimit, si dhe pajisjeve e instalimeve të tjera detare;

mbrojtjes së kablove ose tubacioneve;

konservimit të rezervave gjallore detare;

evitimit të thyerjeve të ligjeve dhe rregullave të peshkimit të shtetit bregdetar;

konservimit të ambientit të shtetit bregdetar dhe parandalimit, kufizimit dhe kontrollimit të

ndotjeve;

kërkimeve shkencore-detare dhe vrojtimeve hidrografike;

evitimit të thyerjeve të ligjeve dhe rregullave doganore, fiskale, kufirit ose shëndetësore të shtetit bregdetar.

2. Ligje dhe rregulla të tilla nuk do të zbatohen për projektet, konstruksionet, ekuipazhet dhe pajisjet e anijeve të huaja përderisa ato plotësojnë rregullat e standardeve ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi.

3. Shteti bregdetar do të japë publikimet e nevojshme për të gjitha ligjet dhe rregullat.

4. Anijet e huaja që ushtrojnë të drejtën e kalimit paqësor nëpërmjet detit territorial duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat e tilla, si dhe të gjitha rregullat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi lidhur me parandalimin e përplasjeve në det.

Neni 22

Vijat e kursit dhe skemat e trafikut të seperuar në detin territorial

1. Shteti bregdetar, kur është e nevojshme të merret në konsideratë siguria e lundrimit, mund t'i kërkojë anijeve të huaja që ushtrojnë të drejtën e kalimit paqësor nëpërmjet detit të tyre territorial, të përdorin kurse të tilla detare dhe zona të trafikut të seperuar siç mund të projektohen ose përshkruhen në rregullat e kalimit të anijeve.

2. Në veçanti mund t'ju kërkohet anijeve çisternë, anijeve me fuqi atomike dhe anijeve që transportojnë substanca ose materiale nukleare ose substanca dhe/ose materiale helmuese e të tjera të rrezikshme, të kufizojnë kalimin e tyre vetëm në këto kurse.

Në projektimin e këtyre kurseve dhe përshkrimin e skemave të trafikut të seperuar sipas këtij neni shteti bregdetar do të marrë në konsideratë :

(a) rekomandimet e organizatave ndërkombëtare kompetente;

(b) çdo kanal të përdorur zakonisht për lundrim ndërkombëtar;

(c)karakteristikat speciale të anijeve dhe kanaleve të veçanta;

(d) densitetin e trafikut.

4. Shteti bregdetar do të tregojë qartë këto vija kursi dhe skema të trafikut të seperuar në hartat të cilave u duhet bërë publikimi i duhur.

Neni 23

Anijet e huaja me fuqi atomike dhe anijet që transportojnë substanca atomike ose substanca helmuese ose të rrezikshme

Anijet e huaja me fuqi atomike dhe anijet që transportojnë substanca atomike ose substanca helmuese ose të rrezikshme, kur ushtrojnë të drejtën për kalimin paqësor nëpërmjet detit territorial, duhet të kenë me vete dokumente dhe të marrin masa të veçanta parandaluese të vendosura për anije të tilla nga marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 24

Detyrat e shtetit bregdetar

1. Shteti bregdetar nuk do të pengojë kalimin paqësor të anijeve të huaja nëpërmjet detit territorial me përjashtim të rasteve në përputhje me këtë Konventë. Në veçanti në zbatimin e kësaj Konvente ose ndonjë ligji ose rregulli të adaptuar në përputhje me Konventën, shteti bregdetar nuk duhet:

a) të vendosë kërkesa mbi anijet e huaja, të cilat do të kenë efekt praktik të dënimit ose ndërhyrjes në të drejtën e kalimit paqësor;

b) të diskriminojë në formë ose në fakt, kundrejt anijes së një shteti ose anijeve që transportojne mallra për e nga për llogari të çdo shteti.

2. Shteti bregdetar do të bëjë publikimet përkatëse për çdo rrezik lundrimi, për të cilat ai ka njohuri brenda detit territorial.

Neni 25
Të drejtat e mbrojtjes së shtetit bregdetar

Shteti bregdetar mund të marrë masat e nevojshme në detin e tij territorial për të parandaluar kalimin që nuk është paqësor.

Në rastet e anijeve që vazhdojnë lundrimin në drejtim të ujërave të brendshme, shteti bregdetar ka të drejtën gjithashtu të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo thyerje të kushteve në mbështetje të të cilave lejohet hyrja e këtyre anijeve në ujërat e brendshme ose prekja e një porti.

Shteti bregdetar pa asnjë diskriminim në formë dhe faktikisht ndërmjet anijeve të huaja, mund të pezullojë përkohësisht në zona të veçanta të detit të tij territorial kalimin e përkohshëm të anijeve të huaja në rast se ky pezullim është thelbësor për mbrojtjen e sigurisë së tij, duke përfshirë dhe ushtrimet me armë. Pezullime të tilla hyjnë në fuqi vetëm pas shpalljes së publikimit në momentin e duhur.

Neni 26
Pagesat që mund të mblidhen nga anijet e huaja

Nuk lejohet të mblidhet asnjë pagesë nga anijet e huaja për arsye vetëm të kalimit të tyre nëpërmjet detit territorial.

Pagesat mund të mblidhen kundrejt anijeve të huaja që kalojnë nëpërmjet detit territorial, si pagesë vetëm për shërbime të veçanta që i jepen anijes. Këto pagesa duhet të mblidhen pa asnjë diskriminim.

PJESA B. REGULLA TË ZBATUESHME PËR ANIJET TREGTARE DHE QEVERITARE QË OPEROJNË PËR QËLLIME TREGTARE

Neni 27
Të drejtat e mbrojtjes të shtetit bregdetar

Juridiksioni kriminal i shtetit bregdetar nuk do të ushtrohet mbi bordin e anijeve të huaja që kalojnë nëpërmjet detit territorial për të arrestuar çdo person ose të kryer investigime në lidhje me çdo krim të kryer në bordin e anijes gjatë kalimit, përveç se në rastet që vijojnë :

kur konseguencat e krimit shtrihen edhe mbi shtetin bregdetar;

në rast se krimi është i llojit që shqetëson paqen e vendit ose sigurinë publike të detit territorial;

në rast se është kërkuar ndihma e autoriteteve lokale nga kapiteni i anijes ose nga përfaqësuesit diplomatik ose nëpunësi i konsullatës të flamurit të shtetit;

në rast se këto masa janë të nevojshme për ndalimin e trafikut të paligjshëm të drogave ose substancave psikotropike.

Parashikimet e mësipërme nuk kanë efekt mbi të drejtën e shtetit bregdetar për të ndërmarrë masat e autorizuara nga ligji i tij për qëllimin e një arrestimi ose investigimi në bordin e anijes së huaj që kalon nëpërmjet detit territorial pas largimit nga ujërat e brendshme.

Në rastet e parashikuara në paragrafin 1 dhe 2, shteti bregdetar duhet të njoftojë në se kapiteni e kërkon axhentin diplomatik ose nëpunësin e konsullatës të shtetit, flamurin e të cilit ka anija përpara marrjes së ndonjë mase dhe duhet të lehtësojë kontaktet ndërmjet axhentëve ose nëpunësve të tillë dhe ekuipazhit të anijes. Në rastet e emergjencës, ky njoftim mund t'i komunikohet gjatë kohës që janë marrë masat.

Në konsiderimin nëse duhet bërë arrestimi dhe në çfarë mënyre duhet bërë ai autoritetet lokale duhet të kenë parasysh interesat e lundrimit.

Me përjashtim siç është parashikuar në pjesën XII ose në lidhje me thyerjet e ligjit dhe rregullave të adaptuara në përputhje me Pjesën e V, shteti bregdetar mund të mos marrë ndonjë masë në bordin e një anijeje të huaj që kalon nëpërmjet detit territorial për arrestimin e çdo personi ose të ndërmarrë investigime në lidhje me çdo krim të kryer përpara mbërritjes së anijes në detin territorial, në rast se anija, që vjen nga një port i huaj, është vetëm duke kaluar nëpërmjet detit territorial pa hyrë në ujërat e brendshme.

Neni 28

Juridiksioni civil në lidhje me anijet e huaja

1. Shteti bregdetar nuk duhet të ndalojë ose kthejë një anije të huaj që kalon nëpërmjet detit territorial për qëllime të ushtrimit të juridiksionit civil në lidhje me një person në bordin e anijes.

2. Shteti bregdetar mund të mos mbledhë ekzekutimet kundër ose arrestimin e anijes për qëllimet e çdo procedure civile, me përjashtim të rasteve të detyrimeve ose përgjegjësive të supozuara ose të ndodhura nga anija gjatë ose për qëllimet e udhëtimit të saj nëpërmjet ujërave të shtetit bregdetar.

3. Paragrafi 2 është pa paragjykim në të drejtën e shtetit bregdetar, në perputhje me ligjet e tij, për të mbledhur ekzekutimin kundër ose arrestimin, për qëllimet e çdo procedure civile, për të arrestuar çdo anije të huaj që ndodhet në detin territorial ose që kalon nëpërmjet detit territorial, pasi ka lënë ujërat e brendshme.

PJESA C. RREGULLA TË ZBATUESHME PËR ANIJET E LUFTËS DHE ATO QEVERITARE PËR QËLLIME JOTREGTARE

Neni 29

Definicioni për anijet e luftës

Për qëllimet e kësaj konvente, “anije lufte“ nënkuptojmë një anije që i përket forcave ushtarake të një shteti, e cila mban shenja të jashtme dalluese për anije të tilla të nacionalitetit të saj, nën komandën e një oficeri të caktuar përkatësisht nga qeveria e shtetit dhe emri i të cilit shprehet në listën përkatëse të shërbimit ose ekuivalencën e saj dhe e drejtuar nga një ekupazh, i cili është nën disiplinën e rregullt ushtarake.

Neni 30

Mospërputhja e anijeve të luftës me ligjet dhe rregullat e shtetit bregdetar

Në rast se çdo anije lufte nuk zbaton ligjet dhe rregullat e shtetit bregdetar në lidhje me kalimin nëpërmjet detit territorial dhe nuk merr në konsideratë asnjë kërkesë për të zbatuar atë që i është bërë asaj, shteti bregdetar mund t’i kërkojë asaj që të lërë detin territorial menjëherë.

Neni 31

Përgjegjësia e shtetit të flamurit për dëmet e shkaktuara nga një anije lufte ose anije të tjera qeveritare të operuara për qëllime joqeveritare

Shteti i flamurit që mban anija do të mbajë përgjegjësi ndërkombëtare për çdo humbje ose dëmtim që i shkaktohet shtetit bregdetar të rezultuar nga mospërputhja me një anije lufte ose anije tjetër qeveritare që operon për qëllime jo tregtare me ligjet dhe rregullat e shtetit bregdetar përsa i përket kalimit nëpërmjet detit territorial ose me parashikimet e kësaj Konvente ose rregullave të tjera të legjislacionit ndërkombëtar.

Neni 32

Imuniteti i anijeve të luftës dhe anijeve të tjera qeveritare që operojne për qëllime jo tregtare

Me përjashtime të tilla siç përmendet në pjesën A, dhe në nenin 30 e 31, asgjë në këtë Konventë do të ndikoje në imunitetin e anijeve të luftës dhe anijeve të tjera qeveritare që operojnë për qëllime jo - tregëtare.

SEKSIONI 4 ZONA NË VAZHDIM

Neni 33
Zone në vazhdim

1. Në një zonë në vazhdim të detit territorial të përshkruar si zona në vazhdim, shteti bregdetar mund të ushtrojë kontrollin e nevojshëm për:

(a) parandalimin e thyerjeve të ligjeve dhe rregullave për doganën, sistemin fiskal, kufirin dhe shëndetësinë brenda territorit të saj ose detit territorial;

(b) dënimin e thyerjeve të mësipërme të ligjeve dhe rregullave të mësipërm të kryera brenda territorit të saj ose detit territorial.

2. Zona në vazhdim mund të shtrihet deri në 24 milje detare nga vijat bazë e gjerësisë së detit territorial.

PJESA E III
NGUSHTICAT E PËRDORURA PËR LUNDRIM NDËRKOMBËTAR
SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 34
Statusi ligjor i ujërave që formojnë ngushticat, të cilat perdoren për lundrim ndërkombëtar

1. Regjimi i kalimit nëpërmjet ngushticave që përdoren për lundrim ndërkombëtar i përcaktuar në këtë pjesë, nuk do të ketë në asnjë mënyrë ndikim në statusin ligjor të ujërave që formojnë ngushtica të tilla ose ushtrimin, nga shtetet që kufizojnë ngushticën, për sovranitetin e tyre ose juridiksionin mbi ujëra të tilla dhe hapësirës ajrore, shtratit dhe nënshtratit të tyre.

2. Sovraniteti dhe juridiksioni i çdo shteti që kufizon ngushticën ushtrohet mbi bazën e kësaj pjese dhe rregullave të tjera të legjislacionit ndërkombëtar.

Neni 35
Qëllimi i kësaj pjese

Asgjë në këtë pjesë nuk ndikon :

(a) në çdo zonë të ujërave të brendshme brenda ngushticës, me përjashtim kur përcaktimi i vijave bazë të ngushticës i bërë në përputhje me metodën e vendosur në nenin 7, ka efektin e përfshirjes si zonë e ujërave të brendshme, e cila nuk është marrë në konsideratë më përpara si e tillë;

(b) në statusin ligjor të ujërave përtej detit territorial të shteteve që kufizojnë ngushticën, zona ekonomike ekskluzive ose det i hapur; (c) në regjimin ligjor në ngushticë që rregullohet krejtësisht ose pjesërisht nga Konventat Ndërkombëtare afatgjate në fuqi që i referohen veçanërisht ngushticave të tilla.

Neni 36
Rrugët në detin e hapur ose rrugët që kalojnë nëpërmjet zonave ekonomike ekskluzive nëpërmjet ngushticave që përdoren për lundrime ndërkombëtare

Kjo pjesë nuk zbatohet ndaj një ngushtice, e cila përdoret për lundrime ndërkombëtare në rast se në të ekziston një rrugë detare e hapur ose një rrugë që kalon nëpërmjet një zone ekonomike ekskluzive të ngjashme përsa i përket karakteristikave hidrografike dhe lundrimore për rrugë të tilla, pjesët e tjera përkatëse të kësaj Konvente, duke përfshirë parashikimet që kanë lidhje me lundrimin e fluturimin e lirë, zbatohen.

SEKSIONI 2. KALIMI TRANZIT

Neni 37
Qëllimi i këtij seksioni

Ky seksion zbatohet për ngushticat të cilat përdoren për lundrim ndërkombëtar ndërmjet një pjese të detit të hapur ose zone ekonomike ekskluzive dhe pjesës tjetër të detit të hapur ose një zone

ekonomike ekskluzive.

Neni 38
E drejta e kalimit tranzit

1. Në ngushticat që referohen në nenin 37, gëzojnë të drejtën e kalimit tranzit, të gjithë anijet dhe hidroplanët të cilët nuk pengojnë, me përjashtim të kësaj, nëse ngushtica formohet nga një ishull i një shteti që kufizon ngushticën dhe kontinentit të saj, kalimi tranzit nuk do të zbatohet nëse atje ekziston, në drejtim të detit nga ishulli, një rrugë nëpërmjet detit të hapur ose zonës ekonomike ekskluzive të ngjashme përsa i përket karakteristikave hidrografike dhe lundrimore.

2. Kalimi tranzit nënkupton ushtrimin në përputhje me këtë pjesë të lirisë së lundrimit dhe fluturimit vetëm për qëllimet e tranzitit të pandërprerë dhe direkt në ngushticë ndërmjet një pjese të detit të hapur ose zone ekonomike ekskluzive dhe pjesës tjetër të detit të hapur ose zone ekonomike ekskluzive. Megjithatë, kërkesat e kalimit tranzit të vashdueshëm dhe sa më të shpejtë, nuk përfshijnë kalimin nëpërmjet ngushticës për qëllime të hyrjes, lënies ose kthimit nga shteti që kufizon ngushticën, mbi bazën e kushteve të hyrjes në këtë shtet.

3. Çdo aktivitet, i cili nuk është ushtrim i të drejtës për kalimin tranzit nëpërmjet ngushticës, mbetet subjekt i parashikimeve të zbatueshme të kësaj Konvente.

Neni 39
Detyrat e anijeve dhe hidroplanëve gjatë kalimit tranzit

1. Anijet dhe hidroplanët, ndërsa ushtrojnë të drejtën e kalimit tranzit duhet:

a) të vazhdojnë pa vonesë lundrimin në ose nëpërmjet ngushticës;

b) të heqë dorë nga çdo kërcënim ose përdorim force kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të shteteve që kufizojnë ngushticën ose në një mënyrë tjetër në thyerjen e parimeve të legjislacionit ndërkombëtar të bashkëngjitura në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

c)Të heqë dorë nga çdo aktivitet, përveç atyre të rastësishme nga mënyra normale e kalimit tranzit në mënyrë të shpejtë e të vazhdueshme, përveçse kur bëhet e nevojshme për arsye të forcës madhore ose nga një avari;

d) Të jetë në përputhje me parashikimet kësaj pjese.

2. Anijet gjatë kalimit tranzit duhet:

a) të jenë në përputhje me rregullat, procedurat dhe praktikat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi, në lidhje me sigurinë në det, duke përfshirë regullat ndërkombëtare për evitimin e përplasjeve në det;

b) të jenë në përputhje me rregullat, procedurat dhe praktikat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi, në lidhje me parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet.

3. Aeroplanët në kalimin tranzit duhet:

a) të vrojtojnë rregullat e ajrit të vendosura nga organizata ndërkombëtare e aviacionit Civil, siç ato zbatohen nga avionet civilë, avionët shtetëror të jenë normalisht në përputhje me masa të tilla sigurie dhe gjatë gjithë kohës të operojnë duke marrë në konsideratë sigurinë e lundrimit;

b) gjatë gjithë kohës të monitorizojnë frekuencat e radios, të caktuara nga autoritet kompetente të kontrollit të trafikut ajror të caktuara ndërkombëtarisht ose radio frekuencat përkatëse ndërkombëtare të avarisë.

Neni 40
Veprimtaritë e kërkimeve shkencore dhe inspektimeve

Gjatë kalimit tranzit, anijet e huaja, duke përfshirë anijet detare te kërkimeve shkencore dhe vrojtimeve hidrografike mund të mos ndërmarrin ndonjë aktivitet kërkimi ose vrojtimi pa autorizimin e mëpërparshëm të shteteve kufizuese të ngushticës.

Neni 41
Vijat detare dhe zonat e trafikut të seperuar në ngushticat që përdoren për lundrim

ndërkombëtar

1. Në përputhje me këtë pjesë, Shtetet që kufizojnë ngushticat mund të projektojnë vijat detare dhe përshkruajnë zona të trafikut të seperuar për lundrim në ngushtica kur është e nevojshme për nxitjen e kalimit të sigurtë të anijeve.

2. Shtete të tilla, kur e lejojnë rrethanat, të kërkojnë dhe pasi kanë bërë publikimin, të zëvendësojnë vija të tjera deti ose skema të tjera të trafikut të seperuar për çdo vijë deti ose zone të trafikut të seperuar të përshkruara që më parë prej tyre.

3. Vija e detit dhe zona të tilla të trafikut të seperuar duhet të jenë konform rregullave ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi.

4. Përpara projektimit ose zëvendësimit të vijave detare ose përshkrimit, ose zëvendësimit të zonave të trafikut të seperuar, shtetet bregdetare që kufizojnë ngushticën do t'i referojnë propozimet, organizatave ndërkombëtare kompetente me qëllimin e adaptimit të tyre. Organizata mund të adaptojë vetëm ato vija deti dhe skema të trafikut të seperuar siç mund të bihet dakord me shtetet kufizuese të ngushticës, pas së cilës shtetet mund të projektojnë, përshkruajnë ose zëvendësojnë ato.

5. Në lidhje me një ngushticë kur vijat e detit ose skemat e trafikut të seperuar nëpërmjet ujërave të dy ose më shumë shteteve kufizuese të ngushticës janë propozuar, shtetet e interesuara do të kooperojnë në formulimin e propozimeve në konsultim me organizatat ndërkombëtare kompetente.

6. Shtetet që kufizojnë ngushticën duhet që të tregojnë qartë të gjitha vijat e detit dhe skemat e trafikut të seperuar të projektuara ose përshkruara nga ato në harta të cilat duhet të publikohen.

7. Anijet në kalim tranzit duhet të respektojnë vijat e detyrueshme të detit dhe skemat e trafikut të seperuar të vendosura në përputhje me këtë nen.

Neni 42

Ligjet dhe rregullat e shteteve që kufizojnë ngushticat në lidhje me kalimin tranzit

1. Mbi bazën e parashikimeve të këtij seksioni, shtetet kufizuese të ngushticave mund të adaptojnë ligje dhe rregulla lidhur me kalimin tranzit nëpërmjet ngushticave, në lidhje me të gjitha ose secilën nga sa vijon:

(a) sigurinë e lundrimit dhe rregulla të trafikut detar, siç parashikohet në nenin 41;

(b) parandalimin, kufizimin dhe kontrollin e ndotjes, duke i dhënë efekt rregullave ndërkombëtare në lidhje me shkarkimin e vajrave, mbeturinave të vajrave dhe substancave të tjera mbytëse në ngushticë;

(c) në lidhje me anijet e peshkimit, ndalimin e peshkimit, duke përfshirë dhe stivimin e vinçit të peshkimit;

(d) ngarkimin dhe shkarkimin e çdo malli, monedhe ose personi në kundërshtim me rregullat dhe ligjet doganore, fiskale, kufirin dhe shëndetësinë të shteteve që kufizojnë ngushticën.

2. Ligje dhe rregulla të tilla nuk do të bëjnë diskriminim në formë ose në fakt ndërmjet anijeve të huaja ose kur në zbatimin e tyre kanë efekt praktik të dënimit, goditjes ose ndërhyrjes në te drejtën e kalimit tranzit siç përcaktohet në këtë seksion.

3. Shtetet kufizuese të ngushticave do të bëjnë publikimet e duhura për të gjitha ligjet dhe rregullat e tilla.

4. Anijet e huaja që ushtrojnë të drejtën e kalimit tranzit do të jenë në përputhje me ligje dhe rregulla të tilla.

5. Shtetet e flamurit që mban anija ose shtetet e regjistrit të një aeroplani që ka imunitet të sovranitetit, të cilat veprojnë në një mënyrë të kundërt me ligjet dhe rregullat e tilla ose parashikime të tjera të kësaj pjese do të mbajnë përgjegjësi ndërkombëtare për çdo humbje ose dëmtim, i cili rezulton kundrejt shteteve që kufizojnë ngushticën.

Neni 43

Pajisjet e lundrimit dhe sigurisë dhe përmirësime e ndalesa të tjera, reduktimi dhe kontrolli i ndotjeve

Shtetet përdoruese dhe shtetet që kufizojnë një ngushticë duhet të kooperojnë me marrëveshje:

(a) në krijimin dhe mirëmbajtjen në një ngushticë të pajisjeve të sigurisë dhe lundrimit ose

përmirësime të tjera të pajisjeve të lundrimit ndërkombëtar;

(b) për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes nga anijet;

Neni 44

Detyrat e shteteve që kufizojnë ngushticat

Shtetet që kufizojnë ngushticat nuk do të pengojnë kalimin tranzit dhe do të bëjnë njoftimet e duhura për çdo rrezik për lundrimin ose fluturimin brenda ose mbi ngushticën për të cilat ato kanë dijeni. Nuk do të ketë pezullim të kalimit tranzit.

SEKSIONI 3
KALIMI PAQËSOR

Neni 45

Kalimi paqësor

1. Regjimi i kalimit paqësor, në përputhje me pjesën e II, seksioni 3 do të zbatohet në ngushtica, të cilat përdoren për lundrim ndërkombëtar:

a) të përjashtuara nga zbatimi i regjimit të kalimit tranzit sipas nenit 38 paragrafi 1;

b) ndërmjet një pjese të detit të hapur ose një zone ekskluzive ekonomike dhe detit territorial të një shteti të huaj.

2. Nuk do të ketë asnjë pezullim të kalimit paqësor nëpërmjet ngushticave të tilla.

PJESA E IV
SHTETET ARQIPELAG

Neni 46

Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) "Shtete arqipelage" nënkupton një shtet të përbërë i gjithi nga një ose shumë arqipelage dhe mund të përfshijë ishuj të tjerë;

(b) "arqipelag" nënkupton një grup ishujsh, duke përfshirë një pjesë ishujve, që ndërlidhin ujërat dhe karakteristikat natyrale të cilat janë aq afër të lidhura sa ishuj të tillë, ujërat dhe karakteristikat e tjera natyrale formojnë një entitet gjeografik, politik dhe ekonomik ose të cilat historikisht janë konsideruar si të tilla.

Neni 47

Vijat bazë të arqipelagut

1. Një shtet arqipelag mund të heqë vijat bazë të drejta të arqipelagut që bashkojnë pikat e ishujve më anësor dhe të cekinave të thata të arqipelagut, me kusht që brenda vijave bazë të tilla të përfshihen ishujt kryesorë dhe një zonë në të cilën raporti i zonës së ujërave mbi raportin e tokës duke përfshirë dhe ishujt e vegjël është 1 me 1 dhe 9 me 1.

2. Gjatësia e vijave bazë të tilla nuk duhet t'i kalojë të 100 miljet detare, me përjashtim që deri në 3 për qind e numrit total të vijave bazë që përmbyll çdo arqipelag mund të kalojë këtë gjatësi, në maksimumin 125 milje detare.

3. Vizatimi i vijave bazë të tilla nuk do të fillojë nga një zgjatje e vlerësueshme e konfiguracionit të përgjithshëm të arqipelagut.

4. Vija bazë të tilla nuk do të vizatohen nga dhe për lartësimet e zbaticës më të ulët, përderisa në to të jetë instaluar një fener ose instalim i ngjashëm dhe që qëndron vazhdimisht mbi ujë, ose kur lartësimet e zbaticës më të ulët janë vendosur të gjitha ose pjesërisht në një distancë që nuk kalon gjerësinë e detit territorial nga ishulli më i afërt.

5. Sistemi i vijave bazë të tilla nuk do të zbatohet nga një shtet arqipelag në mënyrë të tillë që të bllokojë nga deti i hapur ose një zonë ekskluzive eknomike detin territorial të një shteti tjetër.

6. Në qoftë se një pjesë e ujërave të arqipelagut të një shteti arqipelag shtrihen ndërmjet dy pjesëve të shteteve fqinjë me lidhje direkte, të drejtat ekzistuese dhe interesa të tjera të legjitimuara, të cilat shtetet në fjalë i kanë ushtruar tradicionalisht në ujëra të tilla dhe të gjitha të drejtat të stipuluara nga marrëveshjet midis shteteve do të vazhdojnë dhe do të respektohen.

7. Për qëllimet e llogaritjes së raportit të ujit mbi tokën sipas paragrafit 1, zonat e tokës mund të përfshijnë ujërat që shtrihen brenda cekinave të thepisura të ishujve dhe ishujve të vegjël, duke përfshirë atë pjesë të platesë oqeanike e cila është e përfshirë ose përafërsisht e përfshirë me një zinxhir ishujsh gëlqerorë dhe cekinash të thata që shtrihen në perimetrin e platesë.

8. Vijat bazë të hequra në përputhje me këtë nen do të tregohen në harta të një shkalle të përshtatshme për të percaktuar pozicionin e tyre. Alternativisht, mund të zëvendësohet dhe lista e koordinatave gjeografike të pikave që tregojnë të dhënat gjeodezike.

9. Shtetet arqipelage do të bëjnë publikimet e duhura të hartave të tilla ose listave të koordinatave gjeografike dhe do të depozitojnë një kopje të secilës hartë ose listë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Dimensionet e detit territorial, zonës në vazhdim, zonës ekonomike ekskluzive dhe shelfit kontinental

Gjërësia e detit territorial, zonës në vazhdim, zonës ekonomike ekskluzive dhe shelfit kontinental do të matet nga vijat bazë të arqipelagut të hequra në përputhje me nenin 47.

Neni 49

Statusi ligjor i ujërave të arqipelagut, të hapësirës ajrore mbi ujërat e arqipelagut dhe të shtratit e nëntokës së tyre

1. Sovraniteti i një shteti arqipelag shtrihet mbi ujërat të përfshira nga vijat bazë te arqipelagut të hequra mbi bazën e nenit 47, të përshkruara si ujërat e arqipelgut pa marë parasysh thellësinë ose distancën nga bregu.

2. Sovraniteti shtrihet edhe mbi hapësirën ajrore të ujërave të arqipelagut, si dhe mbi shtratin dhe nëntokën e tyre, si dhe burimet që përmbajnë ato.

3. Ky sovranitet ushtrohet mbi bazën e kësaj pjese.

4. Regjimi i vijave detare të kalimit në ujërat e arqipelagut të vendosura në këtë pjesë nga të gjitha pikëpamjet e tjera nuk do të ndikojë mbi statusin e ujërave të arqipelagut duke përfshirë dhe vijat e detit ose në ushtrimin nga shteti arqipelag i sovranitetit mbi ujëra të tilla dhe hapësirës të tyre ajrore, shtratit dhe nëntokës së tyre, si dhe burimet që përmbajnë ato.

Neni 50

Kufijtë e ujërave të brendshëm

Brenda ujërave të tij, shteti arqieplag mund të vizatojë vija mbyllëse për kufirin e ujërave të brendshme, në përputhje me nenin 9, 10, 11.

Neni 51

Marrëveshjet ekzistuese, të drejtat tradicionale të peshkimit, si dhe kabllot eksistuese nënujore

1. Pa asnjë paragjykim të nenit 49, një shtet arqipelag do të respektojë të gjitha marrëveshjet me shtetet e tjera dhe do të njohë të drejtat tradicionale të peshkimit dhe aktivitete të tjera legjitime të shtetit fqinjë me lidhje direkte, në ato zona që i përkasin ujërave të arqipelagut. Termat dhe kushtet për ushtrimin e të drejtave dhe aktiviteteve të tilla, duke përfshirë natyrën, shtrirjen dhe hapësirën në të cilën ato zbatohen, me kërkesën e çdo shteti të interesuar, do të rregullohen me marrëveshje bilaterale ndërmjet tyre. Të drejta të tilla nuk do t'i transferohen ose ndahen me shtete të tjera ose shtetasit e tyre.

2. Një shtet arqipelag do të respektojë kabllot nënujore ekzistuese të shtrira nga shtetet e tjera dhe që kalojnë nëpërmjet ujërave të tyre pa bërë ndonjë hedhje nga toka. Një shtet arqipelag do të

lejojë mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e kabllove të tilla me marrjen e njoftimit të duhur përkatës të vendndodhjes së tyre dhe qëllimit për riparim ose zëvendësim të tyre.

Neni 52
E drejta e kalimit paqësor

1. Mbi bazën e nenit 53 dhe pa asnjë paragjykim të nenit 50, anijet e të gjitha shteteve gëzojnë të drejtën e kalimit paqësor nëpërmjet ujërave të arqipelagut, në përputhje me pjesën e II, seksioni 3.

2. Shteti arqipelag, pa asnjë diskriminim në formë dhe në fakt mbi anijet e huaja mund të pezullojë përkohësisht në zona të veçanta të ujrave të arqipelagut kalimin paqësor të anijeve të huaja në qoftë se një pezullim i tillë është thelbësor për mbrotjen e sigurisë së tij. Pezullime të tilla do të hyjnë në fuqi vetëm pasi janë publikuar si duhet.

Neni 53
E drejta e kalimit të vijave të arqipelagut

1. Një shtet arqipelag mund të projektojë vija deti dhe rrugë ajrore, të kënaqshme për kalimin e shpejtë dhe të vazhdueshëm të anijeve të huaja dhe avionëve nëpërmjet ose mbi ujërat e tij të arqipelagut dhe detin pranë territorit.

2. Të gjitha anijet dhe avionët gëzojnë të drejtën e kalimit të vijave të detit ose rrugëve ajrore.

3. Me kalim të vijave të detit arqipelag nënkuptojmë ushtrimin në përputhje me këtë Konventë të së drejtës të lundrimit dhe fluturimit në mënyrë normale vetëm për qëllime e kalimi të vazhdueshëm, të shpejtë dhe pa krijuar pengesa ndërmjet njërës pjesë të detit të hapur ose një zone ekonomike ekskluzive dhe pjesës tjetër të detit të hapur ose zonës ekonomike ekskluzive.

4. Vija të tilla të detit dhe rrugëve ajrore do të traversojnë ujërat e arqipelagut dhe detin territorial pranë dhe do të përfshijnë të gjitha rrugët normale të kalimit të përdorura si rrugë të lundrimit ose fluturimit ndërkombëtar nëpërmjet ose mbi ujërat e arqipelagut dhe brenda rrugëve të tilla, përderisa anijet janë të interesuara, të gjitha kanalet për lundrim normal, me kusht që dublikimi i rrugëve me konvenience të njëjtë ndërmjet të njëjtës hyrje dhe dalje nuk do të jenë të nevojshme.

5. Vija të tilla detare dhe rrugë ajrore do të përcaktohen me një seri vijash aksi të vazhdueshme nga pika e hyrjes të rrugës së kalimit deri tek pika e daljes. Anijet dhe avionët në vijat e kalimit të detit arqipelag nuk do të devijojnë më shumë se 25 milje detare në drejtim të çdo ane të vijave të tilla të akseve gjatë kalimit, me kusht që anijet dhe avionët nuk do të lundrojnë më afër bregut se 10 për qind e distancës ndërmjet pikave më të afërta në kufijtë e ishujve që kufizojnë vijat e detit.

6. Një shtet arqipelag, i cili projekton vija të detit sipas këtij neni mundet gjithashtu të përshkruajë skema të trafikut të seperuar për kalimin e sigurtë të anijeve nëpërmjet kanaleve të ngushta në të tilla detare.

7. Një shtet arqipelag, pas bërjes së publikimit të duhur, kur rrethanat e kërkojnë mundet të zëvendësojë vija të tjera të detit ose skema të trafikut të seperuar për çdo vijë të detit ose skeme të trafikut të seperuar të projektuar ose përshkruar që më parë nga ai.

8. Vija detare dhe skema të tilla të trafikut të seperuar duhet të jenë konform rregullave ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi.

9. Në projektimin ose zëvendësimin e vijave të detit ose përshkrimin e zëvendësimin e një skeme të trafikut të seperuar, shteti arqipelag do t'i referojë propozimet organizatave ndërkombëtare kompetente me qëlllimin e adaptimit nga ana e tyre. Organizata mund të adaptojë vetëm ato vija dhe skema të trafikut të seperuar siç mund të bihet dakord me shtetin arqipelag, pas së cilës shteti arqipelag mund t'i projektojë, përshkruajë ose zëvendësojë ato.

10. Shteti arqipelag duhet të tregojë qartë akset e vijave të detit dhe skemat e trafikut të seperuar të projektuara ose përshkruara nga ai në harta, të cilave u duhet bërë publikimi i duhur.

11. Anijet në kalim në vijat e detit duhet të respektojnë vijat në fuqi të detit dhe skemat e trafikut të seperuar të krijuara në përputhje me këtë nen.

12. Në qoftë se një shtet arqipelag nuk projekton vija deti ose rrugë ajrore, e drejta e kalimit të vijave të detit mund të ushtrohet nëpërmjet rrugëve normale të përdorura për lundrimin ndërkombëtar.

Neni 54

Detyrat e anijeve dhe avionëve gjatë kalimit të tyre, aktiviteteve të kërkimeve ose zbulimeve, detyrat e shtetit arqipelag dhe ligjet e rregullat e shtetit arqipelag në lidhje me kalimin e vijave të detit arqipelag

Neni 39, 40, 42, dhe 44 zbatohen mutandi mutandis në kalimet e vijave të detit arqipelag.

PJESA E V
ZONA EKONOMIKE EKSKLUZIVE

Neni 55

Regjimi specifik ligjor i zonës ekonomike ekskluzive

Zona ekonomike ekskluzive është një hapësirë përtej dhe pranë detit territorial, subjekt i regjimit ligjor të veçantë të vendosur në këtë pjesë, sipas së cilës të drejtat dhe juridiksioni i shtetit bregdetar dhe të drejtat e liritë e shteteve të tjera udhëhiqen nga parashikimet përkatëse të kësaj konvente.

Neni 56

Të drejta, juridiksioni dhe detyrat e shtetit bregdetar në zonat ekonomike ekskluzive

1. Në zonat ekonomike ekskluzive shtetet bregdetare kanë:

(a) të drejtat e sovranitetit për qëlllimet e eksplorimit dhe shfrytëzimit, konservimit dhe menaxhimit të burimeve natyrale, sidoqofshin të gjalla ose jogjallore, në ujërat super bashkëngjitur shtratit të detit dhe në fundin e detit, si dhe të fundit të nëntokës së detit dhe në lidhje me veprimtari të tjera për shfrytëzim ekonomik dhe eksplorim zone, siç janë prodhimi i energjisë nga uji, rrymat ose era;

(b) të juridiksionit siç parashikohet në nenet përkatëse të kësaj Konvente përsa i përket:

(i) krijimit dhe përdorimit të ishujve artificialë, instalimeve dhe strukturave;

(ii) kërkimeve shkencore detare;

(iii) ruajtjes dhe konservimit të ambientit detar;

(c) të drejtave dhe detyrave të tjera të parashikuara në këtë Konventë.

2. Ushtrimin e të drejtave të tyre dhe zbatimin e detyrave të tyre sipas kësaj Konvente në zonat ekonomike ekskluzive, shtetet bregdetare do të kenë ne vëmendjen e duhur në të drejtat dhe detyrat e shteteve të tjera dhe do të veprojnë në mënyrë kompatibël me parashikimet e kësaj Konvente.

3. Të drejtat e vendosura në këte nen në lidhje me fundin e detit dhe nëntokën e tij do të ushtrohen në përputhje me Pjesën e IV.

Neni 57

Gjerësia e zonës eknonomike ekskluzive

Zona ekonomike ekskluzive nuk do të shtrihet përtej 200 miljeve detare nga vijat bazë prej të cilave matet gjerësia e detit territorial.

Neni 58

Të drejtat dhe detyrat e shteteve të tjera në zonën ekonomike ekskluzive

1. Në zonën ekonomike ekskluzive, të gjitha shtetet si ato bregdetare ose të kufizuara vetëm me tokë, mbi bazën e parashikimeve të kësaj Konvente, gëzojnë lirinë e referuar në nenin 87 të lundrimit dhe fluturimit, shtrirjes së kabllove nënujore dhe tubacioneve dhe përdorimeve të tjera të ligjshme ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë liri, siç janë ato që lidhen me operimin e anijeve, avionëve tubacioneve dhe kabllove nënujore dhe që janë kompatibël me parashikime të tjera të kësaj

konvente.

2. Neni 88 deri në 115 dhe rregulla të tjera përkatëse të ligjit ndërkombëtar zbatohen në zonën ekonomike ekskluzive përderisa ato nuk janë inkompatibël me këtë pjesë.

3. Në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe ekzekutimin e detyrave të tyre sipas kësaj Konvente në zonën ekonomike ekskluzive, shtetet duhet të kenë vëmendjen e duhur në të drejtat dhe detyrat e shteteve bregdetare dhe duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat e adaptuara nga shtetet bregdetare në përputhje me parashikimet e kësaj Konvente dhe rregullave të tjera të ligjit ndërkombëtar përderisa ato nuk janë inkompatibël me këtë Pjesë.

Neni 59

Bazat për rizgjidhjen e konflikteve që kanë lidhje me atributet e të drejtave dhe juridiksionin e zonës ekonomike ekskluzive

Në rastet kur kjo Konventë nuk i atribuon të drejtat dhe juridiksionin shtetit bregdetar ose shteteve të tjera brenda një zone ekonomike ekskluzive dhe lind një konflikt ndërmjet interesave të një shteti bregdetar dhe çdo shteti ose shteteve të tjera, konflikti duhet të zgjidhet mbi bazat e barazisë dhe mbi të gjitha rrethanat respektive, duke marrë në konsideratë rëndësinë përkatëse të interesave të përfshira të palëve si dhe gjithashtu interesat e komunitetit ndërkombëtar si i tërë.

Neni 60

Ishujt artificialë, instalimet dhe strukturat në zonën ekonomike ekskluzive

1. Në zonën ekonomike ekskluzive, shteti bregdetar do të ketë të drejtën ekskluzive të ndërtojë, të autorizojë dhe rregullojë ndërtimin dhe operimin e :

(a) ishujve artificial;

(b) instalimeve dhe strukturave për qëllimet e parashikuara në nenin 56 dhe qëllime të tjera ekonomike;

(c) instalimeve dhe strukturave, të cilat mund të ndikojnë për ushtrimin e të drejtave të shtetit bregdetar në zonë.

2. Shteti bregdetar do të ketë juridiksion ekskluziv mbi të gjithë ishujt artificial, instalimet dhe strukturat, duke përfshirë dhe juridiksionin në lidhje me ligjet dhe rregullat e doganës, sistemin fiskal, shëndetin, kufirin dhe sigurinë.

3. Njoftimet e duhura duhet të jepen për ndërtimet e ishujve të tillë artificial, instalimet dhe strukturat dhe mjete të përhershme që japin lajmërime për prezencën e tyre duhet të ndërtohen. Çdo strukturë dhe instalim, e cila abandonohet ose nuk përdoret më, duhet të hiqet për të siguruar lundrim të sigurtë, duke marrë në konsideratë çdo standard ndërkombëtar të pranuar në përgjithësi i krijuar respektivisht nga organizata ndërkombëtare kompetente. Heqje të tilla duhet të marrin parasysh peshkimin, mbrojtjen e ambientit detar dhe të drejtat e detyrat e shteteve të tjera. Publikimet përkatëse duhet të bëhen për thellësitë, pozicionin dhe dimensionet e çdo instalimi ose strukture që nuk është hequr krejtësisht.

4. Shteti bregdetar, kur është e nevojshme, mund të krijojë zona sigurie përreth ishujve artificialë, instalimeve dhe strukturave, në të cilat ai mund të marrë masat përkatëse për sigurinë e të dyjave si të lundrimit të sigurtë, ashtu edhe të ishullit artificial, instalimeve dhe strukturave.

5. Gjerësia e zonave të sigurisë do të përcaktohet nga shteti bregdetar, duke marrë në konsideratë standardet ndërkombëtare të zbatueshme. Zona të tilla duhet të projektohen për të siguruar që ato janë lidhur arsyeshëm me natyrën dhe funksionin e ishujve artificial, instalimeve dhe strukturave dhe nuk do të kalojnë distancën e 500 metrave përreth tyre, të matur nga secila pikë e qosheve të jashtme të tyre, me përjashtim, siç autorizohet nga standardet ndërkombetare të pranuara në përgjithësi ose siç rekomandohet nga organizatat ndërkombëtare kompetente. Njoftimet e duhura duhet të jepen për zgjatimet e zonave të sigurisë.

6. Të gjitha anijet duhet të respektojnë këto zona sigurie dhe duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi përsa i përket lundrimit në afërsi të ishujve artificialë, instalimeve dhe strukturave dhe zonave të sigurisë.

7. Ishujt artificial. instalimet dhe strukturat dhe zonat e sigurisë përrreth mund të mos krijohen kur ndikimi mund ti shkaktohet përdorimit të një vije deti të njohur dhe thelbësore për lundrimin

ndërkombëtar.

8. Ishujt artificial, instalimet dhe strukturat nuk posedojnë statusin e ishullit. Ato nuk kanë det territorial të tyre dhe prezenca e tyre nuk ndikon në kufirin e detit territorial, zonës ekonomike ekskluzive dhe shelfit kontinental.

Neni 61
Konservimi i burimeve gjallore

1. Shteti bregdetar do të përcaktojë gjuetinë e lejueshme të burimeve gjallore në zonat e tij ekskluzive ekonomike.

2. Shteti bregdetar, duke marrë parasysh dëshmitë më të mira shkencore të vlefshme, duhet të sigurojë nëpërmjet masave të duhura të menaxhimit dhe konservimit, që mirëmbajtja e burimeve gjallore në zonën ekonomike ekskluzive nuk rrezikohet nga mbishfrytëzimi. Respektivisht shteti bregdetar dhe organizatat ndërkombëtare kompetente, sidoqofshin nënrajonale, rajonale ose globale duhet të bashkëpunojnë për këtë qëllim.

3. Masa të tilla duhet të përgatiten gjithashtu për mirëmbajtjen dhe rivendosjen e popullimit të specieve që rriten në ato nivele, të cilat mund të prodhojnë rezultate bindëse maksimale, siç cilësohen nga faktorët ambientalë dhe ekonomik, duke përfshirë nevojat ekonomike të komunitetit bregdetar të peshkimit dhe kërkesat speciale të vendeve në zhvillim dhe duke marrë në konsideratë hapësirat e peshkimit, ndërvartësinë e rezervave dhe çdo standard minimal të rekomanduar në përgjithësi, sidoqoftë nënrajonal, rajonal ose global.

4. Në marrjen e masave të tilla shteti bregdetar do të marrë në konsideratë ndikimin mbi speciet të shoqëruara ose të varura me specie të mbjella me qëllimin e mirëmbajtjes dhe rivendosjes së popullimit të specieve të tilla shoqëruese ose të varura mbi nivelet në të cilat riprodhimi i tyre mund të bëhet seriozisht kërcënues.

5. Informacioni shkencor i vlefshëm, përpjekjet statistikore për gjuetinë dhe peshkimin dhe të dhëna të tjera përkatëse për konservimin e rezervave të peshkut do të kontribuohen dhe shkëmbehen mbi baza të rregullta nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, sidoqofshin nënrajonale, rajonale ose globale, kur është e përshtatshme dhe me pjesëmarrjen e të gjitha shteteve të interesuara, duke përfshirë dhe shtetet, qytetarët e të cileve janë të lejuar për peshkim në zonat ekskluzive ekonomike.

Neni 62
Përdorimi i burimeve gjallore

1. Shteti bregdetar do të nxisë objektivin për përdorimin optimal të burimeve gjallore në zonat eknomike ekskluzive pa asnjë paragjykim të nenit 61.

2. Shteti bregdetar do të përcaktojë kapacitetin e tij për vjeljen e prodhimit të burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive. Kur shteti bregdetar nuk ka kapacitetin e vjeljes së prodhimit me gjithë kapjen e lejueshme, nëpërmjet marrëveshjeve ose rregullimeve të tjera duke marrë parasysh termat, kushtet, ligjet dhe rregullat referuar në paragrafin 4, ju jep të drejtën shteteve të tjera të hyjnë për supermbledhjen e kapjes së lejueshme, duke patur vëmendje të veçantë në parashikimet e neneve 69 dhe 70, veçanërisht në lidhje me shtetet në zhvillim të përmendura më sipër.

3. Në dhënien e të drejtës për hyrje shteteve të tjera në zonën e tij ekonomike ekskluzive sipas këtij neni, shteti bregdetar duhet të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë, inter-alia, rëndësinë e burimeve gjallore të hapësirës në ekonominë e shteti bregdetar të interesuar dhe të interesave të tjera kombëtare, parashikimet e nenit 69 dhe 70, kërkesat e shteteve në zhvillim në nënrajonet ose rajonet në pjesën e të vjelave të mbiprodhimit dhe nevojave për të minimizuar dislokimin ekonomik në shtete, qytetarët e të cilëve kanë peshkuar zakonisht në zonë ose të cilët kanë bërë përpjekje thelbësore në kërkimin dhe identifikimin e rezervave.

4. Qytetarët e shteteve të tjera që peshkojnë në zona ekskluzive ekonomike duhet të jenë në përputhje me masat e konservimit dhe me termat dhe konditat e tjera, të ligjeve dhe rregullave të shtetit bregdetar. Këto ligje dhe rregulla duhet të jenë në përputhje me këtë Konventë dhe mund të lidhen inter-alia me:

(a) licensimin e peshkatarëve, anijeve dhe pajisjeve të peshkimit, duke përfshirë pagesat e

taksave dhe formave të tjera te pagesave, të cilat në rastin e shteteve bregdetare në zhvillim mund të konsistojnë në kompesimin e përshtatshëm në fushën financiare të pajisjeve dhe teknologjive përsa i përket industrisë së peshkimit;

(b) përcaktimin e specieve, të cilat mund të peshkohen dhe fiksimit të kuotave të peshkimit, sidoqoftë për rezerva të veçanta ose grup rezervash ose të gjuetisë për anije për një periudhë kohe ose për gjuetinë nga qytetarët e çdo shteti gjatë një periudhe specifike;

(c) rregullimin e stinëve dhe zonave të peshkimit, tipit, madhësisë e shumës së rrjetave, tipeve, madhësisë dhe numrit të anijeve të peshkimit që mund të përdoren;

(d) fiksimim e moshës dhe madhësisë së peshkut dhe specieve të tjera që mund të peshkohen;

(e) specifikimin e informacioneve që kërkohen nga anijet e peshkimit, duke përfshirë statistikat e peshkimit dhe përpjekjeve dhe raportit të pozicionit të anijeve;

(f) kërkimin, sipas autorizimeve dhe kontrollit të shtetit bregdetar, drejtimin e programeve të kërkimeve të peshkimit specifik dhe rregullimin e drejtimit të kërkimeve të tilla, duke përfshirë dhe marrjen e mostrave të gjuetisë, paraqitjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave shkencore të rezultuara;

(g) vendosjen e vrojtuesve ose trajnuesve në bordin e anijeve të tilla nga shteti bregdetar;

(h) zbarkimin e të gjithë ose një pjese të gjuetisë nga anije të tilla në portet e shtetit bregdetar;

(i) termat dhe kushtet në lidhje me kompanitë e përbashkëta ose marrëveshjeve të tjera të kooperimit;

(j) kërkesat për trajnim të personelit dhe transferimit të teknologjisë së peshkimit, duke përfshirë zmadhimin e aftësisë së shtetit bregdetar për ndërmarrjen e kërkimeve të peshkimit;

(k) procedurat e përdorimit të forcës.

5. Shtetet bregdetare do t'i japin njoftimet e duhura të ligjeve dhe rregullave të konservimit dhe menaxhimit.

Neni 63

Rezervat që ndodhen brenda zonave ekonomike ekskluzive të dy ose më shumë shteteve ose edhe brenda zonës ekonomike ekskluzive dhe një hapësire përtej dhe pranë saj

1. Kur e njëjta rezervë ose rezerva të specieve të përbashkëta ndodhen në një zonë ekonomike ekskluzive të nje ose më shumë shteteve, këto shtete duhet të përpiqen ose direkt, ose nëpermjet organizatave përkatëse nënrajonale ose rajonale, të bien dakord për marrjen e masave të nevojshme të koordinimit dhe të parashikimeve të kësaj pjese.

2. Kur e njejta rezervë ose rezerva të specieve të përbashkëta ndodhen edhe brenda zonës ekonomike ekskluzive dhe në një sipërfaqe përtej dhe pranë zonës, shteti bregdetar dhe shtetet që gjuajnë për rezerva të tilla në hapësirat pranë, duhet të kërkojnë ose direkt, ose nëpërmjet organizatave respektive nënrajonale ose rajonale, të bien dakord mbi masat e nevojshme për konservimin e këtyre rezervave në hapësirën pranë.

Neni 64

Speciet me emigrim të lartë

1. Shteti bregdetar dhe shtetet e tjera, qytetarët e të cilëve peshkojnë në rajon për specie me emigrim të lartë të listuara në aneksin I, do të kooperojnë direkt ose nëpërmjet organizatave përkatëse ndërkombëtare me qëllimin e sigurimit të konservimit dhe nxitjes së objektivit për përdorim optimal të specieve të tilla nëpërmjet rajonit, edhe brenda e përtej zonës ekonomike ekskluzive. Në rajonet për të cilat nuk ekziston një organizatë përkatëse ndërkombëtare, shteti bregdetar dhe shtetet e tjera, qytetarët e të cilëve mbledhin këto specie në rajon do të kooperojnë për të krijuar një organizatë të tillë dhe të marrin pjesë në punimet e saj.

2. Parashikimet e paragrafit 1 zbatohen në plotësim të parashikimeve të tjera të kësaj pjese.

Neni 65

Sisorët detarë

Asgjë në këtë pjesë nuk do të kufizojë të drejtat e shtetit bregdetar ose kompetencat e një

organizate ndërkombëtare, respektivisht, për të ndaluar, kufizuar ose rregulluar shfrytëzimin e sisorëve detarë më strikt sesa parashikohet në këtë pjesë. Shtetet do të kooperojnë me qëllimin e konservimit të sisorëve detarë dhe në rastin e cetaceansve në veçanti, do të punojnë nëpërmjet organizatave ndërkombëtare respektive për konservimin e tyre, menaxhimin dhe studimin.

Neni 66
Rezervat e specieve anadromous

1. Shtetet, në të cilat rezervat anadromous kanë origjinën lumore do të kenë interesimin prioritar dhe përgjegjësinë për rezerva të tilla.

2. Shteti origjinë i rezervave anadromous duhet të sigurojë konservimin e tyre me anën e krijimit të masave rregulluese përkatëse për peshkimin në te gjitha ujërat në drejtim të tokës për kufirin e jashtëm të zonës ekonomike ekskluzive dhe për peshkimin të parashikuar në paragrafin 3 (b). Shtetet origjine, pas konsultimeve që referohen në paragrafet 3 dhe 4 për peshkimin e këtyre rezervave, mund të krijojnë kapjen totale të lejueshme për rezervat që kanë origjinën në lumenjtë e tyre.

3. (a) Peshkimi për rezervat anadromoune duhet të udhëhiqet vetem në ujërat në drejtim të tokës nga kufiri i jashtëm i zonës ekonomike ekskluzive, me përjashtim të rasteve kur ky parashikim do të rezultojë dislokimin ekonomik për një shtet përveçse shtetit të origjinës. Në lidhje me peshkime të tilla përtej kufijve të jashtëm të zonës ekonomike ekskluzive, shtetet e interesuara do të mbajnë konsultime me qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje mbi termat dhe kushtet e një peshkimi të tillë duke i dhënë vëmendjen e duhur kërkesave të konservimit dhe nevojës së shtetit të origjinës në lidhje me këto rezerva.

(b) Shteti i origjinës do të bashkëpunojë në minimizimin e dislokimit ekonomik në peshkimin nga shtetet e tjera të këtyre rezervave, duke marrë në konsideratë gjuajtjen normale dhe llojet e operimit të shteteve të tilla dhe të gjitha hapësirat, në të cilat ndodh një peshkim i tillë.

(c) Shteteve që ju referohet nënparagrafi (b), të cilët marrin pjesë me marrëveshje me shtetin e origjinës në masat për rinovimin e rezervave anadromous, veçanërisht me shpenzime për këtë qëllim, do t'u jepet një konsideratë e veçantë nga shteti i origjinës në mbledhjen e rezervave që e kanë origjinën në lumenjtë e tyre.

(d) Zbatimi i rregullave në lidhje me rezervat anadromous përtej zonave ekonomike ekskluzive do të jetë me marrëveshje nga shteti i origjinës dhe shteteve të tjera të interesuara.

4. Në rastet kur rezervat anadromous emigrojnë në drejtim ose nëpërmjet ujërave në drejtim të tokës të kufirit të jashtëm të zonës ekonomike ekskluzive të shtetit ,përveçse shtetit të origjinës, shtete të tilla do të kooperojnë me shtetin e origjinës përsa i përket konservimit dhe menaxhimit të rezervave të tilla.

5. Shteti i origjinës së rezervave anadromous dhe shtetet e tjera që peshkojnë këto rezerva duhet të bëjnë marrëveshje për zbatimin e parashikimeve të këtij neni kur është e përshtatshme, nëpërmjet organizatave rajonale.

Neni 67
Speciet Catadromous

1. Një shtet bregdetar, në të cilin speciet catadromous kalojnë pjesën më të madhe të ciklit të jetës së tyre, do të kenë përgjegjësinë për menaxhimin e këtyre specieve dhe do të sigurojnë hyrjen dhe daljen e peshqve emigrues.

2. Mbledhja e specieve catadromous do të drejtohet vetëm në ujërat në drejtim të tokës nga kufijtë e jashtëm të zonës ekonomike ekskluzive. Kur drejtohet në zonat ekonomike ekskluzive, mbledhja duhet të jetë subjekt i këtij neni dhe parashikimeve të tjera të kësaj konvente në lidhje me peshkimin në këto zona.

3. Në rastet kur peshqit catadromous emigrojnë nëpërmjet një zone ekonomike ekskluzive të një shteti tjetër, sidoqofshin peshqit e rinj ose në moshë të pjekurisë drejtimi, duke përfshirë dhe mbledhjen e peshqve të tillë do të rregullohet nga marrëveshje ndërmjet shteteve të përmendura në paragrafin 1 dhe shteteve të tjera të interesuara. Marrëveshje të tilla duhet të sigurojnë menaxhimin racional të specieve dhe të marrin në konsideratë përgjegjësitë e shteteve të përmendura në paragrafin

1 për mirëmbajtjen e specieve.

Neni 68
Speciet sedentare

Kjo pjesë nuk zbatohet për speciet sedentare siç përcaktohet në nenin 77 paragrafi 4.

Neni 69
Të drejtat e shteteve me kufij tokësorë

1. Shtetet me kufij tokësor do të kenë të drejtën të marrin pjesë mbi baza të barabarta në shfrytëzimin e një pjese përkatëse të mbiprodhimit të qënieve gjallore të nje zone ekonomike ekskluzive të shtetit bregdetar të të njëjtit nënrajon ose rajon, duke marrë në konsideratë rrethanat përkatëse ekonomike dhe gjeografike të të gjitha shteteve të interesuara dhe në përputhje me parashikimet e këtij neni dhe neneve 61 e 62.

2. Termat dhe modalitetet e pjesëmarrjeve të tilla do të krijohen nga shtetet e interesuara nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale, nënrajonale dhe rajonale duke marrë parasysh inter-alia:

(a) nevojën e shmangies së ndikimeve dëmtuese të komunitetit të peshkimit ose industrisë së peshkimit të shtetit bregdetar;

(b) zmadhimin në të cilin shtete të kufizuara vetëm me tokë, në përputhje me parashikimet e këtij neni, marrin pjesë ose kanë të drejtë të marrin pjesë sipas marrëveshjeve bilaterale, nënrajonale ose rajonale në shfrytëzimin e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive ose shtetet e tjera bregdetare;

(c) zmadhimin në të cilin shtete të kufizuara vetëm me tokë dhe shtete me disavantazh gjeografik marrin pjesë në shfrytëzimin e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shtetit bregdetar, si dhe nevojat e vazhdueshme për të shmangur ngarkesën për çdo shtet të vetëm bregdetar ose një pjesë të tij;

(d) nevojat për ushqim të popullsive të shteteve respektive.

3. Kur kapaciteti mbledhës i shtetit bregdetar afrohet në një pikë, të cilën e bën atë të aftë të mbledhë të gjithë gjuetinë e lejueshme të burimeve gjallore në zonën e tij ekonomike ekskluzive, shteti bregdetar dhe shtetet e tjera të interesuara do të kooperojnë në krijimin e rregullave të barabarta mbi baza bilaterale, nënrajonale ose rajonale për të lejuar pjesëmarrjen e shteteve në zhvillim të kufizuara vetëm me tokë të të njëjtave nënrajone ose rajone për shfrytëzim të burimeve gjallore, të zonës ekonomike ekskluzive të shteteve bregdetare të nënrajonit ose rajonit, siç mund të jetë e përshtatshme nga rrethanat dhe termat për të kënaqur të gjitha palët. Në zbatimin e këtij parashikimi faktorët e përmendur në paragrafin 2 do të merren gjithashtu në konsideratë.

4. Shtetet e zhvilluara të kufizuara vetëm me tokë, sipas parashikimeve të këtij neni, do të kenë të drejtën të marrin pjesë në shfrytëzimin e burimeve gjallore vetëm në zonat ekonomike ekskluzive të shteteve bregdetare të të njejtit nënrajon ose rajon, duke patur parasysh zgjerimin e shtetit bregdetar për të cilin ai i jep të drejtën shteteve të tjera për burimet gjallore të zonës së tij ekonomike ekskluzive, duke marrë në konsideratë nevojën e minimizimit të ndikimeve dëmtuese në komunitetin e peshkimit dhe dislokimin ekonomik në shtetet, qytetarët e të cilëve kanë peshkuar zakonisht në zonë.

5. Parashikimet e mësipërme nuk paragjykojnë rregullimet e rëna dakord në nënrajonet ose rajonet ku shtetet bregdetare mund të garantojnë shtetet e kufizuara vetëm me kufij tokësor të të njëjtave nënrajone ose rajone të drejta të njejta ose preferenciale për shfrytëzimin e burimeve gjallore në zonën ekonomike ekskluzive.

Neni 70
Të drejtat e shteteve me disavantazh gjeografik

1. Shtetet me disavantazh gjeografik do të kenë të drejtën të marrin pjesë në baza të barabarta në shfrytëzimin e pjesëve të barabarta mbi mbledhjen e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shteteve bregdetare të të njëjtit nënrajon ose rajon, duke marrë në konsideratë rrethanat përkatëse ekonomike dhe gjeografike të të gjitha shteteve të interesuara në përputhje me parashikimet

e këtij neni dhe të neneve 61 e 62.

2. Për qëllimet e kësaj pjese "shtete me disavantazh gjeografik", do të nënkuptojmë shtetet bregdetare që kufizojnë detëra të mbyllura ose gjysëm të mbyllura, situata gjeografike e të cileve varet nga shfrytëzimi i burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shteteve të tjera në nënrajon ose rajon për furnizimin e duhur të peshqve, për qëllime të ushqimit të popullsive së tyre ose një pjese të kësaj dhe shteteve bregdetare, të cilat nuk mund të reklamojnë asnjë zonë ekonomike ekskluzive për llogari të tyre.

3. Termat dhe modalitetet e një pjesëmarrje të tillë do të krijohen nga shtetet e interesuara nëpërmjet marrëveshjeve, bilaterale, nënrajonale ose rajonale duke marrë në konsideratë inter-alia:

(a) nevojat për të shmangur efektin dëmtues të unitetit të peshkimit ose industrisë së peshkimit të shtetit bregdetar;

(b) shtrirjen në të cilën shtetet me disavantazh gjeografik, në përputhje me parashikimet e këtij neni, janë duke marrë pjesë ose kanë të drejta të marrin pjesë sipas marrëveshjeve ekzistuese bilaterale, nënrajonale ose rajonale në shfrytëzimin e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shteteve të tjera bregdetare;

(c) shtrirjen në të cilën shtetet me disavantazh gjeografik dhe shtetet e kufizuara vetëm me kufij tokësor marrin pjesë në shfrytëzimin e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shtetit bregdetar dhe nevojën e vazhdueshme për të shmangur një pengesë të veçantë për çdo shtet bregdetar të vetëm ose një pjesë te tij;

(d) nevojat për ushqim të popullsisë së shteteve respektive.

4. Kur kapaciteti mbledhës i shtetit bregdetar i afrohet një pike që e lejon atë të mbledhë gjuetinë e lejueshme komplet të burimeve gjallore në zonën ekonomike ekskluzive, shteti bregdetar dhe shtetet e tjera të interesuara do të bashkëpunojnë në krijimin e marrëveshjeve të barabarta mbi baza, bilaterale, nënrajonale ose rajonale për të lejuar pjesëmarrjen nga shtetet në zhvillim me disavantazh gjeografik të të njëjtit nënrajon ose rajon në shfrytëzimin e burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive të shteteve bregdetare të nënrajonit ose rajonit, siç mund te jetë e pershtatshme mbi termat dhe rrethanat që kënaqin të gjitha palët. Në zbatimin e këtij parashikimi, faktorët e përmendur në paragrafin 3 do të merren gjithashtu në konsideratë.

5. Shtetet e zhvilluara me disavantash gjeografik, sipas parashikimeve të këtij neni kanë të drejta të marrin pjesë në shfrytëzimin e burimeve gjallore vetëm në zonat ekonomike ekskluzive të shteteve të zhvilluara bregdetare të të njëjtit nënrajon ose rajon duke pasur parasysh që gjatë zgjerimit nga shteti bregdetar në dhënien e lejes shteteve të tjera për burimet gjallore të zonës së tij ekskluzive ekonomike, është marrë parasysh nevoja për minimizimin e ndikimeve dëmtuese kundrejt komunitetit peshkatar dhe dislokimin ekonomik në shtetet, qytetarët e të cilëve kanë peshkuar zakonisht në zonë.

6. Parashikimet e mësipërme janë pa paragjykim të rregullave të rëna dakord në nënrajonet ose rajonet, ku shtetet bregdetare të të njëjtit nënrajon ose rajon, ose të drejtave preferenciale për shfrytëzimin e burimeve gjallore në zonën ekonomike ekskluzive.

Neni 71

Mozbatimi i nenit 69 dhe 70

Parashikimet e nenit 69 dhe 70 nuk zbatohen në rastet e një shteti bregdetar, ekonomia e të cilit është komplet e varur nga shfrytëzimi i burimeve gjallore të zonës ekonomike ekskluzive.

Neni 72

Kufizimet në transferimin e të drejtave

1. Të drejta e parashikuara në nenet 69 dhe 70 për shfrytëzimin e burimeve gjallore nuk do të transferohen direkt ose indirekt tek shtete të treta ose tek qytetarët e tyre me qira ose licensë, duke krijuar kompani të përbashkëta ose çdo mënyre tjetër, e cila ka efektin e një transferimi të tillë, përveçse kur është rënë dakord ndryshe nga shtetet e interesuara.

2. Parashikimi i mësipërm nuk parandalon shtetet e interesuar për teknologji dhe ndihmë financiare nga shtete të tjera ose organizatat ndërkombëtare, me qëllim të lehtësimit të ushtrimit të të drejtave të neneve 69 dhe 70, me kusht që ajo nuk ka ndikimin e referuar në paragrafin 1.

Neni 73

Kontrolli i legjislacionit dhe rregullave nga shteti bregdetar

1. Shteti bregdetar, në ushtrimin e të drejtave të tij të sovranitetit për shfrytëzim, eksplorim, konservim dhe menaxhim të burimeve gjallore në zonat ekonomike ekskluzive do të marrë masa të tilla, duke përfshirë edhe hipjen në anije, inspektimin, arrestimin dhe procedurat gjyqësore, siç mund të jenë të nevojshme për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregullat e adaptuara nga ai në konformitet me këtë Konventë.

2. Anijet e arrestuara dhe ekuipazhet e tyre do të lirohen me shpejtësi pasi të kenë postuar një garanci ose siguri të tjera.

3. Dënimet e shtetit bregdetar për thyerjet e ligjeve dhe rregullave të peshkimit në zonën ekonomike ekskluzive mund të mos përfshijnë burgimin në mungesë të marrëveshjeve, në të kundërt nga shtetet e interesuara ose ndonjë formë tjetër të dënimit fizik.

4. Në rastet e arrestimit ose bllokimit të anijeve të huaja shteti bregdetar, menjëherë do të njoftojë shtetin flamurin e të cilit mban anija, nëpërmjet kanaleve përkatëse për veprimet e marra të çdo dënimi të vendosur.

Neni 74

Kufizimi i zonës ekonomike ekskluzive ndërmjet shteteve me brigje ballë për ballë ose me brigje pranë njëri-tjetrit

1. Caktimi i kufijve të zonës ekonomike ekskluzive ndërmjet shteteve me brigje ballë për ballë ose brigje fqinjë me njëri-tjetrin do të kryhet me marrëveshje mbi bazat e ligjeve ndërkombëtare, siç referohet në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në mënyrë që të arrihen zgjidhje të barabarta.

2. Nëse nuk mund të arrihet nje marrëveshje brenda një periudhe kohe të arsyeshme, shtetet e interesuara do t'i drejtohen procedurave të parashikuara në Pjesën e 15.

3. Në pritje të marrëveshjeve siç parashikohet ne paragrafin 1, shtetet e interesuara nën shpirtin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit do të bëjnë çdo përpjekje në rregullimet e përkohshme të një natyre praktike dhe gjatë kësaj periudhe tranzicioni nuk duhet të keqësojnë ose pengojnë në arritjen e marrëveshjes përfundimtare. Rregullime të tilla do të jenë pa asnjë paragjykim në caktimin e kufijve përfundimtar.

4. Kur është një marrëveshje në fuqi, ndërmjet shteteve të interesuara, çështjet në lidhje me kufizimin e zonës ekonomike ekskluzive, duhet të përcaktohen në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 75

Harta dhe listat e koordinatave gjeografike

1. Në mbështetje të kësaj pjese, kufiri i jashtëm i zonës ekonomike ekskluzive dhe vijat e kufizimit të hequra në përputhje me nenin 74, do të tregohen në harta të një shkalle ose shkallëve të përshtatshme për të përcaktuar pozicionin e tyre. Kur është e përshtatshme, listat e koordinatave gjeografike të pikave me specifikimet e të dhënave gjeodezike, mund të zëvendësojnë vijat e kufirit të jashtëm ose vijat e kufirit.

2. Shteti bregdetar do të bëjë publikime e duhura të hartave të tilla ose të listave të koordinatave gjeografike dhe do të depozitojë një kopje të secilës hartë ose listë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

PJESA VI

SHELFI KONTINENTAL

Neni 76

Përcaktimi i shelfit kontinental

1. Shelfi kontinental i një shteti bregdetar përfshin fundin e detit dhe nënburimet e zonës nënujore që shtrihet përtej detit të tij territorial nëpërmjet një zgjatimi natyral të territorit të tij tokësor

në qoshen e jashtme të kornizës kontinentale ose në një distancë prej 200 milje nga vijat bazë nga të cilat matet gjerësia e detit territorial, kur qoshja e jashtme e kornizës kontinentale nuk shtrihet deri në këtë distancë.

2. Shelfi kontinental i shtetit bregdetar nuk do të kalojë përtej kufijve të parashikuar në paragrafet 4 dhe 6.

3. Korniza kontinentale përfshin zgjatimin e zhytur të masës së tokës të shtetit bregdetar, dhe përbëhet nga fundi i detit dhe rezervat nënujore të shelfit, cekinave dhe pjesëve të ngritura. Kjo nuk përfshin fundin e oqeanit të thellë me greminat dhe rezervat nënujore.

4. (a) Për qëllimet e kësaj Konvente, shteti bregdetar do të krijojë anën e jashtme të kornizës kontinentale kurdoherë që korniza kalon 200 miljet detare nga vijat bazë me të cilat matet gjerësia e detit territorial me ose:

(i) një vijë e hequr në përputhje me paragrafin 7 me refencën e pikave më të dala fikse në secilën nga këto, trashësia e shkëmbinjve sedimentarë është 1 për qind e distancës më të shkurtër nga pika të tilla deri në këmbën e rrafshit kontinental;

(ii) një vijë e hequr në përputhje me paragrafin 7 me refencën e pikave fikse në nje distancë prej 60 milje detare deri në këmbën e rrafshit kontinental.

(b) Në mungesë të fakteve për të kundërtën, këmba e rrafshit kontinental do të përcaktohet si pika e ndryshimit maksimal në shkallëzimin e bazës së saj.

5. Pikat fikse që përfshijnë vijën e kufirit të jashtëm të shelfit kontinental në fundin e detit, të hequr në përputhje me paragrafin 4 (a) (i) dhe (ii) ose nuk do të kalojë 350 milje detare nga vijat bazë me të cilat matet gjerësia e ujërave territoriale ose nuk do të kalojë 100 milje detare nga izobata me thellësi 2500 metra,. e cila është një vijë që lidh thellësitë 2500 m.

6. Pa përmendur parashikimet e paragrafit 5, mbi shkëmbinjtë nënujor, kufiri i jashtëm i shelfit kontinental nuk do t'i kalojë 350 miljet detare nga vijat bazë me të cilat maten ujërat territoriale. Ky paragraf nuk zbatohet për lartësimet nënujore që janë komponente natyrale të kornizës kontinentale, siç është plateja e tij, cekinat, kepet etj.

7. Shteti bregdetar do të heqë kufijt e jashtëm të shelfit të tij kontinental, kur ky shelf shtrihet mbi 200 milje detare nga vija bazë nga e cila matet gjerësia e detit territorial, me vija të drejta që nuk kalojnë 60 milje detare në gjatësi dhe që lidhin pika fikse të përcaktuara nga koordinatat e gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike.

8. Njoftimet mbi kufijtë e shelfit kontinental përtej 200 miljeve nga vijat bazë me të cilat matet gjerësia e detit territorial do t'i paraqitet nga shtetet bregdetare komisionit të kufijve të shelfit kontinental të krijuar sipas aneksit II mbi bazat e përfaqësimit të barabartë gjeografik. Komisioni do të bëjë rekomandimet për shtetet bregdetare mbi çështjet e krijimit të kufijve të jashtëm të shelfit kontinental. Kufijtë e shelfit të krijuar nga shteti bregdetar mbi bazat e këtyre rekomandimeve do të jenë përfundimtare dhe do të bashkëlidhen.

9. Shteti bregdetar do të depozitojë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara hartat dhe informacionet përkatëse, duke përfshirë dhe të dhënat gjeodezike, duke përshkruar vazhdimisht kufijtë e jashtëm të shelfit të tij kontinental. Sekretari i Përgjithshëm do të bëjë publikimet e duhura përsa më siper.

10. Parashikimet e këtij neni nuk paragjykojnë çështjet e kufirit të shelfit kontinental ndërmjet dy shteteve me brigje ballë për ballë ose dy shteteve fqinjë.

Neni 77

Të drejtat e shtetit bregdetar mbi shelfin kontinental

1. Shteti bregdetar ushtron mbi shelfin kontinental të drejtat e sovranitetit për qëllimet e eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore të tij.

2. Të drejtat e referuara në paragrafin 1 janë ekskluzive në sensin që nëse shteti bregdetar nuk eksploron shelfin kontinental ose shfrytëzon burimet natyrore të tij, asnjë nuk mund të ndërmarrë këto aktivitete pa konsensusin e shprehur të shtetit bregdetar.

3. Të drejtat e shtetit bregdetar mbi shelfin kontinental nuk varen nga pushtimi efektiv ose me nocione, ose nga çdo proklamim i shprehur.

4. Burimet natyrale të referuara në këtë pjesë konsistojnë në mineralet, dhe burimet e tjera jogjallore të fundit të detit dhe nënujit, së bashku me organizmat e gjalla që i përkasin specieve

sedentare, që do të thotë, organizmave të cilat, në kohën e të mbledhurit,ose janë të palëvizshme, ose poshtë fundit të detit, ose janë të pamundura të lëvizin në kontakte fizike konstante me fundin e detit ose nënujin.

Neni 78

Statusi ligjor i ujërave dhe hapësirës ajrore fqinje dhe të drejtat dhe liritë e shteteve të tjera

1. Të drejtat e shtetit bregdetar mbi shelfin kontinental nuk ndikojnë në statusin ligjor të ujërave dhe hapësirës ajrore fqinje mbi këto ujëra.

2. Ushtrimi i të drejtave të shtetit bregdetar mbi shelfin kontinental nuk duhet të thyejë ose rezultojë në një ndërhyrje të pajustifikueshme për lundrimin dhe të drejta të tjera dhe liritë e shteteve të tjera ,siç parashikohet në këtë Konventë.

Neni 79

Kabllot nënujore dhe tubacionet në shelfin kontinental

1. Të gjitha shtetet kanë drejtë të shtrijnë kabllo nënujore dhe tubacione në shelfin kontinental, në përputhje me parashikimet e këtij neni.

2. Mbi bazën e të drejtave të tij për marrjen e masave të arsyeshme për eksplorimin e shelfit kontinental, shfrytëzimin e burimeve të tij natyrore dhe parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes nga tubacionet, shteti bregdetar mund të mos pengojë shtrirjen ose mirëmbajtjen e kablove ose tubacioneve të tilla.

3. Heqja e kurseve për shtrirjen e tubacioneve të tilla në shelfin kontinental është subjekt i pranimit nga shteti bregdetar.

4. Asgjë në këtë pjesë nuk do të ndikojë në të drejtën e shtetit bregdetar të krijojë kushte për kabllo ose tubacione që hyjnë në territoret ose detin e tij territorial ose në juridiksionin e tij mbi kabllot ose tubacionet e konstruktuara ose përdorura në lidhje me shfrytëzimin e shelfit të tij kontinental ose shfrytëzimin e burimeve të tij, ose operimin e ishujve artificialë, instalimeve dhe strukturave nën juridiksionin e tij.

5. Kur shtrohen kabllo dhe tubacione nënujore, shtetet do të kenë vëmendjen e duhur për kabllot dhe tubacionet që janë në pozicion. Në veçanti, mundësitë e riparimit të kabllove ose tubacioneve ekzistuese nuk do të paragjykohen.

Neni 80

Ishujt artificial, instalimet dhe strukturat në shelfin kontinental

Neni 60 zbatohet mutatis-mutandis për ishujt artificial, instalimet dhe strukturat mbi shelfin kontinental.

Neni 81

Shpimi në shelfin kontinental

Shteti bregdetar do të ketë të drejtën ekskluzive të autorizojë dhe rregullojë shpimet në shelfin kontinental për të gjitha qëllimet.

Neni 82

Pagesat dhe kontributet në lidhje me shfrytëzimin e shelfit kontinental përtej 200 miljeve

1. Shteti bregdetar do të kryejë pagesa ose kontribute në lidhje me shfrytëzimin e burimeve jogjallore të shelfit kontinental përtej 200 miljeve detare nga vijat bazë nga të cilat matet gjerësia e detit territorial.

2. Pagesat dhe kontributet do të bëhen vjetore në lidhje me të gjithë prodhimin hapësirës pas pesë vjetëve të para të prodhimit në këtë pjesë. Për 6 vjetë tarifa e pagesës ose kontributit do të jetë 1 për qind e vlerës së volumit të prodhimit në këtë pjesë. Tarifa do të rritet 1 për qind për çdo vit në vazhdim deri në 12 vjet dhe do të mbetet pas kësaj 7 për qind. Prodhimi nuk përfshin burimet e

përdorura në lidhje me shfrytëzimin.

3. Një shtet në zhvillim, i cili është një importues neto të një burimi mineral të prodhuar në shelfin e tij kontinental, është i përjashtuar nga bërja e një pagese të tillë ose kontributi në lidhje me këtë burim minerali.

4. Pagesat dhe kontributet do të bëhen nëpërmjet Autoritetit, i cili ia shpërndan ato Shteteve Palë të kësaj Konvente, mbi bazat e kritereve të pjesëve të barabarta, duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e shteteve në zhvillim, në mënyrë të veçantë shteteve më pak të zhvilluara dhe shteteve të kufizuara vetëm me tokë ndërmjet tyre.

Neni 83

Kufizimi i shelfit kontinental ndërmjet shteteve me bregdet ballë për ballë ose shteteve fqinjë

1. Kufiri i shelfit kontinental ndërmjet shteteve me bregdet ballë për ballë ose fqinjë realizohet me marrëveshje mbi bazat e ligjit ndërkombëtar, siç referohet në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje të barabartë.

2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje brenda një periudhe të arsyeshme kohe, shtetet e interesuara do t'i drejtohen procedurave të parashikuara në Pjesën e 15.

3. Duke pritur marrëveshjet siç parashikohet në paragrafin 1, shtetet e interesuara mbi bazën e dëshirës për kooperim dhe mirëkuptim, do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të bërë rregulla të përkohshme të natyrës praktike dhe gjatë kësaj periudhe tranzicioni, nuk do të pengojnë ose dëmtojnë arritjen e marrëveshjes përfundimtare. Rregulla të tilla do të jenë pa asnjë paragjykim në përcaktimin e kufirit përfundimtar.

4. Kur ekziston një marrëveshje në fuqi ndërmjet shteteve të interesuar, çështjet që kanë lidhje me kufirin e shelfit kontinental do të përcaktohen në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshjeje.

Neni 84

Hartat dhe listat e koordinatave gjeografike

1. Mbi bazën e kësaj pjese, vijat e kufirit të jashtëm të shelfit kontinental dhe vijat e kufirit të hequra në përputhje me nenin 83, do të tregohen në harta të shkallëve të përshtatshme për përcaktimin e pozicionit të tyre. Kur shihet e dobishme, listat e koordinatave gjeografike të pikave që specifikojne të dhënat gjeodezike mund të zëvendësohen për vijat e kufirit të jashtëm ose vijat e kufirit.

2. Shteti bregdetar do të bëjë publikimet e duhura të hartave ose listave të tilla të koordinatave gjeografike dhe do t'i depozitojë një kopje të secilës hartë të tillë ose listë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe në këto raste, duke treguar vijat e kufirit të jashtëm të shelfit kontinental, nga autoriteti i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 85

Tunelet

Kjo pjesë nuk paragjykon të drejtën e shtetit bregdetar të shfrytëzojë nënujin me mjete të tunelizimit, përkatësisht në thellësitë e ujit mbi nëntokën.

PJESA E VII
DETI I HAPUR
SEKSIONI 1
PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 86

Zbatimi i parashikimeve të kësaj pjese

Parashikimet e kësaj pjese zbatohen në të gjitha pjesët e detërave që nuk janë përfshirë në zonën ekonomike ekskluzive në detin territorial ose në ujërat e brendshme të një shteti, ose në ujërat arqipelage të të njëjtit arqipelag. Ky nen nuk përfshin ndonjë thyerje të lirive që gëzojnë shtetet në zonat ekonomike ekskluzive në përputhje me nenin 58.

Neni 87
Liria në detin e hapur

1. Detërat e hapur janë të hapur për të gjitha shtetet, pavarësisht se janë bregdetar ose të kufizuar vetëm me tokë. Liria në detërat e hapur ushtrohet sipas kushteve të paraqitura nga kjo Konventë dhe nga rregulla të tjera të ligjit ndërkombëtar. Ajo përfshin inter-alia, si për shtetet bregdetare,ashtu dhe për shtetet që kufizohen vetëm me tokë:

(a) lirinë e lundrimit;

(b) lirinë e fluturimit;

(c) liria e shtrimit të kabllve dhe tubacioneve nënujore mbi bazën e Pjesës së VI;

(d) lirinë per të konsruktuar ishuj artificial dhe instalime të tjera të lejuara nga ligji ndërkombëtar mbi bazën e Pjesës së VI;

(e) lirinë e peshkimit mbi bazën e kushteve të paraqitura në seksionin 2;

(f) lirinë e këkimeve shkencore, mbi bazën e pjesës së VI dhe 13.

(2) Këto liri do të ushtrohen nga të gjithashtetet duke pasr parasysh interesat e shteteve të tjera në ushtrimin e lirisë së tyre të detit tëhapur dhe gjithashtu duke patur parasysh të drejtat sipas kësaj Konvente në lidhje me veprimtaritë në këtë hapësirë

Neni 88
Rezervimi i detërave të hapur për qëllime paqësore

Detrat e hapur do të rezervohen për qëllime paqësore.

Neni 89
Pavlefshmëria e reklamimeve të sovranitetit mbi detëat e hapur

Asnjë shtet nuk mund të reklamojë vendosjen në çdo pjesë të detit të hapur sovranitetin e tij.

Neni 90
E drejta e lundrimit

Çdo shtet, pavarësisht se është bregdetar ose i kufizuar vetëm me kufij tokësor, ka të drejtën e lundrimit me anijet që mbajnë flamurin e tij në detin e hapur.

Neni 91
Kombësia e anijeve

1. Çdo shtet do të fiksojë kushtet për garantimin e kombësisë ndaj anijeve për regjistrimin e anijeve në territorin e tij dhe për të drejtën e ngritjes së flamurit të tij. Anijet kanë kombësinë e shtetit, flamurin e të cilit kanë të drejtë të mbajnë. Gjithmonë duhet të ketë një lidhje ndërmjet shtetit dhe anijes.

2. Çdo shtet do t'i lëshojë anijeve, të cilave u ka garantuar të drejtën e ngritjes së flamurit, dokumentin e flamurit për këtë çështje.

Neni 92
Statusi i anijeve

1. Anijet do të lundrojnë nën flamurin e një shteti vetëm, përveç në raste të jashtëzakonshme të parashikuara me shkrim në traktatet ndërkombëtare ose në këtë Konventë, do të jenë subjekt i jurdiksionit ekzkluziv të tyre në detërat e hapur. Një anije mund të mos ndryshojë flamurin e saj gjatë një lundrimi ose kur është në një port, përveç në rastet e një transferimi real të pronësisë ose të ndryshimit të regjistrit.

2. Një anije, e cila lundron sipas flamurit të dy ose më shumë shteteve, duke përdorur atë të konveniencës, mund të mos reklamojë asnjë nga kombësitë, në lidhje me shtetet e tjera dhe mund të

pranohet si një anije pa kombësi.

Neni 93

Anijet që mbajnë flamurin e Kombeve të Bashkuara, të agjencive të specializuara të saj dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike

Nenet e mësipërme nuk paragjykojnë çështjet e anijeve që punojnë per shërbime zyrtare të Kombeve të Bashkuara, agjencive të specializuara të tyre ose Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, që mbajnë flamurin e kësaj organizate.

Neni 94

Detyrat e flamurit të shtetit

1. Çdo shtet, do të ushtrojë me efektivitet juridiksionin e tij dhe kontrollin për çështje sociale, teknike dhe administrative mbi anijet që mbajnë flamurin e tij.

2.Në veçanti çdo shtet do të:

(a) mbajë një regjistër të anijeve që përmban emrat dhe të dhënat e anijeve që mbajnë flamurin e tij, me përjashtim të atyre të përjashtuara nga rregullat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi për a i përket madhësisë së vogël të tyre;

(b) marrë juridiksionin sipas ligjeve të brendshme të tij mbi çdo anije që mban flamurin e tij, mbi kapitenin, oficerat dhe ekuipazhin në lidhje me çështjet sociale, teknike dhe administrative që kanë lidhje me anijen.

3. Çdo shtet do të marrë masa të tilla për anijet që mbajnë flamurin e tij, të cilat janë të nevojshme për sigurinë ne det, duke adaptuar para së gjithash inter-alia masa për:

(a) konstruksionin, pajisjet dhe lundrueshmërinë e anijes;

(b) ekuipazhimin e anijes, kushtet e punës dhe trajnimin e ekuipazhit, duke marrë parasysh instrumentat ndërkombëtare në zbatim;

(c) përdorimin e sinjaleve, mirëmbajtjen e komunikimit dhe parandalimit të përplasjeve.

4. Masa të tilla do të përfshijnë ato të nevojshme për sigurimin:

(a) që çdo anije, përpara regjistrimit dhe si rrjedhim më vonë në intervale kohe përkatëse, është kontrolluar nga një kontrollor anijesh i kualifikuar dhe ka në bord harta të tilla, publikime lundrimi dhe pajisje lundrimi e instrumenta, të cilat janë të nevojshme për lundrimin e sigurtë të anijes;

(b) që secila anije ka në drejtim një kapiten, oficerat, të cilët mbajnë një certifikatë të vlefshme, në mënyrë të veçantë në praktikën detare, lundrimin, komunikimin dhe inxhinierinë navale dhe që ekuipazhi është i mjaftueshëm në kualifikim dhe numër për tipin, madhësinë makinerinë dhe pajisjet e anijes;

(c) që kapiteni, oficerat dhe më tej respektivisht ekuipazhi është kompatibël dhe rregullat ndërkombëtare që kërkohen për vrojtim lidhur me sigurinë e jetës në det, parandalimin e përplasjeve, parandalimin, kufizimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit dhe mirëmbajtjen e komunikimit me radio.

5. Në marrjen e masave të kërkuara nga paragrafet 3 dhe 4 çdo shteti i kërkohet të veprojë konform rregullave ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi, procedurave dhe praktikave dhe të marrë të gjitha masat, të cilat mund të jenë të nevojshme për sigurimin e vrojtimit.

6. Një shtet, i cili ka arsye të qarta për të besuar, që juridiksioni dhe kontrolli i duhur në lidhje me një anije nuk është ushtruar, mund t'i raportojë faktet shtetit, flamurin e të cilit mban anija. Me marrjen e një raporti të tillë shteti, flamurin e të cilit mban anija, do të investigojë çështjet dhe nëse është e përshtatshme, do të marrë çdo veprim të nevojshëm që të rregullojë situatën.

7. Çdo shtet do të kërkojë mbajtjen e një seance përpara një personi ose personave të kualifikuar në mënyrë të kenaqshme në çdo avari detare ose incident të lundrimit në detin e hapur që përfshin një anije, që mban flamurin e një shteti dhe që shkakton humbjen e jetës ose plagosjes serioze të një qytetari të një shteti tjetër ose dëme serioze ndaj anijeve ose instalimeve të një shteti tjetër ose ambientit detar. Shteti i flamurit dhe shteti tjetër do të bashkëpunojnë në udhëheqjen e çdo hetimi të mbajtur nga ky shtet tjetër për çdo avari detare të tillë ose incident të lundrimit.

Neni 95

Imuniteti i anijeve luftarake në detërat e hapur

Anijet e luftës në detërat e hapur kanë imunitet të plotë nga juridiksioni i çdo shteti, përveç shtetit flamurin e të cilit mban.

Neni 96

Imuniteti i anijeve të përdorura vetëm për shërbime jotregtare qeveritare

Anijet që janë pronë ose operohen nga një shtet dhe që përdoren vetëm për qëllime qeveritare jotregtare, në detërat e hapur, do të kenë imunitet të plotë nga juridiksioni i çdo shteti, përveç shtetit flamurin e të cilit mban.

Neni 97

Juridiksioni penal në çështjet e përplasjeve ose çdo incident tjetër gjatë lundrimit

1. Në rast të përplasjeve ose ndonjë incidenti tjetër gjatë lundrimit në lidhje me një anije në detërat e hapur dhe që përfshin me përgjegjësi juridike ose disiplinore kapitenin ose persona të tjerë me shërbim në anije, mund të mos ngrihen as procedura penale dhe as disiplinore kundrejt personave të tillë, me përjashtim të autoriteteve gjyqësore dhe administrative ose të shtetit flamurin e të cilit mban anija, ose të shtetit ku një person i tillë është qytetar.

2. Në çështjet disiplinore, shteti i cili ka lëshuar një certifikatë kapitenit ose një certifikatë aftësie ose licensë do të jetë vetë kompetent, pas një procesi gjyqësor, që të shpallë heqjen e certifikatave të tilla, edhe kur mbajtësi nuk është qytetar i shtetit, i cili ka lëshuar certifikatën.

3. Asnjë arrestim ose bllokim i anijes nuk do të urdhërohet nga çdo autoritet, përveç atyre të shtetit flamurin e të cilit mban anija.

Neni 98

Detyra për të dhënë ndihmë

1. Çdo shtet do t'i kërkojë kapitenit të anijes flamurin e të cilit mban, përderisa nuk paraqet rrezik për anijen, ekuipazhin dhe pasagjerët:

a) që të japë ndihmë çdo personi të gjetur në det në rrezik ose që ka humbur;

b) të vazhdojë lundrimin me të gjithë shpejtësinë e mundshme në drejtim të personave në rrezik, nëse informohet që ka nevojën e tyre për ndihmë, përderisa një veprim i tillë pritet nga ai;

c) pas një përplasje, të japë ndihmën anijes tjetër, ekuipazhit të saj dhe pasagjerëve dhe nëse është e mundur, të informojë anijet e tjera për emrin e anijes së tij, portin e regjistrimit dhe portin më të afërt që do të shkojë.

2. Secili shtet bregdetar do të nxisë krijimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një shërbimi të përshtatshëm dhe efektiv të kërkim shpëtimit në lidhje me sigurinë në det dhe kur rrethanat e kërkojnë, me anën e rregullimeve miqësore rajonale, kooperimin me shtetet fqinjë për këtë qëllim.

Neni 99

Ndalimi i transportimit të skllevërve

Secili shtet do të marrë masat efektive për parandalimin dhe dënimin e transportit të skllevërve me anijet e autorizuara që përdorin flamurin e tij dhe të parandalojë përdorimin e paligjshëm të flamurit të tij për këtë qëllim. Çdo skllav që gjendet në bordin e anijes pavarësisht nga flamuri, ipso fakto do të lirohet.

Neni 100

Detyra për kooperim për shtypjen e piraterisë

Të gjitha shtetet do të kooperojnë në masën maksimale të mundshme për shtypjen e piraterisë

në detërat e hapur ose në çdo vend tjetër jashtë juridiksionit të çdo shteti.

Neni 101
Përcaktimi i termit të piraterisë

Pirateri do të përbëjë çdo akt i mëposhtëm:

a) Çdo akt ilegal i forcës ose bllokimit ose çdo akt i vjedhjes, i kryer për qëllime private nga ekuipazhi ose pasagjerët e një anije private ose hidroplani privat dhe i drejtuar:

(i) në detërat e hapur, kundër një anijeje ose hidroplani tjetër ose kundër personave dhe pronës në bordin e anijeve dhe hidroplanëve të tillë;

(ii)kundër një anijeje, hidroplani, personave ose pronës në një vend jashtë juridiksionit të çdo shteti.

b)Çdo akt i pjesëmarrjes me vullnet në një operacion të një anije ose një hidroplani me dijeninë të fakteve që e bëjnë atë anije pirate ose hidroplan pirat.

c) Çdo akt i nxitjes ose i lehtësimit me ndërgjegje të një akti që përshkruhet në nënparagrafin (a) dhe (b).

Neni 102
Pirateria me një anije luftarake, qeveritare ose hidroplan qeveritar ekuipazhi i të cilës ka rebelim

Aktet e piraterisë, siç përshkruhen në nenin 101, të kryera nga një anije lufte, qeveritare ose hidroplan qeveritar ekuipazhi i të cilës ka rebeluar dhe ka marrë anijen ose hidroplanin nën kontroll, futen tek aktet e kryera nga një anije ose hidroplan privat.

Neni 103
Definicioni i anijeve ose hidroplaneve pirate

Një anije ose hidroplan konsiderohet si anije ose hidroplan pirat, në qoftë se mendohet që nga personat nën kontroll të saj të përdoret për qëllime të kryerjes së një nga aktet e referuara në nenin 101. E njëjta zbatohet në qoftë se anija ose hidroplani është përdorur për kryerjen e çdo akti të tillë për aq gjatë, sa të mbetet nën kontrollin e personave fajtor për këtë akt.

Neni 104
Bllokimi ose humbja e kombësisë së një anije ose hidroplani pirat

Një anije mund t'i bllokohet kombësia e saj, megjithëse ajo është bërë anije ose hidroplan pirat. Bllokimi ose humbja e kombësisë përcaktohen nga ligji i shtetit nga i cili ka rrjedhur kjo kombësi.

Neni 105
Arrestimi i një anijeje ose hidroplani pirat

Në detrat e hapur ose në çdo vend tjetër jashtë juridiksionit të çdo shteti, secili shtet mund të arrestojë një anije ose hidroplan pirat ose një anije dhe hidroplan i marrë nga pirateria dhe nën kontrollin e piratëve dhe të arrestojë personat dhe pronën në bord. Gjykata e shtetit, e cila ndërmerr arrestimin, mund të vendosë mbi gjobitjen dhe gjithashtu mund të vendosë veprimet që do të ndërmerren në lidhje me anijen, hidroplanin ose pronën, mbi bazën e të drejtave të palëve të treta që veprojnë mbi bazat e mirëbesimit.

Neni 106
Përgjegjsia për arrestimin pa faktet e duhura

Kur një arrestim i një anijeje ose hidroplani për dyshime në pirateri është kryer pa fakte të qarta, shteti, i cili bën një arrestim do të jetë përgjegjës përpara shtetit, kombësinë e të cilës zotëron

anija ose hidroplani për çdo humbje ose dëmtim të shkaktuar nga arrestimi.

Neni 107

Anijet dhe hidroplanët, të cilat janë të ngarkuara për të arrestuar për llogari të piraterisë.

Një arrestim për çështje piraterie mund të kryhet vetëm nga anije të luftës ose hidroplane luftarakë, ose anije e hidroplanë të tjerë të shënuar qartë dhe të identifikueshëm se janë në shërbim të qeverisë dhe autorizuar për këtë qëllim.

Neni 108

Trafiku i paligjshëm i drogave narkotike ose substancave psikotropike

1. Të gjitha shtetet do të kooperojnë në shtypjen e trafikut ilegal të drogave narkotike dhe substancave psikotropike të implikuara në anijet, në detërat e hapur në kundërshtim me konventat ndërkombëtare.

2. Çdo shtet, i cili ka fakte të arsuyeshme që të besojë se një anije, e cila mban flamurin e tij, është e implikuar në trafikun e paligjshëm të drogave narkotike ose substancave psikotropike mund të kërkojë bashkëpunimin e shteteve të tjera për të shtypur trafiqe të tilla.

Neni 109

Radioemetimi i paautorizuar nga detërat e hapur

1. Të gjitha shtetet do të bashkëpunojnë në shtypjen e radioemetimit të paautorizuar nga detërat e hapur.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, "radioemetim i paautorizuar" nënkupton transmetimin e sinjaleve të radios ose televizive nga një anije ose instalim në detërat e hapur me qëllim që të merret nga publiku në përgjithësi në kundërshtim me rregullat ndërkombëtare, por duke përjashtuar transmetimin e thirrjeve për rrezik.

3. Çdo person i implikuar në radioemetim të paautorizuar mund të procedohet përpara një gjykate të:

(a) shtetit, flamurin e të cilit mban anija;

(b) shtetit të regjistrimit të instalimit;

(c) shtetit në të cilin personi ka kombësinë;

(d) çdo shteti ku transmetimi mund të merret;

(e) çdo shtet ku radiokomunikimet e autorizuara vuajnë nga interferenca;

4. Mbi detërat e hapur, një shtet që ka juridiksion në përputhje me paragrafin 3 mundet, në përputhje me nenin 110, të arrestojë, çdo person ose anije të implikuar në radioemetim të paautorizuar dhe të bllokojë aparaturat e radioemetimit.

Neni 110

E drejta e vizitës

1. Me përjashtim të rasteve kur aktet e ndërhyrjes rrjedhin nga forca e traktateve, një anije lufte e cila takon në det të hapur një anije të huaj, përveçse një anije, e cila zotëron imunitet të plotë në përputhje me nenet 95 dhe 96, nuk ka justifikim që të kontrollojë atë, përveçse kur ka dëshmi të arsyeshme për të dyshuar se:

(a) anija është e përfshirë në pirateri;

(b) anija është e përfshirë në tregtinë e skllevërve;

(c) anija është e përfshirë në emitime të paautorizuara dhe shteti flamurin e të cilit ka anija luftarake ka juridiksionin sipas nenit 109;

(d) anija është pa kombësi;

(e) megjithëse mban një flamur të huaj ose refuzon ta tregojë flamurin e saj, ajo në realitet është e të njëjtit nacionalitet si dhe anija e luftës.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1, anija luftarake mund të proçedojë për të verifikuar të drejtën e anijes për mbajtjen e flamurit. Për këtë qëllim, ajo mund të dërgojë tek anija në dyshim,

një varkë nën komandën e një oficeri. Nëse dyshimi mbetet edhe pas kontrollimit të dokumentave, ajo mund të procedojë në kontrolle të mëtejshme në bordin e anijes, të cilat duhet të kryhen me të gjithë konsideratën e mundshme.

3. Nëse dyshimi provohet të jetë i pabazuar dhe me kusht që anija që kontrollohet nuk ka shkaktuar ndonjë veprim që ta justifikojë atë, ajo duhet të kompesohet për çdo humbje ose dëmtim që i është shkaktuar asaj.

4. Këto parashikime zbatohen mutatis mutandis edhe për avionët ushtarakë.

5. Këto parashikime zbatohen gjithashtu për çdo anije tjetër të autorizuar ose avion, i cili është i identifikueshëm dhe që shihet qartë që është në shërbim të qeverisë.

Neni 111

E drejta e kontrollit të menjëhershëm

1. Kontrolli i menjëhershëm i një anijeje të huaj mund të ndërmerret kur autoritetet kompetente të shtetit bregdetar kanë arsye të qarta të besojnë se anija ka thyer ligjet dhe rregullat e këtij shteti. Një kontroll i tillë mund të fillojë kur anija e huaj ose një nga barkat e saj është brenda ujërave të brendshme, ujërave të arqipelagut, detit territorial ose zonës së zgjatur të shtetit që kontrollon dhe mund të vazhdohet jashtë detit territorial ose zonës së zgjatur vetëm nëse kontrolli nuk është ndërprerë. Nuk është e nevojshme që në kohën kur anija e huaj është në detin territorial ose në zonën e zgjatur merr urdhrin për të ndaluar anijen që jep urdhërin duhet patjetër të jetë brenda ujërave territoriale ose në zonën e zgjatur. Nëse anija e huaj është brenda zonës së zgjatur, siç përcaktohet në nenin 33, kontrolli mund të ndërmerret vetëm nëse ka patur ndonjë thyerje të të drejtave për mbrojtjen për të cilën zona është krijuar.

2. E drejta e kontrollit të menjëhershëm do të zbatohet mutati mutandis për thyerje në zonat ekskluzive ekonomike ose në zonat e shelfit kontinental, duke përfshirë zonat e sigurisë përreth instalimeve në shelfin kontinental, mbi bazën e ligjeve dhe rregullave të shtetit bregdetar të zbatueshme në përputhje me këtë Konventë për zonat ekonomike ekskluzive ose shelfin kontinental, duke përfshirë zona të tilla sigurie.

3. E drejta e kontrollit të menjëhershëm pushon që në momentin që anija e kontrolluar hyn në detin territorial të shtetit të saj ose të një shteti të tretë.

4. Kontrolli i menjëhershëm nuk do të quhet se ka filluar përderisa anija që do të kontrollojë mendon se me mjetet e praktikueshme, të cilat mund të jenë të vlefshme që anija që kontrollohet ose një nga varkat e saj ose mjete të tjera duke punuar si një ekip, e përdorin anijen që do kontrollohet si një anije mëmë dhe ajo ndodhet brenda kufijve të detit territorial, ose sipas rastit, brenda zonës së zgjatur ose zonës ekonomike ekskluzive ose shelfit kontinental. Kontrolli mund të fillohet vetëm pasi është dhënë një sinjal viziv ose auditiv për të ndaluar në një distancë që është e mjaftueshme për ta dëgjuar ose shikuar sinjalin nga anija e huaj.

5. E drejta e kontrollit të menjëhershëm mund të ushtrohet vetëm nga anije ose aeroplanë luftarake ose anije dhe avionë të tjerë me shënja të qarta dhe të identifikueshme se janë në shërbim qeveritar dhe të autorizuara për këtë qëllim.

6. Kur kontrolli i menjëhershëm kryhet nga një avion:

(a) parashikimet e paragrafit 1 deri në 4 do të zbatohen mutatis mutandis;

(b) avioni që jep urdhër për të ndaluar duhet vetë të kontrollojë aktivisht anijen derisa një anije ose avion tjetër i shtetit bregdetar të shoqëruar nga avionë arrijnë të marrin përsipër kontrollin, përveçse kur avioni është vetë në gjendje që të arrestojë anijen. Nuk është i mjaftueshëm justifikimi për një arrestim jashtë ujërave territoriale, kur anija pothuajse shikohet dobët nga avioni dhe kjo të merret si ofendim ose dyshim për ofendim, derisa as nuk është dhënë urdhër as për të ndaluar dhe as për të kontrolluar nga vetë avioni ose avionë të tjerë ose anije, të cilat vazhdojnë kontrollin pa ndërprerje

7. Lirimi i një anijeje të arrestuar brenda juridiksionit të një shteti dhe çuarja e saj në një port të këtij shteti për qëllime e një hetimi përpara autoriteteve kompetente mund të mos reklamohet vetëm mbi çështjen se anija gjatë rrugës së udhëtimit të saj u shoqëruar në një pjesë të saj nëpërmjet pjesëve të zonës ekonomike ekskluzive ose në detëra të hapur, në rast se rrethanat e bëjnë këtë të nevojshme.

8. Kur një anije është ndaluar ose arrestuar jashtë detit territorial në rrethana të cilat nuk e justifikojnë ushtrimin e të drejtës për kontroll të menjëhershëm, ajo duhet kompesuar për çdo dëm ose

humbje që mund t'i ketë ndodhur si rezultat i sa më sipër.

Neni 112

E drejta e shtrimit të kabllove dhe tubacioneve nënujore

1. Të gjitha shtetet kanë të drejtë të shtrojnë kabllo dhe tubacione nënujore në fundin e detërave të hapur poshtë shelfit kontinental.

2. Neni 79 paragrafi 5 zbatohet për kabllo dhe tubacione të tilla.

Neni 113

Thyerja ose dëmtimi i një kablli ose tubacioni nënujor

Çdo shtet do të adaptojë ligjet dhe rregullat e nevojshme që parashikojnë se thyerja ose dëmtimi nga një anije që mban flamurin e tij ose nga persona subjekt i juridiksionit të tij, të një kablli nënujor poshtë detërave të hapur të bërë me qëllim ose nëpërmjet neglizhencës të dënueshme, në mënyrë të tillë që të bëhet përgjegjës për ndërprerje të komunikimit telefonik ose pengojë telegrafinë dhe në mënyrë të ngjashme për thyerjen e tubacioneve nënujore ose kabllove të tensionit të lartë, që duhet të jetë i dënueshëm me gjobë. Këto parashikime do të zbatohen gjithashtu në mënyrë që të drejtojnë llogaritjet ose për rezultatet në thyerje të tilla ose dëmtime. Megjithatë, këto nuk do të zbatohen për çdo thyerje ose dëmtim të shkaktuar nga persona, të cilët veprojnë kryesisht me objekte të legjitimuara ose që shpëtojnë jetën e tyre ose anijet e tyre, pasi kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të evituar këto thyerje ose dëmtime.

Neni 114

Thyerja ose dëmtimi nga pronarët e një kablli ose tubacioni nënujor të një kablli ose tubacioni nënujor tjetër

Çdo shtet do të adaptojë ligje dhe rregulla të nevojshme për të parashikuar që, nëse personat mbështetur në juridiksionin e tyre, të cilët janë pronarët e kabllove ose tubacioneve në detërat e hapur, gjatë shtrimit ose riparimit të këtyre kabllove ose tubacioneve, shkaktojnë një thyerje ose dëmtim tek një kabëll ose tubacion tjetër, ata do të përballojnë koston e riparimeve.

Neni 115

Zhdëmtimi për humbjet e ndodhura për evitimin e dëmtimit të një kablli ose tubacioni nënujor

Çdo shtet do të adaptojë ligje dhe rregulla të nevojshme për të siguruar që pronarët e anijeve, të cilët provojnë se ata kanë sakrifikuar një spirancë, një rrjetë ose çdo mjet peshkimi, në mënyrë që të shmangin dëmtimin e një kablli ose tubacioni nënujor do të shpërblehen nga pronari i kabllit ose tubacionit nënujor, me kusht që pronarët e anijes të kenë marrë të gjitha masat e arsyeshme parandaluese që përpara.

SEKSIONI 2

KONSERVIMI DHE MANAXHIMI I BURIMEVE GJALLORE NË DETËRAT E HAPUR

Neni 116

E drejta për të peshkuar në detrat e hapur

Të gjitha shtetet kanë të drejtën për qytetarët e tyre të përfshihen në peshkimin në detërat e hapur mbi bazën e:

(a) detyrimeve nga traktatet e tyre;

(b) të drejtave dhe detyrave, si dhe interesave të shteteve bregdetare të parashikuara, inter-alia në nenin 63 paragrafi 2 dhe nenet 64 e 67;

(c) parashikimeve të këtij neni.

Neni 117

Detyrat e shteteve për të adaptuar në lidhje me qytetarët e tyre masat për konservimin e burimeve gjallore të deteve të hapur

Të gjitha shtetet kanë detyrime të marrin masa të tilla për qytetarët e tyre respektivisht, që mund të jenë të nevojshme ose të bashkëpunojnë me shtetet e tjera, për marrjen e masave të tilla për konservimin e burimeve gjallore në detet e hapura.

Neni 118

Bashkëpunimi i shteteve në konservimin dhe menaxhimin e burimeve gjallore

Shtetet do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në konservimin dhe menaxhimin e burimeve gjallore në zonat e detërave të hapur. Shtetet, qytetaret e të cilëve shfrytëzojnë burime gjallore të njëjta ose burime gjallore të ndryshme në të njëjtën zonë, do të hyjnë në negociime me qëllimin e marrjes së masave të nevojshme për konservimin e burimeve gjallore që ju interesojnë. Ato respektivisht do të bashkëpunojnë për të krijuar organizatat e peshkatarëve nënrajonale ose rajonale për këtë qëllim.

Neni 119

Konservimi i burimeve gjallore të deteve të hapura

1. Në përcaktimin e gjuetisë së lejueshme dhe krijimin e masave të tjera për konservimin e burimeve gjallore në detet e hapura shtetet do të:

(a) marrin të gjitha masat, të cilat janë planifikuar, mbi bazat e evidencave shkencore të vlefshme të shteteve të interesuara për mirëmbajtjen ose zëvendësimin e popullimit dhe të specieve që do të kapen në nivele, të cilat mund të sjellin vjelje maksimale të përballueshme, siç cilësohet nga faktorë kryesorë të ambientit dhe ekonomikë, duke përfshirë kërkesat speciale të shteteve në zhvillim dhe duke marrë në konsideratë kuotat e peshkimit, ndërvartësinë e stokut dhe çdo standard ndërkombëtar minimal të rekomanduar në përgjithësi, pavarësisht se është nënrajonal, rajonal ose global.

(b) marrë në konsideratë efektet në speciet që lidhen ose varen nga speciet që do të kapen me qëllimin e mirëmbajtjes ose zëvendësimit të popullimit të specieve të tilla shoqëruese ose që varen mbi nivelet në të cilat riprodhimi i tyre mund të kërcënohet seriozisht.

2. Informacioni i vlefshëm shkencor, përpjekjet statistikore për gjuetinë dhe peshkimin, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për konservimin e stokut të peshqëve do të jenë kontribut ose shkëmbehen mbi baza të rregullta nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare, pavarësisht se janë nënrajonale, rajonale ose globale, kur është e vlefshme dhe me pjesëmarrjen nga të gjitha shtetet e interesuara.

3. Shtetet e interesuara do të sigurojnë që masat e konservimit dhe zbatimi i tyre nuk do të diskriminojë formalisht ose faktikisht peshkatarët e të gjitha shteteve.

Neni 120

Mammalët detarë

Neni 65 do të zbatohet gjithashtu për konservimin dhe menaxhimin e mamalëve detarë në detërat e hapur.

PJESA E VIII

REGJIMI I ISHUJVE

Neni 121

Regjimi i ishujve

1. Një ishull është i një formë natyrale toke i rrethuar me ujë dhe i cili është mbi nivelin e ujit në kohën e zbaticës më të madhe.

2. Me përjashtim siç parashikohet në paragrafin 3, deti territorial, zona e zgjatur, zona

ekonomike ekskluzive dhe shelfi kontinental i një ishulli përcaktohen në përputhje me parashikimet e kësaj konvente të zbatueshëm si dhe për pjesën tjetër të territorit.

3. Shkëmbinjtë, të cilët nuk mund të përballojnë banime njerëzore ose jetë ekonomike në pronat e tyre nuk do të kenë zona ekonomike ekskluzive ose shelf kontinental.

PJESA E IX
DETËRAT E MBYLLUR OSE GJYSËM TË MBYLLUR

Neni 122
Termi

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "det i mbyllur ose gjysëm i mbyllur", nënkupton një gji, basen ose det të rrethuar nga dy ose më shumë shtete dhe që lidhen me detin tjetër ose oqeanin nga një ngushticë ose që konsiston krejtësisht ose parësisht me detërat territoriale dhe zonat ekonomike ekskluzive të dy ose më shumë shteteve bregdetare.

Neni 123
Bashkëpunimi i shteteve që kufizojnë detet e mbyllur ose gjysëm të mbyllur

Shtetet që kufizojnë një det të mbyllur ose gjysëm të mbyllur do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe në zbatimin e detyrave të tyre sipas kësaj Konvente. Për këtë qëllim, ata do të përpiqen direkt ose nëpërmjet një organizate rajonale respektive:

(a) të koordinojnë menaxhimin, konservimin, eksplorimin dhe shfrytëzimin e burimeve gjallore të detit;

(b) të koordinojnë zbatimin e të drejtave dhe detyrave të tyre në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit detar;

(c) të koordinojnë politikat e kërkimeve të tyre shkencore dhe të ndërmarrin kur është e përshtatshme programe të përbashkëta të kërkimeve shkencore në rajon;

(d) të ftojnë kur është e përshtatshme, shtete të tjera të interesuara ose organizata ndërkombëtare për të bashkëpunuar me to në vazhdim të parashikimeve të këtij neni.

PJESA E X
E DREJTA E HYRJES SË SHTETEVE ME KUFIJË VETËM TOKËSOR NGA E PËR NË DET DHE LIRIA E TRANZITIT

Neni 124
Përdorimi i termave

1. Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) termi “shtet i kufizuar vetëm me kufij tokësor”. nënkupton një shtet, i cili nuk ka bregdet;

(b) "shtet tranzit" nënkupton një shtet me ose pa bregdet, i ndodhur ndërmjet një shteti me kufij vetëm tokësor dhe detit, nëpërmjet territorit të të cilit kalon trafiku tranzit;

(c) "trafiku tranzit" nënkupton tranzitin e udhëtarëve, bagazheve, mallrave dhe mjeteve të transportit nëpërmjet territorit të një ose më shumë shteteve, kur kalimi nëpërmjet territoreve të tilla pa ose me transhipment, magazinim, në rifuzxho ose duke ndryshuar llojin e transportit, është vetëm një pjesë e udhëtimit të plotë. i cili fillon ose mbaron brenda territorit të shtetit të kufizuar vetëm me tokë;

(d) "mjet transporti" nënkupton:

i) vagonat hekurudhor, anijet detare, lumore dhe liqenore dhe automjetet rrugore;

ii) kur e kërkojnë kushtet lokale, paketimet e kafshëve dhe trailerat etj.

2. Shtetet e kufizuar vetëm me tokë dhe shtetet tranzit, me marrëveshje ndërmjet tyre mund të përfshijnë përveç atyre të përmendura në paragrafin 1 edhe transportin me tubacione dhe të gazit dhe mjete të tjera transporti.

Neni 125

E drejta e hyrjes nga e për në det dhe liria e tranzitit

1. Shtetet e kufizuar vetëm me kufij tokësor do të kenë të drejtën e hyrjes nga e për në det për qëllime të ushtrimit të të drejtave të parashikuara sipas kësaj Konvente duke përfshirë ato që kanë lidhje me lirinë në detërat e hapur dhe të drejtat e përbashkëta të njerëzimit. Për këtë qëllim, shtetet e kufizuara vetëm me tokë do të gëzojnë lirinë e tranzitimit nëpërmjet territoreve të shteteve tranzit me të gjitha mjetet e transportit.

2. Për kushtet dhe modalitetet në ushtrimin e lirisë së tranzitimit do të bihet dakord ndërmjet shteteve të kufizuar vetëm me tokë dhe shteteve tranzit të interesuar nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale, nënrajonale ose rajonale.

3. Shtetet tranzit, në ushtrimin e sovranitetit të tyre të plotë mbi territorin e tyre do të kenë të drejtën që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që këto të drejta dhe lehtësira të parashikuara në këtë pjesë për shtetet e kufizuara vetëm me tokë, të mos prekin në asnjë mënyrë interesat legjitime të tyre.

Neni 126

Përjashtimi i zbatimit të klauzolës për shtetin më të favorizuar

Parashikimet e kësaj Konvente, si dhe marrëveshjet e veçanta në lidhje me ushtrimin e të drejtave të hyrjes për e nga deti, të cilat krijojnë të drejta dhe lehtësira për llogari të pozicioneve gjeografike të veçanta të shteteve të kufizuara vetëm me tokë, përjashtohen nga zbatimi i klauzolës për shtetin më të favorizuar.

Neni 127

Taksat doganore, pagesat dhe taksat e tjera

1. Trafiku tranzit nuk do të jetë subjekt i pagesave doganore, taksave ose pagesave të tjera, me përjashtim të pagesave të mbledhura për shërbime të veçanta që jepen në lidhje me trafiqe të tilla.

2. Mjetet e transportit në tranzit dhe pajisjet e tjera të parashikuara dhe që përdoren nga shtetet e kufizuara vetëm me tokë nuk do të jenë subjekt i taksave ose pagesave më të larta sesa ato të mbledhura për përdorimin e mjeteve të transportit të shtetit tranzit.

Neni 128

Zonat e lira dhe lehtësirat e tjera doganore

Për komoditetin e trafikut tranzit, zonat e lira ose zonat e tjera të lehtësirave doganore mund të parashikohen në portet e hyrjes dhe daljes në shtetet tranzit, me marrëveshje ndërmjet këtyre shteteve dhe shteteve të kufizuara vetëm me tokë.

Neni 129

Bashkëpunimi në ndërtimin dhe përmirësimin e mjeteve të transportit

Kur nuk ka asnjë mjet transporti në shtetet tranzit për t'i dhënë lirinë e kalimit tranzit ose kur mjetet ekzistuese, duke përfshirë dhe instalimet dhe pajisjet portuale, janë të papërshtatshme nga çdo pikëpamje, shtetet tranzite dhe shtetet e kufizuar vetëm me tokë të interesuara mund të kooperojnë në ndërtimin ose përmirësimin e tyre.

Neni 130

Masat për evitimin e vonesave ose vështirësive të tjera të natyrës teknike në trafikun tranzit

1. Shtetet tranzit do të marrin të gjitha masat e duhura për të evituar vonesat ose vështirësi të tjera të natyrës teknike në trafikun tranzit.

2. Kur këto vështirësi ose vonesa ndodhin, autoritetet kompetente të shteteve tranzite dhe shteteve të kufizuara vetëm me tokë të interesuara, do të kooperojnë me qëllimin e zhdukjes së tyre të

shpejtë.

Neni 131
Trajtimi i njëjtë në portet detare

Anijet që mbajnë flamurin e një shteti të kufizuar vetëm me tokë do të gëzojnë trajtim të barabartë siç u akordohet dhe anijeve të huaja të tjera në portet detare.

Neni 132
Garantimi i pajisjeve më të mëdha tranziti

Kjo konventë nuk e bën të nevojshme në asnjë mënyrë përjashtimin e pajisjeve tranzit të cilat janë më të mëdha se ato të parashikuara nga kjo Konventë dhe për të cilat është rënë dakord ndërmjet Shteteve Palë të kësaj Konvente ose garantimin nga një Shtet Palë. Kjo Konventë gjithashtu nuk përfshin garanci të tilla për pajisje më të mëdha në të ardhmen.

PJESA E XI
RAJONI
SEKSIONI 1 PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 133
Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:
(a) termi "Burime" nënkupton të gjitha burimet minerare të ngurta, të lëngëta ose të gazta in - situ në rajone mbi ose nën fundin e detit, duke përfshirë puset polymetalike;
(b) burimet kur merren nga një rajon, referohen si "minerale".

Neni 134
Qëllimi i kësaj pjese

1. Kjo pjesë zbatohet në rajonet.
2. Veprimtaritë në rajon do të udhëhiqen nga parashikimet e kësaj pjese.
3. Kërkesat në lidhje me depozitimin dhe publikimin që duhet të jepet, hartat dhe listat e koordinatave gjeografike, të cilat tregojnë kufijtë e referuar në nenin 1 paragrafi 1 janë formuluar në pjesën e VI.
4. Asgjë e këtij neni nuk do të ndikojë mbi krijimin e kufijve të jashtëm të shelfit kontinental në përputhje me pjesën e VI ose vlefshmërinë e marrëveshjeve në lidhje me kufizimin ndërmjet shteteve me brigje ballë për ballë ose fqinjë.

Neni 135
Statusi ligjor i ujërave superfqinjë dhe hapësirës ajrore

As kjo pjesë dhe asnjë e drejtë e garantuar ose e ushtruar në vazhdim nuk do të ndikojë në statusin ligjor të ujërave super fqinje në rajon ose të hapësirës ajrore të këtyre ujërave.

SEKSIONI 2 PARIMET QË UDHËHEQIN RAJONIN

Neni 136
Prona e përbashkët e shoqërisë njerëzore

Rajonet dhe burimet e tyre janë pronë e përbashkët e shoqërisë njerëzore.

Neni 137
Statusi ligjor i rajonit dhe burimet e tij

1. Asnjë shtet nuk do të reklamojë ose ushtrojë sovranitetin ose të drejtat e sovranitetit mbi çdo pjesë të rajonit ose burimeve të tij dhe asnjë shtet ose person juridik e fizik, respektivisht nuk do të pronësojnë ndonjë pjesë të saj. Asnjë reklamim ose ushtrim sovraniteti ose të drejtave të sovranitetit dhe asnjë pronësim i tillë nuk do të njihen.

2. Të gjitha të drejtat mbi burimet e rajonit i jepen shoqërisë njerëzore në total në emër të të cilit do të veprojnë autoriteti. Këto burime nuk janë subjekt i armiqësimit. Mineralet e nxjerra nga rajoni megjithatë mund të rregullohen në përputhje me këtë pjesë dhe rregullat dhe udhëzimet si dhe procedurat e autoritetit.

3. Asnjë shtet, person fizik ose juridik nuk do të reklamojë, fitojë ose ushtrojë të drejtat në lidhje me mineralet e nxjerra nga rajoni me përjashtim kur janë në përputhje me këtë pjesë. Përndryshe asnjë reklamim, përfitim ose ushtrim të drejtave të tilla nuk do të njihen.

Neni 138
Drejtimi i përgjithshëm i shteteve në lidhje me rajonin

Drejtimi i Përgjithshëm i shteteve në lidhje me rajonin do të jetë në përputhje me parashikimet e kësaj pjese, parimet bashkangjitur në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe rregulla të tjera të legjislacinit ndërkombëtar në interes të ruajtjes së paqes dhe sigurisë dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar e mirëkuptimit miqësor.

Neni 139
Përgjegjësia për të siguruar përputhjen dhe të drejtat për dëmet

1. Shtetet Palë do të kenë përgjegjësinë për të siguruar që veprimtaritë në rajon pavarësisht se kryhen nga Shtete Palë ose ndërmarrje shtetërore ose persona fizikë e juridikë, të cilët zotërojnë kombësinë e Shtetit Palë ose janë efektivisht të kontrolluar nga ato ose qytetarët e tyre do të kryhen në përputhje me këtë pjesë. Të njëjtat përgjegjësi zbatohen edhe për organizatat ndërkombëtare për veprimtaritë në rajon të kryera nga organizata të tilla.

2. Pa paragjykim ndaj rregullave të legjislacionit ndërkombëtar dhe aneksit III, nenit 22, dëmet e shkaktuara nga gabimet e Shteteve Palë ose organizatave ndërkombëtare për marrjen e përgjegjësive sipas kësaj pjese do të futen në përgjegjësi, Shtetet Palë ose organizatat ndërkombëtare që veprojnë së bashku do të mbajnë përgjegjësi së bashku dhe veç e veç. Një Shtet Palë megjithatë nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga çdo gabim në përputhje me këtë pjesë nga një person, i cili sponsorizohet sipas nenit 153 paragrafi 2(b), nëse Shteti Palë ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të siguruar një përputhje efektive sipas nenit 153, paragrafi 4 dhe aneksit III, neni 4 paragrafi 4.

3. Shtetet Palë që janë anëtarë të organizatave ndërkombëtare do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij neni lidhur me këto organizata.

Neni 140
Përfitimi i shoqërisë njerëzore

1. Veprimtaritë në rajon siç specifikohen në këtë pjesë, do të kryhen për përfitimet e shoqërisë njerëzore si e gjithë, pa marrë parasysh vendosjen gjeografike të shteteve, pavarësisht se janë shtete bregdetare ose të kufizuar vetëm me tokë dhe duke marrë në konsideratë të veçantë interesat dhe nevojat e shteteve në zhvillim dhe të popujve, të cilët nuk kanë fituar pavarësinë e plotë ose të atyre që kanë statusin e vetqeverisjes të njohur nga Kombet e Bashkuara në përputhje me rezolutën 1514 (XV) dhe rezoluta të tjera kryesore të Asamblesë së Përgjithëshme.

2. Autoritetet duhet të parashikojnë ndarjen e barabartë të përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga veprimtaritë në rajon nëpërmjet çdo mekanizmi, mbi baza jo diskriminuese, në përputhje me nenin 160, paragrafi 2 (f) (i).

Neni 141
Përdorimi i rajonit ekskluzivisht për qëllime paqësore

Rajoni do të jetë i hapur për përdorim ekskluziv me qëllime paqësore nga të gjithë shtetet pavarësisht se janë shtete bregdetare ose të kufizuar vetëm me tokë, pa asnjë diskriminim dhe pa asnjë paragjykim të parashikimeve të tjera të kësaj pjese.

Neni 142
Të drejtat dhe interesat legjitime të shteteve bregdetare

1. Veprimtaritë në rajon, në lidhje me depozitat e burimevet në rajon, të cilat shtrihen nëpërmjet kufijve të juridiksionit kombëtar, do të udhëhiqen duke patur parasysh të drejtat dhe interesat legjitime të çdo shteti bregdetar nëpërmjet juridiksioni të të cilëve shtrihen depozita të tilla.

2. Ndërmjet shteteve të interesuara do të mbahen konsultime, duke përfshirë dhe një sistem njoftimi para kohe, me qëllimin e evitimit të thyerjeve të këtyre të drejtave dhe interesave. Në rastet kur veprimtaria në rajon mund të rezultojë në shfrytëzimin e burimeve që shtrihen brenda juridiksionit kombëtar, do të kërkohet pranimi që përpara i shteteve bregdetare të interesuara.

3. As kjo pjesë dhe asnjë e drejtë tjetër e garantuar ose e ushtruar nuk do të prekë të drejtat e shteteve bregdetare për të marrë të masa të tilla, që janë në përputhje me parashikimet kryesore të pjesës së XII, siç mund të jetë e nevojshme për parandalimin, uljen, ose eleminimin e rreziqeve serioze dhe iminente gjatë bregdetit të tyre ose interesave respektive nga ndotja dhe kërcënimi si rrjedhim ose nga ngjarje të tjera të rrezikshme të shkaktuara nga çdo veprimtari në rajon.

Neni 143
Kërkimet detare shkencore

1. Kërkimet shkencore detare në rajon do të kryhen ekskluzivisht për qëllime paqësore dhe për përfitimin e shoqërisë njerëzore si e tërë, në përputhje me Pjesën e XIII.

2. Autoritetet mund të ndërmarrin kërkime shkencore detare në lidhje me zonën dhe burimet e saj dhe mund të bëjnë kontrata për këtë qëllim. Autoritetet do të nxisin dhe inkurajojnë kryerjen e kërkimeve detare shkencore në zonë dhe do të koordinojnë dhe mbledhin rezultatet e kërkimeve të tilla, si dhe analizave kur është e mundur.

3. Shtetet Palë mund të ndërmarrin kërkime shkencore detare në zonë. Shtetet Palë do të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar për kërkimet shkencore detare në Zonë me anën e:

(a) pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare dhe inkurajimin e bashkëpunimit në kërkimet shkencore detare nga personeli i vendeve të ndryshme dhe të Autoritetit;

(b) të sigurimit nëse programet janë zhvilluar nëpërmjet autoritetit ose organizmave ndërkombëtare të tjera, respektivisht për të mirën e shteteve në zhvillim dhe shteteve me teknologji më pak të zhvilluar me synimin e:

i) forcimit të aftësive të tyre kërkuese;

ii) trajnimit të personelit të tyre dhe personelit të autoritetit në teknikat e zbatimit të kërkimeve;

iii) detyrimit të punësimit të personelit të tyre të kualifikuar për kërkimet më Zonë;

mbledhjes efektive të rezultateve të kërkimeve dhe analizave kur kërkohen, nëpërmjet Autoritetit ose kanaleve të tjera diplomatike kur është e mundshme.

Neni 144
Transferimi i teknologjisë

1. Autoriteti do të marrë masa në përputhje me këtë Konventë:

(a) Për të fituar dije shkencore dhe teknologjike në lidhje me veprimtaritë në Zonë;

(b) Do të nxisë e inkurajojë transferimin tek shtetet në zhvillim të teknologjive dhe njohurive shkencore të tilla në mënyrë të tillë që të gjitha Shtetet Palë të perfitojnë nga kjo.

2. Si përfundim Autoriteti dhe të gjitha Shtetet Palë do të bashkëpunojnë në nxitjen e transferimit të teknologjive dhe dijeve shkencore që lidhen me veprimtaritë në Zonë në mënyrë që

ndërmarrjet dhe Shtetet Palë të mund të përfitojnë. Në veçanti, ato do të fillojnë dhe nxisin:

(a) Programe për transferimin e teknologjive në ndërmarrjet dhe shtetet në zhvillim në lidhje me aktivitetet në Zonë, duke përfshirë, inter-alia, lehtësimin e futjes së ndërmarrjeve dhe të shteteve në zhvillim me teknologji të rëndësishme, me terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme;

(b) Masa në drejtim të përparimit të teknologjive të ndërmarrjeve dhe teknologjisë vendase të shteteve në zhvillim për trajnimin me teknologjinë dhe shkencën detare dhe për pjesëmarrjen e tyre të plotë në veprimtaritë detare në Zonë.

Neni 145

Mbrojta e ambientit detar

Në përputhje me këtë Konventë, do të merren masat e nevojshme në lidhje me veprimtaritë në Zonë për të siguruar mbrotjen efektive të ambientit detar nga efektet e dëmshme, të cilat mund të lindin nga veprimtari të tilla. Për këtë qëllim, Autoriteti duhet të adaptojë rregullat përkatëse, procedurat dhe rregulla inter- lia për:

(a) mbrojtjen, kufizimin dhe kontrollin e ndotjes dhe rreziqeve të tjera për ambientin detar, duke përfshirë bregdetin dhe të ndërhyrjes në ekuilibrin ekologjik të ambientiti detar, duke i kushtuar vëmedje të veçantë nevojës për mbrojtjen nga efektet e dëmshme të veprimtarive të tilla, si: shpimi, thellimi, gërmimi, hedhja e mbeturinave, ndërtimi dhe operimi ose mirëmbajtja e instalimeve, tubacioneve dhe pajisjeve të tjera që lidhen me veprimtaritë;

(b) mbrojtjen dhe konservimin e burimeve natyrore të Zonës dhe mbrojtjen e dëmtimit të florës dhe faunës të ambientit detar.

Neni 146

Mbrojtja e jetës njerëzore

Në lidhje me veprimtaritë në Zonë, duhet të merren masat e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes efektive të jetës njerëzore. Për këtë qëllim, Autoriteti do të adaptojë rregullat, rregulloret dhe procedurat përkatëse në plotësim të legjislacionit ndërkombëtar, siç janë të vendosura në traktatet më të rëndësishme.

Neni 147

Ngritja e veprimtarive në Zonë dhe në ambientin detar

1. Veprimtaritë në Zonë do të kryhen me kujdes të arsyeshëm për veprimtaritë e tjera të ambientit detar.

2. Instalimet që përdoren për kryerjen e veprimtarive në Zonë do të jenë subjekt i kushteve të mëposhtme:

(a) Instalime të tilla duhet të zhduken, zhvendosen ose lëvizen vetëm në përputhje me këtë Pjesë dhe bazuar në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit. Për zhdukjen, zhvendosjen dhe levizjen e pajisjeve të tilla, si dhe për pajisjet e përhershme për dhënie paralajmërimi të prezencës së tyre e mirëmbajtjes duhen dhënë njoftimet e duhura;

(b) Instalime të tilla mund të mos krijohen kur ndikojnë në perdorimin e kurseve detare të njohura thelbësor, ose në zona të veprimtarive të dendura të peshkimit.

(c) Zona sigurie duhet të krijohen rreth instalimeve të tilla me shenjat përkatëse për të siguruar njëkohësisht si lundrimin, ashtu dhe pajisjet. Konfigurimi dhe pozicioni i zonave të tilla të sigurisë nuk duhet të jetë i tillë që të formojë një brez që pengon hyrjen e ligjshme të transportit detar në zona të veçanta detare ose lundrimi gjatë kurseve detare ndërkombëtare.

(d) Instalime të tilla duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllime paqësore.

Instalime të tilla nuk zotërojnë statusin e ishullit. Ato nuk kanë ujëra territoriale, zonë eksluzive ekonomike ose shelf kontinental.

Veprimtaritë e tjera në ambientin detar duhet të udhëhiqen duke patur kujdes të arsyeshëm për veprimtarinë në Zonë.

Neni 148
Pjesëmarrja e shteteve në zhvillim në veprimtaritë e Zonës

Pjesëmarrja efektive e shteteve në zhvillim në Zonë do te nxitet siç është shprehur specifikisht në këtë Pjesë, duke pasur parasysh interesat e nevojat e veçanta dhe në veçanti nevojat specifike të shteteve pa dalje në det ose atyre me disavantazh gjeografik, mbi të gjitha pengesat që vijnë nga disavantazhi i pozicionit të tyre, duke përfshirë zhvendosjen nga Zona dhe vështirësinë e kalimit për e nga ajo.

Neni 149
Objektet historike dhe arkeologjike

Të gjitha objektet e natyrës historike dhe arkeologjike që gjenden në Zonë duhet të ruhen ose të disponohen për përfitim të njerëzimit si i tërë, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë të drejtave preferenciale te shtetit ose vendit të origjinës ose shtetit të origjinës historike ose arkeologjike.

SEKSIONI 3. ZHVILLIMI I BURIMEVE TË ZONËS

Neni 150
Politikat në lidhje me veprimtaritë në Zonë

Veprimtaritë në Zonë, siç shprehet në veçanti në këtë Pjesë, do të kryhen në mënyrë të tillë që të sjellin sa më shumë të jetë e mundur zhvillimin e shëndetshëm të ekonomisë botërore dhe rritjen e bilancuar të tregtisë ndërkombëtare dhe të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillimet e përgjithshme të të gjitha vendeve, në mënyrë të veçantë për shtetet në zhvillim dhe me synimin e sigurimit të:

(a) zhvillimit të burimeve të zonës;

(b) menaxhimit të rregullt, të sigurtë dhe racional të burimeve të Zonës, duke përfshirë drejtimin efektiv të veprimtarive në Zonë dhe në përputhje me parimet e shëndosha të konservimit dhe evitimit të mbeturinave të panevojshme;

(c) zgjerimit të mundësive për pjesëmarrje në veprimtari të tilla që mbështeten në veçanti në nenet 144 dhe 148;

(d) pjesëmarrjes në të ardhurat nga ana e Autoritetit dhe transferimit të teknologjisë në ndërmarrjet dhe shtetet në zhvillim siç shprehet në këtë Konventë;

(e) rritjes së vlefshmërisë së mineraleve që rrjedhin nga Zona siç nevojitet në lidhje me mineralet që rrjedhin nga burime të tjera, për të siguruar furnizim të konsumatorëve me minerale të tilla;

(f) promovimit të çmimeve të qëndrueshme dhe të drejtë të përfitueshëm nga prodhuesit dhe i drejtë për konsumatorët për mineralet që rrjedhin si nga Zona, ashtu edhe nga burimet e tjera, si dhe promovimin e një ekuilibri afatgjatë ndërmjet kërkesës dhe ofertës;

(g) zmadhimit të mundësive për të gjitha Shtetet Palë, pavarësisht nga sistemet e tyre ekonomike e sociale ose pozita gjeografike, për të marrë pjesë në zhvillimin e burimeve të zonës dhe parandalimit të monopolizimit të veprimtarive në zonë;

(h) mbrojtjes së shteteve në zhvillim nga efektet e kundërta në ekonomitë e tyre ose në fitimet nga eksporti që rezultojnë nga reduktimi i çmimit në çmim për një mineral në veprim ose me volum në eksport, në hapësirën që një reduktim i tillë është shkaktuar nga veprimtaria në zonë, siç parashikohet në nenin 151;

(i) zhvillimit të përfitimit të përbashkët të shoqërisë njerëzore si e tëra;

(j) kushteve të hyrjes në treg për mineralet e prodhuara nga burimet në Zonë dhe për importimin e mallrave të prodhuara nga minerale të tilla nuk do të jenë më shumë të favorizuara se ato më të favorizuarat, të zbatuara për importet nga burime të tjera.

Neni 151
Politikat e prodhimit

1. (a) Pa asnjë paragjykim të objektivave të vendosur në nenin 150 dhe për qëllimet e zbatimit të nënparagrafit (h) të këtij neni, Autoriteti, që vepron nëpërmjet forumeve ekzistuese ose rregullimeve ose marrëveshjeve të reja të tilla, siç mund të jetë e përshtatshme, në të cilat të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë së bashku prodhuesit dhe konsumatorët, marrin pjesë, do të marrin masat e nevojshme për të nxitur rritjen, efektivitetin, dhe qëndrueshmërinë e tregut për keto mallra të prodhuara nga mineralet që rrjedhin nga Zona, me çmime për përfitim të prodhuesve dhe të drejta për konsumatorët. Të gjitha Shtetet Palë do të bashkëpunojnë për këtë qëllim.

(b) Autoriteti do të ketë të drejtë të marrë pjesë në çdo konferencë që ka të bëjë me këto mallra dhe në të cilat marrin pjesë së bashku të gjitha palët e interesuara duke përfshirë si prodhuesit, ashtu dhe konsumatorët. Autoriteti do të ketë të drejtën të bëhet palë në çdo rregullim ose marrëveshje që rezulton nga konferenca të tilla. Pjesëmarrja e Autoritetit në çdo organ të krijuar sipas këtyre rregullimeve ose marrëveshjeve do të jetë në lidhje me prodhimin në Zonë dhe në perputhje me rregulla të veçanta të këtyre organeve.

(c) Autoriteti do të kryejë të gjitha detyrimet e tij sipas rregullimeve apo marrëveshjeve të referuara në këtë paragraf në mënyrë të tillë që të sigurojë një zbatim uniform dhe jodiskriminues, në lidhje me të gjitha produktet në Zonë të mineraleve në fjalë. Duke vepruar në këtë mënyrë, Autoriteti do të veprojë bazuar në termat e kontratave ekzistuese dhe planeve të miratuara të punës së ndërmarrjes.

2. (a) Gjatë nje periudhe të përkohshme të specifikuar në paragrafin 3, prodhimet komerciale nuk do të trajtohen mbi bazën e një plani të miratuar pune, derisa operatori të kërkojë dhe t'i lëshohet një autorizim prodhimi nga Autoriteti. Autorizime të tilla prodhimi mund të mos kërkohen ose lëshohen më shumë se 5 vjet përpara fillimit të planizuar ose prodhimit komercial sipas një plani pune, përveçse kur lidhet me natyrën, afatin e projektit të zhvillimit, rregullat dhe procedurat e përshkruara nga Autoriteti në një periudhë tjetër.

(b) Në kërkesën për autorizimin e prodhimit, operatori duhet të specifikojë sasinë vjetore të nikelit të pritur për t'u nxjerrë sipas një plani të miratuar pune. Kërkesa duhet të përfshijë një pasqyrë të shpenzimeve që do të bëjë operatori pasi ai të ketë marrë autorizimin, të cilat janë llogaritur arsyeshëm për të lejuar atë që të fillojë prodhimin komercial në datën e planifikuar.

(c) Për qëllimet e nënparagrafeve (a) dhe (b), Autoriteti do të formojë kërkesat përkatëse të zbatimit në përputhje me aneksin III, neni 17.

(d) Autoriteti do të lëshojë një autorizim prodhimi për nivelin e prodhimit të kërkuar përderisa shuma e këtij niveli dhe nivelet tashmë të autorizuara tejkalojnë tavanin e prodhimit të nikelit, siç llogaritet në bazë të paragrafit 4 në vitin e lëshimit të autorizimit, gjatë çdo viti të prodhimit të planizuar që përkon brenda periudhës së përkohshme.

(e) Kur lëshohet, autorizimi i prodhimit dhe kërkesa e miratuar, do të bëhet një pjesë e planit të miratuar të punës.

(f) Nëse kërkesa e operatorit për autorizim prodhimi denoncohet mbi bazën e nënparagrafit.

(d) Operatori mund të kërkojë përsëri tek Autoriteti në çdo kohë.

3. Periudha e përkohshme do të fillojë 5 vjet përpara 1 janarit të vitit në të cilin prodhimi më i hershëm komercial është planizuar të fillojë sipas planit të miratuar të punës.

Në qoftë se prodhimi i hershëm komercial vonohet përtej vitit origjinal të planifikuar, fillimi i periudhës së përkohshme dhe niveli tavan i prodhimit dhe llogaritjet origjinale do të rregullohen perkatesisht. Periudha e përkohshme do të zgjasë 25 vjet ose deri në përfundimin e konferencës të rishikimit të referuar në nenin 155 ose deri në ditën kur rregullime ose marrëveshje të tilla të reja, siç referohen në paragrafin 1, hyjnë në fuqi, kushdoqoftë më përpara. Autoriteti do të marrë fuqitë e parashikuara në këtë nen për periudhën e përkohshme të mbetur nëse rregullimet ose marrëveshjet, në fjalë do të skadojnë ose bëhen joefektive për çdo arsye dhe kurdoherë.

4. (a) Niveli tavan i prodhimit për çdo vit të periudhës së përkohshme do të jetë shuma e:

i) diferencës ndërmjet vijës së qëndrimit të vlerave për konsumin e nikelit siç llogaritet mbi bazën e nënparagrafit (b) për vitin menjëherë përpara vitit më të hershëm të prodhimit komercial dhe vitit menjëherë përpara fillimit të periudhës së përkohshme;

ii) Gjashtëdhjetë për qind e diferencës ndërmjet vijës së qëndrimit të vlerave për konsumin e nikelit siç llogaritet mbi bazën e nënparagrafit (b) për vitin në të cilin autorizimi i prodhimit është kërkuar dhe vitit të menjëhershëm përpara prodhimit komercial më të hershëm.

(b) Për qëllimet e nënparagrafit (a):

i) Vijat e qëndrimit të vlerave të përdorura për të llogaritur nivelin tavan të prodhimit të nikelit do të jenë ato vlera vjetore të konsumit të nikelit mbi një vijë qëndrimi të llogaritur gjatë viti në të cilin është lëshuar autorizimi i prodhimit. Vija e qëndrimit duhet të rrjedhë nga një regresion linear i logaritmit të konsumit aktual të nikelit për 15 vjetët e fundit, për të cilën këto të dhëna janë të vlefshme, koha është nje variabël i pavarur. Kjo vijë qëndrimi do të referohet si vija origjinale e qëndrimit.

ii) Nëse shkalla vjetore e rritjes së vijës origjinale të qëndrimit është më pak se 3 për qind, atëhere vija e qëndrimit e përdorur për përcaktimin e sasisë së referuar në nënparagrafin (a), në vend që të jetë ajo që kalon mbi vijën origjinale të qëndrimit do të jetë ajo që vija e origjinale e qëndrimit e rritur 3 për qind për në vitet e para brenda periudhës 15-vjeçare me kusht që, megjithëse niveli tavan i prodhimit i vendosur për çdo vit të periudhës së përkohshme mundet që jo në çdo rast të kalojë diferencën ndërmjet vijës origjinale të qëndrimit për këtë vit dhe vijës origjinale të qëndrimit menjëherë përpara vitit të menjehershëm të fillimit të periudhës së përkohshme.

5. Autoriteti do të rezervojë për ndërmarrjen si prodhim fillestar një sasi prej 38 000 metrik ton nikeli nga niveli tavan i prodhimit i llogaritur mbi bazën e paragrafit 4.

6. (a) Një operator mundet në çdo vit të prodhojë më pak ose deri në 8 për qind më shumë se niveli vjetor i prodhimit të mineraleve me prejardhje polimetalike të specifikuar në autorizimin e tij të prodhimit, me kusht që shuma e përgjithshme e prodhimit, të mos kalojë atë që është specifikuar në autorizim. Çdo tejkalim mbi 8 për qind dhe deri në 20 për qind në çdo vit ose çdo tejkalim në vitin e parë dhe vitet pasuese për dy vjet në të cilët tejkalimi ndodh, do të negociohen me Autoritetin, i cili mund të kërkojë që operatori të pajiset një autorizim plotësues prodhimi për të mbuluar prodhimin shtesë.

(b) Kërkesat për të tilla autorizime prodhimi shtesë, duhet të merren në konsideratë nga Autoriteti, vetëm pas kërkesave të tjera nga operatorë në pritje, të cilët nuk kanë marrë akoma autorizimin e prodhimit dhe pasi ato janë ligjëruar dhe për kërkues të ngjashëm. Autoriteti do të udhëhiqet nga parimet e mos tejkalimit të prodhimit total të lejuar sipas nivelit tavan të prodhimit në çdo vit për periudhën e përkohshme. Ai nuk do të autorizojë prodhimin poshtë çdo plani pune për një sasi mbi 46.500 metrik ton nikeli në vit.

7. Nivelet e prodhimit për metale të tjera siç janë bakri, kobalti dhe manganezi të nxjerrë nga nga materiale polimetalike, që janë nxjerrë mbi bazën e një autorizimi prodhimi nuk do të jenë më të mëdhaja se ato të cilat do të prodhoheshin sikur operatori të prodhonte nivelin maksimal të nikelit nga ato materiale mbi bazën e këtij neni. Autoriteti duhet të përgatisë rregulla, rregullore dhe procedura mbi bazën e aneksit III, neni 17 për të zbatuar këtë paragraf.

8. Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me praktika ekonomike të padrejta sipas marrëveshjeve multilaterale tregtare do të zbatohen në eksplorimin dhe shfrytëzimin e mineraleve nga Zona. Në zgjidhjen e diskutimeve të ngritura sipas këtij parashikimi, Shtetet Palë, të cilat janë Palë në marrëveshje të tilla multilaterale tregtare kanë të drejtën e rekursit për procedura të zgjidhjes së diskutimeve të marrëveshjeve të tilla.

9. Autoriteti do të ketë fuqinë për të kufizuar nivelin e prodhimit të mineraleve në zonë, përveçse nga materialet polimetalike, sipas kushteve të tilla dhe të zbatojë metoda të tilla më të përshtatshme duke adaptuar rregulla në përputhje me nenin 161, paragrafi 8.

10. Me rekomandimin e Këshillit mbi bazën e këshillave të dhëna nga komisioni i Planizimit ekonomik, Asambleja do të krijojë një sistem kompesimi ose do të marrë masa të tjera të ndihmës ekonomike duke përfshirë bashkëpunimin me agjenci të specializuara dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të ndihmuar vendet në zhvillim, të cilat vuajnë efekte serioze të kundërta mbi të ardhurat e tyre nga eksporti ose ekonomitë që rezultojnë nga një reduktim në çmimet të nje minerali të kërkuar ose në volumin e eksportit të këtij minerali, mbi atë që një reduktim i tillë është shkaktuar nga veprimtaria në Zonë. Autoriteti pas kërkesës, do të fillojë studimin mbi problemet e këtyre shteteve, të cilët janë seriozisht ndikuar me qëllimin e minimizimit të vështirësive të tyre dhe të ndihmojë ato në rregullimet ekonomike të tyre.

Neni 152

Ushtrimi i fuqive dhe funksioneve nga Autoriteti

1. Autoriteti do të evitojë diskriminimin në ushtrimin e fuqisë dhe funksioneve, duke përfshirë

dhe garantimin e mundësive për veprimtaritë në zonë.

2. Megjithatë do të lejohen, konsiderata të veçanta për shtetet në zhvillim, duke përfshirë dhe konsideratat e veçanta për shtetet pa bregdet dhe me disavantazh gjeografik ndërmjet tyre, të cilat janë parashikuar në këtë pjesë.

Neni 153

Sistemi i eksplorimit dhe shfrytëzimit

1. Veprimtaritë në Zonë do të organizohen, ndërmerren dhe kontrollohen nga Autoriteti në emër të shoqërisë njerëzore si e tërë në përputhje me këtë nen dhe gjithashtu me parashikimet e rëndësishme të kësaj pjese e anekseve respektive, si dhe rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit.

2. Veprimtaritë në Zonë do të zhvillohen siç përshkruhet në paragrafin 3:

(a) nga Ndërmarrja;

(b) së bashku me Autoritetin nga Shtetet Palë ose ndërmarrjet e shtetit ose personat juridikë dhe fizikë të cilët zotërojnë kombësinë e Shteteve Palë ose kontrollohen efektivisht nga ato ose shtetasit e tyre. Kur sponsorizohen nga shtete të tilla ose çdo grup i përmendur më sipër, i cili plotëson kërkesat e parashikuara në këtë pjesë dhe në aneksin III.

3. Veprimtaria në Zonë duhet të kryhet në përputhje me një plan formal të shkruar dhe të përgatitur në përputhje me aneksin III dhe të miratuar nga Këshilli pas rishikimit të komisionit teknik dhe ligjor. Në rastet e veprimtarive në Zonë të kryera nga ndërmarrjet, siç autorizohet nga Autoriteti, të specifikuara në paragrafin 2(b), plani i punës do të jetë, në përputhje me aneksin III neni 3, në formën e një kontrate. Kontrata të tilla mund të parashikojnë marrëveshje të përbashkëta në përputhje me Aneksin III, neni 11.

4. Autoriteti do të ushtrojë kontrolle të tilla mbi veprimtaritë në Zonë siç është e nevojshme, për qëllimet e sigurimit të përputhjes së parashikimeve të kësaj pjese me anekset përkatëse dhe rregullat, rregulloret e procedurat e Autoritetit dhe planet e punës të miratuara në përputhje me paragrafin 3. Shtetet Palë do të ndihmojnë autoritetin duke marrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojnë këtë përputhje sipas nenit 139.

5. Autoriteti do të ketë të drejtën që të marrë në çdo kohë çfarëdo mase të parashikuar sipas kësaj pjese për sigurimin e përputhjes me këto parashikime dhe ushtrimin e funksioneve të kontrollit dhe rregullimit të caktuara sipas çdo kontrate. Autoriteti do të ketë të drejtën të inspektojë të gjitha instalimet në Zonë të përdorura në lidhje me veprimtaritë në Zonë.

6. Një kontratë sipas paragrafit 3 duhet të parashikojë sigurimin e pronës. Respektivisht, kontrata nuk duhet të rishikohet, pezullohet ose përfundojë me përjashtim në përputhje me aneksin III, neni 18 dhe 19 .

Neni 154

Rishikimi Periodik

Çdo 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, Asambleja do të ndërmarrë një rishikim të përgjithshëm dhe sistematik të mënyrës në të cilën regjimi ndërkombëtar i zonës i krijuar në këtë Konventë ka operuar në praktikë. Në dritën e këtij rishikimi, Asambleja mund të marrë ose të rekomandojë që organet e tjera të marrin masat në përputhje me parashikimet dhe procedurat e kësaj pjese dhe të anekseve bashkëlidhur, të cilat do të çojnë në përmirësimin e regjimit të operimit.

Neni 155

Konferenca e rishikimit

1. Pesëmbëdhjetë vjet nga 1 janari i vitit në të cilin fillon prodhimi më i parë komercial sipas planit të miratuar të punës, Asambleja do të mbledhë një konferencë për rishikimin e këtyre parashikimeve të kesaj pjese dhe anekseve bashkëlidhur, të cilët udhëheqin sistemin e eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve të Zonës. Konferenca e rishikimit do të marrë në konsideratë detajet, nën dritën e eksperiencës së fituar gjatë kësaj periudhe:

(a) nëse parashikimet e kësaj Pjese, të cilët udhëheqin sistemin e eksplorimit dhe shfrytëzimit

të burimeve të Zonës kanë arritur qëllimet e tyre në të gjitha drejtimet duke përfshirë edhe ato kur përfiton shoqëria njërëzore në përgjithësi;

(b) nëse gjatë periudhës 15-vjeçare, zona rezervë janë shfrytëzuar në mënyrë efektive dhe të ekuilibruar, në krahasim me zonat jorezervë;

(c) nëse zhvillimi dhe përdorimi i Zonës dhe burimeve të saj është ndërmarrë në mënyrë të tillë që të forcojë zhvillimin e shëndoshë të ekonomisë botërore dhe rritjen e ekuilibruar të tregtisë ndërkombëtare;

(d) nëse monopolizimi i veprimtarive në zonë ka qënë i ndaluar;

(e) nëse politikat e bëra në nenet 150 dhe 151 janë plotësuar;

(f) nëse sistemi ka rezultuar në ndarje të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga veprimtaritë në zonë, duke marrë në konsideratë të veçantë interesat dhe nevojat e shteteve në zhvillim.

2. Konferenca e rishikimit do të sigurojë mirëmbajtjen e parimeve të traditës së përbashkët të shoqërisë njerëzore, regjimin ndërkombëtar të përcaktuar për shfrytëzim të barabartë të burimeve në zonë për përfitim të të gjitha vendeve, në mënyrë të veçantë të shteteve në zhvillim dhe një Autoritet që të organizojë, drejtojë dhe kontrollojë veprimtaritë në Zonë. Ajo do të sigurojë gjithashtu mirëmbajtjen e parimeve të paraqitura në këte Pjesë duke marrë parasysh përjashtimin e reklamimeve ose ushtrimin e sovranitetit mbi çdo pjesë të Zonës, të drejtat e shteteve dhe drejtimi i përgjithshëm i tyre në lidhje me Zonën dhe pjesëmarrja e tyre në veprimtaritë në Zonë në përputhje me këtë Konventë, parandalimi i monopolizimit të veprimtarive në Zonë, përdorimi i Zonës ekskluzivisht për qëllime paqësore, aspektet ekonomike të veprimtarive në Zonë, kërkimet shkencore detare, transferimi i teknologjive, mbrojtja e ambientit detar, mbrojtja e jetës njerëzore, të drejtat e shteteve bregdetare, statusi ligjor i ujërave superbashkëlidhur të Zonës dhe asaj të hapësirës ajrore mbi ujërat dhe lidhjet ndërmjet veprimtarive në Zonë dhe veprimtarive të tjera në ambientin detar.

3. Procedurat e marrjes së vendimit të zbatueshme në konferencën e rishikimit do të jenë të njëjta siç janë zbatuar në Konferencën e Tretë të Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit. Konferenca do të bëjë çdo përpjekje që të arrijë marrëveshje mbi çdo amendament me konsensus dhe nuk do të ketë ndonjë votim mbi çështje të tilla derisa të arrihet një konsensus.

4. Në qoftë se pesë vjet pas fillimit të saj, konferenca nuk ka arritur marrëveshje mbi sistemin e eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve në Zonë, mund të vendoset brenda 12 muajve në vazhdim nga tre të katërtat e mazhorancës së Shteteve Palë, të adaptojnë dhe parashtrojnë Shteteve Palë për ratifikim ose bashkim amendamente të tilla, ndryshime ose modifikime të sistemit siç mund të vendoset e nevojshme dhe e duhur. Amendamente të tilla do të hyjnë në fuqi për të gjitha Shtetet Palë 12 muaj pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose bashkimit nga tre të katërtat e Shteteve Palë.

5. Amendamentet e adaptuara nga konferenca e rishikimit mbi bazën e këtij neni nuk do të prekë të drejtat e fituara sipas kontratës ekzistuese.

SEKSIONI 4. AUTORITETI
NËNSEKSIONI A. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 156
Krijimi i Autoritetit

1. Megjithatë krijohet Autoriteti ndërkombëtar i shtratit të detit, i cili do të funksionojë në përputhje me këtë Pjesë.

2. Të gjitha Shtetet Palë janë ipso facto anëtarë të Autoritetit.

3. Vrojtuesit në Konferencën e Tretë të Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit, të cilët kanë firmosur aktin final dhe të cilët nuk janë referuar në nenin 305, paragrafi 1 (c), (d), (e), ose (f), do të kenë të drejtën të marrin pjesë tek Autoriteti si vrojtues, në përputhje me rregullat e tij, rregulloret dhe procedurat.

4. Selia e Autoritetit do të jetë në Jamaica.

5. Autoriteti mund të krijojë qendra të tilla rajonale ose zyra si mund t'i duket e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij.

Neni 157
Natyra dhe parimet bazë të Autoritetit

1. Autoriteti është organizata nëpërmjet së cilës Shtetet Palë, në përputhje me këtë Pjesë, do të organizojnë dhe kontrollojnë veprimtaritë në Zonë, në mënyrë të veçantë me detyrimet e marra nga ato në përputhje me këtë Pjesë në mënyrë që t'ju sigurojë të gjithë atyre të drejtat dhe përfitimet që rezultojnë nga anëtarësia.

2. Fuqitë dhe funksionet e Autoritetit do të jenë ato që shprehen në këtë Konventë. Autoriteti do të ketë fuqi të tilla më të vogla, mbi bazën e kësaj Konvente siç janë shprehur këtu dhe të nevojshme për ushtrimin e këtyre fuqive dhe funksioneve lidhur me veprimtaritë në zonë.

3. Autoriteti formohet mbi parimet e barazizë dhe sovranitetit të barabartë për të gjithë anëtarët.

4. Të gjithë anëtarët e Autoritetit do të përmbushin me mirëbesim detyrimet e marra nga ata në përputhje me këtë pjesë ,me qëllim të sigurimit të të gjithëve të drejtat dhe përfitimeve që rrjedhin nga anëtarësia.

Neni 158
Organet e Autoritetit

1. Krijohen këtu dhe kurdoherë si organet kryesore: Autoriteti, Asambleja, Këshilli dhe Sekretariati.

2. Krijohet gjithashtu ndërmarrja, e cila është organi nëpërmjet të cilit Autoriteti do të kryejë funksionet referuar në nenin 170, paragrafi 1.

3. Këto organe subvencionuese siç mund të dalë e nevojshme mund të krijohen në përputhje me këtë pjesë.

4. Çdo organ bazë i Autoritetit dhe ndërmarrjes do të jetë përgjegjës për ushtrimin e këtyre fuqive dhe funksioneve, të cilat referohen këtu. Në ushtrimin e fuqive të tilla dhe funksioneve secili organ do të shmangë marrjen e çdo veprimi, i cili mund të sjellë ose pengojë ushtrimin e fuqive dhe funksioneve specifike të referuar çdo organi tjetër.

NËNSEKSIONI B. ASAMBLEJA

Neni 159
Përbërja, procedurat dhe votimi

1. Asambleja do të përbëhet nga të gjithë anëtarët e Autoritetit. Secili anëtar do të ketë një përfaqësues në Asamble, i cili mund të shoqërohet me zëvendësues dhe këshilltarë.

2. Asambleja do të mblidhet në sesion te rregullt vjetor dhe në sesione të tilla të veçanta siç mund të vendoset nga asambleja ose të mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm me kërkesën e Këshillit ose të mazhorancës të anëtarëve të Autoritetit.

3. Sesionet do të mblidhen në selinë e Autoritetit, përveçse kur vendoset ndryshe nga Asambleja.

4. Asambleja do të adaptojë rregullat e saj të procedurave. Në fillim të çdo sesioni të rregullt, ajo do të zgjedhë presidentin dhe nëpunësit e tjerë të tillë siç mund të kërkohet. Ata do të mbajnë një zyrë derisa të zgjidhet presidenti dhe nëpunësat e tjerë të rinj në sesionin e ardhshëm të rregullt.

5.Mazhoranca e anëtarëve të Asamblesë do të përbëjnë një quorum.

6. Secili anëtar i Asamblesë do të ketë një votë.

7. Vendimet mbi çështjet e procedurave, duke përfshirë dhe vendimet për mbledhjen e sesioneve të veçanta të Asamblesë, duhet të merren me maxhorancën e anëtarve të pranishëm dhe që votojnë.

8. Vendimet mbi çështjet substanciale do të merren me dy të tretat e mazhorancës së anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që një mazhorancë e tillë të përfshijë një mazhorancë të anëtarëve që marrin pjesë në sesion. Kur çështjet e ngritura pavarësisht nëse një çështje është substanciale ose jo, kjo çështje do të trajtohet si substanciale përveçse kur është vendosur ndryshe nga Asambleja me anën e mazhorancës së kerkuar për vendimet mbi çështjet e substancave.

9. Kur çështja e substancave ngrihet për votim për herë të parë, Presidenti, nëse kërkohet nga të paktën një e pesta e anëtarve të Asamblesë mund dhe do të shtyjë çështjen e votimit mbi këtë çështje për një periudhë që nuk kalon 5 vjet ditë kalendarike. Ky rregull mund të zbatohet vetëm një herë për çdo çështje dhe nuk do të zbatohet për të zgjatur çështjen përtej përfundimit të sesionit.

10. Kur Presidentit i adresohet një kërkesë me shkrim dhe e sponsorizuar së paku nga një e katërta e anëtarëve të Autoritetit për një opinion këshillues në përputhje me këtë Konventë të një propozimi përpara Asamblesë mbi çdo çështje, Asambleja do t'i kërkojë Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit të Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit për të dhënë një mendim këshillues dhe do të shtyjë votimin mbi këtë propozim duke pritur marrjen e një opinioni këshillues nga dhoma. Nëse opinioni këshillues nuk merret përpara javës përfundimtare të sesionit në të cilën ajo kërkohet, Asambleja do të vendosë kur ajo do të mblidhet për votim për propozimin e shtyrë.

Neni 160
Fuqitë dhe funksionet

1. Asambleja, si i vetmi organ i Autoritetit që përbëhet nga të gjithë anëtarët, do të konsiderohet si organi suprem i Autoritetit kundrejt të cilit organet e tjera kryesore duhet të marrin në konsideratë siç parashikohet në këtë Konventë. Asambleja do të ketë fuqinë për ndërtimin e politikave të përgjithshme në përputhje me parashikimet përkatëse të kësaj Konventë mbi çdo çështje ose problem brenda kompetencave të Autoritetit.

2. Në plotësim, fuqitë dhe funksionet e Asamblesë do të jenë:

(a) të zgjedhin anëtarët e Këshillit në përputhje me nenin 161.

(b) Të zgjedhin Sekretarin e Përgjithshëm ndërmjet kandidatëve të propozuar nga Këshilli.

(c) Të zgjedhin me rekomandim të Këshillit, anëtarët e Bordit Drejtues të ndërmarrjes dhe Drejtorin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

(d) Të krijojnë organe të tilla subvencionuese siç mund t'ju duket e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre në perputhje me këtë pjesë. Në formimin e këtyre organeve duhet t'i kushtohet vëmendje e njëjtë parimeve të shpërndarjes së barabartë gjeografike dhe interesave të veçanta e nevojave për anëtarët e kualifikuar dhe kompetent në çështjet thelbësore teknike që kanë të bëjnë me këto organe.

(e) Të mbledhë kontributet e anëtarëve në buxhetin administrativ të Autoritetit në përputhje me shkallën e rënë dakord të vlerësimit bazë mbi shkallën e përdorur për buxhetin e rregullt të Kombeve të Bashkuara derisa Autoriteti të ketë të ardhura të mjaftueshme nga burime të tjera për të përballuar shpenzimet e tij administrative.

(f) (i) Të marrë në konsideratë dhe të miratojë, me rekomandimin e Këshillit rregulla, rregullore dhe procedurat për nje ndarje të barabartë të përfitimeve të tjera ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga veprimtaria në zonë, si dhe pagesat e kontributet e bëra mbi bazën e nenit 82, duke marrë në konsideratë të veçantë interesat dhe nevojat e shteteve dhe popujve në zhvillim, të cilët nuk kanë arritur pavarësinë e plotë ose statusin e vetadministrimit. Nëse Asambleja nuk miraton rekomandimet e Këshillit, Asambleja do t'ia kthejë ato Këshillit për rikonsiderim mbi dritën e mendimeve të shprehura nga Asambleja.

(ii) Të marrë në konsideratë dhe të miratojë rregulla, rregullore dhe procedurat e Autoritetit dhe çdo amendamenti kudo, adaptuar përkohësisht nga Këshilli mbi bazën e nenit 162, paragrafi 2 (o) (n). Këto rregulla, rregullore dhe procedura do të lidhen me parashikimin, eksplorimin dhe shfrytëzimin në Zonë, menaxhimin financiar dhe administrimin e brendshëm të Autoritetit dhe mbi bazën e rekomandimeve të Bordit Drejtues të ndërmarrjes për transferimin e fondeve nga ndërmarrja tek autoriteti.

(g) Për të vendosur për shpërndarjen e barabartë të përfitimeve të tjera ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga veprimtaritë në zonë mbi bazën e kësaj Konvente, rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit.

(h) Të konsiderojë dhe të miratojë buxhetin vjetor të propozuar të Autoriteti të parashtruar nga Këshilli.

(i) Të ekzaminojë raportet periodike nga Këshilli dhe nga ndërmarrja dhe raporteve speciale të kërkuara nga Këshilli ose çdo organ tjetër i Autoritetit.

(j) Të fillojë studime dhe të përgatisë rekomandime me qëllimin e promocionit të

bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me veprimtaritë në Zonë dhe të inkurajojë zhvillimet progresive të legjislacionit ndërkombëtar përkates, si dhe kodifikimin e tij.

(k) Të marrë në konsideratë natyrën e përgjithshme në lidhje me veprimtaritë në Zonë të ngritura në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim, si dhe ato probleme për shtetet në lidhje me veprimtaritë në Zonë që lidhen me pozitën e tyre gjeografike, në mënyrë të veçantë me shtetet pa bregdet ose disavantazh gjeografik.

(l) Të krijojnë me rekomandim të Këshillit, mbi bazën e këshillave nga komisioni i planizimit ekonomik, sistemin e kompesimit ose masa të tjera të rregullimit të asistencës ekonomike, siç parashikohet në nenin 151, paragrafi 10.

(m) Të pezullojë ushtrimin e të drejtave dhe privilegjeve të anëtarësisë mbi bazën e nenit 185.

(n) Të diskutojë çdo problem mbi çështjet brenda kompetencave të Autoritetit dhe të vendosë se cili organ i Autoritetit do të merret me çdo çështje të tillë ose problem që nuk i është besuar në mënyrë specifike ndonjë organi të veçantë, duke u bazuar në shpërndarjen e fuqive dhe funksioneve ndërmjet organeve të Autoritetit.

NËNSEKSIONI C. KËSHILLI

Neni 161
Përbërja, procedurat dhe votimi

1. Këshilli do të përbëhet nga 36 anëtarë të Autoritetit të zgjedhur nga Asambleja sipas rradhës që vijon:

(a) Katër anëtarë ndërmjet Shteteve Palë të cilët, gjatë 5 vjetëve të fundit për të cilat statistikat janë të vlefshme, kanë ose konsumuar më shumë se 2 për qind të konsumit botëror ose kanë patur import neto më shumë se 2 për qind të shumës së importit botëror të mallrave të prodhuara nga kategoritë e mineraleve që rrjedhin nga Zona dhe në çdo rast një shtet nga rajonet e shteteve të Europës Lindore (Socialiste), si dhe të konsumatorëve më të mëdhenj.

(b) Katër anëtarë nga tetë Shtete Palë, të cilat kanë investimet më të mëdha në përgatitjen dhe drejtimin e veprimtarive në Zonë ose direkt ose nëpërmjet shtetasve të tyre, duke përfshirë së paku një shtet nga rajoni Europës Lindore (Socialiste).

(c) Katër anëtarë ndërmjet Shteteve Palë, të cilat mbi bazën e prodhimit në zonë sipas juridiksionit të tyre janë eksportuesit më të mëdhenj të kategorisë së mineraleve që rrjedhin nga Zona, duke përfshirë së paku dy shtete në zhvillim, eksportet e të cilëve për minerale të tilla kanë peshë thelbësore në ekonomitë e tyre.

(d) Gjashtë anëtarë ndërmjet Shteteve Palë në zhvillim, që përfaqësojnë interesa të veçanta. Interesat e veçanta që duhet të paraqiten do të përfshijnë ato të shteteve me popullsi më të madhe, shtetet të cilat nuk kanë bregdet ose me disavantazh gjeografik, shtetet të cilat janë importuesit më të mëdhenj të kategorisë së mineraleve që rrjedhin nga Zona, shtetet të cilat janë prodhues potencial të mineraleve të tilla dhe shtetet më pak të zhvilluara;

(e) Tetëmbëdhjetë anëtarë të zgjedhur sipas parimeve të sigurimit të shpërndarjes së barabartë gjeografike të vendeve në Këshill si i tërë, me kusht që secili rajon gjeografik do të ketë së paku një anëtar të zgjedhur sipas këtij nënparagrafi. Për këtë qëllim, rajonet gjeografike do të jenë: Afrika, Azia, Europa Lindore (Socialiste), Amerika Latine dhe Europa Perëndimore e të tjerët.

2. Në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit në përputhje me paragrafin 1, Asambleja do të sigurohet që:

(a) shtetet pa bregdet ose me disavantazh gjeografik, përfaqësohen në një shkallë, e cila është në mënyrë të arsyeshme proporcionale me përfaqësimin e tyre në Asamble;

(b) shtetet bregdetare, në mënyrë të veçantë shtetet në zhvillim, të cilat nuk kualifikohen sipas paragrafit 1 (a), (b), (c) ose (d) përfaqësohen në një shkallë, e cila është proporcionale me përfaqësimin e tyre në Asamble;

(c) çdo grup Shtetesh Palë që duhet të përfaqësohen në Këshill, përfaqësohet nga ato shtete, nëse janë, të cilët janë emëruar nga ky grup.

3. Zgjedhjet do të bëhen në sesionet e rregullt të Asamblesë. Secili anëtar i Këshillit do të zgjidhet për 4 vjet. Në zgjedhjen e parë, megjithatë, do të jetë kusht që gjysma e anëtarëve të çdo grupi referuar në paragrafin 1 të jetë për 2 vjet.

4. Anëtarët e Këshillit do të kenë të drejtë edhe të rizgjidhen, por duke i kushtuar vëmendjen e duhur dëshirës së rotacionit të anëtarëve.

5. Këshilli do të funksionojë në selinë e Autoritetit dhe do të mblidhet sa herë që ta kërkojë puna e Autoritetit, por jo më pak se 3 herë në vit.

6. Mazhoranca e anëtarëve të Këshillit do të përbëjë një quorum.

7. Çdo anëtar i Këshillit do të ketë një votë.

8. (a) Vendimet për çështjet e procedurave do të merren nga mazhoranca e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë.

(b) Vendimet mbi çështjet e substancave të ngritura sipas parashikimeve që vijojnë do të merren me mazhorancën e dy të tretave të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që një mazhorancë e tillë të përfshijë një mazhorancë të anëtarëve të Këshillit: neni 162 paragrafi 2, nënparagrafi (f), (g), (h), (i), (n), (p), (v), neni 191.

(c) Vendimet mbi çështjet e substancave të ngritura sipas parashikimeve që vijojnë do të merren nga tre të katërtat e mazhorancës së anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me kusht që kjo mazhorancë të përfshijë mazhorancën e anëtarëve të Këshillit: neni 162, paragrafi 1; neni 162, paragrafi 2, nënparagrafët (a), (b), (c), (d), (e), (i), (q), (r), (s), (t), (u) në rastet e mospërputhjes nga një kontraktor ose sponsorizues; (ë) me kusht që urdhërat e lëshuar spontanisht mundet të vonohen jo më shumë se 30 ditë përderisa të konfirmohen nga një vendim i marrë në përputhje me nënparagrafin (d); neni 162, paragrafi 2, nënparagrafi (x), (y), (z), neni 163, paragrafi 2, neni 174, paragrafi 3, aneksi IV, neni 11.

(d) Vendimet mbi çështjet e substancave të ngritura sipas parashikimeve që vijojnë do të merren me konsensus: neni 162, paragrafi 2(m) dhe (o), adaptimi i amendamenteve në Pjesën XI.

(e) Për qëllimet e nënparagrafëve (d), (f) dhe (g), "konsensus" do të thotë mungesa e kundërshtimeve formale. Brenda 14 ditëve të parashtrimit të një propozimi të Këshillit, Presidenti i Këshillit do të përcaktojë nëse do të ketë një kundërshtim formal për adaptimin e propozimit. Nëse Presidenti do të krijojë dhe mbajë brenda tre ditëve duke ndjekur një përcaktim të tillë, një komision i përbashkët i përbërë prej jo më shumë se nëntë anëtarë të Këshillit, me Presidentin si kryetar, për qëllimet e ribashkimit të diferencave dhe dhënien e nje propozimi, i cili mund të adaptohet me konsensus. Komiteti do të punojë pa ndërprerje dhe do i raportojë Këshillit brenda 14 ditëve pas krijimit të tij. Nëse komisioni është i pamundur të rekomandojë një propozim, i cili duhet adaptuar me konsensus, ai duhet të paraqesë në raportin e tij faktet përse një propozim i tillë kundërshtohet.

(f) Vendimet mbi çështjet jo të treguara më sipër për të cilat Këshilli është i autorizuar të marrë sipas rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit ose përndryshe duhet të merren mbi bazë të nënparagrafëve të këtij paragrafi të specifikuara në rregullat, rregulloret dhe procedurat ose, nëse nuk janë specifikuar këtu, atëherë mbi bazën e nënparagrafëve të përcaktuar nga Këshilli në e është e mundur që përpara, me konsensus.

(g) Kur çështja e ngritur është brënda nënparagrafëve (a), (b), (c) ose (d), çështja do të trajtohet sikur të ishte brënda nënparagrafëve duke kërkuar konsensusin e mazhorancës më të lartë sipas rastit, përveçse kur vendoset ndryshe nga Këshilli, nga mazhoranca e përmendur më sipër ose me konsensus.

9. Këshilli do të përgatisë procedurat kur një anëtar i autoritetit që nuk është i pranishëm mund të dërgojë një përfaqësues për të ndjekur takimin e Këshillit, kur kërkesa është bërë nga një anëtar i tillë ose një çështje e veçantë që ndikon është për marrje në konsideratë. Një përfaqësues i tillë do të ketë të drejtën të marrë pjesë me votë deliberative, por jo të votojë.

Neni 162

Fuqitë dhe funksionet

1. Këshilli është organ ekzekutiv i Autoritetit. Këshilli do të ketë fuqinë të krijojë, në përputhje me këtë Konventë dhe politikat e përgjithshme të vendosura nga Asambleja, politika të veçanta që ndiqen nga Autoriteti mbi çdo çështje ose problem brenda kompetencave të Autoritetit.

2. Në plotësim Këshilli do të:

(a) të mbikqyrë dhe koordinojë zbatimin e parashikimeve të kësaj Pjese dthe mbi të gjitha çështjet e problemet brenda kompetencës së Autoritetit, si dhe të kërkojë vëmendjen e Asamblesë në rastet e mospërputhjes;

(b) ti propozojë Asamblesë kandidatët për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm;

(c) t'i rekomandojë Asamblesë kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të ndërmarrjes dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ndërmarrjes;

(d) të krijojë, përkatësisht dhe me vëmendjen e duhur ekonomike e efektive, organet subvencionuese të tilla që i duket e nevojshme për ushtrimin e funksioneve në përputhje me këtë Pjesë. Në formimin e organeve subvencionuese, theks i duhet vënë nevojës për anëtarë të kualifikuar dhe komepetent në çështjet thelbësore teknike që duhet të merren këto organe me kusht që t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë parimit për shpërndarje të barabartë gjeografike dhe interesave speciale;

(e) të adaptojë rregullat dhe procedurat e tij duke përfshirë metodën e zgjedhjes të presidentit të tij;

(f) të hyjë në marrëveshje me Kombet e Bashkuara ose organizata ndërkombëtare të tjera nën emër të Autoritetit dhe brenda kompetencave të tij, mbi bazën e miratimit nga Asambleja;

(g) të marrë në konsideratë raportet e ndërmarrjes dhe t'i transmetojë ato Asamblesë me rekomandimet e tij;

(h) t'i paraqesë Asamblesë raportin vjetor dhe raporte të veçanta të tilla siç mund t'i kërkojë Asambleja;

(i) t'i lëshojë direktiva ndërmarrjes në përputhje me neni 170;

(j) të miratojë planet e punës në përputhje me aneksin III, neni 6. Këshilli do të veprojë mbi secilin plan pune brenda 60 ditëve të parashtrimit të tij nga komisioni tekniko-juridik në sesionin e Këshillit në përputhje me procedurat që vijojnë:

i) Nëse komisioni e rekomandon miratimin e planit të punës, ai do të merret sikur është miratuar nga Këshilli, nëse asnjë anëtar i Këshillit i parashtron me shkrim Presidentit brenda 14 ditëve një kundërshtim specifik që parashtron mospërputhjen me kërkesat e aneksit III, neni 6, nëse nuk ka kundërshtim, proçedura e bashkimit e vendosur në nenin 161, paragrafi 8(e), do të zbatohet. Nëse në perfundim të proçedurës së bashkimit, kundërshtimi akoma mbetet, plani i punës duket sikur është miratuar nga Keshilli, përveçse kur Këshilli nuk e miraton atë me konsensus ndërmjet anëtarëve te tij duke përjashtuar çdo shtet ose shtete që bëjnë kërkesë për sponsorizim të një kërkuesi.

ii) Nëse komisioni rekomandon mosmiratimin e planit të punës ose nuk bën një rekomandim, Këshilli mundet të miratojë planin e punës me dy të tretat e mazhorancës së anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, me kusht që kjo mazhorancë të përfshijë mazhorancën e anëtarëve që janë të pranishëm ne sesion.

(k) të miratojë planin e punës të parashtruar nga ndërmarrja në përputhje me aneksin IV, nenin 12, paragrafi (j)

(l) të ushtrojë kontroll mbi veprimtaritë në Zonë në përputhje me nenin 153, paragrafi 4 dhe rregullat e procedurat e autoritetit;

(m) të marrë masat e nevojshme dhe përkatëse pas rekomandimeve të komisionit të planizimit ekonomik në përputhje me nenin 150 nënparagrafi (h) për të parashikuar mbrojtje nga efektet ekonomike të kundërta të specifikuara këtu;

(n) t'i bëje rekomandime Asamblesë mbi bazat e këshillave nga komisioni i planizimit ekonomik, për një sistem kompesimi ose masa të tjera të ndihmës së rregullimit ekonomik siç parashikohet në nenin 151 paragrafi 10;

(o) (i) t'i rekomandojë Asamblesë, rregullat dhe procedurat mbi ndarjen e barabartë të përfitimeve ekonomike dhe financiare që rrjedhin nga veprimtaritë në Zonë dhe pagesat e kontributet e bëra në mbështetje të nenit 82, duke marrë në konsideratë të veçantë interesat dhe nevojat e shteteve dhe popujve në zhvillim, të cilët nuk kanë fituar pavarësinë e plotë ose kanë statusin e vetëqeverisjes;

(ii) të adaptojnë dhe zbatojnë përkohësisht, duke pritur miratimin e Asamblesë, çdo amendament si rrjedhim, duke marrë në konsideratë rekomandimet e komisionit tekniko- ligjor ose organeve e nënvarura të interesuara. Këto rregulla dhe procedura duhet t'i përkasin perspektivës, shfrytëzimit dhe eksplorimit në Zonë dhe menaxhimit financiar e administrimit të brendshëm të Autoritetit. Prioritet duhet t'i jepet adaptimit të rregullave dhe procedurave të eksplorimit, shfrytëzimit të burimeve polimetalike. Rregullat dhe procedurat për shfrytëzim të çdo burimi, përveç atyre polimetalike do të miratohen brenda tre vjetëve nga data e kërkesës ndaj Autoritetit prej çdo anëtari të saj për të adaptuar rregulla dhe procedura të tilla në lidhje me burime të tilla. Të gjitha rregullat, rregulloret dhe procedurat do të mbeten në fuqi mbi baza të përkohshme derisa të miratohen nga

Asambleja ose derisa të amendohen nga Këshilli mbi bazën e mendimeve të shprehura nga Asambleja.

(p) Të rishikojë mbledhjen e pagesave që i duhen bërë Asamblesë ose nga ajo në lidhje me operimet në vijim të kësaj pjese.

(q) Të bëjë zgjedhjen ndërmjet kërkuesve për autorizimin e prodhimit në mbështetje të aneksit III, neni 7 kur kërkohet një zgjedhje e tillë nga parashikimet.

(r) Të parashtrojë buxhetin vjetor të autoritetit në Asamble për miratimin e tij;

(s) T'i bëjë Asamblesë rekomandime në lidhje me politikat që i interesojnë mbi çdo çështje dhe problem brenda kompetencave të Autoritetit.

(t) T'i bëjë rekomandime Asamblesë në lidhje me pezullimin e ushtrimit të të drejtave dhe privilegjeve të anëtarësisë mbi bazën e nenit 185.

(u) Të ngrejë proçedurat në emër te Autoritetit përpara Dhomës së Diskutimeve të shtratit të Detit në rastet e mos përputhjes;

(v) Të njoftojë Asamblenë menjëherë pas një vendimi të Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit në procedurat e krijuara sipas nënparagrafit (u) dhe të bëjë çdo rekomandim të cilin mund ta gjejë të përshtatshëm në lidhje me masat që duhen marrë.

(ë) Të lëshojë urdhëra emergjence, të cilat mund të përfshijnë urdhëra për pezullimin ose rregullimin e veprimtarisë, për të parandaluar dëme serioze ndaj ambientit detar që rrjedhin jashtë veprimtarive në Zonë.

(x) Të mos miratojë zonat për shfrytëzim nga kontraktorët ose nga ndërmarrja në rastet e fakteve thelbësore që tregojnë rrezikun e dëmeve serioze ndaj ambientit detar.

(y) Të krijojë një një organizëm subvencionues për përpunimin e draftit të rregullave financiare, rregullave dhe procedurave në lidhje me:

i) menaxhimin financiar në përputhje me nenin 171 deri 175; dhe

ii) rregullmet financiare në përputhje me aneksin III, neni 13 dhe neni 17, paragrafi 1 (c).

(z) Të krijojë mekanizmat përkatëse për drejtimin dhe supervizimin e një stafi inspektorësh, i cili do të inspektojë veprimtaritë në Zonë për të përcaktuar ne se në këtë pjesë, rregullat, rregulloret dhe procedurat dhe termat e çdo kontrate me Autoritetin përputhen.

Neni 163
Organet e Këshillit

1. Krijohen organet e poshtëshënuara të Këshillit:

(a) komisioni i planizimit ekonomik;

(b) një komision tekniko-ligjor.

2. Secili komision do të përbëhet nga 15 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli ndërmjet kandidatëve të emëruar nga Shtetet Palë. Megjithatë, nëse është e nevojshme, Këshilli mund të vendosë të rrisë madhësinë e secilit komision duke pasur parasysh ekonominë dhe efektivitetin.

3. Anëtarët e komisionit do të kenë kualifikimet përkatëse të kompetencave të këtij komisioni në Zonë. Shtetet Palë do të emërojnë kandidatët me standardet me të larta të kompetencës dhe integritetit me kualifikimet në fusha thelbësore në mënyrë të tillë që të sigurojnë ushtrimin efektiv të funksioneve të komisionit.

4. Në zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojës për shpërndarje të barabartë gjeografike dhe përfaqësimit të interesave të veçanta.

5. Asnjë Shtet Palë nuk emëron më shumë se një kandidat për të njëjtin komision. Asnjë person nuk do të zgjidhet për të shërbyer në më shumë se një komision.

6. Anëtarët e komisionit do të kenë zyrat për pesë vjet. Ato do të jenë të zgjedhshëm për rizgjedhje për një periudhë tjetër.

7. Në rastet e vdekjes, mosaftësisë ose dorëheqjes së një anëtari të komisionit përpara skadimit të kushteve të zyrës, Këshilli do të zgjedhë për periudhën e mbetur të kushteve, një anëtar nga i njëjti rajon gjeografik i Zonës së interesuar.

8. Anëtarët e komisionit nuk do të kenë interesa financiare në çdo veprimtari që ka lidhje me eksplorimin dhe shfrytëzimin në Zonë. Mbi bazën e përgjegjësive të tyre kundrejt komisionit, të cilit ata i shërbejnë, ata nuk do të mbyllin, edhe pas përfundimit të funksioneve të tyre, ndonjë sekret industrial, të dhënat personale që i janë transferuar Autoritetit në përputhje me aneksin III, neni 14 ose

çdo informacion tjetër konfidencial që vjen në dijeni të tyre për arsye të detyrave të tyre për Autoritetin.

9. Secili komision do të ushtrojë funksionet e tij në përputhje me këto udhëzime dhe direktiva që Këshilli mund të adaptojë.

10. Secili komision do t'i formulojë dhe parashtrojë Këshillit për miratim rregulla, rregullore të tilla që mund të jenë të nevojshme për drejtim efektiv të funksioneve të komisionit.

11. Procedurat e marrjes së vendimeve të komisionit do të bëhen prej rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit. Rekomandimet për Këshillin, kur janë të nevojshme, do shoqërohen nga një përmbledhje mbi divergjencat e mendimeve në komision.

12. Secili komision do të funksionojë normalisht në selinë e Autoritetit dhe do të takohet aq herë siç mund të kërkohet për ushtrimin efikas të funksioneve të tij.

13. Në ushtrimin e funksioneve të tij, secili komision kur duhet, mundet të konsultohet me një komision tjetër, çdo organ kompetent të Kombeve të Bashkuara ose organizatë ndërkombëtare me kompetenca në çështjet e konsultimeve të tilla.

Neni 164
Komisioni i planizimit ekonomik

1. Anëtarët e komisionit të planizimit ekonomik do të kenë kualifikimet e duhura të tilla si ato të minierave, drejtimit të veprimtarive të burimeve minerale, tregtisë ndërkombëtare ose ekonomisë ndërkombëtare. Këshilli do të përpiqet për të siguruar që të gjithë anëtarët e komisionit të kenë të gjitha kualifikimet përkatëse. Komisioni do të përfshijë së paku dy anëtarë nga shtetet në zhvillim, eksporti i të cilëve për kategoritë e mineraleve që rrjedhin nga zona kanë një peshë mbi ekonomitë e tyre.

2. Komisioni do:

(a) të propozojë, me kërkesën e Këshillit, masat për zbatimin e vendimeve që lidhen me veprimtaritë në Zonë, të marra në përputhje me këtë Konventë;

(b) të rishikojë qëndrimet dhe faktorët që ndikojnë në furnizim, kërkesën dhe çmimet e materialeve, të cilat mund të rrjedhin nga Zona, duke patur parasysh interesat e vendeve eksportuese dhe importuese dhe në mënyrë të veçantë të shteteve në zhvillim ndërmjet tyre;

(c) të ekzaminojnë çdo situatë që mund të çojë në efekte të kundërta referuar në nenin 150, nenparagrafi (h), të sjellë në vëmendje të tij nga Shteti ose Shtetet Palë të interesuara dhe t'i bëjë rekomandimet e duhura Këshillit;

(d) t'i propozojë Këshillit për t'i parashtruar Asamblesë, siç parashikohet në nenin 151, paragrafi 10, një sistem kompesimi ose masa të tjera të rregullimit të asistencës ekonomike për shtetet në zhvillim që vuajnë efekte të kundërta të shkaktuara nga veprimtaritë në Zonë. Komisioni do të bëjë rekomandime per Këshillin që janë të nevojshme për zbatimin e sistemit ose masave të tjera të adaptuara nga Asambleja në raste të veçanta.

Neni 165
Komisioni tekniko-ligjor

1.Anëtarët e komisionit tekniko-ligjor do të kenë kualifikimet përkatëse siç janë ato mbi eksplorimin, shfrytëzimin dhe procedimin e burimeve minerale, oqeanologjisë, mbrojtjes së ambientit detar ose çështjet ekonomike dhe ligjore në lidhje me minierat e oqeanit fushat përkatëse të ekspertizës. Këshilli do të përpiqet të sigurojë se anëtarët e komisionit zotërojnë të gjitha kualifikimet përkatëse.

2. Komisioni do të:

(a) bëjë rekomandime përsa i përket ushtrimit të funksioneve të Autoritetit me kërkesën e Këshillit;

(b) rishikojë planin formal të shkruar të punës për aktivitetet në Zonë në përputhje me nenin 153, paragrafi 3 dhe parashtrojë rekomandimet përkatëse Këshillit. Komisioni do t'i bazojë rekomandimet e tij vetëm në drejtimet e shpallura në aneksin III dhe do të raportojë plotësisht për të gjitha tek Këshilli;

(c) supervizojë me kërkesën e Këshillit, veprimtaritë në Zonë, kur është e përshtatshme, në

konsultim dhe bashkëpunim me çdo ent që zhvillon veprimtari të tilla ose shtet dhe shtete të interesuara dhe t'i raportojë Këshillit;

(d) pregatisë vlerësimet për ndikimin në ambient të veprimtarive në zonë;

(e) bëjë rekomandime Këshillit për mbrojtjen e ambientit detar, duke marrë në konsideratë dijet e ekspertëve te njohur në këtë fushë;

(f) formulojë dhe parashtrojë Këshillit rregullat, rregulloret dhe procedurat e referuara në nenin 162, paragrafi 2(o) duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët përkatës duke përfshirë vlerësimet e ndikimit në ambient të veprimtarive në Zonë;

(g) t'i mbajë rregullat, rregulloret dhe procedurat nën rishikim dhe rekomandojë Këshillit herë pas here, amerndamente të tilla që mund të jenë të nevojshme dhe dëshirueshme;

(h) t'i bëjë rekomandime Këshillit përsa i perket krijimit të një programi monitorizimi që duhet të vrojtojë, masë, vlerësojë dhe analizojë me metoda të njohura shkencore, mbi baza të rregullta, rrezikun ose efektet e ndotjes së ambientit detar që rezulton nga veprimtaritë ne Zonë, të sigurojë që rregullat ekzistuese janë të përshtatshme dhe në përputhje, si dhe të koordinojnë zbatimin e programit të monitorizimit të miratuar nga Këshilli;

(i) t'i rekomandojë Këshillit që procedurat të ngrihen, në emër të Autoritetit përpara Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit, në përputhje me këtë pjesë dhe anekset përkatëse duke marrë në konsideratë veçanërisht nenin 187;

(j) t'i bëjë rekomandime Këshillit në lidhje me masat që duhen marrë, pas vendimit të Dhomës së diskutimeve të shtratit të setit për procedurat e ngritura në përputhje me nënparagrafin (i);

(k) t'i bëjë rekomandime Këshillit për lëshimin e urdhërave emergjente, të cilët mund të përfshijnë urdhëra për pezullim ose rregullim të operimeve, për parandalimin e dëmeve serioze në ambientin detar të dala nga veprimtaritë në Zonë. Rekomandime të tilla do të merren nga Këshilli mbi bazat e prioritetit;

(l) t'i bëje rekomandime Këshillit për disaprovimin e zonave për shfrytëzim nga kontraktuesi ose ndërmarrja në rastet kur faktet thelbësore tregojnë rrezikun e dëmeve serioze për ambientin detar;

(m) të bëjë rekomandime Këshillit në lidhje me drejtimet dhe supervizionin e një stafi të inspektorëve të cilët do të inspektojnë veprimtaritë në Zonë për përcaktimin nëse parashikimet e kësaj Pjese, rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, si dhe termat e kushtet e çdo kontrate të autoritetit janë në përputhje;

(n) të llogarisë tavanin e prodhimit dhe lëshojë autorizimet e prodhimit në emër të Autoritetit mbi bazën e nenit 151, paragrafet 2 deri 7, duke ndjekur çdo zgjedhje të nevojshme ndërmjet kërkuesve për autorizim prodhimi nga Këshilli në përputhje me aneksin III, neni 7.

3. Anëtarët e komisionit mbas kërkesës së bërë nga çdo Shtet Palë ose Palë të tjera të interesuara, do të shoqërohen nga një përfaqësues i një shtetit të tillë ose Pale tjetër të interesuar kur kryejnë funksionet e tyre të supervizionit dhe inspektimit.

NËNSEKSIONI D. SEKRETARIATI

Neni 166
Sekretariati

1. Sekretariati i Autoritetit do të përfshijë Sekretarin e Përgjithshëm, si dhe një staf të tillë që e kërkon Autoriteti.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të zgjidhet për katër vjet nga Asambleja ndërmjet kandidatëve të propozuar nga Këshilli dhe mund të rizgjidhet.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të jetë shefi administrativ i nëpunësve të Autoritetit dhe do të veprojë në këtë detyrë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, të Këshillit dhe çdo organi tjetër të varur dhe do të kryejë funksione të tjera të tilla administrative që i janë besuar Sekretarit të Përgjithshëm nga këto organe.

4. Sekretari i Përgjithshëm do të bëjë një raport vjetor për Asamblenë mbi punën e Autoritetit.

Neni 167
Stafi i Autoritetit

1. Stafi i Autoritetit do të përbëhet nga personel shkencor, teknik dhe të tjerë të tillë që mund të kërkohen për kryrjen e funksioneve administrative të Autoritetit.

2. Konsideratat mbizotëruese në rekrutimin dhe punësimin e stafit dhe në përcaktimin e kushteve të tyre të shërbimit do të jenë domosdoshmëri për sigurimin e standardeve më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit. Mbi bazën e këtyre konsideratave, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rëndësisë së rekrutimit të stafit sa të jetë e mundur mbi baza gjeografike.

3. Stafi do të caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Termat dhe kushtet mbi të cilat ata do të caktohen, paguhen dhe pushohen do të jenë në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

Neni 168

Karakteri ndërkombëtar i sekretariatit

1. Në kryerjen e detyrave të tyre Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi i tij nuk do të kërkojë dhe marrë instruksione nga ndonjë qeveri ose nga çdo burim tjetër i jashtëm i Autoritetit. Ata do të shmangen nga çdo veprim, i cili mund të reflektojë mbi pozitën e tyre si nëpunës ndërkombëtar të përgjegjësive vetëm të Autoritetit. Secili Shtet Palë zotohet të respektojë karakterin ekskluziv të përgjegjësive të Sekretarit të Përgjithshëm dhe stafit dhe të mos kërkojë t'i influencojë ata në shkarkimin e përgjegjësive të tyre. Çdo thyerje e përgjegjësive nga një anëtar i stafit do t'i parashtrohet gjykatave përkatëse administrative siç parashikohet në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

2. Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi nuk do të kenë asnjë interes financiar në çdo veprimtari që lidhet me eksplorimin dhe shfrytëzimin në Zonë. Mbi bazën e përgjegjësive të tyre kundrejt Autoritetit, ata nuk do të mbyllin edhe pas përfundimit të funksioneve të tyre, ndonjë sekret industrial, të dhëna personale, të cila i transferohen Autoritetit në përputhje me Aneksin III, neni 14, ose çdo informacioni tjetër konfidencial që vjen për dijeni të tyre për arësye të punësimit të tyre tek Autoriteti.

3. Thyerja e detyrimeve të një anëtari të stafit të përmendur në paragrafin 2, me kërkesën e Shtetit Palë të dëmtuar nga një thyerje e tillë ose të një personi fizik ose juridik, do të sponzorizohet nga një Shtet Palë siç parashikohet në nenin 153, paragrafi 2(b) dhe i ndikuar nga një thyerje e tillë, do t'i parashtrohet nga Autoriteti kundër një anëtari të stafit të një gjykate të përcaktuar nga rregulla, rregullore dhe procedura të Autoritetit. Pala e ndikuar do të ketë të drejtën të marrë pjesë në procedurat. Nëse gjykata e rekomandon ashtu, Sekretari i Përgjithshëm do të pushojë anëtarin e stafit të interesuar.

4. Rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit do të përmbajnë të tilla parashikime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij neni.

Neni 169

Konsultimet dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare ndërkombëtare

1. Sekretari i Përgjithshëm, mbi çështjet në kompetencë të Autoritetit, do të bëjë rregullimet e kënaqshme, me miratimin e Këshillit, për konsultime dhe bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare e joqeveritare të njohura nga Këshilli ekonomik dhe social i Kombeve të Bashkuara.

2. Çdo organizatë me të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka hyrë në marrëveshje sipas paragrafit 1 mund të caktojë përfaqësues për të ndjekur takimin e organeve të Autoritetit si vrojtues në përputhje me rregullat e procedurave të këtyre organeve. Procedura do të krjohen për të marrë mendimin e organizatave të tilla në rastet përkatëse.

3. Sekretari i Përgjithshëm mund t'i shpërndajë Shteteve Palë raporte me shkrim të parashtruara nga organizatat joqeveritare të referuara në paragrafin 1, mbi bazën e të cilave ato kanë kompetenca speciale dhe të cilat janë të lidhura me punën e Autoritetit.

NËNSEKSIONI E. NDËRMARRJA

Neni 170

Ndërmarrja

1. Ndërmarrja do të jetë organi i Autoritetit, e cila do të kryejë veprimtaritë në Zonë direkt, mbi bazën e nenit 153, paragrafi 2(a), si dhe të transportimit, procesimit dhe marketimit të mineraleve të nxjerra nga Zona.

2. Ndërmarrja, brenda kuadrit të personalitetit ndërkombëtar ligjor të Autoritetit do të ketë fuqi të tilla ligjore siç është parashikuar në statutin e dhënë në aneksin IV. Ndërmarrja do të veprojë në përputhje me këtë Konventë dhe rregullat, rregulloret e procedurat e Autoritetit, si dhe poltikave të përgjithshme të vendosura nga Asambleja dhe do të jetë subjekt i direktivave dhe kontrollit të Këshillit.

3. Ndërmarrja do të ketë vendin kryesor të bisnezit në selinë e Autoritetit.

4. Ndërmarrja , në përputhje me nenin 173, paragrafi 2 dhe aneksi IV, neni 11 do të furnizohet me fonde të tilla siç mund të kërkohet për të kryer funksionet e saj dhe do të vendosë teknollogji siç parashikohet në nenin 144, dhe parashikime të tjera përkatëse të kësaj Konvente.

NËNSEKSIONI F. RREGULLIMET FINANCIARE TË AUTORITETIT

Neni 171
Fondet e Autoritetit

Fondet e Autoritetit do të përfshijnë:

(a) kontributet e vlerave të bëra nga anëtarët e Autoritetit në përputhje me nenin 160, paragrafi 2(e);

(b) fondet e marra nga Autoriteti mbi bazën e aneksit III, neni 13 në lidhje me veprimtaritë ne Zonë;

(c) fondet e transferuara nga ndërmarrja në përputhje me aneksin IV, neni 10;

(d) fondet e marra hua mbi bazën e nenit 174;

(e) kontribute vullnetare të bëra nga anëtarë ose ente të tjera;

(f) pagesat për një fond kompesimi, në përputhje me nenin 151, paragrafi 10, burimet e të cilave duhet të rekomandohen nga komisioni i planizimit ekonomik.

Neni 172
Buxheti vjetor i Autoritetit

Sekretari i Përgjithshëm do të përgatisë dhe propozojë buxhetin vjetor të Autoritetit dhe t'ia parashtrojë atë Këshillit. Këshilli do ta marrë në konsideratë buxhetin e propozuar vjetor dhe do t'ia parashtrojë atë Asamblesë, së bashku me rekomandimet mbi të. Asambleja do ta marrë në konsideratë buxhetin e propozuar vjetor në përputhje me nenin 160, paragrafi 2(h).

Neni 173
Shpenzimet e Autoritetit

1. Kontributet e referuara në nenin 171, nënparagrafi (a) do të paguhen në një llogari speciale për të mbuluar shpenzimet administrative të Autoritetit, derisa Autoriteti të ketë fonde të mjaftueshme nga burime të tjera për të mbuluar shpenzimet.

2. Shpenzimet administrative të Autoritetit do të kenë prekjen e parë mbi fondet e Autoritetit. Më përjashtim për kontributet e vlerësuara të referuara në nenin 171, nënparagrafi (a), fondet të cilat mbesin pas pagesës së shpenzimeve administrative, mund inter-alia:

(a) të ndahen në përputhje me nenin 140 dhe nenin 160, paragrafi 2(g);

(b) të përdoren për të furnizuar ndërmarrjen me fonde në përputhje me nenin 170, paragrafi 4;

(c) të përdoren për kompesimin e shteteve në zhvillim, në përputhje me nenin 151, paragrafi 10 dhe nenin 160, paragrafi 2(1).

Neni 174
Fuqia për marrje hua e Autoritetit

1. Autoriteti do të ketë të drejtën për të marrë hua fonde.

2. Asambleja do të përshkruajë kufirin e fuqive për të marrë hua të Autoritetit në rregullat financiare të adoptuara mbi bazën e nenit 160, paragrafi 2(f).

3. Këshilli do të ushtrojë fuqitë për marrje hua të Autoritetit.

4. Shtetet Palë nuk do të jenë përgjegjëse për debitë e Autoritetit.

Neni 175
Auditimi vjetor

Regjistrat, librat dhe llogaritë e Autoritetit, duke përfshirë dhe deklarimin financiar të tij, do të auditohet çdo vit nga një auditor i pavarur i caktuar nga Asambleja.

NËNSEKSIONI G. STATUSI LIGJOR, PRIVILEGJET
DHE IMUNITETET

Neni 176
Statusi Ligjor

Autoriteti do të ketë personalitet ligjor ndërkombëtar dhe fuqi të tilla ligjore, siç mund të jenë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij dhe plotësimin e qëllimeve të tij.

Neni 177
Privilegjet dhe imunitetet

Në mënyrë që t'i jepet mundësi Autoritetit të ushtrojë funksionet e tij, ai duhet të gëzojë në territoret e secilit Shtet Palë, privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në këtë nënseksion. Privilegjet dhe imunitetet në lidhje me Ndërmarrjen do të jenë ato të vendosura në aneksin IV, neni 13.

Neni 178
Imuniteti nga proceset ligjore

Autoriteti, prona e tij dhe asetet do të gëzojnë imunitet nga proceset ligjore me përjashtim të rasteve të veçanta kur Autoritetit shprehet për heqjen e këtij imuniteti.

Neni 179
Imuniteti nga kërkimi dhe çdo formë e arrestimit

Pronat dhe asetet e Autoritetit, kudoqofshin vendosur dhe të mbajtura nga kushdo, do të jenë imune nga kërkimi, rekuizimi, konfiskimi, shpronësimi ose çdo formë e arrestimit nga veprime ekzekutive ose legjislative.

Neni 180
Përjashtimi nga kufizimet, rregullat, kontrollet dhe moratoriumet

Pronat dhe asetet e Autoritetit do të përjashtohen nga kufizimet, rregullat, kontrollet dhe moratoriumet e çdo natyre.

Neni 181
Arshivat dhe komunikimet zyrtare të Autoritetit

1. Arshivat e Autoritetit, kudo që të jenë vendosur do të jenë të pathyeshme.

2. Të dhënat në pronësi, sekretete industriale ose informacione të ngjashme dhe shënimet e personelit nuk do të vendosen në arshivat, të cilat janë të hapura për inspektim publik.

3. Në lidhje me komunikimet e tij zyrtare, Autoritetit do t'i akordohet nga çdo Shtet Palë një trajtim jo më pak i favorshëm sesa ai që i jepet nga ky shtet organizatave të tjera ndërkombëtare.

Neni 182

Privilegjet dhe imunitetet e personave të caktuar të lidhur me Autoritetin

Përfaqësuesit e Shteteve Palë që ndjekin mbledhjet e Asamblesë, Këshillit ose organeve të Asamblesë ose Këshillit, si dhe Sekretari i Përgjithme stafi i Autoritetit, do të gëzojnë në territoret e secilit Shtet Palë:

(a) Imunitet nga çdo proces gjyqësor lidhur me veprimet e kryera nga ata në ushtrimin e funksioneve të tyre, me përjashtim kur shteti të cilin ata përfaqësojnë ose Autoriteti, përkatësisht, shprehen për heqjen e këtij imuniteti në raste të veçanta.

(b) Nëse ata nuk janë shtetas të një Shteti Palë, përjashtimet e njëjta nga kufizimet kufitare, kërkesat e regjistrimit dhe detyrimet e shërbimeve kombëtare, të njëjtat lehtësira përsa i përket kufizimit të shkëmbimit, si dhe të njëjtin trajtim në lidhje me lehtësirat e udhëtimit siç u janë akorduar nga ky shtet përfaqësuesve, zyrtarëve dhe të punësuarve të të njëjtit rang të Shteteve të tjera Palë.

Neni 183

Përjashtimi nga taksat dhe taksat doganore

1. Brenda qëllimit të veprimtarisë së tij zyrtare, Autoriteti, asetet e tij dhe pronat, të ardhurat e tij dhe operacionet e transaksionet të autorizuara nga kjo Konventë, do të përjashtohen nga të gjitha taksat direkte dhe mallrat e importuara ose eksportuara për përdorim të tij zyrtar, do të përjashtohen nga të gjitha taksat doganore. Autoriteti nuk do të kërkojë përjashtim për taksa që nuk janë gjë tjetër vetëm pagesa për shërbimet e bëra.

2. Kur blerjet e mallrave ose shërbimet e një vlere substanciale të nevojshme për veprimtarinë zyrtare të Autoritetit janë bërë nga ose në emër të Autoritetit dhe kur çmimi i mallrave ose shërbimeve të tilla përfshin taksa ose pagesa, masat e duhura, sa më shumë të jetë e praktikueshme do të merren nga Shtetet Palë për të garantuar përjashtimin nga taksa të tilla pse pagesa ose të parashikojnë iimbursimin e tyre. Mallrat e importuara ose blerjet sipas një përjashtimi të parashikuar në këtë nen nuk do të shiten ose të disponohen ndryshe në territorin e Shtetit Palë, e cili garanton përjashtimin, me përjashtim mbi bazën e kushteve të rëna dakord me Shtetin Palë.

3. Asnjë taksë nuk do të mblidhet nga Shtetet Palë në lidhje me rrogat dhe shpërblimet e paguara ose çdo formë tjetër pagese e bërë nga Autoriteti, Sekretarit të Përgjithshëm ose stafi i Autoritetit, si dhe ekspertëve që kryejnë misione për Autoritetin, të cilët nuk janë shtetasit e tyre.

NËNSEKSIONI H. PEZULLIMI I USHTRIMIT TË TË DREJTAVE DHE PRIVILEGJEVE TË ANËTARVE

Neni 184

Pezullimi i ushtrimit të së drejtës së votës

Një Shtet Palë, i cili është në debi për pagesën e kontributeve financiare të Autoritetit nuk do të ketë votë nëse shuma e debisë së tij është e barabartë ose tejkalon shumën e kontributeve që duhej të paguante për dy vite të plota. Asambleja, megjithatë, mund të lejojë anëtarë të tillë për të votuar nëse ajo bindet që faji për mospagesën është përtej aftësive të anëtarit.

Neni 185

Pezullimi i ushtrimit të së drejtës dhe privilegjeve të anëtarësisë

1. Një Shtet Palë, i cili ka thyer rëndë dhe vazhdimisht, parashikimet e kësaj pjese mund të pezullohet nga ushtrimi i të drejtave dhe privilegjeve të anëtarësisë nga Asambleja me rekomandimin e Këshillit .

2. Asnjë veprim nuk do të merret sipas paragrafit 1 derisa Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit ka shpallur se një Shtet Palë ka thyer rëndë dhe vazhdimisht parashikimet e kësaj pjese.

SEKSIONI 5. ZGJIDHJA E DISKUTIMEVE DHE OPINIONET KËSHILLUESE

Neni 186

Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit të Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit

Krijimi i dhomës së diskutimeve të shtratit të detit dhe mënyra sesi ajo do të ushtrojë juridiksionin e saj do të udhëhiqet nga parashikimet e këtij seksioni, të Pjesës XV dhe të aneksit VI.

Neni 187

Juridiksioni i dhomës së diskutimeve të shtratit të detit

Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit do të ketë juridiksion sipas kësaj pjese dhe anekseve përkatëse në diskutimet në lidhje me veprimtaritë në Zonë që futen brenda kategorive të mëposhtme:

(a) Diskutimet ndërmjet Shteteve Palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj pjese dhe aneksit përkatës;

(b) Diskutimet ndërmjet një Shteti Palë dhe Autoritetit në lidhje me:

(i) veprime ose pengesa të Autoritetit ose të një Shteti Palë që mendohet se është thyerje e kësaj pjese ose aneksit që lidhet me të ose rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit të adaptuera në përputhje me sa bëhet fjalë;

(ii) veprime të Autoritetit të menduara sikur janë jashtë juridiksionit ose një keqpërdorim i fuqive.

(c) Diskutimeve ndërmjet Palëve në një kontratë, të cilat janë Shtete Palë, Autoritetit ose Ndërmarrjes, një ndërmarrje shtetërore dhe personat fizikë ose juridik të referuar në nenin 153, paragrafi 2 (b), në lidhje me:

(i) interpretimin ose zbatimin e një kontrate të rëndësishme ose një një plani pune;

(ii) veprime ose gabime të një Pale në një kontratë që lidhet me veprimtarinë në zonë dhe i drejtuar Palës tjetër ose që ndikon direkt interesat e saj të ligjshme;

(d) Diskutimeve ndërmjet Autoritetit dhe një kontraktori të ardhshëm, i cili është sponsorizuar nga një shtet siç parashikohet në nenin 153, paragrafi 2 (b) dhe ka plotësuar rregullisht kushtet e referuara në aneksin III, neni 4, paragrafi 6 dhe nenit 13, paragrafi 2, në lidhje me refuzimin e një kontrate ose çështje ligjore të ngritur në negociatat e kontratës.

(e) Diskutimeve ndërmjet Autoritetit dhe një Shteti Pale, një ndërmarrje shtetërore ose një personi fizik ose juridik të sponsorizuar nga Shtet Palë siç parashikohet në nenin 153, paragrafi 2(b), ku mendohet se Autoriteti ka kaluar përgjegjësitë siç parashikohet në aneksin III, neni 22;

(f) Çdo diskutim tjetër për të cilin juridiksioni i dhomës është parashikuar veçanërisht në këtë Konventë.

Neni 188

Parashtrimi i diskutimeve në një dhomë speciale të Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit ose të një dhome ad hoc të Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit ose të bashkëlidhjes së një arbitrazhi tregtar

1. Diskutimet ndërmjet Shteteve Palë referuar në nenin 187, nënparagrafi (a), mund të parashtrohen:

(a) me kërkesën e Palëve në diskutim, një dhome speciale të Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit që formohet në përputhje me aneksin IV, neni 15 dhe 17;

(b) me kërkesën e secilës Palë në diskutim, tek një dhomë ad hoc e Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit që formohet në përputhje me aneksin IV, neni 36.

2. (a) Diskutimet në lidhje me interpretimet ose zbatimet e një kontrate të referuar në nenin 187, nënparagrafi (c) (i) do t'i parashtrohet, me kërkesën e çdo Pale në diskutim, një arbitrazhi tregtar, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe. Një gjykatë arbitrazhi tregtare, të cilës i është parashtruar diskutimi nuk do të ketë juridiksionin të vendosë për çdo çështje të interpretimit të kësaj Konvente. Kur diskutimi përfshin gjithashtu një çështje të interpretimit të Pjesës IX që lidhen me të, në lidhje me veprimtaritë në Zonë, kjo çështje do t'i referohet Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit për një rregull.

(b) Në qoftë se, në fillimin ose gjatë vazhdimit të një arbitrimi të tillë gjykata e arbitrazhit përcakton, si me kërkesën e çdo Pale në diskutim ose dhe proprio motu, ky vendim i saj varet nga rregullat e Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit, atëherë një gjykatë e tillë do t'i referojë çështje të tilla Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit për këto rregulla. Gjykata e arbitrazhit do të vazhdojë pastaj procedimin për të dhënë vendimin e saj në përputhje me këto rregulla të Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit.

(c) Në mungesë të një parashikimi në kontratë mbi procedurat e arbitrazhit që duhet të zbatohen në diskutim, arbitrazhi do të udhëhiqet në përputhje me rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL ose rregulla të tilla të tjera arbitrazhi, siç mund të përshkruhen në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, përderisa Palët në diskutim të bien dakord ndryshe.

Neni 189

Kufizimi i juridiksionit përsa i përket vendimeve të Autoritetit

Dhoma e Diskutimeve të Shtratit të Detit nuk do të ketë juridiksion përsa i përket ushtrimit nga Autoriteti të fuqive të tij arbitrare në përputhje me këtë pjesë, në asnjë rast ajo nuk do zëvendësojë arbitraritetin e saj më atë të të Autoritetit. Pa asnjë paragjykim të nenit 191, në ushtrimin e juridiksionit të saj mbi bazën e nenit 187, Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit nuk do ta prononcojë veten e saj me çështje edhe kur nëse ndonjë rregull, rregullore ose procedurë e Autoritetit është në përputhje me këtë Konventë dhe të mos deklarojë të pavlefshme ndonjë rregull, rregullore ose procedurë të tillë. Juridiksioni i saj në lidhje me këtë do të kufizohet për vendosjen e reklamimeve që zbatimi i ndonjë rregulli, rregulloreje ose procedure të Autoritetit në raste të veçanta do të jetë në konflikt me detyrimet kontraktuale të Palëve në diskutim ose me detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente. Reklamimet që lidhen me tejkalimin e juridiksionit ose keqpërdorimin e fuqive dhe reklamimet për dëmet që duhet të paguhen ose pagesa të tjera që duhet t'i jepen Palës së interesuar për një faj të Palës tjetër për të zbatuar detyrimet e saj kontraktuale ose detyrimet e saj sipas kësaj Konvente.

Neni 190

Pjesëmarrja dhe paraqitja e Shteteve Palë sponsorizuese në procedim

1. Nëse një person fizik ose juridik është Palë në një diskutim referuar nenit 187, shtetit sponsorizues do t'i jepet një njoftim dhe si rrjedhim, do të ketë të drejtën të marrë pjesë në procedurat duke parashtruar deklarata me shkrim ose me gojë.

2. Nëse një veprim është ngritur kundër një Shteti Palë, nga një person fizik ose juridik i sponsorizuar nga një Shtet tjetër Palë në një diskutim referuar nenit 187, nënparagrafi (c), shteti përgjegjës mund t'i kërkojë shtetit që sponsorizon personin për t'u paraqitur në procedurat në emër të këtij personi. Nëse nuk arrihet paraqitja, shteti përgjegjës mund të rregullojë të paraqitet me anën e një personi juridik të shtetësisë së tij.

Neni 191

Opinionet këshilluese

Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit do të japë opinione këshilluese me kërkesën e Asamblesë ose të Këshillit mbi çështjet ligjore të ngritura brenda qëllimit të veprimtarisë së tyre. Opinione të tilla do të jepen si një çështje urgjente.

PJESA XII

MBROJTJA DHE KONSERVIMI I AMBIENTIT DETAR

SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 192

Detyrime të përgjithshme

Shtetet kanë detyrimin të mbrojnë dhe konservojnë ambientin detar.

Neni 193

E drejta sovrane e shteteve të shfrytëzojnë burimet natyrore të tyre

Shtetet kanë të drejtën sovrane të shfrytëzojnë burimet natyrore të tyre mbi bazën e politikave ambientaliste të tyre dhe në përputhje me detyrat e tyre për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar.

Neni 194

Masat për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar

1. Shtetet do të marrin individualisht ose së bashku si është më e përshtashme, të gjitha masat mbi bazën e kësaj Konvente që janë të nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar nga çdo burim, duke përdorur për këtë qëllim mjetet me të mira të praktikueshme në dispozicion të tyre dhe në përputhje me aftësitë e tyre dhe ato do të përpiqen të harmonizojnë politikat e tyre në lidhje me këtë.

2. Shtetet do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që veprimtaritë sipas juridiksionit të tyre ose kontrollit janë të drejtuara që të mos shkaktojnë dëme nga ndotja e shteteve të tjera dhe ambientit të tyre dhe që ndotja që vjen nga një incident ose veprimtari sipas këtij juridiksioni ose kontrolli mos të përhapet përtej Zonave ku ushtrohen të drejtat sovrane në përputhje me këtë Konventë.

3. Masat e marra mbi bazën e kësaj pjese do të kenë të bëjnë me të gjitha burimet e ndotjes së ambientit detar. Këto masa do të përfshijnë inter-alia, ato të parashikuara për minimizimin e shtrirjes sa më të mundshme të madhe:

(a) Heqjen e substancave toksike, të dëmshme ose mbytëse, në mënyrë të veçantë atyre që janë të qëndrueshme nga burimet në baza tokësore, nga ose nëpërmjet atmosferës ose me anën e transferimit.

(b) Ndotjes nga anijet, në mënyrë të veçantë të masave për parandalimin e aksidenteve dhe që kanë të bëjnë me emergjencë, duke siguruar sigurimin e operimeve në det, duke parandaluar shkarkimet me paramendim ose jo dhe duke rregulluar projektet, konstruksionet, pajisjet operimin dhe ekuipazhimin e anijeve.

(c) Ndotjen nga instalime dhe pajisje që përdoren në eksplorim dhe shfrytëzim të burimeve natyrore të shtratit të detit dhe nëntokës së tij, në mënyrë të veçantë masa për parandalimin e aksidenteve dhe që kanë të bëjnë me emergjenca, duke siguruar operacionet në det dhe duke rregulluar projektet, konstruksionet, pajisjet, operimin dhe ekuipazhimin e instalimeve ose pajisjeve të tilla.

(d) Ndotjen nga pajisje dhe instalime të tjera që operojnë në ambientin detar, në mënyrë të veçantë masa për parandalimin e aksidenteve dhe që kanë të bëjnë me emergjenca, duke siguruar operacionet në det dhe duke rregulluar projektet, konstruksionet, pajisjet, operimin dhe ekuipazhimin e instalimeve ose pajisjeve të tilla.

4. Gjatë marrjes së masave për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar, shtetet do të shmangen nga ndikimi i pajustifikueshëm me veprimtaritë e kryera nga shtetet e tjera në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe në mbështetje të detyrave të tyre në përputhje me këtë Konventë.

5. Masat e marra në përputhje me këtë pjesë do të përfshijnë ato të nevojshme për ruajtjen dhe konservimin e ekosistemeve të rrallë dhe të dobët si dhe gjithashtu prishjen e qendrave të banimit, kërcënimin ose rrezikimin e specieve dhe formave të tjera të jetës detare.

Neni 195

Detyra e mostransferimit të dëmeve ose rreziqeve ose transformimit të një tipi ndotje në tjetër

Në marrjen e masave për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar, shtetet do të veprojnë në mënyrë të tillë që të mos transferojnë direkt ose indirekt, dëme ose rreziqe nga një zonë në tjetrën ose të transformojnë një tip ndotje në tjetër.

Neni 196

Përdorimi i teknologjive ose paraqitja e një alieni ose specie të re

1. Shtetet do të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar, që rezultojnë nga përdorimi i teknologjive sipas juridiksionit të tyre ose kontrollit, ose paraqitjes së specieve të vjetra ose të reja, me paramendim ose aksidentalisht në një pjesë të veçantë të ambientit detar, të cilat mund të sjellin ndryshime thelbësore dhe të dëmshme.

2. Ky nen nuk do të prekë zbatimin e kësaj Konvente në lidhje me parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar.

SEKSIONI 2. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE GLOBAL

Neni 197

Bashkëpunimi mbi baza globale ose rajonale

Shetet do të bashkëpunojnë mbi një bazë globale dhe përkatësisht mbi baza rajonale, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, në formulimin dhe përpunimin e rregullave ndërkombëtare, standardeve dhe procedurave e praktikave të rekomanduara, bazuar në këtë Konventë për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar duke marrë në konsideratë karakteristikat e cilësive rajonale.

Neni 198

Lajmërimi i dëmeve aktuale ose iminente

Kur një shtet bindet për një rast në të cilin ambienti detar është në një rrezik iminent ose është duke u dëmtuar ose është dëmtuar nga një ndotje, ai menjëherë njofton shtetet e tjera, të cilat duket se do të preken nga dëme të tilla, si dhe organizatat ndërkombëtare kompetente.

Neni 199

Planet e kontingjencës kundër ndotjes

Në rastet e referuara në nenin 198, shtetet e prekura në Zonë, në përputhje me aftësitë e tyre dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të bashkëpunojnë, sa më gjerë të jetë e mundur, në eleminimin e efekteve të ndotjes ose parandalimin ose minimizimin e dëmeve. Për këtë qëllim do të zhvillojnë dhe promocojnë së bashku planet e kontigjencës për kundërpërgjigje incidenteve të ndotjes në ambientin detar.

Neni 200

Studimet, programet e kërkimit dhe shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve

Shtetet do të bashkëpunojnë, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, për qëllimet e nxitjes së studimeve, do të ndërmarrin programe të kërkimeve shkencore dhe inkurajojnë shkëmbimin e të dhënave dhe informatave të fituara rreth ndotjes së ambientit detar. Ato do të përpiqen të marrin pjesë aktivisht në programet rajonale dhe globale për të fituar dije për vlerësimin e natyrës dhe shtrirjen e ndotjes, përhapja e saj, rruga që ndjek, rreziqet dhe zgjidhjet.

Neni 201

Kriteret shkencore për rregullat

Në dritën e informatave dhe të dhënave të fituara mbi bazën e nenit 200, shtetet do të bashkëpunojnë, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, në krijimin e kritereve përkatëse shkencore për formulimin dhe përpunimin e rregullave, standardeve dhe procedurave e praktikave të rekomanduara për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar .

SEKSIONI 3. NDIHMA TEKNIKE

Neni 202
Asistenca shkencore dhe teknike për vendet në zhvillim

Shtetet direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente do të:

(a) nxisin programe të ndihmës teknike, shkencore, edukuese dhe të tjera për vendet në zhvillim për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar dhe parandalimin, reduktimin e kontrollin e ndotjes detare. Një asistencë e tillë do të përfshijë inter-alia:

(i) trajnimin e personelit të tyre teknik dhe shkencor;

(ii) lehtësimin e pjesëmarrjes së të tyre në programet ndërkombëtare;

(iii) furnizimin e tyre me pajisjet dhe aparaturat e nevojshme;

(iv) zgjerimin e aftësive të tyre për prodhimin e pajisjeve të tilla;

(v) këshillim për zhvillimin e pajisjeve për monitorizimin, kërkimin, edukimin dhe programe të tjera;

(b) dhënien e asistencës përkatëse, në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim, për minimizimin e efekteve të incidenteve më të mëdha, të cilët mund të shkaktojnë ndotje serioze të ambientit detar;

(c) dhënien e ndihmës së duhur, në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim, në lidhje me përgatitjen e vlerësimit ambiental.

Neni 203
Trajtimi preferencial i shteteve në zhvillim

Shtetet në zhvillim, për qëllimet e parandalimit, reduktimit, kontrollit të ndotjes së ambientit detar ose minimizimit të efekteve të tij, do të jenë një preferencë e garantuar nga organizatat ndërkombëtare në:

(a) alokimin e fondeve përkatëse dhe asistencës teknike;

(b) në përdorimin e shërbimeve të tyre të specializuara;

SEKSIONI 4. MONITORIZIMI DHE VLERËSIMI AMBIENTAL

Neni 204
Monitorizimi i rreziqeve ose efekteve të ndotjes

1. Shtetet, mbi bazën e të drejtave të shteteve të tjera, do të përpiqen sa më shumë të jetë e mundur praktikisht, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, të vrojtojnë, masin, vlerësojnë dhe analizojnë me metoda të njohura shkencore, rreziqet ose efektet e ndotjes së ambientit detar.

2. Në veçanti, shtetet do të mbajnë nën survejim efektet e çdo veprimtarie, të cilat mund të lejojnë ose në të cilat ato përcaktojnë nëse aktivitete të tilla mund të ndotin ambientin detar.

Neni 205
Publikimet e raporteve

Shtetet do të publikojnë raportet e rezultateve të fituara mbi bazën e nenit 204 ose do të japin raporte të tilla në intervale të caktuara për organizatat ndërkombëtare kompetente, të cilat do t'i bëjnë ato të vlefshme për të gjitha shtetet.

Neni 206
Vlerësimi dhe efekti potencial i veprimtarive

Kur shtetet kanë arsye të besojnë që veprimtaritë e planizuara sipas juridiksionit ose kontrollit të tyre mund të shkaktojnë ndotje thelbësore të ndryshimeve të rëndësishme dhe të rrezikshme të ambientit detar, ato sa më shumë të jetë e praktikueshme do të vlerësojnë efektet potenciale dhe do të

komunikojnë raporte të rezultateve të vlerësimeve të tilla sipas mënyrës së parashikuar në nenin 205.

SEKSIONI 5. RREGULLAT NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, DHE KONTROLLIN E NDOTJES SË AMBIENTIT DETAR

Neni 207
Ndotja nga burimet e bazave tokësore

1. Shtetet do të adaptojnë ligje dhe rregulla për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar nga burimet e bazave tokësore, duke përfshirë lumenjtë, deltat, vijat e tubacioneve dhe strukturat, duke marrë në konsideratë rregullat ndërkombëtare të rëna dakord, standardet dhe procedurat e praktikat e rekomanduara.

2. Shtetet do të marrin masat e tjera siç mund të jetë e nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla.

3. Shtetet do të përpiqen të harmonizojnë politikat e tyre në lidhje me këtë në nivelin përkatës rajonal.

4. Shtetet, duke vepruar në mënyrë të veçantë nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike, do të përpiqen të krijojnë rregulla globale dhe rajonale, standarde dhe procedura e praktika të rekomanduara për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar nga burimet e bazave tokësore, duke marrë parasysh karakteristikat e cilësive rajonale, fuqinë ekonomike të shteteve në zhvillim dhe nevojat e tyre për zhvillim ekonomik. Rregulla të tilla standarde dhe procedura e praktika të rekomanduara do të riekzaminohen herë pas here kur të jetë nevoja.

5. Ligjet, rregulloret, masat, rregullat, standardet, procedurat dhe praktikat e rekomanduara të referuara në paragrafet 1, 2 dhe 4 do të përfshijnë ato të projektuara për minimizimin sa më shumë të jetë e mundur të heqjes së substancave toksike, të dëmshme dhe mbytëse, në mënyrë të veçantë ato që janë konstante në ambientin detar.

Neni 208
Ndotja nga veprimtaritë e shtratit të detit mbi bazën e juridiksionit kombëtar

1. Shtete bregdetare do të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar të ngritura nga ose në lidhje me veprimtaritë e shtratit të detit në mbështetje të legjislacionit të tyre dhe nga ishujt artificial, instalimet e strukturat nën juridiksionin e tyre mbi bazën e nenit 60 dhe 80.

2. Shtetet do të marrin të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla.

3. Ligjet, rregulloret dhe masat nuk do të jenë më pak efektive se rregullat ndërkombëtare, standardet dhe procedurat e praktikave të rekomanduara.

4. Shtetet do të përpiqen të harmonizojnë politikat e tyre në lidhje me nivelet përkatëse rajonale.

5. Shtetet, që veprojnë në mënyrë të veçantë nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike, do të krijojnë rregulla globale dhe rajonale, standarde dhe procedura e praktika të rekomanduara për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar referuar në paragrafin 1. Rregulla të tilla, standarde dhe praktika e procedura të rekomanduara do të riekzaminohen herë pas here sipas nevojës.

Neni 209
Ndotja nga aktivitetet në Zonë

1. Rregullat ndërkombëtare, rregulloret dhe procedurat do të krijohen në përputhje me Pjesën e XI për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar nga veprimtaritë në Zone. Rregulla, rregullore dhe procedura të tilla do të riekzaminohen herë pas here sipas nevojës.

2. Në mbështetje të parashikimeve më thelbësore të këtij seksioni, shtetet do të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes së ambientit detar nga

veprimtaritë në Zonë të ndërmarra nga anijet, instalimet, strukturat dhe pajisje të tjera që mbajnë flamurin e tyre ose të regjistrit te tyre, ose që operojnë sipas autoritetit të tyre, sipas rastit. Kërkesat e ligjeve, rregulloreve të tilla nuk do të jenë më pak efektive sesa rregullat, rregulloret dhe procedurat ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1.

Neni 210
Ndotja nga transferimi

1. Shtetet do të adaptojnë ligje dhe rregulla, që parandalojnë, reduktojnë dhe kontrollojnë ndotjen e ambientit detar nga transferimi.

2. Shtetet do te marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla.

3. Ligje të tilla, rregullore dhe masa do të sigurojnë që transferimi të mos kryhet pa lejen e autoriteteve kompetente të shteteve.

4. Shtetet, duke vepruar në mënyrë të veçantë nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike, do të përpiqen të krijojnë rregulla globale dhe rajonale, standardet dhe procedurat e praktikat e rekomanduara për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve të tilla. Rregulla të tilla, standarde dhe procedura e praktika të rekomanduara do të riekzaminohen herë pas here sipas nevojës.

5. Transferimi brenda ujërave territoriale dhe zonës ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental nuk do të kryhet pa miratimin më përpara të shtetit bregdetar, i cili ka të drejtën e lejes, rregullimit dhe kontrollit të një transferimi të tillë pas konsiderimit të duhur të çështjeve me shtetet e tjerë, të cilët për arsye të situatës së tyre gjeografike mund të ndikohen sidoqoftë në të kundërt.

6. Ligjet kombëtare, rregulloret dhe masat nuk do të jenë më pak efektive në parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla sesa rregullat dhe standardet globale.

Neni 211
Ndotja nga anijet

1. Shtetet, duke vepruar në mënyrë të veçantë nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike, do të krijojnë rregulla ndërkombëtare dhe standarde për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga anijet dhe do të nxisin adaptimin, në të njëjtën mënyrë, kurdoherë që është e përshtashme, të sistemeve të rrugëve të projektuara për minimizimin e kërcënimit të aksidenteve, të cilat mund të shkaktojnë ndotje të ambientit detar, duke përfshirë vijën bregdetare dhe dëmin e ndotjes në lidhje me interesat e shteteve bregdetare. Rregulla të tilla e standarde, në të njëjtën mënyrë, do të riekzaminohen herë pas here kur është e nevojshme.

2. Shtetet do të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga anijet që mbajnë flamurin e tyre ose regjistrin e tyre. Ligjet e tilla dhe rregulloret së paku do të kenë të njëjtin efekt si ato të pranuara në përgjithësi për rregullat e standardet ndërkombëtare nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike të përgjithshme.

3. Shtetet, të cilat krijojnë kërkesa të veçanta për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar si kusht për hyrjen e anijeve të huaja në portet e tyre ose në ujërat e brendshme ose për një prekje në terminalet jashtë bregut do t'i japin publicitetin e duhur kërkesave të tilla dhe do t'i komunikojnë ato organizatave kompetente ndërkombetare. Kurdoherë kërkesa të tilla krijohen në formë të tillë të njëjtë nga dy ose më shumë shtete bregdetare në një përpjekje për të harmonizuar politikat. Komunikimi do të tregojë cilët shtete marrin pjesë në marrëveshje të tilla të përbashkëta. Secili shtet do të kërkojë kapitenit të anijes që mban flamurin ose regjistrin e tij, kur lundron brenda ujërave territoriale të një shteti që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët të tillë, që të japë, me kërkesën e këtij shteti, informacion nëse ai është duke vazhduar në drejtim të një shteti të të njëtit rajon që merr pjesë në marrëveshje të përbashkëta të tilla dhe nëse është kështu, të tregojë nëse ai është në përputhje me kërkesat për hyrje në portin e këtij shteti. Ky nen është pa paragjykim të ushtrimit nga anija të së drejtave të saj për kalimin paqësor ose të zbatimit të nenit 25, paragrafi 2.

4. Shtetet bregdetare, në ushtrimin e sovranitetit të tyre, brenda ujërave territoriale, mund të

adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve detare nga anijet e huaja, duke përfshirë anijet që ushtrojnë të drejtën e kalimit paqësor. Ligje dhe rregullore të tilla në përputhje me Pjesën 11, seksioni 3 nuk do të pengojne kalimin paqësor të anijeve të huaja.

5. Shtetet bregdetare, për qëllimet e presionit të parashikuar në seksionin 6, mundet në lidhje me zonat e tyre ekskluzive ekonomike, të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet duke u përputhur dhe duke i dhënë efekt rregullave të pranuara ndërkombëtare dhe standardeve të krijuara nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente dhe konferencave të përgjithshme diplomatike.

6. (a) Kur rregullat ndërkombëtare dhe standardet e referuara në paragrafin 1 janë të papërshtashme për të plotësuar rrethanat speciale dhe shtetet bregdetare kanë arsye të besojnë që një zonë e veçantë dhe e përcaktuar qartë e zonave ekonomike ekskluzive të shteteve bregdetare, është një sipërfaqe ku adoptimi i masave mandatore speciale për parandalimin e ndotjes nga anijet kërkohet për arsye të njohura teknike në lidhje me kushtet e tij oqeanografike dhe ekologjike, si dhe përdorimin ose mbrojtjen e burimeve të saj dhe karakterin e veçantë te trafikut të tij, shtetet bregdetare apo konsultimeve përkatëse nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente me çdo shtet tjetër të interesuar, mundet për këtë zonë, t'i drejtojnë një komunikim kësaj organizate, duke i parashtruar evidenca teknike dhe shkencore në mbështetje dhe informacion mbi lehtësirat e nevojshme marrëse.

Brenda 12 muajve mbas marrjes së një komunikimi të tillë, organizata do të përcaktojë nëse kushtet në këtë zonë korrespondojnë me kërkesat e vendosura më lart. Nëse organizata vendos kështu, shetete bregdetare, mundet për këtë zonë, të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet duke zbatuar rregulla dhe standarde të tilla ose praktika novigacionale siç janë zbatuar, nëpërmjet organizatës për zona speciale. Këto ligje dhe rregullore nuk do të hyjnë në fuqi për anijet e huaja brenda një periudhe prej 15 muajsh të parashtrimit të tyre ndaj organizatës.

(b) Shtetet bregdetare do të publikojnë kufijtë e çdo zone të veçantë dhe të përcaktuar qartë.

(c) Nëse shtetet bregdetare mendojnë të adaptojnë ligje dhe rregullore plotësuese për të njëjtën zonë për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet, ato, kur parashtrojnë komunikimin e përmendur më sipër, në të njëjtën kohë do të njoftojnë dhe organizatën. Ligje dhe rregullore të tilla mund t'i përkasin shkarkimeve dhe praktikave navigacionale, por nuk do t'i kërkojnë anijeve të huaja të vrojtojnë standardet e projektit, konstruksionit, drejtimit dhe ekuipazhimit, përveçse standardeve dhe rregullave ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi. Ato do të bëhen të zbatueshme për anijet e huaja 15 muaj pas parashtrimit për komunikim kundrejt organizatës, me kusht që organizata të bjerë dakord brenda 12 muajve pas parashtrimit të komunikimit.

7. Rregullat dhe standardet ndërkombëtare të referuara në këtë nen duhet të përfshijnë inter-alia ato që lidhen me njoftimin e shpejtë të shteteve bregdetare, bregdeti i të cilëve ose interesat përkatëse mundet nga incidentet e ndodhura, duke përfshirë dhe avaritë detare, të cilat përfshijnë shkarkimet ose mundësinë e shkarkimeve.

Neni 212

Ndotja nga ose nëpërmjet atmosferës

1. Shtetet do të adaptojnë ligje dhe rregullore për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga e nëpërmjet atmosferës, i zbatueshëm për hapësirën ajrore nën sovranitetin e tyre dhe për anijet ose aeroplanët, që mbajnë flamurin ose regjistrin e tyre, duke marrë në konsideratë rregullat standarde ndërkombëtare të rëna dakord dhe procedurat e praktikat e rekomanduara dhe sigurinë e navigacionit ajror.

2. Shtetet do të marrin të gjitha masat që mund t'ju duken të nevojshme për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla.

3. Shtetet, duke vepruar në mënyrë të veçantë nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare ose konferencave diplomatike, do të përpiqen të krijojnë rregulla, standarde globale ose rajonale dhe procedura e praktika të rekomanduara për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të tilla.

SEKSIONI 6. USHTRIMI I FORCËS

Neni 213

Ushtrimi i forcës në lidhje me ndotjen nga burimet e bazave tokësore

Shtetet do të ushtrojnë forcën për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tyre të adaptuara në përputhje me nenin 207 dhe do të adaptojnë ligje dhe rregulla e do të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të krijuara nga organizatat kompetente ndërkombëtare ose konferencat diplomatike për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga burimet e bazave tokësore.

Neni 214

Ushtrimi i forcës në lidhje me ndotjet nga veprimtaritë e shtratit të detit

Shtetet do të ushtrojnë forcën për ligjet dhe rregulloret e tyre të adaptuara në përputhje me nenin 208 dhe do të adaptojnë ligje dhe rregulla, dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave e standardeve ndërkombëtare të krijuara nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencës diplomatike për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar të dala nga ose në lidhje me veprimtaritë e shtratit të detit mbi bazën e juridiksionit të tyre, si dhe nga ishujt artificial, instalimet dhe strukturat nën juridiksionin e tyre mbi bazën e nenit 60 dhe 80.

Neni 215

Ushtrimi i forcës në lidhje me ndotjen nga veprimtaritë në Zonë

Ushtrimi i forcës për rregullat ndërkombëtare, rregulloret dhe procedurat e krijuara në Pjesën XI për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga veprimtaritë në Zonë do të udhëhiqet nga kjo pjesë.

Neni 216

Ushtrimi i forcës në lidhje me ndotjet nga transferimi

1. Ligjet dhe rregulloret e adaptuara në përputhje me këtë Konventë dhe rregullat e standardet ndërkombëtare në fuqi të krijuara nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencës diplomatike për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga transferimi do të zbatohen me forcë:

(a) nga shteti bregdetar në lidhje me transferimin brenda ujërave territoriale ose zonës ekskluzive ekonomike të tij ose në shelfin kontinental të tij;

(b) nga flamuri i shtetit në lidhje me anijet dhe hidroplanët që mbajnë flamurin ose regjistrin e tij;

(c) nga çdo shtet në lidhje me veprime të ngarkimit të mbeturinave ose materialeve të tjera që ndodhin brënda territorit të tij ose në terminalet jashtë bregut të tij.

2. Asnjë shtet nuk është i detyruar mbi bazën e këtij neni të ngrejë procedime, kur një shtet tjetër ka ngritur gjithashtu procedime në përputhje me këtë nen.

Neni 217

Ushtrimi i forcës nga flamuri i shtetit

1. Shtetet do të sigurojnë përputhjen e anijeve që mbajnë flamurin e tyre ose regjistrin e tyre me rregullat ndërkombëtare dhe standardet në fuqi, të krijuara nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencës dipllmatike dhe me ligjet dhe rregulloret e tyre të adaptuara në përputhje me këtë Konventë për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga anijet dhe respektivisht do të adaptojnë ligje dhe rregullore dhe do të marrin masa të tjera të nevojshme për zbatimin e tyre. Flamuri i shtetit do të parashikojnë për ushtrimin efektiv të forcës për rregulla të tilla, standarde, ligje dhe rregullore respektivisht kur një thyerje ndodh.

2. Shtetet, në mënyrë të veçantë do të marrin të gjitha masat përkatëse, në mënyrë që te sigurojnë, që anijet që mbajnë flamurin ose regjistrin e tyre, janë të ndaluara për lundrim derisa ato të

vazhdojnë lundrimin në përputhje me kërkesat e rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. Duke përfshirë kërkesat në lidhje me projektin, konstruksionin, pajisjen dhe ekuipazhimin e anijeve.

3. Shtetet do të sigurohen që anijet që mbajnë flamurin ose regjistrin e tyre mbajnë në bord certifikatat e kërkuara dhe lëshuara mbi bazën e rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. Shtetet do të sigurohen që anijet që mbajnë flamurin e tyre inspektohen periodikisht, në më nyrë që të verifikojnë që certifikata të tilla janë në përputhje me kushtet aktuale të anijeve. Këto anije do të pranohen nga shtetet e tjera si një evidencë të kushteve të anijeve dhe do të konsiderohen sikur të kenë të njëjtën forcë si certifikatat e lëshuara nga ata, derikur të ketë fakte të qarta për të besuar që kushtet e anijeve nuk korrespondojnë thellësisht me të dhënat e certifikatës.

4. Nëse një anije kryen një thyerje të rregullave dhe standardeve të krijuara nga organizatat ndërkombëtare kompetente ose konferenca diplomatike e pergjithshme, flamuri i shtetit, pa asnjë paragjykim të neneve 218, 220 dhe 228, do të parashikojnë investigime të menjëhershme dhe kur është e përshtatshme të ngrenë procedime në lidhje me gjoja thyerjen, pavarësisht se ku ka ndodhur thyerja ose ku ndotja e shkaktuar nga një thyerje e tillë ka ndodhur ose dallohet.

5. Flamuri i shteteve që drejtojnë një investigim të një thyerjeje mund të kërkojnë ndihmë nga çdo shtet tjetër bashkëpunimi me të cilin mund të jetë i dobishëm në qartësimin e rrethanave të rastit. Shtetet do të përpiqen të plotësojnë kërkesat përkatëse të flamurit të shteteve.

6. Shtetet, me kërkesën me shkrim të çdo shteti, do të investigojnë çdo thyerje që mund të jetë kryer nga anijet që mbajnë flamurin e tyre. Nëse vërtetohet që ka fakte të mjaftueshme për të filluar procedimin në lidhje me një aludim thyerjeje. Shtetet flamur pa asnjë vonesë do të ngrejnë procedura të tilla në përputhje me ligjet e tyre.

7. Shtetet flamur menjëherë do të informojnë shtetin kërkues dhe organizatën ndërkombëtare kompetente mbi veprimin e marrë dhe rezultatet e tij. Informacione të tilla do të jenë të vlefshme për të gjitha shtetet.

8. Gjobat e parashikuara nga ligjet dhe rregulloret e shteteve për anijet që mbajnë flamurin e tyre do të jenë të përshtashme nga ashpërsia për të dekurajuar thyerjet kurdoherë që ato ndodhin.

Neni 218

Ushtrimi i forcës nga shtetet portual

1. Kur një anije është vullnetarisht brenda një porti ose në një terminal jashtë bregut të një shteti, ky shtet do të ndërmarrë investigime dhe kur faktet garantojnë, do të ngrejë procedim në lidhje me shkarkimin nga anija jashtë ujërave të brendshme, ujërave territoriale ose Zonës ekonomike ekskluzive të këtij shteti në thyerje të standardeve dhe rregullave ndërkombëtare në fuqi të krijuara nëpërmjet organizatës ndërkombëtare kompetente ose konferencës diplomatike të përgjithshme.

2. Asnjë procedim në bazë të paragrafit 1 nuk do të ngrihet në lidhje me thyerjet e shkarkimeve në ujërat e brendshme, ujërat territoriale ose zonën ekonomike ekskluzive të një shteti tjetër përderisa të kërkohet nga ky shtet, shteti flamur ose një shtet i dëmtuar ose I kërcënuar nga një thyerje shkarkimi, ose derisa një thyerje ka shkaktuar ose duket që po shkakton një ndotje në ujërat e brendshme, ujërat territoriale ose zonën ekonomike ekskluzive të një shteti që po ngre procedurat.

3. Kur një anije është vullnetarisht në një port ose në një terminal jashtë bregut të një shteti, ky shtet, sa më shumë të jetë praktike, do të jetë në përputhje me kërkesën nga çdo shtet flamur për investigimin e thyerjeve të tilla, pavarësisht se ku ndodh thyerja.

4. Shënimet e investigimit të bëra nga Shteti port mbi bazën e këtij neni do ‘ti transmetohen me kërkesë shtetit flamur ose shtetit bregdetar. Çdo procedurë e ngritur nga shteti port mbi bazën e një investigimi, mbi bazën e seksionit 7 do të pezullohet me kërkesën e shtetit bregdetar, kur thyerja ka ndodhur brenda ujërave të brendshme, ujërave territoriale ose zonës ekonomike ekskluzive. Faktet dhe shënimet e rastit, së bashku me një faturë ose sigurime të tjera financiare të postuara me autoritetin e shtetit port, do t’i transmetohet në këtë rast shtetit bregdetar. Një transmetim i tllë do të përfshijë vazhdimin e procedimit në shtetin port.

Neni 219

Masat në lidhje me lundrueshmërinë e anijeve për shmangien e ndotjes

Mbi bazën e seksionit 7, shtetet të cilët, me kërkesën e ose inciativën e tyre, kanë sqaruar që një anije brenda një porti ose porteve të tyre ose në një strukturë terminali të tyre jashtë bregut është në thyerje të rregullave dhe standardeve ndërkombëtare në fuqi në lidhje me lundrueshmërinë e anijeve dhe si rezultat, kërcënon me dëm ndaj ambientit detar, sa më praktike të jetë e mundshme, do të marrë masa administrative për parandalimin e anijeve nga lundrimi. Shtete të tilla mund të lejojnë anijet të vazhdojnë lundrimin vetëm pas riparimeve sa më të afërta të përshtatshme në kantier dhe pas zhvendosjes së shkaqeve të thyerjes, do të lejojnë anijen të vazhdojë menjëherë.

Neni 220

Ushtrimi i forcës nga shtetet bregdetare

1. Kur një anije ndodhet vullnetarisht në një port ose në një terminal jashtë bregut të një shteti, mbi bazën e seksionit 7, ky shtet mundet të ngrejë një procedurë në lidhje me çdo thyerje të ligjeve dhe rregulloreve të tij të adaptuara në përputhje me këtë Konventë ose rregullat dhe standardet ndërkombëtare për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet kur thyerja ndodh brenda ujërave territoriale ose zonës ekonomike ekskluzive të këtij shteti.

2. Kur ka fakte të qarta për të besuar që një anije, e cila lundron në ujërat territoriale të një shteti, gjatë kalimit të saj, ka thyer ligjet dhe rregullat e këtij shteti të adaptuara në përputhje me këtë Konventë ose standardet dhe rregullat ndërkombëtare në fuqi për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet, ky shtet, pa asnjë paragjykim në zbatimin e parashikimeve më të rëndësishme të Pjesës së II, seksioni 3 mund të ndërmarrë inspektime fizike të anijes në lidhje me thyerjet dhe mundet, kur faktet garantojnë kështu, të ngrejë procedime duke përfshirë dhe bllokimin e anijes, në përputhje të ligjeve të tij, mbi bazën e parashikimeve të seksionit 7.

3. Kur ka fakte të qarta për të besuar që një anije që lundron në zonën ekonomike ekskluzive ose ujërat territoriale të një shteti ka kryer në zonën ekonomike ekskluzive, një thyerje të rregullave dhe standardet ndërkombëtare për parandalimin, reduktimin, dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet ose ligjeve dhe rregulloreve të këtij shteti që janë në përputhje dhe zbatojnë rregulla dhe standarde të tilla, ky shtet mund t'i kërkojë anijes për t'i dhënë informacion lidhur me identitetin dhe portin e regjistrimit, portin e fundit dhe të ardhshëm të prekjes dhe informata të tjera përkatëse të kërkuara nëse një thyerje ka ndodhur.

4. Shtetet do të adaptojnë ligjet dhe rregulloret dhe do të marrin masat në mënyrë që anijet, të cilat mbajnë flamurin e tyre të jenë në përputhje me kërkesat për informatat mbi bazën e paragrafit 3.

5. Kur ka fakte të qarta për të besuar që nje anije e cila lundron në zonën ekonomike ekskluzive ose ujërat territoriale të nje shteti ka kryer, në zonen ekonomike ekskluzive një thyerje referuar paragrafit 3 që rezulton në një shkarkim thelbësor që shkakton kërcënim për një ndotje të madhe të ambientit detar, ky shtet mund të ndërmarrë inspektime fizike të anijes për çështjet në lidhje me thyerjet nëse anija refuzon të japë informacion ose nëse informacioni i dhënë nga anija manifeston ndryshime me situatën faktike të evidentuar dhe në se rrethanat e rastit justifikojnë një inspektim të tillë.

6. Kur ka fakte objektive të qarta që një anije që lundron në zonën ekonomike ekskluzive ose ujërat territoriale të një shteti, ka kryer një thyerje në zonën ekonomike ekskluzive që i referohet paragrafit 3, e cila rezulton në një shkarkim që shkakton dëmet më të mëdha ose kërcënon një dëm shumë të madh për bregdetin ose lidhet me interesat e shtetit bregdetar, ose për çdo burime të ujërave territoriale ose zonës ekonomike ekskluzive, ky shtet mundet, mbi bazën e seksionit 7, me kusht që fakti ta vërtetojë këtë, ngrenë një procedurë, duke përfshirë dhe bllokimin e anijes, në përputhje me ligjet e tij.

7. Pa marrë parasysh parashikimet e paragrafit 6, kurdoherë që janë ngritur procedurat përkatëse ose ndërmjet organizatës ndërkombëtare kompetente ose siç të jetë vendosur ndryshe, për përputhjen me kërkesat, faturimi ose siguri të tjera financiare duhet të sigurohen, shteti bregdetar nëse niset nga këto procedura duhet ta lejojë anijen të vazhdojë.

8. Parashikimet e paragrafeve 3, 4, 5, 6 dhe 7 zbatohen gjithashtu në lidhje me ligjet dhe rregullat kombëtare të adaptuara mbi bazën e nenit 211, paragrafi 6.

Neni 221

Masat për evitimin e ndotjes që del nga një avari detare

1. Asgjë në këtë pjesë nuk do të paragjykojë të drejtën e shteteve, mbi bazën e ligjit ndërkombëtar si atij të zakonshëm, ashtu dhe të atij konvencional, për të marrë masa dhe ushtruar forcë përtej ujërave territoriale, në proporcion me dëmin aktual ose të kërcënuar për të mbrojtur bregdetet e tyre ose interesat përkatëse, duke përfshirë peshkimin, nga ndotja ose kërcënimin nga ndotja që ndjek një avari detare ose vepron në lidhje me avari të tilla, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të pritet për rezultate me konsekuenca maksimale të dëmit.

2. Për qëllimet e këtij neni "avari detare" nënkuptojmë një përplasje anijesh, futje ujit ose incidenti tjetër të lundrimit ose ngjarje të tjera në bordin e anijes ose jashtë saj që rezultojnë në dëm material ose kërcënim iminent të një dëmi material për një anije ose ngarkesën.

Neni 222

Ushtrimi i forcës në lidhje me ndotjen nga ose nëpërmjet atmosferës

Shtetet do të ushtrojnë forcën brenda hapësirës ajrore nën sovranitetin e tyre ose lidhur me anijet që mbajnë flamurin ose anijeve dhe hidroplanëve që kanë regjistrin e tyre, ligjet dhe rregulloret e tyre të adoptuara mbi bazën e nenit 212, paragrafi 1, dhe me parashikimet e tjera të kësaj Konvente. Shtetet do të adaptojnë ligje e rregullore e do të marrin masat e tjera të nevojshme për zbatimin e rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të krijuara nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente ose konferencave diplomatike për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga e nëpërmjet atmosferës, në përputhje me të gjitha rregullat e rëndësishme ndërkombëtare e standardeve në lidhje me lundrimin e sigurtë.

SEKSIONI 7. SIGURITË

Neni 223

Masat për lehtësimin e procedurave

Në procedurat e krijuara mbi bazën e kësaj pjese, shtetet do të marrin të gjitha masat për lehtësimin e dëgjimit të dëshmitarëve dhe pranimin e fakteve të parashtruar nga autoritetet e një shteti tjetër ose nga organizatat kompetente ndërkombëtare dhe do të lehtësojnë ndjekjen e procedurave të tilla nga zyrtarë përfaqësues të organizatave kompetente ndërkombëtare, shteti flamur dhe çdo shtet i ndikuar nga ndotja e ngritur jashtë çdo thyerje. Zyrtarët përfaqësues që ndjekin procedura të tilla do të kenë të drejtën dhe detyrat siç mund të parashikohet në ligjet dhe rregullat kombëtare të ligjit ndërkombëtar.

Neni 224

Ushtrimi i fuqive të forcës

Fuqia e ushtrimit të forcës kundër anijeve te huaja sipas kësaj pjese mundet të ushtrohet vetëm nga nëpunës ose nga anije lufte, hidroplanë ushtarakë ose anije dhe hidroplanë të tjerë me shenja të dallueshme dhe të shkruara qartë sikur të ishin në shërbim qeveritar dhe të autorizuara për këtë qëllim.

Neni 225

Detyra për shmangien e konseguencave në ushtrimin e fuqive për zbatimin e forcës

Në ushtrimin sipas kësaj Konvente të fuqive të tyre për zbatimin e forcës kundrejt anijeve të huaja, shtetet nuk do të rrezikojnë sigurinë e lundrimit ose të krijojnë ndonjë rrezik per anijen ose ta çojë atë në një port ose spirancë të pasigurtë, ose të ekspozojë ambientin detar në një rrezik të paarsyeshëm.

Neni 226
Investigimi i anijeve të huaja

1. (a) Shtetet nuk do të vonojnë një anije të huaj më shumë se çfarë është esenciale për qëllimet e investigimeve të parashikuar në nenet 216, 218 dhe 220. Çdo inspektim fizik i anijeve të huaja do të kufizohet në një ekzaminim të certifikatave të tilla, shënimeve dhe dokumentave të tjera që i kërkohen anijes të mbajë nga rregullat dhe standardet e pranuara në përgjithësi ose nga çdo dokument i ngjashëm që ajo mban. Inspektime të mëtejshme fizike të anijeve mund të ndërmerren vetëm pas një ekzaminimi të tillë dhe vetëm kur:

(i) ka fakte të qarta për të besuar që kushtet e anijes ose pajisjet e saj nuk korrespondojnë thellësisht me karakteristikat e këtyre dokumentave;

(ii) përmbajtja e dokumentave të tillë nuk është e mjaftueshme për të konfirmuar ose verifikuar një thyerje të dyshuar;

(iii) anija nuk ka certifikata të vlefshme dhe shënime.

(b) Në rast se investigimet tregojnë një thyerje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi ose rregullave dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar, lëshimi do të bëhet subjekt i procedurave të shpejta të arsyeshme siç janë faturimi ose siguri të tjera financiare.

Pa paragjykim të rregullave e standardeve ndërkombëtare në lidhje me lundrueshmërinë e anijes, lirimi i anijes mundet, kurdoherë që ajo paraqet një kërcënim të paarsyeshëm për dëme të ambientit detar, t'i refuzohet ose do t'i vihen kushte për të vazhduar deri në kantierin përkatës të riparimit. Kur lirimi i është refuzuar ose i janë vënë kushte shteti flamurin e të cilit mban anija duhet të njoftohet me shpejtësi dhe mund të kërkojë lirimin e anijes në përputhje me Pjesën e XV.

2. Shtetet do të bashkëpunojnë për zhvillimin e procedurave për të shmangur inspektime fizike të panevojshme të anijeve në det.

Neni 227
Mosdiskriminimi në lidhje me anijet e huaja

Në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe kryerjes së detyrave sipas kësaj pjese, shtetet nuk do të diskriminojnë formalisht ose në faktt anijet e çdo shteti tjetër.

Neni 228
Pezullimi dhe kufizimi mbi ngritjen e procedurave

1. Procedurat për imponimin e gjobave në lidhje me një thyerje të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi ose rregullave dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve nga anijet e kryera nga një anije e huaj përtej ujërave territoriale të një shteti që ka institucionalizuar procedura që do të pezullohen me marrjen e procedurave për imponimin e gjobave në lidhje me pagesat nga shteti flamur brenda 6 muajve nga data në të cilën procedurat filluan, përveçse kur këto procedura lidhen me një dëm shumë të madh kundrejt një shteti bregdetar ose shtetit flamur në fjalë, ka përsëritur mosinteresimin e detyrimeve të tij për të imponuar efektivisht rregullat dhe standardet ndërkombëtare në fuqi në lidhje me thyerjet e kryera nga anijet e tij. Shteti flamur duhet në kohën e duhur t'i bëjë të vlefshme shtetit që ka ngritur përpara procedura dosjen e plotë të rastit dhe shënimet e procedurave, kurdoherë që shteti flamur ka kërkuar pezullimin e procedurave në përputhje me këtë nen. Kur procedurat e ngritura nga shteti flamur kanë sjellë një konkluzion, procedurat e pezulluara duhet të përfundojnë. Me pagesën e kostos të ndodhur në lidhje me procedura të tilla, çdo faturë të postuar ose sigurime të tjera financiare të parashikuara në lidhje me procedurat e pezullimit do të lirohen nga shteti bregdetar.

2. Procedurat për imponimin e gjobave mbi anijet e huaja nuk do të institucionalizohen pas kalimit të tre vjetëve nga data në të cilën thyerja u krye dhe nuk do të merren nga çdo shtet në rast të procedurave që kanë qenë ngritur nga një shtet tjetër subjekt i parashikimeve të paraqitura në paragrafin 1.

3. Parashikimet e këtij neni kanë paragjykuar të drejtën e shtetit flamur për të marrë të gjitha masat, duke përfshirë procedurat për imponimin e gjobave, në ligjet e tij pavarësisht nga procedurat e mëparshme nga një shtet tjetër.

Neni 229
Institucionalizimi i provedurave civile

Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në institucionalizimin e procedurave civile në lidhje me çdo reklamim për humbje ose dëm që rezulton nga ndotja e ambientit detar.

Neni 230
Gjobat monetare dhe vrojtimi i të drejtave të njohura të akuzës

1. Gjobat monetare vetëm mund të imponohen në lidhje me thyerjet e ligjeve dhe rregulloreve kombëtare ose rregullat e standardet ndërkombëtare për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar të shkaktuar nga anijet e huaja përtej ujërave territoriale.

2. Gjobat monetare mund të imponohen vetëm në lidhje me thyerjet e ligjeve dhe rregulloreve kombëtare ose rregullave e standardeve ndërkombëtare për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar, të kryera nga anijet e huaja në ujërat territoriale, me përjashtim në rastin e një veprimi të ndërgjegjshëm dhe serioz të ndotjes në ujërat territoriale.

3. Në drejtimin e procedurave në lidhje me thyerje të tilla të shkaktuara nga anijet e huaja, të cilat mund të rezultojnë në imponimin e gjobave, të drejtat e njohura të të akuzuarit do të vrojtohen.

Neni 231
Lajmërimi i shtetit flamur dhe shteteve të tjera të interesuar

Shtetet do të njoftojnë me shpejtësi shtetin flamur dhe çdo shtet tjetër të interesuar për çdo masë të marrë mbi bazën e seksionit 6 kundër anijeve të huaja dhe do t'i parashtrojë shtetit flamur të gjitha raportet zyrtare në lidhje me masa të tilla. Megjithatë, në lidhje me thyerjet e kryera në ujërat territoriale, detyrimet e mësipërme të shteteve bregdetare zbatohen vetem per ato masa siç janë marrë në proçedurat. Axhentët diplomatikë ose nëpunësit konsullor dhe kur është e mundur autoritetet detare të shtetit flamur, duhet menjëherë të informojnë për çdo masë të tillë të marrë mbi bazën e seksionit 6 kundër anijeve të huaja.

Neni 232
Përgjegjësitë e shteteve të ngritura nga ushtrimi me forcë i masave

Shtetet do të jenë përgjegjës për dëmet ose humbjet e atribuara kundrejt tyre nga masat e marra mbi bazën e seksionit 6 kur masa të tilla janë të paligjshme ose tejkalojnë ato të kërkuara në mënyrë të arsyeshme mbi dritën e informatave të vlefshme. Shtetet do të parashikojnë për burimet e gjykatave të tyre për të vepruar në lidhje me dëme dhe humbje të tilla.

Neni 233
Siguria në lidhje me ngushticat e përdorura për lundrim ndërkombëtar

Asgjë në seksionet 5, 6 dhe 7 nuk do të ndikojë mbi regjimin ligjor të ngushticave të perdorura per lundrim ndërkombëtar. Megjithatë, në qoftë se një anije e huaj, përveç atyre të referuara në seksionin 10, ka kryer një thyerje të ligjeve dhe rregullave të referuara në nenin 42, paragrafi 1 (a) dhe (b), duke shkaktuar ose kërcënuar një dëm të madh të ambientit detar të ngushticës, shtetet që kufizojnë ngushticën mund të marrin masat përkatëse të ushtrimit të forcës dhe nëse është kështu, do të respektojnë mutatis mutandis parashikimet e këtij seksioni.

SEKSIONI 8. ZONAT E MBULUARA ME AKULL

Neni 234
Zonat e mbuluara me akull

Shtetet bregdetare kanë të drejtën të adaptojnë dhe ushtrojnë forcë për ligje e rregullore

jodiskriminuese për parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjeve të ambientit detar nga anijet në një zonë të mbulur me akull brenda kufijve të zonës ekonomike ekskluzive, ku kushtet klimatike të veçanta të ashpra dhe prezenca e mbulimit me akull të zonave të tilla për shumë vjet krijon pengesa ose rreziqe të veçanta për lundrimin dhe ndotja e ambientit detar mund të shkaktojë dëm shumë të madh ose turbullim të pakthyeshëm të ekuilibrit ekologjik. Ligje dhe rregullore të tilla duhet të kenë vëmendjen e duhur për lundrimin dhe ruajtjen e konservimin e ambientit detar mbështetur në faktet më të mira shkencore.

SEKSIONI 9. PËRGJEGJSITË DHE DETYRIMET

Neni 235
Përgjegjësitë dhe detyrimet

1. Shtetet janë përgjegjëse për plotësimin e detyrimeve ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen dhe konservimin e ambientiti detar. Ata do të jenë përgjegjës në përputhje me ligjin ndërkombëtar.
2. Shtetet do të sigurohen që rekursi është i vlefshëm në përputhje me sistemet e tyre ligjore për një kompensim të shpejtë dhe të përshtatshëm ose lëshime të tjera në lidhje me dëmet e shkaktuara nga ndotja e ambientit detar nga personat fizik dhe juridik nën juridiksionin e tyre.
3. Me objektivin për sigurimin e një kompesimi të shpejtë dhe të përshtatshëm në lidhje me të gjitha dëmet e shkaktuara nga ndotja e ambientit detar, shtetet do të bashkëpunojnë në zbatimin e ligjit ekzistues ndërkombëtar dhe zhvillimet e mëtejshme të ligjit ndërkombëtar në lidhje me përgjegjësitë e detyrimet për vlerësimin e kompesimin e dëmeve dhe zgjidhjen e diskutimeve, si dhe gjithashtu, kur është e përshtatshme, zhvillimit të kritereve dhe procedurave për pagesën e kompensimit të përshtatshëm, siç janë siguracioni i detyrueshëm ose fondi i kompensimit.

SEKSIONI 10. IMUNITETI I SOVRANITETIT

Neni 236
Imuniteti i sovranitetit

Parashikimet e kësaj Konvente në lidhje me ruajtjen dhe konservimin e ambientit detar nuk zbatohen mbi anijet e luftës, anijet luftarake ndihmuese, anijet e tjera ose hidroplanët pronë ose të operuara nga një shtet dhe të përdorura, për periudhën e mbetur vetëm per shërbime qeveritare jotregtare. Megjithatë, secili shtet do të sigurojë, me anën e adaptimit të masave përkatëse që të mos ngatërrojë operimin ose aftësitë operacionale të anijeve dhe hidroplanëve të tillë pronë ose që operohen nga ai, se anijet të tilla ose hidroplane veprojnë në një mënyrë të qëndrueshme, aq sa është e arsyeshme dhe praktike me këtë Konventë.

SEKSIONI 11. DETYRIMET SIPAS KONVENTAVE TË TJERA MBI MBROJTJEN DHE KONSERVIMIN E AMBIENTIT DETAR

Neni 237
Detyrimet sipas konventave të tjera mbi mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar

1. Parashikimet e kësaj pjese janë pa asnjë paragjykim të detyrimeve specifike të supozuara nga shtetet sipas Konventat konvencionale dhe marrëveshjeve të përfunduara që përpara, të cilat lidhen me mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar dhe rregullimeve, të cilat mund të konkludohen në të ardhmen e parimeve të përgjithshme të vendosura nga kjo Konventë.
2. Detyrimet specifike të supozuara nga shtetet sipas Konventave të veçanta, në lidhje me mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar, duhet të kryhet në mënyrë të tillë në mbështetje të parimeve e objektivave të përgjithshme të kësaj Konvente.

PJESA XIII
KËRKIMET SHKENCORE DETARE
SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 238
E drejta e drejtimit të kërkimeve shkencore detare

Të gjitha shtetet, pavarësisht nga pozita e tyre gjeografike dhe organizatat ndërkombëtare kompetente, kanë të drejtën e drejtimit të kërkimeve detare shkencore mbi bazën e të drejtave dhe detyrave të shteteve të tjera siç parashikohet në këtë Konventë.

Neni 239
Promocioni i kërkimeve shkencore detare

Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të nxisin dhe lehtësojnë zhvillimin dhe drejtimin e kërkimeve detare shkencore në përputhje me këtë Konventë.

Neni 240
Parimet e përgjithshme per drejtimin e kërkimeve shkencore detare

Në drejtimin e kërkimeve detare shkencore duhen mbajtur parasysh për t'u zbatuar parimet e mëposhtme:

(a) Kërkimi shkencor detar duhet të drejtohet ekskluzivisht për qëllime paqësore.

(b) Kërkimi shkencor detar duhet të drejtohet me metoda përkatëse shkencore dhe mjete kompatibël me këtë Konventë.

(c) Kërkimet shkencore detare nuk duhet të ndërhyjnë në mënyrë të pajustifikueshme me përdorime të tjera të legjitimuara të detit kompatibël me këtë Konventë dhe duhet respektivisht të respektohen gjatë periudhës së përdorimeve të tilla.

(d) Kërkimet shkencore detare duhet të drejtohen në përpërputhje me të gjitha rregullat përkatëse të adaptuara në përputhje me këtë Konventë duke përfshirë ato për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar.

Neni 241
Mosnjoha e veprimtarive të kërkimeve shkencore detare si bazë ligjore për reklamime

Veprimtaritë e kërkimeve shkencore detare nuk do të përbëjnë bazë ligjore për çdo reklamim mbi çdo pjesë të ambientit detar ose burimeve të tij.

SEKSIONI 2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 242
Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar

1. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente në përputhje me parimet e respektimit të sovranitetit dhe juridiksionit dhe mbi bazat e përfitimit reciprok, do të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në kërkimet shkencore detare për qëllime paqësore.

2. Në këtë kontekst, pa asnjë paragjykim në të drejtat dhe detyrat e shteteve sipas kësaj Konvente, një shtet në zbatimin e kësaj pjese do të parashikojë si të jetë e mundur, shtetet e tjerë më një mundësi të arsyeshme për ta marrë atë ose bashkëpunimit të tij, informatat e nevojshme për parandalimin dhe kontrollin e dëmit për shëndetin dhe sigurinë e personave dhe të ambientit detar.

Neni 243
Krijimi i kushteve të favorshme

Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të bashkëpunojnë, nëpërmjet

përfundimit të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, për të krijuar kushte të favorshme për drejtimin e kërkimeve shkencore detare në ambientin detar dhe të integrojnë përpjekjet e shkencëtarëve në studimin e esencës të fenomeneve dhe proceseve që ndodhin në ambientin detar dhe lidhjet ndërmjet tyre.

Neni 244
Publikimi dhe qarkullimi i informatave dhe dijeve

1. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente, në përputhje me këtë Konventë, do të bëjnë të vlefshme publikimet dhe do të qarkullojnë nëpërmjet kanaleve përkatëse informacione mbi programet më të mëdha të propozuara dhe objektivat e tyre si dhe dijet që rrjedhin nga kërkimet shkencore detare.

2. Për këtë qëllim, shtetet si individualisht, ashtu dhe në bashkëpunim me shtete të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente, do të nxisin aktivisht rrjedhjen e informacioneve dhe të dhënave shkencore dhe transferimin e dijeve që rrjedhin nga kërkimet shkencore detare, në mënyrë të veçantë për vendet në zhvillim, si dhe për forcimin e aftësive për kërkime shkencore detare të pavarura të vendeve në zhvillim nëpërmjet, inter alia, programeve për dhënie të edukimit dhe trajnimit të duhur personelit të tyre tekniko-shkencor.

SEKSIONI 3. DREJTIMI DHE NXITJA E KËRKIMEVE SHKENCORE DETARE

Neni 245
Kërkimet shkencore detare në ujërat territoriale

Shtetet bregdetare, në ushtrimin e sovranitetit të tyre, kanë të drejtën ekskluzive të rregullojnë, autorizojnë dhe drejtojnë kërkime shkencore detare në ujërat e tyre territoriale. Kërkimet shkencore detare do të drejtohen vetëm me konsensusin e shpejtë të vendosur sipas kushteve nga shtetet bregdetare.

Neni 246
Kërkimet shkencore detare në zonën ekonomike ekskluzive dhe në shelfin kontinental

1. Shtetet bregdetare, në ushtrimin e juridiksionit të tyre, kanë të drejtën të rregullojnë, autorizojnë dhe drejtojnë kërkimet shkencore detare në zonat e tyre ekonomike ekskluzive dhe shelfin e tyre kontinental në përputhje me parashikimet përkatëse të kësaj Konvente.

2. Kërkimet shkencore detare në zonën ekonomike ekskluzive dhe në shelfin kontinental do të drejtohen me konsensusin e shtetit bregdetar.

3. Shtetet bregdetare, në rrethana normale, do të garantojnë konsensusin e tyre për projektet e kërkimeve shkencore detare nga shtetet e tjera ose organizatat detare kompetente në zonat e tyre ekonomike ekskluzive ose në shelfin e tyre kontinental për t'u ndërmarrë në përputhje me këtë Konventë ekskluzivisht për qëllime paqësore dhe me synimin e rritjes së dijeve shkencore të ambientit detar për përfitim nga e gjithë shoqëria njerëzore. Për këtë qëllim, shtetet bregdetare do të bëjnë rregulla dhe procedura për sigurimin që një konsensus i tillë nuk do të vonohet ose të dënohet pa arsye.

4. Për qëllimet e zbatimit të paragrafit 3, rrethana normale mund të ekzistojnë edhe kur mungojnë marrëdhënie diplomatike ndërmjet shtetit bregdetar dhe shtetit që kryen kërkimet.

5. Shtetet bregdetare megjithatë sipas dëshirës së tyre mund të kthejnë mbrapsht konsensusin e tyre për drejtimin e projekteve të kërkimeve shkencore detare nga një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare kompetente në zonën e tyre ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental të shtetit bregdetar nëse ky projekt:

(a) është i një rëndësie direkte për eksplorimin ose shfrytëzimin e burimeve natyrore, si të gjësë së gjallë dhe asaj jo të gjallë;

(b) përfshin shpime në shelfin kontinetal, përdorimin e eksplozivëve ose paraqitjen e substancave të dëmshme në ambientin detar;

(c) përfshin ndërtimin, operimin ose përdorimin e ishujve artificial, instalime dhe struktura të

referuara në nenet 60 dhe 80;

(d) përmban informacione të komunikuara mbi bazën e nenit 248, në lidhje me natyrën dhe objektivat e projektit, i cili është i pasaktë ose nëse shteti ose organizata ndërkombëtare kërkuese ka detyrime të papaguara shtetit bregdetar nga një projekt kërkues i mëparshëm.

6. Pa marrë parasysh parashikimet e paragrafit 5, shtetet bregdetare mund të mos ushtrojnë dëshirën e tyre për të kthyer konsensusin e tyre sipas nënparagrafit (a) të këtij paragrafi në lidhje me projektet e kërkimeve shkencore detare, që duhet të ndërmerren në përputhje me parashikimet e kësaj pjese në shelfin kontinental, përtej 200 miljeve detare nga vija bazë në të cilën matet gjerësia e ujërave territoriale, jashtë atyre zonave specifike, të cilat shtetet bregdetare mundet në çdo kohë t'i parashikojnë publikisht si zona në të cilat operime shfrytëzimi ose eksplorimi të detajuar ndodhin ose do të ndodhin brenda një periudhe kohe të arsyeshme. Shtetet bregdetare do të japin njoftime të arsyeshme të projekteve për këto zona, si dhe modifikimet përkatëse, por nuk janë të detyruara të japin detaje të operimit .

7. Parashikimet e paragrafit 6 nuk paragjykojnë të drejtën e shteteve bregdetare mbi shelfin kontinetal siç është vendosur në nenin 77.

8. Veprimtaritë e kërkimeve shkencore detare të referuara në këtë nen nuk duhet të ndikojnë pa u justifikuar në veprimtaritë e ndërmarra nga shtetet bregdetare në ushtrimin e të drejtave të tyre sovrane dhe juridiksionit të parashikuar në këtë Konventë.

Neni 247

Kërkimet shkencore detare të ndërmarra nga organizata detare të dëgjuara

Një shtet bregdetar, i cili është anëtar ose ka një marrëveshje bilaterale me një organizatë ndërkombëtare dhe në zonën ekonomike ekskluzive ose shelfin kontinental të të cilit kjo organizatë dëshiron të ndërmarrë një projekt për kërkim shkencor detar direkt ose sipas dëshirës së saj, duhet të konsiderohet sikur ka autorizuar ndërmarrjen e projektit në përputhje me specifikimet e rëna dakord nëse ky shtet aprovon projektin e detajuar kur vendimi është marrë nga organizata për ndërmarrjen e projektit ose dëshiron të marrë pjesë në të dhe nuk ka shprehur ndonjë kundërshtim brenda katër muajve të lajmërimit të projektit nga organizata ndërkombëtare për shtetin bregdetar.

Neni 248

Detyra për dhënien e informatave shtetit bregdetar

Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente, të cilat mendojnë të ndërmarrin kërkime shkencore detare në zonat ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental të një shteti bregdetar, brenda jo më pak se 6 muajve përpara ditës së pritshme të fillimit të projektit të kërkimeve shkencore, do ta furnizojnë shtetin me përshkrimet e plota të:

(a) natyrës dhe objektivat e projektit;

(b) metodave dhe mjeteve që do të përdoren, duke përfshirë emrin, tonazhin, tipin dhe klasin e anijeve dhe një përshkrim të pajisjeve shkencore;

(c)zonës ekzakte gjeografike në të cilën projekti do të drejtohet;

(d) datës së pritshme të mbërritjes për herë të parë dhe nisjes përfundimtare të anijes kerkimore ose prishjes së pajisjeve dhe zhvendosjes së saj, si të jetë e nevojshme;

(e) emrit të institucionit sponsorizues, drejtorit të tij dhe personit të ngarkuar për projektin;

(f) madhësisë në të cilën konsiderohet se shteti bregdetar do të jetë në gjendje të marrë pjesë ose të përfaqësohet në projekt.

Neni 249

Detyra për të përmbushur disa kushte

1. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente kur ndërmarrin kërkime shkencore detare në zonën ekonomike ekskluzive ose shelfin kontinental të një shteti bregdetar do të përmbushin kushtet e mëposhtme:

(a) Të sigurojnë të drejtën e shtetit bregdetar, nëse ai dëshiron për të marrë pjesë ose të përfaqësohet në projektet e kërkimevet shkencore detare, në mënyrë të veçantë në bordin e anijeve

kërkimore dhe hidroplaneve të tjerë ose pajisjeve kërkimore shkencore, kur është e mundur, pa asnjë pagesë ose shpërblim për shkencëtarët e shtetit bregdetar dhe pa asnjë detyrim për kontribut në drejtim të kostos së projektit.

(b) Të furnizojë shtetin bregdetar, me kërkesën e tij, me raporte të parakohshme, sa më shpejtë që të jetë praktike dhe me rezultatet e konkluzionet përfundimtare pas përfundimit të kërkimeve.

(c) Të përpiqet per sigurimin e hyrjes për shtetin bregdetar, me kerkesën e tij, në tëe gjitha të dhëmat dhe shembujt që rrjedhin nga projektet e kërkimeve shkencore detare dhe në të kundërt të furnizojë atë me të dhëna të cilat mund të kopjohen dhe shembuj, të cilat mund të ndahen pa ndikuar në vlerën e tyre shkencore;

(d) Nëse kërkohet të furnizojë shtetin bregdetar me vlerësimin e këtyre të dhënave, shembujve dhe rezultatet e kërkimeve ose të furnizojë me ndihmë në vlerësimin ose interpretimin e tyre.

(e) Të sigurojë në mbështetje të paragrafit 2, që rezultatet e kërkimeve janë bërë të vlefshme ndërkombëtarisht nëpërmjet kanaleve përkatëse kombëtare ose ndërkombëtare, sa më shpejt të jetë e mundur praktikisht.

(f) Të informojë shtetin bregdetar menjëherë mbi çdo ndryshim të madh në programin e kërkimeve.

(g) Përveçse kur është rënë dakord ndryshe, të zhvendosë instalimet e kërkimeve shkencore ose pajisjet menjëherë pasi kërkimi të ketë përfunduar.

2. Ky nen nuk paragjykon kushtet e krijuara nga ligjet dhe rregullat e shtetit bregdetar për ushtrimin e të drejtës diskreciale të tij për të garantuar ose mospranuar konsensus mbi bazën e nenit 246, paragrafi 5, duke përfshirë kërkesën e një marrëveshjeje të mëparshme për bërjen të vlefshme ndërkombëtarisht të rezultateve të kërkimit të një projekti të një rëndësie direkte për shfrytëzim ose eksplorim të burimeve natyrore.

Neni 250

Komunikimi në lidhje me projektet e kërkimeve shkencore detare

Komunikimi në lidhje me projektet e kërkimeve shkencore detare do të bëhen nëpërmjet kanaleve zyrtare përkatëse, përveçse kur është rënë dakord ndryshe.

Neni 251

Kriteret e përgjithshme dhe udhëzimet

Shtetet do të kërkojnë të nxisin nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare krijimin e kritereve të përgjithshme dhe udhëzimeve për të ndihmuar shtetet në sqarimin e natyrës dhe implikimeve të kërkimeve shkencore detare.

Neni 252

Konsensusi i nënkuptuar

Shtetet ose organizata ndërkombëtare kompetente mund të vazhdojnë me një projekt kërkimi shkencor detar gjashtë muaj pas datës kur informacioni i kërkuar mbi bazën e nenit 248 i është dhënë shtetit bregdetar përveçse kur brenda katër muajve të marrjes së komunikimit që përmban një informacion të tillë shteti bregdetar ka informuar shtetin ose organizatën që drejton kërkimet se:

(a) ai nuk e pranuar konsensusin e tij sipas parashikimeve të nenit 246;

(b) informacioni i dhënë nga ky shtet ose organizatë ndërkombëtare kompetente në lidhje me natyrën dhe objektivat e projektit nuk janë konform fakteve të manifestuar;

(c) kërkohet informacion shtesë në lidhje me kushtet dhe informacionin e dhënë sipas neneve 248 dhe 249;

(d) ekzistojnë detyrime të papaguara në lidhje me projektet e mëparshme kërkimore shkencore detare të ndërmarra nga ky shtet ose organizatë, në lidhje me kushtet e vendosura në nenin 249.

Neni 253

Pezullimi ose pushimi i veprimtarisë së kërkimeve shkencore detare

1. Një shtet bregdetar do të ketë të drejtën të kërkojë pezullimin e çdo veprimtarie të kërkimeve shkencore detare në vazhdim brenda zonës ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental:

(a) Kur veprimtaritë kërkimore nuk janë drejtuar në përputhje me informacionin e komunikuar siç parashikohet në nenin 248, mbi të cilin u bazua konsensusi i shtetit bregdetar.

(b) Shteti ose organizata ndërkombëtare kompetente që drejton veprimtaritë kërkimore nuk arrin të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 249, në lidhje me të drejtat e shtetit bregdetar lidhur me projektin e kërkimeve shkencore detare.

2. Një shtet bregdetar do të ketë të drejtën të kërkojë pushimin e veprimtarisë kërkimore shkencore detare në rastet e çdo mospërputhjeje me parashikimet e nenit 248, kur ka një ndryshim të madh në projektin e kërkimeve ose veprimtarinë kërkimore.

3. Një shtet bregdetar mundet gjithashtu të kërkojë pushimin e veprimtarisë kërkimore shkencore detare nëse ndonjë situatë e konsideruar në paragrafin 1 nuk është ratifikuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

4. Mbi bazën e njoftimit nga shteti bregdetar të vendimit të tij për urdhërimin e pezullimit ose pushimit, shtetet ose organizatat ndërkombëtare kompetente të autorizuara për drejtimin e veprimtarive shkencore kërkimore detare do të përfundojnë veprimtarinë kërkimore, që janë subjekt i një njoftimi të tillë.

5. Një urdhër pezullimi sipas paragrafit 1 do të hiqet nga shteti bregdetar dhe veprimtaria kërkimore shkencore detare do të vazhdojë menjëherë sa shteti ose organizata kompetente ndërkombëtare është në përputhje me kushtet e kërkuara sipas neneve 248 dhe 249.

Neni 254

Të drejtat e shteteve fqinjë pa bregdet dhe me disavantazh gjeografik

1. Shtetet dhe organizatat kompetente ndërkombëtare, të cilat kanë parashtruar kundrejt një shteti bregdetar një projekt për të ndërmarrë kërkime shkencore detare që referohen në nenin 246, paragrafi 3, do t'u japin njoftim shteteve fqinjë pa bregdet dhe shteteve me disavantazh gjeografik të projekteve kërkimore të propozuara dhe gjithashtu do të njoftojnë shtetin bregdetar.

2. Pasi është dhënë konsensusi për projektin e kërkimeve shkencore detare të propozuar nga shteti bregdetar i interesuar, në përputhje me nenin 246 dhe parashikime të tjera të rëndësishme të kësaj Konvente, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente që ndërmarrin projekte të tilla, do të furnizojnë shtetet fqinjë pa bregdet dhe ato me disavantazh gjeografik me kërkesën e tyre dhe kur është e nevojshme, informatat e duhura siç specifikohet në nenin 248 dhe nenin 249, paragrafi 1 (f).

3. Shteteve fqinjë pa bregdet dhe ato me disavantazh gjeografik të referuara më sipër, me kërkesën e tyre, do t'u jepet mundësia e pjesëmarrjes, kurdoherë që është e mundur, në projekte të propozuara të kërkimeve detare shkencore nëpërmjet ekspertëve të kualifikuar të caktuara nga ato dhe jo të kundërshtuar nga shtetet bregdetare, në përputhje me kushtet e rëna dakord për projektin, në përputhje me parashikimet e kësaj Konvente, ndërmjet shtetit bregdetar të interesuar dhe shtetit ose organizatës ndërkombëtare kompetente, të drejtojnë kërkimet shkencore detare.

4. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente të referuara në paragrafin 1 do të parashikojnë për shtetet e përmendura më sipër pa bregdet dhe me disavantazh gjeografik, më kerkesën e tyre, informacion dhe asistencë të specifikuar në nenin 249, paragrafi 1 (d) mbi bazën e parashikimeve të nenit 249, paragrafi 2.

Neni 255

Masat për lehtësimin e kërkimeve shkencore detare dhe ndihmëse për anijet kërkimore

Shtetet do të përpiqen të adaptojnë rregulla, rregullore dhe procedura për nxitjen dhe lehtësimin e kërkimeve shkencore detare të drejtuara në përputhje me këtë Konventë përtej ujërave territoriale të tyre dhe respektivisht të lehtësojnë mbi bazën e parashikimeve në ligjet dhe rregullat e tyre, hyrjen në portet e tyre e të nxisin ndihmën për anijet e kërkimeve shkencore detare, të cilat plotësojnë parashikimet përkatëse të kësaj pjese.

Neni 256
Kërkimet shkencore detare në Zonë

Të gjitha shtetet, pavarësisht nga vendosja e tyre gjeografike dhe të gjitha organizatat ndërkombëtare kompetente kanë të drejtën, në përputhje me parashikimet e Pjesës XI, të drejtojnë kërkimet shkencore detare në Zonë.

Neni 257
Kërkimet shkencore detare në kolonën e ujërave përtej zonës ekonomike ekskluzive

Të gjitha shtetet, pavarësisht nga vendosja e tyre gjeografike dhe organizatat ndërkombëtare kompetente kanë të drejtën, në përputhje me këtë Konventë, të drejtojnë kerkimet shkencore detare, në kolonën e ujërave përtej kufijve të zonës ekonomike ekskluzive.

SEKSIONI 4. INSTALIMET KËRKIMORE SHKENCORE OSE PAJISJET NË AMBIENTIN DETAR

Neni 258
Vendosja dhe përdorimi

Vendosja dhe përdorimi i çdo tipi të instalimeve ose pajisjeve kërkimore shkencore në çdo zonë të ambientit detar do të jetë subjekt i të njëjtave kushteve siç janë përshkruar në këtë Konventë për drejtimin e kërkimeve shkencore detare në çdo Zonë të tillë.

Neni 259
Statusi ligjor

Instalimet ose pajisjet e referuara në këtë seksion nuk zotërojnë statusin e ishullit. Ato nuk kanë ujëra territoriale dhe prezenca e tyre nuk ndikon në kufijtë e ujërave territoriale të zonës ekonomike ekskluzive ose shelfit kontinental.

Neni 260
Zona e Sigurisë

Zonat e sigurisë të një gjerësie të arsyeshme që nuk kalon 500 metra mund të krijohen rreth instalimeve të kërkimeve shkencore në përputhje me parashikimet përkatëse të kësaj Konvente. Të gjitha shtetet duhet të sigurohen që një zonë e tillë sigurie respektohen nga anijet e tyre.

Neni 261
Mosndikimi në rrugët detare

Vendosja e përdorimi i çdo tipi instalimesh ose pajisjesh për kërkime shkencore nuk do të përbëjnë një pengesë për ngritjen e rrugëve detare.

Neni 262
Sinjalet e paralajmërimit dhe shenjat e identifikimit

Instalimet dhe pajisjet e referuara në këtë seksion do të mbajnë shënjat e identifikimit që tregojnë shtetin e regjistrimit ose organizatat ndërkombëtare, të cilëve ato i përkasin dhe do te kenë sinjalet paralajmëruese të përshtashme ndërkombëtare të rëna dakord për sigurinë në det dhe sigurinë e navigacionit ajror, duke marrë në konsideratë rregullat dhe standardet e krijuara nga organizatat ndërkombëtare kompetente.

SEKSIONI 5. PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT

Neni 263
Përgjegjësitë dhe të drejtat

1. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të jenë përgjegjëse për sigurinë e kërkimeve shkencore detare, pavarësisht nëse ndërmerren nga ato ose në emër të tyre dhe të drejtohen në përputhje me këtë Konvente.

2. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të jenë përgjegjëse dhe do të kenë detyra për masat që ata marrin në kundravajtje me këtë Konventë në lidhje me kërkimet shkencore detare të drejtuara nga shtete të tjera, personat e tyre juridik ose fizik ose nga organizata ndërkombëtare kompetente, dhe do të parashikojnë kompensim për dëmet që rrjedhin nga masa të tilla.

3. Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kompetente do të jenë përgjegjëse dhe do të kenë detyra mbi bazën e nenit 235, për dëmet e shkaktuara nga ndotja e ambientit detar që rrjedh nga kërkimet shkencore detare e ndërmarrë nga ata ose në emër të tyre.

SEKSIONI 6. ZGJIDHJA E DISKUTIMEVE DHE MASAT E PËRKOHSHME

Neni 264
Zgjidhja e diskutimeve

Diskutimet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e parashikimeve të kësaj Konvente për sa i përket kërkimit shkencor detar, do të zgjidhet në përputhje me Pjesën e XV, seksionet 2 dhe 3.

Neni 265
Masat e përkohshme

Në pritje të zgjidhjes së diskutimeve në përputhje me Pjesën XV, seksionet 2 dhe 3, shteti ose organizata ndërkombëtare kompetente e autorizuar për të drejtuar një projekt kërkimor shkencor detar nuk do të lejojë që të fillojë ose vazhdojë veprimtari kërkimore pa konsensusin e shprehur të shtetit bregdetar të interesuar.

PJESA XIV
ZHVILLIMI DHE TRANSFERIMI I TEKNOLOGJISË DETARE
SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 266
Nxitja e zhvillimit dhe transferimi i teknologjisë detare

1. Shtetet, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare detare, do të bashkëpunojnë në përputhje me aftësitë e tyre për të nxitur aktivisht zhvillimin dhe transferimin e shkencës detare e teknologjisë detare me terma dhe kushte të arsyeshme.

2. Shtetet do të nxisin zhvillimin e aftësinë e kërkimeve detare e teknollogjive të shteteve të cilat mund t'ju nevojitet dhe të kerkojne asistencë teknike në këtë fushë, në mënyrë të veçantë për shtetet në zhvillim, duke përfshirë shtetet pa bregdet e shtetet me disavantazh gjeografik, në lidhje me eksplorimin, shfrytëzimin, konservimin dhe menaxhimin e ambientit detar, mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar, kërkimeve shkencore detare dhe veprimtarive të tjera në ambientin detar kompatibël me këtë Konventë, me qëllimin e zhvillimit social dhe ekonomik të shteteve në zhvillim.

3. Shtetet do të përpiqen që të paraqesin kushte të favorshme ekonomike dhe ligjore për transferimin e teknologjisë detare për përfitimin e të gjithë Palëve të interesuara mbi bazat e barazisë.

Neni 267
Mbrojtja e interesave legjitime

Shtetet, në nxitjen e bashkëpunimit mbi bazën e nenit 256, do të kenë vëmendje të veçantë për të gjitha interesat legjitime duke përfshirë inter-alia, të drejtat dhe detyrat e mbajtësve, furnizuesve dhe

marrësve të teknologjisë detare.

Neni 268
Objektivat bazë

Shtetet, direkt ose ndërmjet organizatave ndërkombëtare detare kompetente, do të nxisin:

(a) blerjen, vlerësimin dhe mbledhjen e dijeve detare të teknologjive dhe lehtësojnë hyrjen në të dhëna dhe informacione të tilla;

(b) zhvillimin e teknologjive përkatëse detare;

(c) zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme teknologjike për lehtësimin e transferimit të teknologjisë detare;

(d) zhvillimin e burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimit dhe edukimit të shtetasve të vendeve e shteteve në zhvillim në mënyrë të veçantë shtetasve të vendit më pak të zhvilluar ndërmjet tyre;

(e) bashkëpunimin ndërkombëtar në të gjitha nivelet, në veçanti në nivelet rajonale, nënrajonale dhe bilaterale.

Neni 269
Masat per të arritur objektivat bazë

Në mënyrë që të arrihen objektivat e referuara në nenin 268, shtetet, direkt ose nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare, do të perpiqen inter-alia që:

(a) Të krijojnë programe të bashkëpunimit teknik për transferim efektiv të të gjitha llojeve të teknologjive detare në shtetet, të cilat mund t'u nevojitet dhe të kërkojnë asistencë teknike në këtë fushë, në veçanti shtetet në zhvillim pa bregdet dhe me disavantazh gjeografik, si dhe shtetet e tjera në zhvillim, të cilat nuk kanë qenë në gjendje as të krijojnë ose zhvillojnë aftësitë e tyre teknologjike në shkencën detare, as të zhvillojnë infrastrukturën e teknologjive të tilla.

(b) Të nxisin kushte të favorshme për përfundimin e marrëveshjeve, kontratave dhe rregullimeve të tjera të ngjashme, me kushte të arsyeshme dhe të barabarta.

(c) Të mbajnë konferenca, seminare dhe simpoziume mbi tema shkencore dhe teknollogjike, në veçanti mbi politikat dhe metodat për transferimin e teknologjive detare.

(d) Të nxisin shkëmbimin e shkenctarëve, teknologëve dhe ekspertëve të tjerë.

(e) Të ndërmarrin projekte dhe nxisin shoqëri të përbashkëta e forma të tjera të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral.

SEKSIONI 2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 270
Rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë detare do të kryhet, kur është fizibël dhe e përshtatshme, nëpërmjet programeve ekzistuese bilaterale, rajonale dhe multilaterale dhe gjithashtu nëpërmjet zgjerimit dhe programeve të reja në mënyrë që të lehtësojnë kërkimet shkencore detare, transferimin e teknologjisë detare, në veçanti në fusha të reja dhe fondeve ndërkombëtare përkatëse për zhvillimin e kërkimeve oqeanike.

Neni 271
Udhëzimet, standardet dhe kriteret

Shtetet direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente, do të nxisin krijimin e udhëzimeve të pranuara në përgjithësi, standardeve dhe kritereve për transferimin e teknologjisë detare mbi baza bilaterale ose brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare dhe forumeve të tjera, duke marrë në konsideratë, në veçanti, interesat dhe nevojat e shteteve në zhvillim.

Neni 272
Koordinimi i programeve ndërkombëtare

Në fushën e transferimit të teknologjisë detare, shtetet do të përpiqen të sigurojnë që organizatat kompetente ndërkombëtare të koordinojnë veprimtaritë e tyre, përfshirë çdo program rajonal ose global, duke marrë në konsideratë interesat dhe nevojat e shteteve në zhvillim, në veçanti të shteteve pa bregdet e atyre me disavantazh gjeografik.

Neni 273
Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe Autoritetin

Shtetet do të bashkëpunojnë aktivisht me organizatat kompetente ndërkombetare e Autoritetin në mënyrë që të inkurajojnë dhe lehtësojnë transferimin tek shtetet në zhvillim, të eksperiencës së shtetasve dhe ndërmarrjeve të tyre dhe teknologjisë detare në lidhje me veprimtaritë në Zonë.

Neni 274
Objektivat e Autoritetit

Mbi bazën e të gjitha interesave legjitime duke përfshirë inter-alia, të drejtat dhe detyrat e mbajtësve, furnizuesve dhe marrësve të teknologjisë, Autoriteti, në lidhje me veprimtaritë në Zonë, duhet të sigurohet që:

(a) mbi bazat e parimeve të shpërndarjes së barabartë gjeografike, shtetasit e shteteve në zhvillim, sidoqofshin bregdetar, pa bregdet ose me disavantazh gjeografik, do të merren për qëllime trajnimi si anëtarë të stafit menaxhues, kërkues dhe teknik të ndërtuar për këtë ndërmarrje;

(b) dokumentacioni teknik mbi pajisjet, makineritë, aparaturat dhe proceset përkatëse ju bëhen të vlefshme të gjithë shteteve në veçanti shteteve në zhvillim, të cilëve u nevojitet dhe kërkojnë asistencë teknike në këtë fushë;

(c) parashikimi përkatës bëhet nga Autoriteti për të lehtësuar blerjen e asistencës teknike në fushën e teknologjisë detare nga shtetet, të cilat mund t'u nevojitet dhe kërkojnë atë, në veçanti të shteteve në zhvillim dhe fitimit nga shtetasit e tyre të eksperiencës së nevojshme dhe dijeve, duke përfshirë trainjmin profesional;

(d) shtetet, të cilët mund t'u nevojitet dhe kërkojnë asistence teknike në këtë fushë, në veçanti shtete tnë zhvillim, ndihmohen në blerjen e pajisjeve, proceseve, uzinave dhe dijeve të tjera teknike të nevojshme nëpërmjet rregullimeve financiare të parashikuara në këtë Konventë.

SEKSIONI 3. QENDRAT KOMBËTARE DHE RAJONALE SHKENCORE DHE TEKNIKE

Neni 275
Krijimi i qendrave kombëtare

1. Shtetet, direkt ose nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente dhe Autoritetit, do të nxisin krijimin, në veçanti në shtetet në zhvillim, të qendrave kombëtare të kërkimeve shkencore dhe teknike detare dhe forcimin e qendrave ekzistuese kombëtare, në menyrë që të stimulojnë dhe përparojnë drejtimin e kërkimeve shkencore detare nga shtetet bregdetare në zhvillim dhe të zgjerojnë aftësitë e tyre kombëtare për përdorimin dhe konservimin e burimeve të tyre detare për përfitimin e tyre ekonomik.

2. Shtetet, nëpërmjet organizatave ndërkombëtare kompetente dhe Autoritetit, do të japin përkrahjen e duhur që të ndihmojnë krijimin dhe forcimin qendrave të tilla kombëtare që të jenë në gjendje të furnizojnë lehtësira trajnimi dhe dijenitë e eksperiencën dhe pajisjet, si dhe ekspertë teknikë për shtete te tilla, të cilat mund t'u nevojitet dhe kerkojnë asistencë të tillë.

Neni 276
Krijimi i qendrave rajonale

1. Shtetet, në koordinim me organizatat ndërkombëtare kompetente, Autoritetin dhe

institucionet kombëtare shkencore detare dhe kërkimeve teknilogjike, do të nxisin krijimin e qendrave rajonale të kërkimeve shkencore dhe teknologjike, në veçanti në shtetet në zhvillim, me qëllim që të stimulojnë dhe përparojnë drejtimin e kërkimeve shkencore detare nga shtetet në zhvillim dhe të bëjnë presion për transferimin e teknologjisë detare.

2. Të gjitha shtetet e rajonit do të bashkëpunojnë me qendrat rajonale për të siguruar arritjet më efektive të objektivave të tyre.

Neni 277
Funksionet e qendrave rajonale

Funksionet e qendrave rajonale të tilla do të përfshijnë, inter-alia:

(a) programet e trajnimit dhe edukimit në të gjitha nivelet mbi aspekte të ndryshme të kërkimeve shkencore dhe teknologjike detare, në veçanti të biologjisë detare, duke përfshirë konservimin dhe menaxhimin e burimeve gjallore, oqeanografisë, hidrografisë, inxhinierisë, eksplorimit gjeologjik të shtratit të detit, teknologjive të minierave dhe të projektimit;

(b) studime menaxhimi;

(c) programe studimi në lidhje me mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar dhe mbrojtjes, reduktimit dhe kontrollit të ndotjes;

(d) organizimin e konferencave, seminareve dhe simposiumeve rajonale;

(e) përfitimin dhe përpunimin e të dhënave dhe informacioneve teknologjike;

(f) shperndarjen e shpejtë të rezultateve të kërkimeve shkencore dhe teknologjike detare me anën e publikime të vlefshme të gatshme;

(g) publikimet e politikave kombëtare në lidhje me transferimin e teknologjive detare dhe studimeve krahasuese sistematike të këtyre politikave;

(h) llogaritjen dhe sistematizimin e informacionit mbi marketingun e teknologjive dhe mbi kontratat dhe rregullat e tjera përsa i përket patentave;

(i) bashkëpunimin teknik me shtetet e tjera të rajonit.

SEKSIONI 4. BASHKËPUNIMI NDËRMJET ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

Neni 278
Bashkëpunimi ndërmjet organizatave ndërkombëtare

Organizatat ndërkombëtare kompetente të referuara në këtë pjesë dhe në Pjesën XIII, do të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar ose direkt ose në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tyre, shkarkimin efektiv të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre sipas kësaj pjese.

PJESA XV
ZGJIDHJA E DISKUTIMEVE
SEKSIONI 1. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 279
Detyrimi i zgjidhjes së diskutimeve me mjete paqësore

Shtetet Palë do të zgjidhin çdo diskutim ndërmjet tyre përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente me anën e mjeteve paqësore në përputhje me nenin 2, paragrafi 3 i Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe për këtë qëllim do të kërkojnë një zgjidhje me anën e mjeteve të treguara në nenin 33, paragrafi 1 i Kartës.

Neni 280
Zgjidhja e diskutimeve me çdo mjet paqësor të zgjedhur nga Palët

Asgjë e kësaj pjese nuk do të ndikojë në të drejtat e çdo Shteti Palë që te bien dakort në çdo kohë për zgjidhjen e diskutimit ndërmjet tyre në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente me çdo mjet paqësor të zgjedhjes së tyre personale.

Neni 281

Procedurat kur nuk është arritur asnjë zgjidhje nga Palët

1. Në qoftë se Shtetet Palë, të cilat janë Palë në një diskutim përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente kanë rënë dakord që të kërkojnë zgjidhje të një diskutimi me mjete paqësore të llojit të tyre, procedurat e parashikuara në këtë pjesë zbatohen vetëm kur nuk është arritur zgjidhje nga rekursi për mjete të tilla dhe marrëveshja ndërmjet Palëve nuk përjashton ndonjë procedurë të mëtejshme.

2. Nëse Palët kanë rënë gjithashtu dakord mbi afatin e kohës, paragrafi 1 zbatohet pas skadimit të këtij afati kohe.

Neni 282

Detyrimet sipas marrëveshjeve të përgjithshme, rajonale ose bilaterale

Në qoftë se Shtetet Palë, të cilat janë Palë në një diskutim përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente kanë rënë dakord, nëpërmjet një marrëveshje të përgjithshme, rajonale ose bilaterale ose ndryshe, që një diskutim i tillë, duhet me kërkesën e çdo Pale në diskutim, t'i nënshtrohet një procedure që bëjnë të nevojshëm një vendim bashkëlidhur. Kjo procedurë do të zbatohet mbi bazën e procedurave të parashikuara në këtë Pjesë, përderisa Palët në diskutim bien dakord ndryshe.

Neni 283

Detyrimi për të shkëmbyer mendime

1. Kur një diskutim ngrihet ndërmjet Shteteve Palë përsa i perket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente, Palët në diskutim do të procedojnë sa më shpejt në shkëmbimin e mendimeve në lidhje me zgjidhjen me negociata ose mjete të tjera paqësore.

2. Palët do të procedojnë pa ndërprerje në një shkëmbim mendimesh kur një procedurë për zgjidhjen e një diskutimi të tillë ka përfunduar pa zgjidhje ose kur një zgjidhje është arritur dhe rrethanat kërkojnë konsultime në lidhje me mënyrën e implementimit të zgjidhjes.

Neni 284

Mbledhja

1. Një Shtet Palë, i cili është Palë në një diskutim përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente mund të ftojë Palën ose Palët e tjera që të parashtrojë diskutimin për reparacione në përputhje procedurat sipas aneksit V, seksioni 1 ose ndonjë procedurë tjetër reparacioni.

2. Në qoftë se ftesa pranohet dhe nëse Palët bien dakord për zbatimin e procedurave të reparacionit, secila Palë mund të parashtrojë diskutimin sipas kësaj procedure.

3. Në qoftë se ftesa nuk pranohet ose Palët nuk bien dakord me procedurat, del se procedurat e reparacionit kanë përfunduar.

4. Përveçse kur Palët bien dakord ndryshe, kur një diskutim parashtrohet për reparacion, procedurat mund të përfundojnë vetëm në përputhje me procedurat e rëna dakord për reparacionin.

Neni 285

Zbatimi i këtij seksioni për diskutimet e parashtruar mbi bazën e Pjesës XI

Ky seksion zbatohet për çdo diskutim, i cili mbi bazën e Pjesës XI, seksioni 5, duhet të zgjidhet në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë pjesë. Nëse një subjekt, përveçse nje Shteti Palë është Palë në një diskutim të tillë, ky seksion zbatohet mutatis mutandis.

SEKSIONI 2. PROCEDURAT E DETYRUESHME TË NEVOJSHME PËR COMPULSORY PROCEDURES ENTAILING
VENDIMET THELBËSORE

Neni 286
Zbatimi i procedurave sipas këtij seksioni

Mbi bazën e seksionit 3, çdo diskutim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, kur nuk është arritur një zgjidhje sipas rekursit të seksionit 1, duhet t'i parashtrohet me kërkesën e seciles Palë për diskutim gjykatës që ka juridiksionin sipas këtij seksioni.

Neni 287
Tipi i procedurave

1. Kur firmoset, ratifikohet ose hyhet në këtë Konvente ose në çdo kohë më pas, një shtet do të jetë i lirë të zgjedhë, me anën e mjeteve të një deklarate me shkrim, një ose më shumë prej mjeteve të mëposhtme për zgjidhjen e diskutimeve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente:

(a) Gjykatën Ndërkombetare për ligjin e detit të krijuar në përputhje me aneksin VI;

(b) Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë;

(c) një gjykatë arbitrazhi të formuar në përputhje me aneksin VII;

(d) një gjykatë speciale e formuar në përputhje aneksin VIII për një ose më shumë kategori diskutimesh të specifikuara këtu.

2. Një deklarate e bërë sipas paragrafit 1 nuk do të ndikojë ose ndikohet nga një detyrim i një Shteti Palë për të pranuar juridiksionin e Dhomës së diskutimeve të shtratit të detit të gjykatës ndërkombëtare për ligjin e detit si vazhdim dhe në një mënyrë të parashikuar në Pjesën XI, seksioni 5.

3. Një shtet Palë, i cili është Palë në një diskutim jo i mbuluar nga një deklaratë në fuqi, del që është pranuar nga Arbitrazhi në përputhje me aneksin VII.

4. Nëse Palët në një diskutim kanë pranuar të njëjtat procedura për zgjidhjen e një diskutimi, ajo duhet t'i nënshtrohet vetëm atyre procedurave, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

5. Nëse Palet në një diskutim nuk kanë pranuar të njëjtën procedurë për zgjidhjen e diskutimit, ajo duhet t'i nënshtrohet vetëm arbitrazhit në përputhje me aneksin VII, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

6. Një deklarate e bërë sipas paragrafit 1 do të mbetet në forcë deri në tre muaj pasi lajmërimi për revokim të jetë depozituar tek Sekretari i Përgjithsëm i Kombeve të Bashkuara.

7. Një deklaratë e re, një lajmërim për revokim ose skadimi i deklaratës nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në procedurat që presin përpara një gjykate që ka juridiksionin sipas këtij neni, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

8. Deklaratat dhe lajmërimet e referuara në këtë nen do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ia transmetojë kopjet të gjitha Shteteve Palë.

Neni 288
Juridiksioni

1. Një gjykatë referuar në nenin 287 do të ketë juridiksionin mbi çfarëdo diskutimi në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila parashtrohet në përputhje me këtë Pjesë.

2. Një gjykatë referuar në nenin 287 do të ketë gjithashtu juridiksionin mbi çfarëdo diskutimi në lidhje me interpretimin ose zbatimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare në lidhje me qëllimet e kësaj Konvente, e cila i është parashtruar asaj në përputhje me marrëveshjen.

3. Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit e Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit e krijuar në përputhje me aneksin VI dhe çdo dhome tjetër ose gjykatë arbitrazhi referuar në Pjesën XI, seksioni 5, do të ketë juridiksionin mbi çdo çështje, e cila i është parashtruar asaj në përputhje me sa përmendet këtu.

4. Në rastet e një diskutimi nëse një gjykatë ka juridiksion ose jo, çështja do të zgjidhet me një vendim të gjykatës.

Neni 289
Ekspertët

Në çdo diksutim që përfshin çështje shkencore ose teknike, një gjykatë që ushtron juridiksion sipas këtij seksioni, me kërkesën e një Pale ose proprio motu, zgjedh në konsultim me Palët jo më shumë se dy ekspertë teknikë ose shkencor të preferuar për t'u zgjedhur nga lista përkatëse e përgatitur në përputhje me aneksin VIII, neni 2, që të bashkohen me gjykatën, por pa të drejtën e votës.

Neni 290
Masat e përkohshme

1. Nëse një diskutim i është parashtruar siç duhet një gjykate, e cila e konsideron që ajo ka juridiksionin prima facie, ajo ka juridiksionin sipas kësaj pjese ose Pjesa XI, seksioni 5, gjykata mund të përshkruajë çdo masë të përkohshme, të cilën ajo e konsideron si të duhur sipas rrethanave për të drejtat respektive të Palëve në diskutim ose të parandalojë dëmin serioz për ambientin detar, duke pritur për vendimin final.

2. Masat e përkohshme mund të modifikohen ose revokohen sa më shpejt që rrethanat që i justifikojnë ato të kenë ndryshuar ose të kenë pushuar së ekzistuari.

3. Masat e përkohshme mund të përshkruhen, modifikohen ose revokohen sipas këtij neni vetëm me kërkesën e një pjese në diskutim dhe pasi Palëve u është dhënë një mundësi për t'u dëgjuar.

4. Gjykata që përpara do t'u japë lajmërim Ppalëve në diskutim dhe Shteteve Palë të tjerë të tillë siç mund ta konsiderojnë të duhur, të përshkrimit, modifikimit ose revokimit të masave të përkohshme.

5. Duke pritur formimin e një gjykate arbitrazhi të cilës i është parashtruar një diskutim sipas këtij seksioni, secila gjykatë e rënë dakord nga Palët ose duke u prishur një marrëveshje e tillë brenda dy javëve nga data e kërkesës për masa të përkohshme, Gjykata Ndërkombëtare e ligjit të detit ose në lidhje me veprimtaritë në Zonë, Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit, mund të përshkruajë, modifikojë ose revokojë masa të përkohshme në përputhje me këtë nen, nëse ajo e konsideron si prima facie që gjykata, e cila duhet të formohet, ka juridiksionin dhe që e kërkon kështu urgjenca e situatës. Menjëhere sa formohet, gjykata të cilës i është paraqitur diskutimi, mund të modifikojë, revokojë ose afirmojë këto masa të përkohshme, duke vepruar në përputhje me paragrafët 1 dhe 4.

6. Palët në diskutim do të veprojnë shpejt në përputhje me masat e përshkruara sipas ketij neni.

Neni 291
Hyrja

1. Të gjitha procedurat e zgjidhjeve të diskutimeve të specifikuara në këtë Pjesë do të jenë të hapura për të gjitha Shtetet Palë.

2. Procedurat e zgjidhjeve të diskutimeve të specifikuara në këtë Pjesë do të jenë të hapura për subjektet, përveçse Shteteve Palë vetëm siç janë parashikuar specifikisht në këtë Konventë.

Neni 292
Lëshimi i shpejtë i anijeve dhe ekuipazheve

1.Kur autoritetet e një Shteti Palë kanë bllokuar një anije që mban flamurin e një Shteti Palë tjetër dhe supozohet që shteti bllokues nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet e kësaj Konvente për lëshimin e shpejtë të anijes ose ekuipazhit të saj me postimin e një fature të arsyeshme ose një sigurie financiare, çështja e lëshimit nga bllokimi mund t'i parashtrohet çfarëdo gjykate të rënë dakord nga Palët ose nëse nuk bëhet një marrëveshje e tillë brenda 10 ditëve nga data e bllokimit, në një gjykatë të pranuar nga Shteti bllokues sipas nenit 287 ose Gjykatës Nderkombëtare për ligjin e detit, përveçse kur është rënë dakord ndryshe nga Palët.

2. Kërkesa për lëshim mund të bëhet vetëm nga ose në emër të shtetit flamurin e të cilit mban anija.

3. Gjykata duhet të merret pa asnjë vonesë me kërkesën për lëshim dhe duhet të merret vetëm me çështje e lëshimit, pa paragjykuar meritat e çdo rasti përpara forumeve përkatëse kombëtare kundër anijes, pronarit dhe ekuipazhit të saj. Autoritetet e shtetit bllokues mbeten kompetent për lëshimin e anijes ose ekuipazhit të saj në çdo kohë.

4. Me postimin e faturës ose sigurive të tjera bankare të përcaktuara nga gjykata, autoritetet e shtetit bllokues duhet te jenë me shpejtësi në përputhje me vendimin e gjykatës në lidhje me lëshimin e anijes ose ekuipazhit të saj.

Neni 293
Legjislacioni i zbatueshëm

1. Një gjykatë që ka juridiksionin sipas këtij seksioni do të zbatojë këtë Konventë dhe rregulla të tjera të ligjit ndërkombëta,r jo të ndryshme nga kjo Konventë.

2. Paragrafi 1 nuk paragjykon fuqinë e gjykatës që ka juridiksion sipas këtij seksioni të vendosë një rast ex equo et bono, në rast se Palët bien dakord kështu.

Neni 294
Procedurat paraprake

1. Një gjykatë e parashikuar ne nenin 287, të cilës i është bërë një kërkesë në lidhje me një diskutim të referuar nenin 297 do të vendosë me kërkesën e një Pale ose mundet të vendosë proprio motu, nëse një reklamim përbën një abuzim të një procesi ligjor ose nëse prima facie ajo gjendet në rregull. Nëse gjykata përcakton që reklamimi përbën një abuzim të procesit ligjor ose është prima facie i pabazuar, ajo nuk do të marrë veprime të tjera për rastin.

2. Me marrjen e kërkesës, Gjykata menjeherë do të lajmërojë Palën ose Palët e tjera për kërkesën dhe do të fiksojë një afat kohor të arsyeshëm brenda të cilit ato mund të kërkojnë që të bëjë një përcaktim në përputhje me paragrafin 1.

3. Asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë në të drejtën e çdo Pale në një diskutim që të bëjë kundërshtim paraprak në përputhje me rregullat në zbatim të procedurave.

Neni 295
Shpenzimet e pagesave lokale

Çdo diskutim ndërmjet Shteteve Palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente mund t'i nënshtrohet procedurave të parashikuara në këtë seksion vetëm pasi të jenë hequr pagesat lokalet, kur kjo kërkohet nga legjislacioni ndërkombëtar.

Neni 296
Përfundimi dhe bashkëlidhja e vendimeve me forcë

1. Çdo vendim i marrë nga një gjykatë që ka juridiksionin sipas këtij seksioni do të jetë përfundimtar dhe do të zbatohet nga të gjitha Palët në diskutim.

2. Çdo vendim i tillë nuk do të ketë ndonjë forcë bashkëlidhëse, përveç ndërmjet Palëve dhe në lidhje me këtë diskutim të veçantë.

SEKSIONI 3. KUFIZIMET DHE PËRJASHTIMET NË ZBATIMIN E SEKSIONIT 2

Neni 297
Kufizimet e zbatimit të seksionit 2

1. Diskutimet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente në lidhje me ushtrimin nga një shtet bregdetar të të drejtave të tij sovrane ose juridiksionit të parashikuar në këtë Konventë, do të jenë subjekt i procedurave të parashikuara në seksionin 2 në rastet e mëposhtme:

(a) Kur supozohet që një shtet bregdetar ka vepruar në thyerje të parashikimeve të kësaj

Konvente përsa i përket lirisë dhe të drejtës së lundrimit, fluturimit ose të shtrimit të një tubacioni ose kablli nënujor, ose përsa i përket përdorimeve të tjera të ligjshme ndërkombëtare të detit të specifikuara në nenin 58.

(b) Kur supozohet që një shtet gjatë ushtrimit të të drejtave të përmendura më sipër, lirive ose përdorimeve ka vepruar në thyerje të kësaj Konvente ose ligjeve dhe rregullave të adaptuara nga shteti bregdetar në përputhje me këtë Konventë dhe rregullat e tjera të legjislacionit ndërkombëtar kompatibël me këtë Konventë.

(c) Kur supozohet që një shtet bregdetar ka vepruar në thyerje të rregullave e standardeve ndërkombëtare specifike për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar të cilat janë të zbatueshme në shtetin bregdetar dhe të cilat janë krijuar mbi bazën e kësaj Konvente ose nëpërmjet një organizate ndërkombëtare kompetente ose konference diplomatike në përputhje me këtë Konventë.

2. (a) Diskutimet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e parashikimeve të kësaj Konvente përsa i përket kërkimeve shkencore detare do të zgjidhen në përputhje me seksionin 2, me përjashtim që shteti bregdetar nuk do të jetë i detyruar të pranojë parashtrimin e zgjidhjeve të tilla për çdo diskutim të ngritur jashtë:

(i) ushtrimit nga shteti bregdetar të një drejte ose alternative në përputhje me nenin 246;

(ii) një vendimi nga shteti bregdetar për një urdhër, pezullim ose pushim të një projekti kërkimi në përputhje me nenin 253.

(b) Një diskutim i ngritur nga një supozim nga një shtet kërkimor, që përsa i përket një projekti të veçantë, një shtet bregdetar nuk ushtron të drejtat e tij sipas neneve 246 dhe 253 në një mënyrë kompatibël më këtë Konventë do t'i parashtrohet, me kërkesën e secilës Palë, për këshillim sipas aneksit V, seksioni 2, me kusht që ky komision i mbledhur nuk do të ngrejë çështjen e ushtrimit nga një shtet bregdetar të alternativave të tij për të projektuar zona specifike siç referohen në nenin 246, paragrafi 6 ose të alternativës së tij për të mospranuar konsensusin në përputhje me nenin 246, paragrafi 5.

3. (a) Diskutimet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e parashikimeve të kësaj Konvente përsa i përket peshkimit do të zgjidhen në përputhje me seksionin 2, më përjashtim që shteti bregdetar nuk do të jetë i detyruar të pranojë nënshtrimin e zgjidhjeve të tilla për çdo diskutim që lidhet me të drejtat e sovranitetit të tij përsa i përket burimeve gjallore në zonat ekonomike ekskluzive ose ushtrimit të tyre, duke përfshirë fuqitë diskrete të tyre për përcaktimin e gjuetisë së lejueshme, kapacitetit të zënies, lokalizimit të tepricës për shtetet e tjera dhe termave e kushteve të vendosura në ligjet dhe rregulloret e tij për konservimin dhe menaxhimin.

(b) Kur nuk arrihet ndonjë zgjidhje me anën e rekursit në seksionin 1 të kësaj Pjese, një diskutim do t'i parashtrohet për këshillim sipas aneksit V, seksionit 2, me kërkesën e çdo Pale në diskutim, kur supozohet se:

(i) një shtet bregdetar ka manifestuar se nuk mund të jetë në përputhje me detyrimet e tij për të siguruar nëpërmjet masave të duhura të konservimit dhe menaxhimit që mirëmbajtja e burimeve gjallore në zonën ekonomike ekskluzive mos të dëmtohet seriozisht;

(ii) një shtet bregdetar ka refuzuar të përcaktojë, me kërkesën e një shteti tjetër, gjuetinë e lejueshme dhe kapacitetin e tij për të kapur burimet gjallore në lidhje me stokun që shteti tjetër është i ineteresuar për peshkim;

(iii) një shtet bregdetar ka refuzuar arbitrarisht për t'i përcaktuar çdo shteti, sipas neneve 62, 69 dhe 70 dhe sipas termave dhe kushteve të krijuara nga shteti bregdetar në mbështetje të kësaj Konvente, një pjesë ose të gjithë mbishtesën të cilin ka deklaruar që ekziston.

(c) Në asnjë rast komisioni i këshillimit nuk do të zëvendësojë alternativën e tij me atë të shtetit bregdetar.

(d) Raporti i komisionit të këshillimit do t'i komunikohet organizatave ndërkombëtare përkatëse.

(e) Në marrëveshjet e negociimit mbi bazën e neneve 69 dhe 70, Shtetet Palë, përveç kur bien dakord ndryshe, do të përfshijnë një klauzolë për masat, të cilat ata do të marrin në mënyrë që të minimizojnë mundësinë e një mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjes dhe sesi ata do të procedojnë nëse një mosmarrëveshje megjithatë ngrihet.

Neni 298

Përjashtimet opsionale të zbatimit të seksionit 2

1. Kur firmos, ratifikon ose bashkohesh me këtë Konventë ose në çdo kohë më vonë, një shtet mundet, pa asnjë paragjykim të detyrimeve të ngritura sipas seksionit 1, të deklarojë me shkrim që ai nuk pranon çfarëdo procedure ose njërën nga procedurat e parashikuara në seksionin 2 në lidhje me një ose më shumë kategori që vijojnë të diskutimeve:

(a) (i) Diskutime në lidhje me interpretimin ose zbatimin e neneve 15, 74 dhe 83 në lidhje me kufirin e detit ose ato që përfshijnë gjire historike ose tituj, me kusht që një shtet që ka bërë nje deklaratë të tillë, kur një diskutim i tillë ngrihet në vazhdim të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe kur nuk është arritur asnjë marrëveshje brenda një periudhe kohe të arsyeshme të negociatave ndërmjet Palëve, me kërkesën e secilës Palë në diskutim, duhet të pranojë parashtrimin e çështjes për këshillim sipas aneksit V, seksioni 2 dhe gjithashtu me kusht që çdo diskutim që përfshin domosdoshmërisht konsiderata konkurruese të çdo diskutimi të pazgjidhur në lidhje me të drejtat e sovranitetit ose të drejta të tjera mbi territore tokësore kontinentale ose insulare do të përjashtohen nga një parashtrim i tillë;

(ii) Pasi komisioni i këshillimit ka paraqitur raportin e tij, i cili do të deklarojë arsyen mbi të cilën bazohet, Palët do të negociojnë një marrëveshje mbi bazat e këtij raporti, nëse këto negociata nuk rezultojnë në një marrëveshje, Palët, me konsensus miqësor, do t'ia nënshtrojnë çështjen njërës nga procedurave të parashikuara në seksionin 2, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

(iii) Ky nënparagraf nuk zbatohet në çdo kufi detar i zgjidhur përfundimisht nga një marrëveshje ndërmjet Palëve ose për çdo diskutim të tillë, i cili duhet të zgjidhet në përputhje me një marrëveshje bilaterale ose multilaterale që përfshin këto Palë.

(b) Diskutimet në lidhje me veprimtaritë ushtarake, duke përfshirë veprimtaritë ushtarake nga anijet qeveritare dhe hidroplanëve të përfshirë në shërbime jotregtare dhe diskutimet në lidhje veprimtaritë e zbatimit me forcë të ligjit të ushtrimit të juridiksionit ose të drejtës së sovranitetit të përjashtuar nga juridiksioni i një gjykate sipas nenit 297, paragrafi 2 ose 3.

(c) Diskutimet në lidhje me të cilat Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ushtron funksionet e caktuara atij nga Karta e Kombeve të Bashkuara, përveçse kur Këshilli i Sigurimit vendos të transferojë çështjen nga axhenda e tij ose u bën thirje Palëve të zgjidhin atë sipas mjeteve të parashikuara në këtë Konventë.

2. Një Shtet Palë, i cili bën një deklaratë sipas paragrafit 1, mundet në çdo kohë ta hedhë poshtë atë ose të bjerë dakord për parashtrimin e një diskutimi të përjashtuar nga një deklaratë e tillë për çdo procedurë të specifikuar në këtë Konventë.

3. Një shtet Palë, i cili bën një deklaratë sipas paragrafit 1 nuk do të ketë të drejtë të parashtrojë çdo diskutim që është brenda kategorive të diskutimeve për çdo procedurë në këtë Konventë kundrejt çdo Shteti Palë, pa konsensusin e kësaj Pale.

4. Nëse një nga Shtetet Palë ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 (a), çdo Shtet tjetër Palë mund të parashtrojë çdo diskutim që është brenda një kategorie të pritshme kundrejt Palës deklaruese për procedurat e specifikuara në një deklaratë të tillë.

5. Një deklaratë e re ose kthimi i deklaratës, nuk ndikon në asnjë mënyrë në procedurat që presin përpara një gjykate në përputhje me këtë nen, përveçse kur Palët kanë rënë dakord ndryshe.

6. Deklaratat dhe lajmërimet e mospranimit sipas këtij neni do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i transmetojë kopjet të gjitha Shteteve Palë.

Neni 299

Të drejtat e Palëve për të rënë dakord për një procedurë

1. Një diskutim i përjashtuar sipas nenit 297 ose i pritur sipas një deklarate mundet sipas nenit 298 nga procedurat e zgjidhjes së dikutimit të parashikuara në seksionin 2 mundet t'i nënshtrohen procedurave të tilla vetëm me marrëveshje nga Palët në diskutim.

2. Asgjë në këtë seksion nuk ndikon në të drejtat e Palëve në diskutim për t'u marrë vesh për procedura të tjera për zgjidhjen e diskutimeve ose të arrijnë një zgjidhje miqësore.

PJESA XVI
PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 300
Besimi dhe abuzimi i të drejtave

Shtetet Palë do të përmbushin me mirëbesim detyrimet e marra sipas kësaj Konvente dhe do të ushtrojnë të drejtat, juridiksionin dhe liritë e njohura në këtë Konventë në një mënyrë, e cila nuk do të përbëjë një abuzim të të drejtave.

Neni 301
Përdorimi paqësor i detërave

Në ushtrimin e të drejtave dhe kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj Konvente, Shtetet Palë do të shmangen nga çdo kërcënim ose përdorim force kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të çdo shteti, ose nga çdo lloj tjetër që nuk mbështetet në parimet e legjislacionit ndërkombëtar të vendosur në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 302
Deklarimi i informacionit

Pa paragjykuar të drejtat e një Shteti Palë për të shpallur procedurat për zgjidhjen e diskutimeve të parashikuara në këtë Konventë, asgjë e kësaj Konvente nuk kërkon nga një Shtet Palë, gjatë përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj Konvente, të furnizojë me informacion deklarimi i të cilave është në kundërshtim me interesat esenciale të sigurisë së tij.

Neni 303
Objektet arkeologjike dhe historike të gjetura në det

1. Shtetet kanë detyrën e mbrojtjes së objekteve të natyrës arkeologjike dhe historike të gjetura në det dhe do të bashkëpunojnë për këtë qëllim.
2. Në mënyrë që të kontrollojnë trafikun për objekte të tilla, shtetet bregdetare, në zbatim të nenit 33, mundet të dyshojnë se zhvendosja e tyre nga shtrati i detit në zonat e referuara në këtë nen pa miratimin e tij do të rezultojnë në një thyerje të ligjeve dhe rregullave të referuara në këtë nen brenda territorit ose ujërave terrtoriale të tij.
3. Asgjë e këtij neni nuk ndikon në të drejtat e pronarëve të identifikueshëm, ligjin e shpëtimit ose rregulla të tjera të admiraliatit ose ligjet e praktikat përsa i përket shkëmbimeve kulturare.
4. Ky nen nuk paragjykon marrëveshjet e tjera ndërkombëtare dhe rregullat e legjislacionit ndërkombëtar në lidhje me mbrojtjen e objekteve të natyrës arkeologjike dhe historike.

Neni 304
Përgjegjësia dhe detyrimi për dëmin

Parashikimet e kësaj Konvente në lidhje me përgjegjësinë dhe detyrimin për dëmin janë pa paragjykuar zbatimin e rregullave ekzistuese dhe zhvillimin e rregullave të mëtejshme përsa i përket përgjegjësisë dhe detyrimit sipas legjislacionit ndërkombëtar.

PJESA XVII
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

Neni 305
Firmosja

1. Kjo konventë do të jetë e hapur për firmosje nga:
(a) të gjitha shtetet;

(b) Namibia, përfaqësuar nga Këshilli i Kombevet të Bashkuara për Namibinë;

(c) të gjitha shtetet e vetadministruara, të cilët kanë zgjedhur këtë status në një akt të vetëqeverisjes të supervizuar dhe miratuar nga Kombet e Bashkuara në përputhje me rezolutën 1514 (XV) dhe të cilat kanë kompetencë mbi çështjet e drejtuara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën e hyrjes në traktate në lidhje me këto çështje;

(d) të gjitha shtetet në vetadministrim të bashkëngjitura, të cilat në përputhje me instrumentat e tyre të bashkëngjitjes, kanë kompetencën mbi çështjet e drejtuara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën që të hyjnë në traktate në lidhje me këto çështje;

(e) të gjitha territoret, të cilat gëzojnë e vetëqeverisjes së brendshme të plotë, të njohura si të tilla nga Kombet e Bashkuara, por që nuk kanë arritur pavarësinë e plotë në përputhje me resolution 1514 (XV) të Asamblesë së Përgjithshme dhe të cilat kanë kompetencë mbi çështjet e drejtuara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të hyrë në traktate në lidhje me këto çështje;

(f) organizatat ndërkombëtare, në përputhje me aneksin IX.

2. Kjo Konventë do të mbetet e hapur për firmosje deri në 9 dhjetor 1984 në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Xhamaikës dhe gjithashtu, nga 1 korriku 1983 deri 9 dhjetor 1984, në selinë e Kombeve të Bashkuara në New York.

Neni 306

Ratifikimi dhe konfirmimi formal

Kjo Konventë është subjekt për ratifikim nga shtetet dhe institucionet e tjera të referuara në nenin 305, paragrafi 1 (b), (c), (d) dhe (e), dhe për konfirmim formal, në përputhje me Aneksin IX, nga institucionet e referuara në nenin 305, paragrafi 1 (f). Instrumentet e ratifikimit dhe konfirmimi formal do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 307

Bashkimi

Kjo Konventë do të mbetet e hapur për bashkim nga shtetet dhe institucionet e tjera të referuara në nenin 305. Bashkimi nga institucionet e referuara në nenin 305, paragrafi 1 (f), do të jenë në përputhje me Aneksin IX. Instrumentat e bashkimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 308

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës së depozitimit të gjashtëdhjetë instrumentave të ratifikimit ose bashkimit.

2. Për secilin shtet që ratifikon ose bashkohet me këtë Konventë pas depozitimit të gjashtëdhjetë instrumentave të ratifikimit ose bashkimit, Konventa do të hyjë në fuqi pas tridhjetë ditëve të depozitimit të instrumentave të ratifikimit ose bashkimit, mbi bazën e paragrafit 1.

3. Asambleja e Autoritetit do të mblidhet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe do të zgjedhë Këshillin e Autoritetit. Këshilli i parë do të ndërtohet në nje mënyrë në mbështetje me qëllimet e nenit 161, nëse parashikimet e këtij neni nuk mund të zbatohet strikt.

4. Regullat, rregulloret dhe procedurat e përgatitura nga komisioni përgatitor do të zbatohen përkohësisht duke pritur adaptimin e tyre formal nga Autoriteti në përputhje me Pjesën XI.

5. Autoriteti dhe organet e tij do të veprojnë në përputhje me rezolutën II të Konferencës së Tretë të Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit në lidhje me instrumentat përgatitorë dhe vendimet e komisionit përgatitor të marra mbi bazën e kësaj rezolute.

Neni 309

Vërejtjet dhe përjashtimet

Asnjë vërejtje ose përjashtim nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente, përveçse kur është shprehur ndryshe në nenet e tjerë të kësaj Konvente.

Neni 310
Deklarimet dhe deklaratat

Neni 309 nuk përfshin një shtet, kur firmos, ratifikon ose bashkohet me këtë Konventë, nga bërja e deklarimeve ose deklaratave, sidoqofshin perifrazuar ose emëruar, inter-alia, me qëllimin e harmonizimit të ligjeve dhe rregulloreve të tij me parashikimet e kësaj Konvente, me kusht që një deklaratë ose deklarim i tillë nuk ka për qëllim të përjashtojë ose modifikojë efektin ligjor të kësaj Konvente në zbatimin e tyre në këtë shtet.

Neni 311
Lidhjet me marrëveshjet dhe konventat e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë do të mbizotërojë, ndërmjet Shteteve Palë, mbi Konventën e Xheneves mbi ligjin e detit të 29 prillit 1958.

2. Kjo Konventë nuk do të ndryshojë të drejta dhe detyrimet e Shteteve Palë, të cilat ngrihen nga marrëveshje të tjera kompatibël me këtë Konventë dhe e cila nuk ndikon në gëzimin nga Shtete të tjera Palë të të drejtave të tyre ose zbatimit të detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente.

3. Dy ose më shumë shtete mund të përfundojnë një marrëveshje duke modifikuar ose pezulluar operimin e parashikimeve të kësaj Konvente, të zbatueshme vetëm në lidhjet ndërmjet tyre, me kusht që marrëveshje të tilla nuk kanë lidhje me parashikimet e humbjes nga e cila është jo kompatibël me ekzekutimin efektiv të objektit dhe qëllimit të kësaj Konvente dhe më tej me kusht që marrëveshje të tilla nuk do të ndikojnë në zbatimin e parimeve bazë të bashkëngjitura këtu dhe që parashikimet e marrëveshjeve të tilla nuk do të ndikojnë në gëzimin nga Shtete të tjera Palë të drejtave të tyre ose të zbatimit të detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente.

4. Shtetet Palë duke menduar të përfundojnë një marrëveshje referuar në paragrafin 3 do të njoftojnë Shtetet e tjera Palë nëpërmjet depozitimeve të kësaj Konvente të ideve të tyre për përfundimin e një marrëveshjeje dhe të modifikimeve ose pezullimeve që ajo parashikon.

5. Ky nen nuk ndikon në marrëveshjet ndërkombëtare që janë të pranuara shprehimisht ose që janë siguruar nga nenet e tjerë të kësaj Konvente.

6. Shtetet Palë bien dakord që nuk do të ketë ndonjë amendament për parimet bazë në lidhje me zakonet e përbashkëta të shoqërisë njerëzore të vendosura në nenin 136 dhe që ato nuk do të jenë pjesëtar në çdo marrëveshje në humbje për sa përmendet.

Neni 312
Amendimi

1. Pas tejkalimit të një periudhe prej 10 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, një Shtet Palë, me anën e një komunikate me shkrim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, propozojnë amendamente specifike të kësaj Konvente, përveçse atyre që kanë lidhje me veprimatritë në zonë dhe të kërkojnë mbledhjen e një konference për të marrë në konsideratë amendamente të tilla të propozuara. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë komunikata të tilla tek të gjitha Shtetet Palë. Nëse, brenda 12 muajve nga data e qarkullimit të komunikatës, jo më pak se gjysma e Shteteve Palë përgjigjen në favor të kërkesës, Sekretari i Përgjithshëm do të mbledhë konferencën.

2. Procedurat e marrjes së vendimit të zbatueshme në konferencën e amendamentit do të jenë të njëjta siç zbatohen në Konferencën e Tretë të Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit, përveç se kur vendoset ndryshe nga konferenca. Konferenca duhet të bëjë çdo përpjekje për të arritur një marrëveshje mbi çdo amendament me konsensus dhe nuk do të ketë një votim mbi të derisa të jenë konsumuar të gjitha përpjekjet për konsensus.

Neni 313
Amendamenti sipas procedurave të thjeshtëzuara

1. Një Shtet Palë, me anën e një komunikate me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të

Kombeve të Bashkuara, mund të propozojë një amendament për këtë Konventë, përveçse një amendamenti që ka lidhje me veprimtarinë në zonë, për t'u adaptuar me procedura të thjeshtëzuara të vendosura në këtë nen pa mbledhjen e një konference. Sekretari i Përgjithshëm do t'i qarkullojë një komunikatë të gjitha Shteteve Palë.

2. Nëse brenda një periudhe 12 mujore nga data e qarkullimit të komunikatës, një Shtete Palë ka objeksion për amendamentin e propozuar ose për propozimin për adaptimin e tij me procedura të thjeshtëzuara, amendamenti i propozuar duhet të konsiderohet i pa pranuar. Sekretari i Përgjithshëm menjëherë do të njoftojë të gjitha Shtetet Palë respektivisht.

3. Nëse brenda një periudhe 12 mujore nga data e qarkullimit të komunikatës, asnjë Shtet Palë nuk ka objeksion për amendamentin e propozuar ose për propozimin për adaptimin e tij me procedura të thjeshtëzuara, amendamenti i propozuar duhet të konsiderohet i pranuar. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Shtetet Palë se amendamenti i propozuar është adaptuar.

Neni 314

Amendamentet për parashikimet e kësaj Konvente në lidhje me eksklusivitetin në Zonë

1. Një Shtet Palë, me anën e një komunikate me shkrim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit, mund të propozojë një amendament për parashikimet e kësaj Konvente në lidhje me ekskluzivitetin e veprimtarive në Zonë, duke përfshirë aneksin VI, seksionin 4. Sekretari i Përgjithshëm do ta qarkullojë një komunikatë të tillë të gjitha Shteteve Palë. Amendamenti i propozuar do të jetë subjekt i miratimit nga Asambleja në vazhdim të miratimit të tij nga Këshilli. Përfaqësuesit e Shteteve Palë në këto organe do të kenë fuqinë e plotë të marrin në konsideratë dhe miratojnë amendamentet e propozuara. Amendamentet e propozuara siç janë miratuar nga Këshilli dhe Asambleja do të konsiderohen të adaptuara.

2. Përpara miratimit të çdo amendamenti sipas paragrafit 1, Këshilli dhe Asambleja duhet të sigurohen që kjo nuk paragjykon sistemin e eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve në Zonë, duke pritur Konferencën e Rishikimit në përputhje me nenin 155.

Neni 315

Firmosja, ratifikimi ose bashkimi në një tekst autentik të amendamenteve

1. Menjëherë sapo adaptohet, amendamenti për këtë Konvente do të jetë i hapur për firmosje nga Shtetet Palë për 12 muaj pas datës së adaptimit, në selinë e Kombeve të Bashkuara në New York, përveçse kur është parashikuar ndryshe në amendamentin vetë.

2. Nenet 306, 307 dhe 320 zbatohen për të gjitha amendamentet e kësaj Konvente.

Neni 316

Hyrja në fuqi e amendamenteve

1. Amendamentet e kësaj Konvente, përveçse atyre të referuara në paragrafin 5, do të hyjnë në fuqi për Shtetet Palë që ratifikojnë ose bashkohen me to në ditën e tridhjetë nga depozitimi i instrumentit të ratifikimit ose bashkimit nga dy të tretat e Shteteve Palë ose nga 60 Shtetet Palë, cila është më e madhe. Amendamente të tilla nuk do të ndikojnë gëzimin nga Shtetet e tjera Palë të drejtave të tyre ose kryerjes së detyrimeve të tyre sipas kësaj Konvente.

2. Një amendament mund të parashikojë që të kërkohet një numër më i madh ratifikimesh ose bashkimesh për hyrjen e tij në fuqi sesa kërkohet nga ky nen.

3. Për secilin Shtet Palë që ratifion ose bashkohet me një amendament të referuar në paragrafin 1 pas depozitimit të numrit të kërkuar të instrumentave të ratifikimit ose bashkimit, amendamentet do të hyjnë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentave të tij të ratifikimit ose bashkimit .

4. Një shtet bëhet një Palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të një amendamenti në përputhje me paragrafin 1, në mungesë të shprehjes së një mendimi të ndryshëm nga ky shtet do të:

(a) konsiderohet si një Palë në këtë Konventë siç amendohet;

(b) konsiderohet si një Palë për një Konventë të paamenduar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk e njeh amendamentin.

5. Çdo amendament përsa i përket ekskluzivisht veprimtarisë në Zonë dhe çdo amendament për aneksin VI do të hyjë në fuqi për të gjitha Shtetet Palë një vit pas depozitimit të instrumentave të ratifikimit ose bashkimit nga tre të katërtat e Shteteve Palë.

6. Një shtet, i cili bëhet Palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të amendamentit në përputhje me paragrafin 5 do të konsiderohet si një Palë në këtë Konventë siç amendohet.

Neni 317
Denoncimi

1. Një Shtet Palë, me një lajmërim me shkrim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund të denoncojë këtë Konventë dhe mund të tregojë arsyet e tij. Mungesa e tregimit të arëyeve nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e denoncimit. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit, përveçse kur lajmërimi specifikon një datë të mëvonshme.

2. Një shtet nuk shkarkohet nga arsyeja e denoncimit prej detyrimeve kontraktuale dhe financiare, të cilat rrjedhin ndërsa ai ishte Palë e kësaj Konvente dhe denoncimi nuk do të ndikojë ndonjë të drejtë, detyrim ose situatë ligjore të këtij shteti të krijuar gjatë ekzekutimit të kësaj Konvente përpara përfundimit të saj për këtë shtet.

3. Denoncimi në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë në detyrat e çdo Shteti Palë për të plotësuar çdo detyrim të bashkëngjitur në këtë Konventë, të cilat mund të jenë subjekt i legjislacionit ndërkombëtar i pavarur nga kjo Konventë.

Neni 318
Statusi i anekseve

Anekset përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Konvente dhe përveçse kur është shprehur ndryshe, një referencë ndaj kësaj Konvente ose ndaj njërës nga Pjesët e saj, përfshin një referencë ndaj anekseve që lidhen me të.

Neni 319
Deposituesit

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozituesi i kësaj Konventen dhe amendamenteve të saj.

2. Në plotësim të funksioneve të tij si depozitues, Sekretari i Përgjithshëm do të:

(a) raportojë të gjitha Shteteve Palë, Autoritetit dhe organizatave kompetente ndërkombëtare mbi çështjet e natyrës së përgjithshme që kanë ngritur përsa i përket kësaj Konvente;

(b) njoftojë Autoritetin për ratifikimet dhe konfirmimet formale dhe bashkimin me këtë Konventë dhe amendamentet gjithashtu, si dhe denoncimet ndaj kësaj Konvente;

(c) njoftojë Shtetet Palë për marrëveshjet në përputhje me nenin nenin 311, paragrafi 4;

(d) qarkullojë amendamentet e adaptuara në përputhje me këtë Konventë Shteteve Palë për ratifikim ose bashkim;

(e) organizojë mbledhjet e nevojshme të Shteteve Palë në përputhje me këtë Konventë.

3. (a) Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu do t'i transmetojë vrojtuesve referuar në nenin 156:

(i) raportet referuar në paragrafin 2 (a);

(ii) lajmërimet referuar në paragrafin 2 (b) dhe (c);

(iii) tekstet e amendamenteve referuar në paragrafin 2 (d), për dijeninë e tyre.

(b) Sekretari i Përgjithsëm gjithashtu do të ftojë këta vrojtues për të marrë pjesë si vrojtues në mbledhjet e Shteteve Palë referuar në paragrafin 2(e).

Neni 320
Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente, nga të cilat tekstet arabisht, kinezçe, Anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë autentike të barabartë, mbi bazën e nenit 305, paragrafi 2, do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi, të nënshkruarit e plotfuqishëm, që janë te autorizuar, kanë firmosur këtë Konventë.

BËRË NË MONTEGO BAY, këtë ditë të dhjetë të dhjetorit, njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy.

ANEKSI I. SPECIET ME EMIGRIMIN MË TË LARTË

Albacore tuna: Thunnus alalunga.
Bluefin tuna: Thunnus thynnus.
Bigeye tuna: Thunnus obesus.
Skipjack tuna: Katsuëonus pelamis.
Yelloëfin tuna: Thunnus albacares.
Blackfin tuna: Thunnus atlanticus.
Little tuna: Euthynnus alletteratus; Euthynnus affinis.
Southern bluefin tuna: Thunnus maccoyii
Frigate mackerel: Auxis thazard; Auxis rochei.
Pomfrets: Family Bramidae.
Marlins: Tetrapturus angustirostris; Tetrapturus belone; Tetrapturus pnuegeri; Tetrapturus albidus; Tetrapturus audax; Tetrapturus georgei; Makaira mazara; Makaira indica; Makaira nigricans.
Sail-fishes: Istiophorus platypterus; Istiophorus albicans.
Sëordfish: Xiphias gladius.
Sauries: Scomberesox saurus; Cololabis saira; Cololabis adocetus; Scomberesox saurus scombroides.
Dolphin: Coryphaena hippurus; Coryphaena equiselis.
Oceanic sharks: Hexanchus griseus; Cetorhinus maximus; Family Alopiidae; Rhincodon typus; Family Carcharhinidae; Family Sphyrnidae; Family Isurida.
Cetaceans: Family Physeteridae, Family Balaenopteridae; Family Balaenidae; Family Eschrichtiidae; Family Monodontidae; Family Ziphiidae; Family Delphinidae.

ANEKSI II. KOMISIONI I KUFIJVE TË SHELFIT KONTINENTAL

Neni 1

Në përputhje me parashikimet e nenit 76, do të krijohet një komision mbi kufijtë e shelfit kontinental përtej 200 miljeve detare konform me nenet që vijojnë.

Neni 2

1. Komisioni do të përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët do të jenë ekspertë në fushat e gjeologjisë gjeofizikës ose hidrografisë, të zgjedhur nga Shtetet Palë për këtë Konventë ndërmjet qytetarëve te tyre, duke pasur vëmendjen e duhur në sigurimin e përfaqësimit të barabartë gjeografikisht, të cilët do të shërbejnë në kapacitetet e tyre personale.

2. Zgjedhja fillestare do të mbahet sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 18 muajve pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj konvente. Së paku tre muaj përpara datës së secilës zgjdhje, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'i adresojë një shkresë Shteteve Palë, duke i ftuar për paraqitjen e emrave, pas konsultimeve rajonale përkatëse, brenda tre muajve. Sekretari i Përgjithshëm do të përgatisë një listë sipas rendit alfabetik të të gjithë personave te emëruar dhe do t'ia paraqesë të gjitha shteteve.

3. Zgjedhjet e anëtarëve të komisionit do të mbahen në një mbledhje të Shteteve Palë të mbledhura nga Sekretari i Përgjithshëm në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në mbledhje, për të cilën dy të tretat e Shteteve Palë përbëjnë një quorum, personat e zgjedhur për Komisionin do të jenë ata të cilët fitojnë dy të tretat e mazhoranxës së votave të përfaqësuesve të Shteteve Palë që janë prezent dhe votojnë. Jo më pak se tre anëtarë do të zgjidhen nga çdo rajon gjeografik.

4. Anëtarët e komisionit do të zgjidhen për një periudhë prej pesë vjetësh. Ata do të jenë të ligjshëm për t'u rizgjedhur.

5. Shtetet Palë, të cilat paraqesin emërimin e një anëtari të komisionit do të paguajnë shpenzimet e këtij anëtari ndërsa kryen detyrat e komisionit. Shtetet bregdetare të interesuara do të paguajnë shpenzimet që ndodhin përsa i përket këshillave të referuara në nenin 3, paragrafi 1 (b) të këtij aneksi. Sekretariati i komisionit do të parashikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 3

1. Funksionet e Komisionit do të jenë:

(a) Konsiderimi i të dhënave dhe materialeve të tjera të paraqitura nga shtetet bregdetare në lidhje me kufijtë e shelfit kontinental në zonat ku këto kufij shtrihen përtej 200 miljeve detare dhe të bëjë rekomandime në përputhje me nenin 76 dhe Deklaratën e Mirëkuptimit të adaptuar në 29 gusht 1980 nga Konferenca e Tretë e Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit;

(b) Të japë këshilla teknike dhe shkencore, nëse kërkohen nga shtetet bregdetarë të interesuara gjatë përgatitjes së të dhënave të referuara në nënparagrafin (a).

2. Komisioni mund të bashkëpunojë, në zgjerimin e asaj që konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme, me komisionin ndërqeveritar oqeanografik të UNESCO, Organizatën Ndërkombëtare Hidrografike dhe organizata të tjera ndërkombëtare kompetente me synimin e shkëmbimit të informacionit teknik dhe shkencor, të cilat mund të jenë të një ndihme në shkarkimin e përgjegjësive të komisionit.

Neni 4

Kur një shtet bregdetar mendon të krijojë, në përputhje me nenin 76, kufijtë e jashtëm të shelfit të tij kontinental përtej 200 miljeve detare, ai do t'i paraqesi detaje të kufijve të tillë komisionit së bashku me të dhënat mbështetëse teknike dhe shkencore sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 10 vjetëve të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë shtet. Shtetet bregdetare në të njëjtën kohë do të japin emrat e secilit anëtar të komisionit, të cilët kanë furnizuar atë me këshilla teknike dhe shkencore.

Neni 5

Përveçse kur komisioni vendos ndryshe, Komisioni do të funksionojë me anën e nënkomisioneve të përbërë nga 7 anëtarë, të caktuar në një mënyrë të balancuar duke marrë në konsideratë elementët specifik të secilit nënmision nga një shtet bregdetar. Shtetasit e shtetit bregdetar që bëjnë një nënmision, të cilët janë anëtarë të komisionit dhe çdo anëtar komisioni, i cili ka asistuar një shtet bregdetar duke dhënë këshilla teknike dhe shkencore në lidhje me projektet nuk do të jetë një anëtar i nënkomisionit që ka të bëjë me këtë nënmision por ka të drejtën të marrë pjesë si një anëtar në procedurat e komisionit në lidhje me nënmisionin në fjalë. Shteti bregdetar, i cili ka bërë një nënmision të komisionit mund të dërgojë përfaqësuesit e tij të marrin pjesë në procedurat përkatëse pa të drejtë vote.

Neni 6

1. Nënkomisioni do t'i parashtrojë rekomadimet e tij komisionit.

2. Miratimi nga komisioni i rekomandimeve të një nënkomisioni do të bëhet nga një mazhorancë prej dy të tretave të anëtarëve të komisionit që janë prezent dhe votojnë.

3. Rekomandimet e komisionit do t'i paraqiten me shkrim shtetit bregdetar, i cili bën nënmisionin dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara..

Neni 7

Shtetet Bregdetare do të krijojnë kufijtë e jashtëm të shelfit kontinental në përputhje me parashikimet e nenit 76, paragrafi 8, dhe në konformitet me proçedurat përkatëse kombëtare.

Neni 8

Në rastet e mosrënies dakord nga shteti bregdetar me rekomandimet e komisionit, shteti bregdetar, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, do të bëjë një nënmision të ri ose për rishikim për komisionin.

Neni 9

Veprimet e Komisionit nuk do të paragjykojnë çështjet në lidhje me përcaktimin e kufijve ndërmjet shteteve ballë për ballë ose fqinjë.

ANEKSI III. KUSHTET BAZË TË PRESPEKTIVËS, EKSPLORIMIT DHE SHFRYTËZIMIT

Neni 1
Prona për minerale (titulli)

Pronësia për mineralet do kalojë menjëherë pas zbulimit në përputhje me këtë Konventë.

Neni 2
Parashikimi

1. (a) Autoriteti do të inkurajojë perspektivën në Zonë.

(b) Parashikimi duhet të udhëhiqet vetëm pasi Autoriteti të ketë marrë një ndërmarrje të kënaqshme me shkrim të propozuar nga parashikuesi që do të jetë në përputhje me këtë Konventë dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat përkatëse të Autoriteti, përsa i përket bashkëpunimit në programet trajnuese të referuara në nenet 143 dhe 144 dhe mbrojtjen e ambientit detar dhe do të zbatojë verifikimin nga Autoriteti për përputhjen. Parashikuesi që propozon, në të njëjtën kohë, do të njoftojë Autoritetin për zonën e përafërt ose zonat, në të cilat parashikimi do të drejtohet.

(c) Parashikimi mund të drejtohet në mënyrë simultane nga një ose më shumë parashikues në të njëjtën zonë ose zona.

2. Parashikimi nuk do t'i garantojë parashikuesit çdo të drejtë në lidhje me burimet. Një parashikues, megjithatë, mundet të zbulojë një sasi të arsyeshme mineralesh që mund të përdoren për testim.

Neni 3
Eksplorimi dhe shfrytëzimi

1. Ndërmarrja, Shtetet Palë dhe institucione të tjera të referuara në nenin 153, paragrafi 2(b), mund t'i kërkojë Autoritetit për miratim planet e punës për veprimtaritë në Zonë.

2. Ndërmarrja mund të kërkojë përsa i përket çdo pjese të Zonës, por kërkesat nga të tjerat në lidhje me zonat rezervë janë subjekt i kërkesave plotësuese të nenit 9 të këtij aneksi.

3. Eksplorimi dhe shfrytëzimi do të kryhen vetëm në zonat e specifikuara në planet e punës të referuara në nenin 153, paragrafi 3 dhe miratuar nga Autoriteti në përputhje me këtë Konventë, si dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat përkatëse të Autoritetit.

4. Çdo plan i miratuar pune duhet të:

(a) të jetë konform me këtë Konventë dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit;

(b) parashikojë kontroll nga Autoriteti për veprimtaritë në zonë në përputhje me nenin 153, paragrafi 4;

(c) bjerë dakord me operatorin, në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, të drejtat ekskluzive për eksplorim dhe shfrytëzim të kategorive specifike të burimeve në zonë të mbuluara nga plani i punës. Nëse, megjithatë, kërkuesi paraqet për aprovim një plan pune që mbulon vetëm fazën e eksplorimit ose fazën e shfrytëzimit, plani i aprovuar i punës do të garantojë të drejta të tilla ekskluzive për a i përket vetëm kësaj faze.

5. Me aprovimin e tij nga Autoriteti, secili plan i punës, me përjashtim të atyre të paraqitur nga ndërmarrja, do të jetë në formën e një kontrate të përfunduar ndërmjet Autoritetit dhe kërkuesit ose

kërkuesve.

Neni 4
Kualifikimet e kërkuesve

1. Kërkuesit, përveçse Ndërmarrjes, duhet të jenë të kualifikuar, nëse ata kanë shtetësinë ose kontrollin dhe sponsorizimin e kërkuar neni 153, paragrafi 2(b) dhe nëse ata ndjekin procedurat dhe plotësojnë kualifikimin e standardeve të vendosura në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

2. Me përjashtim siç është parashikuar në paragrafin 6, standarde kualifikimi të tilla do të lidhen me aftësitë teknike dhe financiare të kërkuesit dhe zbatimit të tij të kontratës së mëparshme me Autoritetin.

3. Secili kërkues do të sponsorizohet nga Shtetet Palë shtetas i të cilit janë përveçse kur kërkuesi ka më shumë se një shtetësi, si në rastin e partneritetit ose konsorciumit të ndërmarjeve nga shtete të ndryshme, rast në të cilin të gjitha Shtetet Palë të përfshira do të sponsorizojnë kërkuesin ose përveçse kur kërkuesi kontrollohet efektivisht nga Shtetet Palë ose shtetasit e tyre, rast në të cilin të dy Shtetet Palë do të sponsorizojnë kërkuesin. Kriteret dhe procedurat për zbatimin e kërkesave të sponsorizimit do të vendosen në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

4. Shteti ose shtetet sponsorizuese, mbi bazën e nenit 139, do të kenë përgjegjësinë për të siguruar, brenda sistemeve të tyre ligjore, që një kontraktor i sponorizuar kështu, do të kryejë veprimtaritë në Zonë në konformitet me termat e kontratës së tij dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Konvente. Një shtet sponsorizues, megjithatë, nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga çdo faj i një kontraktuesi sponsorizuar nga ai për të qenë në përputhje me detyrimet e tij nëse ku Shteti Palë ka adoptuar ligje dhe rregulla dhe ka marrë masa administrative, të cilat janë brenda kuadrit të sistemit të tyre ligjor, përkatësisht të arsyeshme për të siguruar përputhjen nga personat sipas juridiksionit të tyre.

5. Procedurat për vlerësimin e kualifikimeve e Shteteve Palë, të cilët janë kërkues duhet të marrin në konsideratë karakterin e tyre si shtet.

6. Standadet kualifikuese do të kërkojnë që secili kërkues, pa asnjë përjashtim, si pjesë e kërkesës së tij do të ndërmarrë:

(a) që të pranojë si të pavendosura me forcë dhe të jetë në përputhje me detyrimet në zbatim të krijuara nga parashikimet e Pjesës XI, rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, vendimet e organeve të Autoritetit dhe termat e kontratës së tij me Autoritetin;

(b) që të pranojë kontrollin nga Autoriteti të veprimtarisë në Zonë, siç autorizohet nga kjo Konventë;

(c)të furnizojë Autoritetin me siguri të shkruara që detyrimet e tij sipas kontratës do të përmbushen me mirëbesim;

(d) të jetë në përputhje me parashikimet mbi transferimin e teknologjisë së vendosur në nenin 5 të këtij aneksi.

Neni 5
Transferimi i teknologjisë

1. Kur parashtron një plan pune, çdo kërkues duhet t'i paraqesë Autoritetit një përshkrim të përgjithshëm të pajisjeve dhe metodave që do të përdorë në zhvillimin e veprimtarive në Zonë dhe informacione të tjera jopersonale rreth karakteristikave të teknologjive të tilla dhe informacioneve përsa i përket vlefshmërisë së kësaj teknologjie.

2. Çdo operator do të njoftojë Autoritetin për rishikimet në përshkrimin dhe informacionin e bërë të vlefshëm në mbështetje të paragrafit 1 kurdoherë që ndodh një ndryshim thelbësor teknologjik ose prezantohet një novacion.

3. Çdo kontratë për të ushtruar veprimtari në Zonë do të përmbajë detyrimet që vijojnë nga kontraktuesi:

(a) T'i bëjë të njohur ndërmarrjes kurdoherë që autoriteti i kërkon, termat komerciale të arsyeshme dhe të drejta, teknologjinë që ai përdoë në ushtrimin e veprimtarive në zonë sipas kontratës, të cilën kontraktuesit i është ngarkuar ta transferojë.

Kjo duhet të bëhet me anën e licensave ose rregullave të tjera përkatëse, të cilat kontraktuesi duhet t'i negociojë me ndërmarrjen dhe të cilat duhet të vendosen në një marrëveshje shtesë të kontratës. Këto angazhime mundet te anullohen në qoftë se ndërmarrja e mendon që kjo është e pamundur për të fituar teknologjinë e njëjtë ose të barabartë efikase dhe të dobishme në tregun e hapur me kushtet dhe termat komerciale të arsyeshme dhe të drejta.

(b) Të marrë një siguri me shkrim nga pronari i çdo teknologjie që përdoret në ushtrimin e veprimtarive në zonë sipas kontratës, e cila nuk është në përgjithësi e vlefshme në tregun e hapur dhe e cila nuk është e mbuluar nga nënparagrafi (a) që pronari, kur ja kërkon Autoriteti do të ketë teknologji të vlefshme ndaj ndërmarrjes sipas licencës ose rregullave të tjera përkatëse dhe me terma e kushte komerciale të drejta dhe të arsyeshme në të njëjtën madhësi siç ju kërkua edhe kontraktuesit. Nëse kjo siguri nuk merret, teknologjia në fjalë nuk do të përdoret nga kontraktuesi në ushtrimin e veprimtarive në Zonë.

(c) Të marrë nga pronari me anën e një kontrate të detyruar me kërkesën e ndërmarrjes dhe nëse është e mundur ta bëjë këtë pa një kosto substanciale ndaj kontraktuesit, të drejtat ligjore për të transferuar në ndërmarrje çdo teknologji të përdorur nga kontraktuesi, në ushtrimin e veprimtarive në zonë sipas kontratës, të cilën kontraktuesi në të kundërt nuk është ligjërisht i ngarkuar për ta transferuar dhe e cila nuk është në përgjithësi e vlefshme në tregun e hapur. Në rastet kur është një marrëdhënie korporate substanciale ndërmjet kontraktuesit dhe pronarit të teknologjisë, afërsia e kësaj marrëdhënieje dhe shkalla e kontrollit ose influencës do të jetë e rëndësishme në përcaktimin nëse masat flesibël jane marrë për të fituar këtë të drejtë. Në rastet kur kontraktuesi ushtron kontroll efektiv mbi pronarin mosmarrja nga pronari i të drejtës ligjore duhet të konsiderohet i rëndësishëm për kualifikimin e kontraktuesit për çdo kërkesë të vazhdueshme për miratimin e planit të punës.

(d) Për të lehtësuar, pas kërkesës së ndërmarrjes, blerjen nga ndërmarrja të çdo teknologjie të mbuluar nga nënparagrafi (b) sipas licensës ose marrëveshjeve të tjera përkatëse dhe mbi kushte dhe terma komerçiale të drejta dhe të arsyeshme, në qoftë se ndërmarrja vendos të negociojë direkt me pronarin e teknologjisë.

(e) Të marrë të njëjtat masa siç përshkruhen në nënparagrafët (a), (b), (c) dhe (d) për përfitim të një shteti në zhvillim ose disa shteteve në zhvillim, të cilët kanë kërkuar për një kontratë sipas nenit 9 të këtij aneksi, me kusht që këto masa të jenë të kufizuara në shfrytëzimin e një pjese të zonës të propozuar nga kontraktuesi, e cila është rezervuar sipas nenit 8 të këtij aneksi dhe me kusht që veprimtaritë sipas kontratës të kërkuara nga shteti në zhvillim ose një grup shtetesh në zhvillim nuk do të përfshijnë transferimin e teknologjisë tek një shtet i tretë ose tek qytetarët e një shteti të tretë. Detyrimet sipas këtyre parashikimeve nuk do të zbatohen lidhur me çdo kontraktues të dhënë kur teknologjia nuk është kërkuar nga ndërmarrja ose transferuar nga kontraktuesi tek ndërmarrja.

4. Diksutimet lidhur me masat e kërkuara nga paragrafi 3, si dhe parashikimet e tjera të kontratës, do të jenë subjekt i vendimeve të detyrueshme në përputhje me Pjesën XI dhe në rastet e thyerjeve të këtyre masave, pezullimi ose mbyllja e kontratës ose dënime monetare mundet të urdhërohen në përputhje me nenin 18 të këtij aneksi. Diskutimet nëse ofertat e bëra nga kontraktuesi janë brenda hapësirës së kushteve dhe termave komerciale të drejta dhe të arsyeshme, mundet t'i parashtrohen nga secila Palë ndaj një arbitrazhi komercial në përputhje me rregullat e arbitrazhit UNICTRAL ose rregullave të arbitrazheve të tjere të tillë siç mundet të përshkruhen në rregulla, rregullore dhe procedurat e Autoritetit. Nëse del që oferta e bërë nga kontraktuesi nuk është brenda hapësirës së kushteve dhe termave komercialë të drejta dhe të arsyeshme, kontraktuesit do t'i jepen 45 ditë afat të rishikojë ofertën e tij për ta sjellë brenda hapësirave përpara se Autoriteti të marrë ndonjë veprim në përputhje me nenin 18 të këtij aneksi.

5. Nëse ndërmarrja nuk mundet të marrë me kushte dhe terma komerciale të drejta dhe të arsyeshme teknologjinë e duhur për ta bërë atë të aftë që të fillojë siç duhet nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve nga zona, atëherë ose Këshilli, ose Asambleja mund të mbledhë një grup Shtetesh Palë të përbërë nga ata të cilët janë të përfshirë në veprimtarinë në zonë, ata të cilët kanë sponsorizuar ndërmarrjet, të cilat janë përfshirë në veprimtaritë në Zonë dhe Shtete të tjera që kanë lidhje me teknologji të tilla. Grupi do të konsultohet së bashku dhe do të marrë masat efektive për të siguruar që teknologjia e tillë, është bërë e vlefshme me kushte dhe terma tregtare të drejta dhe të arsyeshme. Secili Shtet Palë do të marrë të gjitha masat flesibël për këtë qëllim brenda sistemit ligjor të tij.

6. Në rastin e shoqërive të përbashkëta me ndërmarrjen, transferimi i teknologjisë do të jetë në përputhje me termat e marrëveshjes për shoqëritë e përbashkëta.

7. Përpjekjet e kërkuara nga paragrafi 3 do të përfshihen në secilën kontratë për ushtrimin e veprimtarive në zonë deri në 10 vjet pas fillimit të prodhimit tregtar nga ndërmarrja, dhe mund të prishet gjatë kësaj periudhe.

8. Për qëllimet e këtij neni "teknologji" nënkupton pajisjet speciale dhe asistencën teknike, duke përfshirë manualet, projektet, instruksionet e operimit, këshillimin teknik, asistencën dhe trajnimin të nevojshme për të bashkuar, mirëmbajtur dhe operuar një sistem të vlefshëm dhe të drejtën ligjore për t'i përdorur këto pika për këtë qëllim mbi baza joekskluzive.

Neni 6

Miratimi i planit të punës

1. Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe më vonë çdo katër muaj, Autoriteti do të marrë në konsideratë planin e punës së propozuar.

2. Kur merret në konsideratë një kërkesë për miratimin e planit të punës në formën e kontratës, Autoriteti duhet së pari të sqarojë nëse:

(a) Kërkuesi është në përputhje me procedurat e vendosura për kërkesat në përputhje me nenin 4 të këtij aneksi dhe i ka dhënë Autoritetit përpjekjet dhe sigurimet e kërkuara nga ky nen. Në rastet e mospërputhjes me këto procedura ose në mungesë të disa nga këto përpjekje dhe sigurime, kërkuesit do t'i jepen 45 ditë për të rregulluar këto difekte.

(b) Kërkuesi zotëron rekuizitën e kualifikimeve të parashikuara në nenin 4 të këtij aneksi.

3. Të gjitha planet e punës të propozuar do të merren sipas rradhës në të cilën ato janë marrë. Planet e punës së propozuar do të jenë në përputhje dhe do të udhëhiqen nga parashikimet e duhura të kësaj Konvente, rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit, duke përfshirë ato mbi kërkesat e operimit, kontributeve financiare dhe masave lidhur me transferimin e teknologjisë. Nëse plani i propozuar i punës është konform këtyre kërkesave, Autoriteti do të miratojë ato me kusht që ato janë në përputhje me kërkesat e uniforme dhe jodiskriminuese të vendosura në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, përveçse:

(a) një pjese e të gjithë zonës e mbuluar nga plani i propozuar i punës është i përfshirë në një plan pune të miratuar ose në një plan pune të propozuar që përpara, i cili akoma nuk është vendosur nga autoriteti;

(b) një pjese të të gjithë zonës së mbuluar nga plani i punës i propozuar nuk është i miratuar nga Autoriteti në mbështetje të nenit 162, paragrafi 2 (x);

(c) planit të propozuar të punës që është parashtruar ose sponsorizuar nga një Shtet Palë, i cili tashmë ka:

(i) planet e punës për eksplorim dhe shfrytëzim dhe shfrytëzimin e burimeve polimetalike në zona jo të rezervuara që, së bashku me secilën pjesë të zonës së mbuluar nga kërkesa për një plan pune, tejkalon 30 % të një zone rrethore prej 400 000 km katror që rrethon qendrën e secilës pjesë të zonës së mbuluar nga plani i propozuar i punës;

(ii) planet e punës për shfrytëzimin dhe eksplorimin e burimeve polimetalike në një zonë jo të rezervuar, të cilat të marra së bashku, përbëjnë 2 për qind të totalit të zonës së shtratit të detit, i cili nuk është rezervuar ose miratuar për shfrytëzim mbi bazën e nenit 162, paragrafit 2(x).

4. Për qëllimet e standardeve të vendosura në paragrafin 3 (c), një plan pune i parashtruar nga një partneritet ose konsorcium duhet të llogaritet mbi baza pro rata ndërmjet shteteve palë sponsorizuese të përfshira në përputhje me nenin 4, paragrafi 3 të këtij aneksi. Autoriteti mundet të miratojë plane pune të mbuluara nga paragrafi 3(c) nëse përcakton që një miratim i tillë nuk do të lejojë një Shtet Palë ose ndërmarrje të sponsorizuar nga ai të monopolizojë drejtimin e veprimtarive në Zonë ose të përjashtojë Shtete të tjera Palë nga veprimtaritë në zonë.

5. Pa marrë parasysh paragrafin 3(a), pas skadimit të periudhës së përkohshme të specifikuar në nenin 151, paragrafi 3, autoriteti mundet të adaptojë me anë të rregullave rregulloreve dhe procedurave, procedura dhe kritere të tjera mbi bazën e kësaj Konvente për të përcaktuar se cili nga kërkuesit do të ketë planin e punës së miratuar në rastet e zgjedhjes ndërmjet kërkuesve për një zonë të propozuar. Këto procedura dhe kritere duhet të sigurojnë miratimin e planit të punës mbi baza të barazisë dhe jodiskriminuese.

Neni 7

Zgjedhja ndërmjet kërkuesve për autorizime prodhimi

1. Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe më vonë çdo katërmujor Autoriteti do te mblidhet për të marrë në konsideratë kerkesat për autorizim prodhimi të parashtruara gjatë periudhës së përparshme. Autoriteti do të lëshojë autorizimet e kërkuara në se te gjithë kërkuesit e tillë mundet të miratohen pa tejlkaluar kufijt e prodhimit ose thyer detyrimet e Autoritetit sipas një marrëveshje ose rregullash për të cilat ai është bërë palë, siç parashikohet në nenin 151.

2. Kur duhet bërë një zgjedhje ndërmjet kërkuesve për autorizime prodhimi për arsye të kufizimit të prodhimit të vendosur në nenin 151, paragrafi 2 deri 7, ose për arsye të detyrimeve të Autoritetit sipas një marrëveshjeje ose rregullave për të cilat ai është bërë Palë, siç është parashikuar në nenin 151, paragrafi 1, Autoriteti do të bëjë zgjedhjen mbi bazën e objektivave standarde dhe jodiskriminuese të vendosura në rregullat, rregulloret dhe procedurat e tij.

3. Në kërkesat e paragrafit 2, Autoriteti do t'i japë prioritet atyre kërkuesve të cilët:

(a) japin siguri më të mirë të zbatimit, duke marrë në konsideratë kualifikimin e tyre teknik dhe financiar dhe zbatimin e tyre, nëse ka, sipas planit të punës paraprak;

(b) parashikojnë përfitime financiare më të shpejta për Autoritetin, duke marrë në konsideratë kur është planifikuar të fillojë prodhimi tregtar;

(c) pothuaj kanë filluar te investojnë shumë burime dhe përpjekje në parashikimin ose shfrytëzimin.

4. Kërkuesit, të cilët nuk janë zgjedhur në çdo periudhë do të kenë prioritet në periudha të vazhdueshme derisa ata të marrin një autorizim prodhimi.

5. Zgjedhja duhet të bëhet duke marrë në konsideratë nevojat e zgjerimit të mundësive për të gjitha Shtetet Palë, pa marrë parasysh sistemet e tyre ekonomike dhe sociale ose pozicionin gjeografik në mënyrë të tillë të shmangin diskriminimin kundër çdo Shteti ose sistemi, për të marrë pjesë në veprimtari në Zonë për të parandaluar monopolizimin e këtyre veprimtarive.

6. Kurdoherë që disa zona të rezervuara sesa zona jo të rezervuara janë në shfrytëzim, kërkesat për autorizim prodhimi lidhur me zonat e rezervuara do të kenë prioritet.

7. Vendimet referuar në këtë nen do të merren sa më shpejt të jetë e mundur pas mbylljes së çdo periudheje.

Neni 8

Rezervimi i zonave

Secila kërkesë, përveçse atyre të parashtruara nga ndërmarrja ose nga ente të tjera për zonat e rezervuara, do të mbulojnë një zone totale, e cila nevojitet të jetë një zonë e vazhdueshme e vetme, mjaftueshëm e madhe dhe të një vlere komerciale të mjaftueshëm të llogaritur që të lejojë dy operime minierash. Kërkuesi duhet të tregojë zonat e e koordinuara të zhytjes në dy pjesë të një vlere të llogaritur të barabartë dhe të parashtrojë të gjitha të dhënat e fituara nga ai lidhur me të dy pjesët. Pa paragjykuar fuqitë e Autoritetit në vazhdim të Nenit 17 të këtij Aneksi, të dhënat që duhet të parashtrohen lidhur me burimet polimetalike duhet të lidhen me nje hartë mostrat rezervat e burimit dhe përmbajtjen e tyre te metaleve. Brënda 45 ditëve të marrjes së të dhënave të tilla, Autoriteti duhet të projektojë se cila pjesë duhet të rezervohet vetëm për drejtimin e veprimtarive nga Autoriteti nëpërmjet ndërmarrjes ose në shoqërim me shhtetet e zhvilluara. Ky projekt mundet t'i referohet për një periudhë tjetër 45 ditore nëse Autoriteti e kërkon një ekspert të pavarur për të vlerësuar nëse të gjitha të dhënat e kërkuara nga ky nen janë parashtruar. Zona e projektuar do të bëhet një zonë në rezervim sa më shpejt të jetë e mundur që plani i punës për zonat e rezervuara janë miratuar dhe kontrata është firmosur.

Neni 9

Veprimtaritë në zona të rezervuara

1. Ndërmarrjes i duhet dhënë një mundësi për të vendosur nëse ajo ka për qëllim të ushtrojë veprimtari në secilën zonë. Ky vendim mund të merret në çdo kohë, përveçse kur njoftimi eshtë marrë në vazhdim të paragrafit 4 nga Autoriteti, në ngjarjet e të cilave ndërmarrja duhet të marrë vendimet e

saj brenda një kohe të arsyeshme. Ndërmarrja mundet të vendosë të shfrytëzojë zona të tilla në ndërmarrje të përbashkëta me shtetin e interesuar ose institucionin.

2. Ndërmarrja mundet të përfundojë kontrata për zbatimin e një pjese të veprimtarive të saj në përputhje me aneksin IV, neni 12. Ajo mund të hyjë gjithashtu në shoqëri të përbashkëta për drejtimin e aktiviteteve të tilla me çdo institucion, të cilët janë të ligjshëm për të ushtruar veprimtari në Zonë mbi bazën e nenit 153, paragrafi 2(b). Kur merr në konsideratë shoqëri të përbashkëta të tilla, ndërmarrja do t'i ofrojë Shteteve Palë të cilat janë shtete të zhvilluara dhe qytetarët e tyre kanë mundësi të pjesëmarrjes efektive.

3. Autoriteti mundet të përshkruajë në rregullat, rregulloret dhe procedurat e tij kërkesa substanciale dhe proceduriale, si dhe kushte lidhur me shoqëri të përbashkëta dhe kontrata të tilla.

4. Çdo Shtet Palë, i cili është një shtet i zhvilluar ose çdo person fizik ose juridik i sponsorizuar nga ai dhe kontrolluar efektivisht nga ai ose shtete të tjera të zhvilluara, i cili është një kërkues i kualifikuar ose çdo grup i përmendur më sipër, mundet të njoftojë Autoritetin që ai dëshiron të parashtrojë një plan pune mbi bazën e nenit 6 të këtij aneksi lidhur me zonat e rezervuara. Plani i punës duhet të konsiderohet nëse ndërmarrja vendos, mbi bazën e paragrafit 1, që ai nuk mendon të zhvillojë veprimtari në këtë zonë.

Neni 10

Prioritetet dhe preferencat ndërmjet kërkuesve

Një operator, i cili ka një plan të miratuar pune vetëm për shfrytëzim siç parashikohet në nenin 3, paragrafi 4(c) të këtij aneksi do të ketë një preferencë dhe prioritet ndërmjet kërkuesve për një plan pune që mbulon shfrytëzimin e së njëjtës zonë dhe burimi. Megjithatë, preferenca dhe prioritete të tilla mundet të hidhen poshte nëse puna e operatorit nuk ka qenë e kënaqshme.

Neni 11

Marrëveshje të përbashkëta

1. Kontratat mundet të parashikohen për marrëveshje të përbashkëta ndërmjet kontraktuesit dhe Autoritetit nëpërmjet ndërmarrjes, në formën e shoqërive të përbashkëta ose ndarjes së prodhimit, të cilat do të kenë të njëjtën mbrojtje kundër revizionit, pezullimit ose përfundimit, si edhe kontratat me Autoritetin.

2. Kontraktuesit që hyjnë në marrëveshje të tilla të perbashkëta me Ndërmarrjen mundet të marrin nxitje financiare, siç parashikohet në nenin 13 të këtij aneksi.

3. Partnerët në shoqëri të përbashkëta me ndërmarrjen do të jenë përgjegjës për pagesat e kërkuara nga neni 13 të këtij aneksi në zgjerim të pjesës së tyre në shoqëritë e përbashkëta, mbështetur në nxitjen financiare siç parashikohet në këtë nen.

Neni 12

Veprimtaritë e ndërmarra nga ndërmarrja

1. Veprimtaritë e ndërmarra nga ndërmarrja në zonë mbi bazën e nenit 153, paragrafi 2(a), do të drejtohen sipas Pjesës XI, rregullave, regulloreve dhe procedurave të Autoritetit dhe vendimeve të tij përkatëse.

2. Çdo plan pune i parashtruar nga ndërmarrja do të shoqërohet me dëshmi që mbështesin aftësitë e tij teknike dhe financiare.

Neni 13

Termat financiare të kontratës

1. Në adaptimin e rregullave, regulloreve dhe procedurave në lidhje me termat financiare të një kontrate ndërmjet Autoritetit dhe enteve të referuara në nenin 153, paragrafi 2(b) dhe në negociimin e këtyre termave financiare në përputhje me Pjesën XI dhe këtyre rregullave, regulloreve dhe procedurave, Autoriteti do të udhëhiqet nga objektivat që vijojnë:

(a) të sigurojë të ardhurat optimale për Autoritetin nga vazhdimi i prodhimit komervial;

(b) të tërheqë investime dhe teknologji për kërkimin dhe shfrytëzimin e Zonës;

(c) të sigurojë barazinë në trajtimin financiar, detyrime financiare të krahasueshme prej kontraktuesve;

(d) të parashikojë nxitje në baza uniforme dhe jodiskriminuese për kontraktuesit për të ndërmarrë rregullime të përbashkëta me ndërmarrjen dhe shtetet në zhvillim ose qytetarët e tyre, për të stimuluar transferimin e teknologjisë dhe të trajnojë personelin e Autoritetit dhe të shteteve në zhvillim;

(e) të afttësojë ndërmarrjen të angazhohet në minierat e shtratit të detit me efektivitet në të njëjtën kohë si entet e referuara në nenin 153, paragrafi 2(b);

(f) të sigurojë, si rezultat i nxitjes financiare të të dhënave kontraktorëve sipas paragrafit 14, sipas termave të kontratës së rishikuar në përputhje me nenin 19 të këtij aneksi ose sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij aneksi lidhur me shoqëritë e përbashkëta, që kontraktorët nuk janë subvencionuar në mënyrë të tillë që t'u jepet avantazh kompetitiv artificial lidhur me minierat e bazuara në tokë.

2. Një taksë do të mblidhet për koston administrative gjatë procesit të një kërkese për miratimin e planit të punës në formën e një kontrate dhe do të fiksohet në vlerën prej 500.000 USD për kërkesë. Shuma e taksës do të rishikohet kohë pas kohe nga Këshilli me qëllim të sigurimit që ajo mbulon koston administrative të kryer. Nëse kostoja administrative e kryer nga Autoriteti gjatë procesit të një kërkese është më e vogël sesa shuma fikse, Autoriteti do t'i kthejë diferencën kërkuesit.

3. Një kontraktues do të paguajë një taksë vjetore fikse prej 1 milion dollarësh nga data e hyrjes në fuqi të kontratës. Nëse data e miratuar e fillimit të prodhimit komercial shtyhet për arsye vonese në lëshimin e autorizimit të prodhimit, në përputhje me nenin 151, taksa vjetore fikse do të hiqet për periudhën e shtyrjes, kontraktuesi do të paguajë ose pagesën e prodhimit ose taksën vjetore fikse, cilado qoftë më e madhe.

4. Brenda një viti nga data e fillimit të prodhimit komercial, në përputhje me paragrafin 3, një kontraktues do të zgjedhë për të bërë kontributin e tij financiar ndaj Autoritetit ose:

(a) duke paguar një pagesë prodhimi vetëm;

(b) duke paguar një kombinim të pageses së prodhimit dhe një pjesë të prodhimit neto.

5. (a) Nëse një kontraktues zgjedh që të bëjë kontributin e tij financiar ndaj Autoritetit duke paguar një pagesë prodhimi vetëm, ajo do të jetë fikse në një përqindje të vlerës së tregut të metalit në proces të prodhuar nga nodulet polimetalike të përfituara nga zona e mbuluar nga kontrata. Kjo përqindje do të jetë fikse si vijon:

(i) Për vitet 1-10 të prodhimit komercial 5 për qind

(ii) Për vitet 11 deri në fundin e prodhimit komercial 12 për qind

(b) Vlera e tregut në fjalë do të jetë prodhimi i sasisë së metalit në proces të prodhuar nga nodulet polimetalike të nxjerra nga zona e mbuluar nga kontrata dhe çmimi mesatar për këto metale gjatë viteve përkatëse të llogaritjes, siç përcaktohet në paragrafin 7 dhe 8.

6. Nëse një kontraktues zgjedh që të bëjë kontributin financiar ndaj Autoritetit duke paguar një kombinim të pagesës së prodhimit dhe një pjese të prodhimit neto, një pagesë e tillë do të përcaktohet si vijon:

(a) Pagesa e prodhimit do të jetë fikse në një përqindje të vlerës së tregut, e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin (b) të metaleve në proces të prodhuara nga nodulet polimetalike të nxjerra nga zona e mbuluar nga kontrata. Kjo përqindje do të jetë fikse si vijon:

(i) Periudha e parë e prodhimit komercial 2 për qind.

(ii) Periudha e dytë e prodhimit komercial 4 për qind

Nëse në periudhën e dytë të prodhimit komercial, siç parashikohet në nënparagrafin (d), kthimi i investimit në çdo vit të llogaritur siç parashikohet në nënparagrafin (m) bie poshte 15 për qind si rezultat i pagesës të prodhimit në 4 për qind, pagesa e prodhimit do të jetë 2 për qind në vend të 4 për qindëve në vitin llogaritës.

(b) Vlera e tregut në fjalë do të jetë prodhimi i sasisë së metaleve në proçes të prodhuar nga nodulet polimetalike të nxjerra nga zona e mbuluar nga kontrata dhe çmimit mesatar për këto metale gjatë viteve përkatëse të llogaritjes, siç përcaktohet në paragrafet 7 dhe 8.

(c) (i) Pjesa neto e Autoritetit duhet të nxirret nga porcioni i pjesës neto të kontraktuesit, e cila është e atribuar ndaj nxjerrjes së burimeve të zonës së mbuluar nga kontrata, e referuar këtu më poshtë si pjesa neto.

(ii) Pjesa e Autoritetit neto do të vendoset në përputhje me programin në rritje që vijon:

Porcioni i atribuar të pjeses neto të Autoritetit. Periudha e parë e prodhimit komercial, periudha e dytë e prodhimit komercial. Ky porcion që përfaqëson një kthim të investimit që është më i madh se 0 për qind, por më pak se 10 për qind, 35 për qind, 40 për qind. Ky porcion përfaqëson një kthim investimi, i cili është 10 për qind ose më i madh, por jo më pak se 20 për qind, 42.5 për qind 50 për qind. Ky porcion përfaqëson një kthim investimi, i cili është 20 për qind ose më i madh 50 për qind, 70 përqind.

(d) (i) Periudha e parë e prodhimit komercial referuar në nënparagrafet (a) dhe (c) do të fillojë në vitin e parë të llogaritjeve të prodhimit komerçial dhe do të përfundojë në vitin e llogaritjeve në të cilin kosto e zhvillimit të kontraktuesit me interesat për pjesën e pambuluar janë mbuluar plotësisht me shtesën në cash të tij, si vijon:

Në vitin e parë të llogaritjeve gjatë të cilit ndodh kostoja e zhvillimit, kostoja e zhvillimit e pambuluar do të jetë e barabartë me koston e zhvillimit të pambuluar minus cash-in shtesë në këtë vit. Në secilin vit në vazhdim kostoja e pambuluar e zhvillimit do të barazohet me koston e pambuluar të zhvillimit plus interesin me një vlerë prej 10 për qind në vit, plus koston e ndodhur të zhvillimit në vitin paraardhës minus keshin plus të kontraktuesit në vitin aktual të llogaritjeve. Viti i llogaritjeve në të cilin kosto e pambuluar e zhvillimit bëhet zero për herë të parë do të jetë viti i llogaritjeve në të cilin kostoja e pambuluar e zhvillimit e kontraktuesit me interesat për pjesën e pambuluar janë mbuluar plotësisht nga cash-i plus i tij. Plusi në cash kontraktuesit në çdo vit llogaritjesh do të jetë pjesa bruto e tij minus koston e tij operative dhe minus pagesat e tij që i kryhen autoritetit sipas nënparagrafit (c).

(ii) Periudha e dytë e prodhimit komerçial do të filloje në vitin e llogaritjeve që pâson përfundimin e periudhës së parë të prodhimit komerçial dhe do të vazhdojë deri në fundin e kontratës.

(e) "Pjesa neto e atribueshme", nënkupton prodhimin e pjesës neto të kontraktuesit me përqindjen e kostos së zhvillimit në sektorin e minierës ndaj kostos së zhvillimit të kontraktuesit. Nëse kontraktuesi i përfshirë në minierë, transportin e noduleve polimetalike dhe prodhimit së pari të tre mineraleve në proces, konkretisht kobalt, bakër dhe nikel, shuma e atribueshme e pjesës neto nuk do të jetë më pak se 25 për qind e pjesës neto të kontraktuesit. Përveç nënparagrafit (n), në të gjitha rastet e tjera, duke përfshirë ato kur kontraktuesi përtfshihet në miniera, transport të noduleve polimetalike, dhe prodhimeve të para të katër metaleve, konkretisht kobalt, manganes bakër dhe nikel, Autoriteti mundet, në rregullat e tij, rregulloret dhe proçedurat, të përshkruajë nivelet përkatëse që duhet ti përmbajnë marrëdhënie të njëjta në secilin rast si niveli 25 përqind i bërë për rastin e tre metaleve.

(f) "Pjesa neto e kontraktuesit" nënkupton pjesën bruto të kontraktuesit minus koston operative dhe minus mbulimin e kostos së tij të zhvillimit, siç është vendosur në nënparagrafin (j).

(g) (i) Në rastet e kontraktuesit të angazhuar në miniera, transportin e noduleve polimetalike dhe prodhimit të metaleve të proçesuara "pjesa bruto e kontraktuesit" nënkupton të ardhurat bruto nga shitja e metaleve të procesuara dhe parave të tjera që duken arsyeshëm të atribueshme për operimin sipas kontratës në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat financiare të Autoritetit.

(ii) Në të gjitha rastet e tjera përveç atyre të specifikuara në nënparagrafet (g)(i) dhe (n)(iii), "pjesa bruto e kontraktuesit", nënkupton të ardhurat bruto nga shitja e metaleve gjysëm të procesuara nga nodulet polimetalike të nxjerra nga zona sipas kontratës dhe çdo paraje tjetër që duket arsyeshëm e atribueshme për operimin sipas kontratës në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat financiare të Autoritetit.

(h) "Kosto e zhvillimit të kontraktuesit" nënkupton:

(i) të gjitha shpenzimet përpara fillimit të prodhimit komercial, të cilat janë të lidhura direkt me zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të zonës së mbuluar nga kontrata dhe veprimtarive përkatëse për operim sipas kontratës në fillimin e prodhimit komercial, të cilat janë të lidhura direkt të lidhura me zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të zonës së mbuluar nga kontrata dhe veprimtarive që lidhen me operimet sipas një kontrate në të gjitha rastet, përveç atyre të specifikuar në nënparagrafin (n), në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogaritjeve, duke përfshirë, inter-alia, koston e makinerive, pajisjeve, anijeve uzinave prodhuese, konstruksioneve, ndërtesave, tokës, rrugëve, perspektivës dhe eksplorimit të zonës së mbuluar nga një kontratë, kërkimit dhe zhvillimit, interesave, qirave të kërkuara, licensave dhe taksave;

(ii) shpenzime të njëjta të vendosura në (i) më sipër të ndodhura në vazhdim të fillimit të prodhimit komercial dhe të nevojshëm për të kryer planin e punës, më përjashtim të atyre që i ngarkohen kostos operative.

(i) Produkti nga disponimi i aseteve kapitale, të cilat nuk duhen më gjatë për operim dhe vlerës së tregut të këtyre aseteve të kapitaleve të cilet nuk kërkohem më gjatë për operim sipas kontratës dhe të cilat nuk janë shitur për operim do të zbriten nga kosto e zhvillimit të kontraktuesit gjatë vitit përkatës të llogaritjeve. Kur këto zbritje tejkalojnë koston e zhvillimit të kontraktuesit tejkalimi duhet ti shtohet pjesës bruto të kontraktuesit.

(j) Kostoja e zhvillimit të kontraktuesit të ndodhur përpara fillimit të prodhimit komercial të referuar në nënparagrafet (h)(i) dhe (n)(iv) do të mblidhet në 10 instalime vjetore nga data e fillimit të prodhimit komercial. Kostoja e zhvillimit të kontraktorit e ndodhur në vazhdim të fillimit të prodhimit komercial referuar në nënparagrafet (h)(ii) dhe (n)(iv) do të mbulohen me 10 për qind ose instalime të tjera vjetore të barabarta që të sigurojnë mbulimin e plotë tëtyre në fundin e kontratës.

(k) "Kostoja e operimit të kontraktuesit" nënkupton të gjitha shpenzimet e ndodhura pas fillimit të prodhimit komercial gjatë operimit të aftësive prodhuese të zonës së mbuluar nga një kontratë në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogarisë, duke përfshirë, inte- alia, taksën vjetore fikse të pagesës për prodhimin, cilado qoftë më e madhe, shpenzimet për pagat, rrogat, përfitimet e punonjësve, materialeve, shërbimeve, transportit, kostos së përpunimit dhe marketimit, interesave, pajisjeve, ruajtjes se ambientit detar, kostos administrative veçanërisht të lidhur me operimin sipas kontratës dhe çdo humbje operative neto të kryer përpara ose prapa siç specifikohet këtu me poshtë. Humbjet operative neto mundet të kryhen përpara për dy vjetëve në vazhdim me përjashtim te dy viteve të fundit të kontratës, rast në të cilin ato mund të kryhen prapa dy viteve që kalojnë.

(l) Në rast se kontraktuesi është i përfshirë në miniera, transportin e noduleve polimetalike dhe prodhimin e metaleve fabrikate ose gjysëm fabrikate, “kosto e zhvillimit të sektorit të minierave” nënkupton porcionin e kostos së zhvillimit të kontraktuesit, e cila është e lidhur direkt me minierat e burimeve të zonës së mbuluar nga një kontratë, në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogaritjeve dhe rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit, duke përfshirë, inte- alia, taksën e kërkesës, taksën fikse vjetore dhe kur është e zbatueshme, koston e eksplorimit dhe perspektivës së zonës së mbuluar nga kontrata dhe një porcion të kostos së zhvillimit dhe kërkimeve.

(m) "Kthimi i investimit" në çdo vit të llogaritjeve nënkupton raportin e pjeses se atribueshme neto në këtë vit ndaj kostos së zhvillimit të sektorit të minierave. Për qëllimet e llogaritjes së këtij raporti kostoja e zhvillimit të sektorit të minierave do të përfshijë shpenzimet e pajisjeve të reja që janë rinovuar në sekstorin e minierave minus koston e origjinës të pajisjeve të zëvendësuara.

(n) Nëse kontraktuesi është i përfshirë vetëm me minierat:

(i) "pjesa neto e atribueshme" nënkupton të gjithë pjesën neto të kontraktuesit;

(ii) "pjesa neto e kontraktuesit" do të jetë siç përcaktohet në nënparagrafin (f);

(iii) "pjesa bruto e kontraktuesit" nënkupton të ardhurat bruto nga shitja e noduleve polimetalike dhe çdo paraje tjetër që duket e arësyeshme për operimin sipas një kontrate në pë pputhje me rregullat, rregulloret dhe proçëdurat financiare të Autoritetit;

(iv) "Kosto e zhvillimit të kontraktuesit" nënkupton të gjitha shpenzimet e ndodhura përpara fillimit të prodhimit komercial siç është paraqitur në nënparagrafin (h)(ii), të cilat janë të lidhura direkt me minierat e burimeve të zonës së mbuluar nga kontrata, në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogaritjeve;

(v) "kosto e operimit të kontraktuesit" nënkupton koston e operimit të kontraktuesit siç është në nënparagrafin (k), e cila është e lidhur direkt me minierat e burimeve të zonës së mbuluar nga kontrata në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogarisë;

(vi) "kthimi i investimit" në ço vit të llogaritjeve nënkupton raportin e pjesës neto të kontraktuesit në këtë vit mbi koston e zhvillimit të kontraktuesit. Për qëllimet e llogaritjes së këtij raporti, kosto e zhvillimit te kontraktuesit do të përfshijë shpenzimet për pajisjet e reja ose ato që rinovohen minus koston e origjinës së pajisjeve të zëvendësuara.

(o) Kostoja e referuar në nënparagrafet (h), (k), (l) dhe (n) në lidhje me interesat e paguara nga kontraktuesi do të lejohen të zgjerohen, në të gjitha rrethanat, kur Autoriteti miraton, mbi bazën e nenit 4, paragrafi 1 të këtij aneksi, raporti i debitit dhe raporti i interesit si të arsyeshëm, duke pasur parasysh praktikat komerciale ekzistuese.

(p) Kostot e referuara në këtë paragraf nuk do të interpretohen si përfshirje e pagesës së taksës mbi të ardhurat e korporatës ose pagesave të ngjashme të mbledhura nga shteti në lidhje me operimin e kontraktuesit.

7. (a) "Metalet e fabrikuara", referuar në paragrafet 5 dhe 6, nënkupton metalet në format bazë në të cilat ata zakonisht tregtohen në tregjet ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Autoriteti duhet të specifikojë në rregullat, rregulloret dhe procedurat financiare, tregjet përkatëse ndërkombëtare. Për metalet, të cilat nuk janë tregtuar në tregje të tilla, "metale të fabrikuara" nënkupton metalet në format bazë në të cilat ata zakonisht janë tregtuar në transaksione representative.

(b) Nëse Autoriteti nuk mund të vendosë ndryshe sasinë e metaleve të fabrikuara të prodhuara nga nodulet polimetalike të nxjerra nga zona e mbuluar nga kontrata e referuar në paragrafet 5(b) dhe 6(b), sasia do të përcaktohet mbi bazën e përmbajtjes së metaleve në nodule, efikasitetit të procesit të nxjerrjes dhe faktorëve të tjerë përkatës, në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogarisë.

8. Nëse një treg ndërkombëtar parashikon mekanizmin e çmimeve për një metal të fabrikuar representativ, për nodulet polimetalike dhe metalet gjysëm të fabrikuara nga nodulet, do të përdoret çmimi mesatar në treg. Në të gjitha rastet e tjera, Autoriteti, pas konsultimit me kontraktuesin, do të përcaktojë një çmim të drejtë për prodhimet në fjalë në përputhje me paragrafin 9.

9. (a) Të gjitha kostot, shpenzimet, prodhimet dhe të ardhurat dhe të gjitha përcaktimet e çmimeve dhe vlerave të referuara në këtë nen do të jenë rezultat i tregut të lirë ose të transaksioneve. Në mungesë të tyre, ato do të përcaktohen nga Autoriteti pas konsultimit me kontraktuesin, sikur ato të ishin rezultat i tregut të lirë ose transaksioneve, duke marrë në konsideratë transaksionet përkatëse në tregjet e tjera.

(b) Me qëllim që të sigurohet përputhja dhe imponimi i parashikimeve të këtij paragrafi, Autoriteti do të udhëhiqet nga parimet e adaptuara dhe interpretimet e dhëna për transaksionet nga komisioni për korporatat transnacionale të Kombeve të Bashkuara, grupit të ekspertëve mbi traktatet e taksave ndërmjet shteteve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara dhe organizatave të tjera ndërkombetare dhe në rregullat, rregulloret dhe procedurat e tij, do të specifikojë rregulla dhe procedura llogaritjeje uniforme të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe mjetet e zgjedhjes nga kontraktuesi i llogaritarëve të pavarur të certifikuar, të pranueshëm nga Autoriteti për qëllimet e kryerjes së auditimit në përputhje me këto rregulla, rregullore dhe procedura.

10. Kontraktuesi do t'i vërë në dispozicion llogaritarëve, në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat financiare të Autoritetit, të dhëna të tilla financiare siç kërkohen për të qenë në përputhje me këtë nen.

11. Të gjitha kostot, shpenzimet, prodhimet dhe të ardhurat dhe të gjitha çmimet dhe vlerat e referuara ne këtë nen, do të përcaktohen në përputhje me parimet e përgjithshme të njohura të llogarisë dhe procedurave të Autoritetit.

12. Pagesat ndaj Autoritetit sipas paragrafëve 5 dhe 6 do të bëhen me monedhë të përdorshme lirisht dhe të përdorshme me efektivitet në tregjet kryesore të huaja të shkëmbimit ose sipas opsionit të kontraktuesit në ekuivalencën e metaleve të fabrikuara në vlerën e tregut. Vlera e tregut do të përcaktohet në përputhje me paragrafin 5(b). Monedhat e përdorshme lirisht dhe monedhat, të cilat janë lirisht të vlefshme dhe efektivisht të përdorueshme në tregjet e huaja kryesore të shkëmbimit, do të përcaktohen në rregulla, rregullore dhe procedurat e Autoritetit ne përputhje me praktikat mbizotëruese monetare ndërkombëtare.

13. Të gjitha detyrimet financiare të kontraktuesit ndaj Autoritetit, si dhe taksat e tij, kostoja shpenzimet, fabrikatet dhe të ardhurat, referuar në këtë nen, do të rregullohen duke i shprehur ato në terma konstante përsa i përket vitit bazë.

14. Autoriteti, duke marrë në konsideratë çdo rekomandim të komisionit të planizimit ekonomik dhe të komisionit tekniko-ligjor adapton rregulla, rregullore dhe procedura që parashikojnë nxitje, mbi baza uniforme dhe jodiskriminuese, ndaj kontraktuesve për objektiva të mëtejshme të vendosura në paragrafin.

15. Në rastet e një diskutimi ndërmjet Autoritetit dhe një kontraktuesi përsa i përket interpretimit ose zbatimit të termave financiare të një kontrate, secila Palë mundet të parashtrojë diskutimin ndaj një arbitrazhi komercial, përveçse kur të dy Palët bien dakord që të zgjidhin diskutimin me mjete të tjera, në përputhje me nenin 188, paragrafi 2.

Neni 14

Transferimi i të dhënave

1. Operatori do të transferojë tek Autoriteti, në përputhje me rregullat, rregulloret, dhe proçedurat, si dhe termat e kushtet e planit të punës, në intervalet e kohës të përcaktuara nga Autoriteti të gjitha të dhënat, të cilat janë të dyja të nevojshme dhe efektive për ushtrimin e fuqive dhe funksioneve të organeve kryesore të Autoritetit në lidhje me zonën e mbuluar nga plani i punës.

2. Të dhënat e transferuara lidhur me zonën e mbuluar nga një plan pune, që duket si pronë, mundet të përdoret vetëm për qëllimet e vendosura në këtë nen. Të dhënat e nevojshme të formuluara nga Autoriteti, të rregullave, rregulloreve dhe procedurave lidhur me mbrojtjen e ambientit detar dhe sigurisë, përveçse të dhënave të projekteve të pajisjeve, nuk do të quhen pronë.

3. Të dhënat e transferuara ndaj Autoritetit nga parashikuesit, kërkuesit për kontratë ose kontraktuesit, që duken pronë, nuk do të mbulohen nga Autoriteti për ndërmarrjen ose tek çdo njeri jashtë Autoritetit, por të dhënat mbi zonat e rezervuara mundet t'i mbyllen ndërmarrjes. Të dhëna të tilla nga persona të tillë ndaj ndërmarrjes nuk do të bllokohen nga ndërmarrja për Autoritetin ose tek çdo njeri jashtë Autoritetit.

Neni 15
Programet e trajnimit

Kontraktuesi do të përgatisë programe praktike për trajnimin e personelit të Autoritetit të shteteve në zhvillim, duke përfshirë pjesëmarrjen e personelit të tillë në të gjitha veprimtaritë në Zonën, e cila mbulohet nga një kontratë, në përputhje me nenin 144, paragrafi 2.

Neni 16
Të drejtat ekskluzive për eksplorim dhe shfrytëzim

Autoriteti mbi bazën e Pjesës, do t'i akordojë operatorit të drejtën ekskluzive për eksplorim dhe shfrytëzim të zonës së mbuluar nga plani i punës lidhur me një kategori specifike të burimeve dhe do të sigurojë që asnjë ent tjetër të operojë në të njëjtën zonë për kategori tjetër të burimeve në një mënyrë që mundet të ndikojë në operimin e operatorit. Operatori do të ketë sigurinë në përputhje me nenin 153, paragrafi 6.

Neni 17
Rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit

1. Autoriteti do të adaptojë dhe zbatojë rregulla, rregullore dhe procedurat uniforme në përputhje me nenin 160, paragrafi 2(f) (ii) dhe nenin 162, paragrafi 2(o)(ii), për të ushtruar funksionet e tij të vendosura në Pjesën XI, inter-alia, për çështjet që vijojnë:

(a) procedurat administrative lidhur me perspektivën, eksplorimin dhe shfrytëzimin e zonës;

(b) operimet:

(i) madhësinë e Zonës;

(ii) periudhën e operimit;

(iii) kërkesat e zbatimit duke përfshirë sigurimet mbi bazën e nenit 4, paragrafi 6(c) të këtij aneksi;

(iv) kategoritë e burimeve;

(v) denoncimin e Zonës;

(vi) raportit të progresit;

(vii) parashtrimit të të dhënave;

(viii) inspektimeve dhe supervizionit të operimeve;

(ix) parandalimit të ndikimt në veprimtari të tjera ne ambientin detar;

(x) transferimit të të drejtave dhe detyrimeve nga një kontraktues;

(xi) procedurave për transferimin e teknologjisë ndaj një shteti në zhvillim në përputhje me nenin 144 dhe për pjesëmarrjen e tyre direkt;

(xii) standardet e minierës dhe praktikave, duke përfshirë ato që lidhen me sigurinë e operimit, konservimin e burimeve dhe mbrojtjen e ambientit detar;

(xiii) përcaktimin e prodhimit komercial;

(xiv) standardet e kualifikimit për kërkuesin;

(c) çështjet financiare:

(i) krijimin e rregullave uniforme dhe jodiskriminuese për koston dhe llogarinë dhe metodën e zgjedhjes së auditorëve;

(ii) caktimin e proceseve të operimit;

(iii) nxitjes referuar në nenin 13 të këtij aneksi;

(d) zbatimit të vendimeve të marra mbi bazën e nenit 151, paragrafi 10 dhe nenit 164, paragrafi 2(d).

2. Rregullave, rregulloreve dhe procedurave mbi çështjet që vijojnë, të cilat duhet të reflektojnë plotësisht kriteret e objektivit të vendosura më poshtë:

(a) Madhësinë e Zonës:

Autoriteti duhet të përcaktojë madhësinë përkatëse të Zonës për eksplorim, e cila mund të jetë dy herë më e madhe se ato për shfrytëzim me qëllim që të lejojë ekslorimin intesiv të operimeve. Madhësia e Zonës do të llogaritet për të kënaqur kërkesat e nenit 8 të këtij aneksi mbi rezervimin e zonave, si dhe gjithashtu kërkesat e shpallura për prodhimin mbi bazën e nenit 151 në përputhje me termat e kontratës duke marrë në konsideratë gjendjen e teknologjisë që do të përdoret për minierat e shtratit të detit dhe karakteristikat fizike përkatëse të Zonave. Zonat nuk do të jenë as më të vogla dhe as më të mëdha se ato të nevojshme për të përmbushur objektivin.

(b) Periudhën e operimit:

(i) parashikimi do të jetë pa kufij kohor;

(ii) eksplorimi duhet të jetë për një periudhë të mjaftueshme për të lejuar një kontroll të gjerë të zonave specifike, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të minierave për zonën dhe projektimin e ndërtimin e uzinave të vogla dhe të mesme për qëllimet e minierave testuese dhe sistemeve të prodhimit;

(iii) Periudha e eksplorimit duhet të lidhet me jetën ekonomike të projektit të minierave, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si nxjerrja e floririt, jetëzgjatja e dobishme e pajisjeve dhe pajisjet e procesit dhe vlefshmërinë komerciale. Shfrytëzimi duhet të jetë i në periudhe të mjaftueshme për të lejuar nxjerrjen e prodhimeve komerciale të zonës dhe duhet të përfshijnë një periudhë kohe të arsyeshme të ndërtimit të minierave dhe sistemeve të prodhimit, që gjatë kësaj periudhe prodhimi komercial nuk duhet të kërkohet. Periudha totale e shfrytëzimi, megjithatë duhet të jetë mjaftueshëm e shkurtër për t'i dhënë Autoritetit një mundësi për të amenduar termat dhe kushtet e planit të punës në kohën që ai e konsideron të rinovuar në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat, të cilat ai i ka adaptuar në vazhdim të miratimit të planit të punës.

(c)Kërkesat e zbatimit:

Autoriteti duhet të kërkojë që gjatë fazës së eksplorimit, shpenzimet të bëhen nga operatori, të cilat janë arsyeshëm të lidhura me madhësinë e zonës të mbuluar nga një plan pune dhe shpenzimet që të cilat duhet të priten me mirëbesim nga operatori, i cili mendon që të sjellë zonën për prodhim komercial brenda kufijve kohor të vendosur nga Autoriteti. Shpënzimet e kërkuara nuk duhet të vendosen në një nivel, të cilin nuk do të kurajonin operatorët e perspektivës me teknologji me kosto më të ulët që është mbizotëruese në përdorim. Autoriteti do të vendosë një interval kohe maksimale pas përfundimit të fazës së eksplorimit dhe fillimit të fazës së shfrytëzimit, për arritjen e prodhimit komercial. Për përcaktimin e këtij intervali, Autoriteti duhet tëe marrë në konsideratë që ndërtimi i minierave të mëdha dhe sistemeve të prodhimit nuk mundet të iniciohet derisa të përfundojë faza e eksplorimit dhe të fillojë faza e shfrytëzimit. Respektivisht, intervali për të sjellë një zonë për prodhim komercial duhet të marrë në konsideratë kohën e nevojshme për këtë ndërtim pas përfundimit të fazës së eksplorimit dhe një lejim i arsyeshëm duhen bërë vonesat e pashmangshme në programin e ndërtimit. Menjëhere sa arrihet prodhimi komercial, Autoriteti brenda kufijve të arsyeshëm dhe duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e duhur i kërkon operatorit që të mbajë prodhimin komercial për të gjithë periudhën e planit të punës.

(d) Kategorive të burimeve:

Në përcaktimin e kategorive të burimeve lidhur me të cilin mund të miratohet një plan pune, Autoriteti do t'i japë rendësi, inter-alia karakteristikave që vijojnë:

(i) që disa burime kërkojnë përdorimin e metodave të njëjta për minierat;

(ii) që disa burime mundet të zhvillohen të pavarura pa ndikimin ndërmjet operatorëve duke zhvilluar burime të ndryshme në të njëjtën zonë.

Asgjë e këtij nënparagrafi nuk do të ndalojë Autoritetin nga miratimi i planit të punës lidhur

me më shumë se një kategori burimi në të njëjtën zonë për të njëjtin kërkues.

(e) Heqja dorë nga Zonat:

Operatori do të ketë të drejtën në çdo kohë të heqë dorë pa u dënuar për të gjitha ose një pjesë të drejtave të tij në një zonë të mbuluar nga një plan pune.

(f) Mbrojtja e ambientit detar:

Rregullat, rregulloret dhe procedurat duhet të përgatiten me qëllim të sigurimit të një mbrojtjeje efektive të ambientit detar nga efektet e dëmshme që rezultojnë direkt nga veprimtaritë në zonë ose nga transporti detar menjëherë mbi një hapësirë miniere, duke marrë në konsideratë që zgjerimi i efekteve të tilla të dëmshme mund të vijnë direkt nga shpimet, thellimet, gërmimet dhe nga hedhja dhe shkarkimi në ambientin detar të mbeturinave ose sendeve të tjera.

(g) Prodhimi komercial:

Prodhimi komercial do të konsiderohet se ka filluar për një operator i përfshirë në operime të shkallës së madhe për nxjerrje, të cilat rezultojnë në mbledhjen e një sasie materiali te mjaftueshëm për të treguar qartë se qëllimi kryesor është prodhimi në shkallë të madhe sesa prodhimi i mbledhur për marrje informacioni, analize ose testimesh të pajisjeve ose uzinës.

Neni 18

Dënimet

1. Të drejtat e kontraktuesit sipas një kontrate mundet të pezullohen ose mbyllen vetëm në rastet që vijojnë:

(a) nëse, në vend të paralajmërimeve nga Autoriteti, kontraktuesi ka drejtuar veprimtaritë e tij në një mënyrë të tillë që të rezultojnë në thyerje me paramendime serioze dhe të vazhdueshme të termave bazë të kontratës, Pjesës XI dhe rregullave, rreguloreve dhe procedurave të vendosura nga Autoriteti;

(b) Nëse kontraktuesi nuk ka mundur të jetë në përputhje me vendimet përfundimtare të trupit gjykues të një diskutimi të vendosur ndaj tij.

2. Në rastet e çdo thyerjeje të kontratës jo të mbuluar nga paragrafi 1(a) ose në lidhje me pezullimin ose përfundimin sipas paragrafit 1(a), Autoriteti mundet të imponojë gjoba monetare kontraktuese në mënyrë proporcionale me seriozitetin e thyerjes.

3. Me përjashtim të urdhërave emergjente sipas nenit 162, paragrafi 2(ë), Autoriteti mundet të mos ekzekutojë një vendim që përfshin gjoba monetare, pezullime ose përfundime derisa kontraktuesi ka rënë dakord për një mundësi të arsyeshme për të shlyer vendimet juridike ndaj tij mbi bazën e Pjesës XI, seksioni 5.

Neni 19

Rishikimi i kontratës

1. Kur rrethanat ngrejnë ose janë pothuaj duke u ngritur, në të cilat sipas palës tjetër, e çojnë kontratën jo të rregullt ose e bëjnë atë të pamundur ose jo të praktikueshme për të arritur objektivat e vendosur në Pjesën XI, palët do të hyjnë në negociata për ta rishikuar atë përkatësisht.

2. Çdo kontratë e hyrë në fuqi në përputhje me nenin 153, paragrafi 3, mundet të rishikohet me konsensusin e Palëve.

Neni 20

Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve

Të drejtat dhe detyrimet e ngritura sipas një kontrate mundet të transferohen vetëm më konsensusin e Autoritetit dhe në përputhje me rregullat, rregulloret dhe procedurat e tij. Autoriteti nuk do të mbajë konsesusin pa arsye për transferim ndaj transferuesit nëse transferuesi i propozuar është nga të gjitha pikëpamjet një kërkues i kualifikuar dhe mban të gjitha detyrimet e transferuesit dhe nëse transferuesi nuk i përmbahet planit të punës, miratimi i të cilit do të jetë i ndaluar nga neni 6, paragrafi 3(c) i këtij aneksi.

Neni 21
Ligji i zbatueshëm

1. Kontrata do të udhëhiqet nga termat e kontratës, rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit, Pjesa XI dhe rregulla të tjera të ligjit ndërkombëtar jo kompatibël me këtë Konventë.

2. Çdo vendim përfundimtar nga një gjykatë ose gjykim që ka juridiksion sipas kësaj Konvente lidhur me të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit dhe të kontraktuesit do të jetë e imponueshme në teritorrin e secilës Palë.

3. Asnjë Shtet Palë nuk mund të imponojë kushtet mbi një kontraktues që janë të pambështetura me Pjesën XI. Megjithatë, kërkesa nga një Shtet Palë ndaj kontraktuesve të sponsorizuar nga ai ose ndaj anijeve që kanë flamurin e tij, për ligjet ose rregullat e tjera të ambientit më shumë të forta se ato në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit të adaptuara mbi bazën e nenit 17, paragrafi 2(f) të këtij aneksi, nuk do të merren sikur janë në mbështetje të Pjesës XI.

Neni 22
Përgjegjësia

Kontraktuesi do të ketë përgjegjësi ose faj për çdo dëm të ngritur jo nga një veprim i gabuar në drejtimin e operacioneve, llogari e marrë sikur është një veprim kontribues ose fshehje nga Autoriteti. Në mënyrë të njëjtë, Autoriteti do të ketë përgjegjësi ose faj për çdo dëm të ngritur nga veprime të gabuara në ushtrimin e fuqive dhe funksioneve të tij, duke përfshirë dhe thyerjet e nenit 168, paragrafi 2, llogari e marrë si një akt kontribues ose thyerje nga kontraktuesi. Faji në çdo rast do të jetë për shumën aktuale të dëmit.

ANEKSI IV. STATUTI I NDËRMARRJES

Neni 1
Qëllimet

1. Ndërmarrja është organ i autoritetit, i cili do të kryejë veprimtaritë në Zonë direkt, mbi bazën e nenit 153, paragrafi 2 (a), si dhe transportimit, procesimit dhe marketingut të mineraleve të nxjerra nga Zona.

2. Gjatë realizimit të qëllimeve të saj dhe në ushtrimin e funksioneve të saj, ndërmarrja do të veprojë në përputhje me këtë Konventë dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

3. Në zhvillimin e burimeve të Zonës mbi bazën e paragrafit 1, ndërmarrja, në mbështetje të kësaj Konvente, do të operojë në përputhje me parimet e shëndosha tregtare.

Neni 2
Lidhjet me Autoritetin

1. Mbi bazën nenit 170, ndërmarrja do të veprojë në përputhje me politikat e përgjithshme të Asambles dhe direktivat e Këshillit.

2. Në mbështetje të paragrafit 1, Ndërmarrja do të gëzojë autonomin në drejtimin e operacioneve të saj.

3. Asgjë në këtë Konventë do ta bëjë ndërmarrjen përgjegjëse për veprimet ose detyrimet e Autoritetit ose të bëjë Autoritetin përgjegjës për veprimet ose detyrimet e ndërmarrjes.

Nenit 3
Kufizimi i Përgjegjsive

Pa asnjë paragjykim të nenit 11, paragrafi 3 të këtij aneksi, asnjë anëtar i Autoritetit do të jetë përgjegjës për arsye vetëm të anëtarsisë për veprimet ose detyrimet e ndërmarrjes.

Neni 4
Struktura

Ndërmarrja do të ketë një bord drejtues, një Drejtor të Përgjithshëm dhe stafin e nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij.

Neni 5
Bordi drejtues

1. Bordi drejtues do të formohet nga 15 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja në përputhje me nenin 160, paragrafi 2(c). Në zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parimeve të shpërndarjes së barabartë gjeografike. Në parashtrimin e emrave të kandidatëve për zgjedhje në bord, anëtarët e Autoritetit duhet të kenë në vëmendje nevojën e caktimit të kandidatëve me standarde aftësie më të larta, me kualifikimet në fushat përkatëse, në mënyrë që të sigurojnë vlefshmërinë dhe suksesin e ndërmarrjes.

2. Anëtarët e bordit do të zgjidhen për 4 vjet dhe mund të rizgjidhen dhe vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parimeve të rotacionit të anëtarëve.

3. Anëtarët e bordit do të vazhdojnë të punojnë derisa pasardhësit e tyre të zgjidhen. Nëse vendi i një anëtari të bordit bëhet vakant, Asambleja, në përputhje me nenin 160, paragrafi 2(c), do të zgjedhë një anëtar të ri për kohën e mbetur me kushtet e paraardhësit.

4. Anëtarët e bordit do të veprojnë mbi aftësitë e tyre personale. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre ata nuk do të kërkojnë ose të marrin instruksione nga ndonjë qeveri ose nga çdo burim tjetër. Secili anëtar i Autoritetit do të respektojë karakterin e pavarur të anëtarëve të bordit dhe do të heqin dorë nga të gjitha përpjekjet për influencuar një nga ato në shkarkimin e detyrave të tyre.

5. Secili anëtar i bordit do të marrë të ardhura të paguara jashtë fondeve të ndërmarrjes. Shuma e të ardhurave do të fiksohet nga Asambleja, me rekomandimin e Këshillin.

6. Bordi do të funksionojë normalisht në selinë qendrore të ndërmarrjes dhe do të mblidhet aq herë sa ta kërkojë bisnezi i ndërmarrjes.

7. Dy të tretat e anëtarëve të bordit do të përbëjnë një kuorum.

8. Secili anëtar i bordit do të ketë një votë. Të gjitha çështjet përpara bordit do të vendosen nga një mazhorancë e anëtarëve të tij. Në qoftë se një anëtar ka një konflikt interesash mbi një çështje ai do të tërhiqet nga votimi mbi këtë çështje.

9. Çdo anëtar i Autoritetit mund t'i kërkojë bordit informata në lidhje me operimet e tij, të cilët në mënyrë të veçantë ndikojnë këtë anëtar. Bordi do të përpiqet që ta furnizojnë me informacione të tilla.

Neni 6
Funksionet dhe Fuqitë e Bordit Drejtues

Bordi drejtues do të drejtojë operacionet e ndërmarrjes. Mbi bazën e kësaj Konvente, bordi drejtues do të ushtrojë fuqitë e nevojshme për të përmbushur qëllimet e ndërmarrjes, duke përfshirë fuqitë:

(a) e zgjedhjes së një Kryetari nga anëtarët e tij;

(b) për adaptimin e rregullat e procedurave;

(c) të pregatisë dhe të parashtrojë një plan pune me shkrim Këshillit në përputhje me nenin 153, paragrafi 3 dhe nenin 162, paragrafi 2(j);

(d) të zhvillojë planet e punës dhe programet për të kryer veprimtaritë e specifikuara në nenin 170;

(e) të përgatisë dhe parashtrojë Këshillit kërkesat për autorizimin e prodhimeve në përputhje me nenin 151, paragrafet 2 deri 7;

(f) të autorizojë negociatat në lidhje me blerjen e teknologjive duke përfshirë ato të parashikuara në aneksin III, nenin 5, paragrafi 3 (a), (c) dhe (d) dhe të aprovojë rezultatet e këtyre negociatavet;

(g) të ndërtojë termat dhe koshtet dhe të autorizojë negociatat, në lidhje me kompanitë e përbashkëta dhe format e tjera të marrëveshjeve të përbashkëta të referuara në aneksin III, nenin 9 dhe

11 dhe të aprovojë rezultatet e negociatave të tilla;

(h) t'i rekomandojë Asamblesë çfarë porcioni të të ardhurave neto të ndërmarrjes duhet të tërhiqen si rezervat e saj në përputhje me nenin 160, paragrafi 2 (f) dhe nenin 10 të këtij aneksi;

(i) të aprovojë buxhetin vjetor të ndërmarrjes;

(j) të autorizojë prokurimin e mallrave dhe shërbimevet në përputhje me nenin 12, paragrafin 3 të këtij aneksi;

(k) t'i parashtrojë një raport vjetor Këshillit në përputhje me nenin 9 të këtij aneksi;

(l) t'i parashtrojë Këshillit për miratimin nga Asambleja të projektit të rregullave në lidhje me organizimin, menaxhimin, caktimin dhe shkarkimin e stafit të ndërmarrjes dhe të adaptojë rregullat për t'i dhënë fuqi këtyre rregullave;

(m) të marrë borxh fonde dhe të furnizojë siguri të tilla kolaterale dhe siguri të tjera siç mund të jetë përcaktuar në përputhje me nenin 11, paragrafi 2 të këtij aneksi;

(n) të hyjë në çdo procedurë ligjore, marrëveshje dhe transaksion dhe të ndërmarrë çdo veprim tjetër në përputhje me nenin 13 të këtij aneksi;

(o) të delegojë, mbi bazën e miratimit nga Këshilli, çdo fuqi jodiskrecionale Drejtorit të Përgjithshëm dhe komisioneve të tij.

Neni 7

Drejtori i përgjithshëm dhe stafi i ndërmarrjes

1. Asambleja shpall, mbi bazën e rekomandimit nga Këshilli dhe emrave të bordit drejtues, do të zgjedhë Drejtorin e Përgjithshëm të ndërmarrjes, i cili nuk do të jetë anëtar i bordit. Drejtori i Përgjithshëm do të jetë në punë me terma fikse, duke mos kaluar 5 vjet dhe mund të rizgjidhet për periudhën e mëvonshme.

2. Drejtori i Përgjithshëm do të jetë përfaqësuesi ligjor dhe shefi ekzekutiv i ndërmarrjes dhe do të jetë direkt përgjegjës përpara bordit për drejtimin e operacioneve të ndërmarrjes. Ai do të jetë përgjegjës për organizimin, menaxhimin, caktimin dhe pushimin e stafit të ndërmarrjes në përputhje me rregullat dhe rregulloret e referuara në nenin 6, nënparagrafi (l) i këtij aneksi. Ai do të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e bordit dhe mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote në mbledhjet e Asamblesë dhe Këshillit kur këto organe janë duke u marrë me çështjet në lidhje me Ndërmarrjen.

3. Konsideratat kryesore në rekrutimin dhe punësimin e stafit dhe në përcaktimin e kushteve të tyre të shërbimit duhet të jenë nevoja e sigurimit të standardeve më të larta të efektivitetit dhe kompetencës teknike. Mbi bazën e këtyre konsideratave, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rëndësisë së rekrutimit të stafit mbi baza të barazisë gjeografike.

4. Gjatë zbatimit të detyrave të tij Drejtori Përgjithshëm dhe stafi nuk do të kërkojë ose marrë instruksione nga ndonjë qeveri ose nga çdo burim tjetër i jashtëm nga ndërmarrja. Ata do të tërhiqen nga çdo veprim, i cili mund të reflektojë në pozicionin e tyre si nëpunës ndërkombëtar të ndërmarrjes përgjegjëse vetëm për ndërmarrjen. Secili Shtet Palë zotohet të respektojë karakterin ndërkombëtar ekskluziv të përgjegjësive të Drejtorit të Përgjithshëm dhe stafit dhe të mos kërkojë të influencojë ato në shkarkimin e përgjegjësive të tyre.

5. Përgjegjësitë e vendosura në nenin 168, paragrafi 2 janë njëlloj të zbatueshme edhe nga stafi i ndërmarrjes.

Neni 8

Selia

Ndërmarrja do të ketë zyrat e saj kryesore në selinë e Autoritetit. Ndërmarrja mund të krijojë zyra të tjera dhe pajisje në territorin e çdo Shteti Palë me konsensusin e Shtetit Palë.

Neni 9

Raportet dhe deklaratat financiare

1. Ndërmarrja, jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të secilit vit financiar, i paraqet Këshillit për konsideratat e tij një raport vjetor që përmban një deklarim të llogarive të tij dhe do t'i transmetojë Këshillit në intervalet përkatëse një deklaratë përmbledhëse të pozitës së tij financiare dhe

një deklaratë për humbjet ose fitimin duke treguar rezultatet e operacioneve të saj.

2. Ndërmarrja do të publikojë raportin e saj vjetor dhe raporte të tjera të tilla siç ajo e konsideron të përshtatshme.

3. Të gjitha raportet dhe deklarat financiare referuar në këtë nen do t'i shpërndahet anëtarëve të Autoritetit.

Neni 10

Përcaktimi i të ardhurave neto

1. Mbi bazën e paragrafit 3, ndërmarrja do t'i bëjë pagesat Autoritetit sipas aneksit III, nenit 13 ose ekuivalentëve të tyre.

2. Asambleja, me rekomandimin e bordit drejtues, do të përcaktojë çfarë porcioni të të ardhurave neto të ndërmarrjes do të tërhiqet si rezervë e ndërmarrjes. Pjesa e mbetur do t'i transferohet Autoritetit.

3. Gjatë një periudhe të fillimit të kërkuar për ndërmarrjen që të bëhet vetëmbështetse, e cila nuk do t'i kalojë 10 vjetët nga fillimi i prodhimit komercial nga ajo, Asambleja do të përjashtojë ndërmarrjen nga pagesat referuar në paragrafin 1 dhe do t'i lërë të gjitha të ardhurat neto të ndërmarrjes në rezervat e saj.

Neni 11

Financat

1. Fondet e Ndërmarrjes do të përfshijnë:

(a) shumën e marrë nga Autoriteti në përputhje me nenin 173, paragrafi 2(b);

(b) kontributet vullnetare të bëra nga Shtetet Palë për qëllimin e veprimtarive financiare të Ndërmarrjes;

(c) shumat e marra borxh nga ndërmarrja në përputhje me paragrafet 2 dhe 3;

(d) të ardhurat e ndërmarrjes nga operimet e saj;

(e) fonde të tjera të bëra të vlefshme ndërmarrjes për të bërë të aftë atë të fillojë operimin sa më shpejt të jetë e mundur dhe të kryejë funksionet e saj.

2. (a) Ndërmarrja do të ketë fuqinë të marrë borxh fonde dhe të japë sigurime të tjera kolaterale të tilla siç mund ta vendosë ajo. Përpara bërjes së një shitjeje publike ose të detyrimeve të saj në tregun financiar ose të monedhës së një Shteti Palë, ndërmarrja do të marrë miratimin e Shtetit Palë. Shuma totale e borxheve do të miratohet nga Këshilli me rekomandim të bordit drejtues.

(b) Shtetet Palë do të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të mbështetur kërkesat nga ndërmarrja për hua në tregun e kapitaleve dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

3. (a) Ndërmarrja do të furnizohet me fondet e nevojshme për eksplorim dhe shfrytëzim të një miniere dhe të transportojë, prodhojë dhe tregtojë mineralet e nxjerra process and market the minerals recovered menjëherë si dhe nikelin, bakrin, kobaltin dhe manganezin, dhe të plotësojë shpenzimet e saj administrative të fillimit. Shuma e fondeve të përmëndura, si dhe kriteret e faktorët për rregullimet e tyre, do të përfshihen nga komisioni përgatitor në draftet e rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit.

(b) Të gjitha Shtetet Palë do t'i bëjnë të vlefshme ndërmarrjes një shumë ekuivalente me gjysmën e fondeve të referuara në nënparagrafin (a) me hua me interesa afatgjate në përputhje me shkallën e vlerësimit të buxhetit të rregullt të Kombeve të Bashkuara në fuqi në kohën e bërjes së vlerësimit, të rregulluara për të marrë në konsideratë shtetet të cilët nuk janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Debiti i krijuar nga ndërmarrja në ngritjen e gjysmës tjetër të fondeve do të garantohet nga të gjitha Shtetet Palë në përputhje me të njëjtën shkallë.

(c) Në qoftë se shuma e kontributeve financiare të Shteteve Palë është më pak sesa fondet që duhen parashikuar nga ndërmarrja sipas nënparagrafit (a), Asambleja, në sesionin e parë të saj, do të marrë në konsideratë gjerësinë e mangësisë dhe do të adaptojnë me konsensus masat që duhen marrë në lidhje me këtë mangësi, duke marrë parasysh detyrimet e Shteteve Palë sipas nënparagrafit (a) dhe (b) dhe çdo rekomandimi të komisionit përgatitor.

(d) (i) Secili Shtet Palë, brenda 60 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose brenda 30 ditëve pas depozitimit të instrumentave të tij të ratifikimit ose bashkimit, kushdoqoftë më vonë, do të

depozitojnë një notë premtimi pa mbajtje intersash, jorevokuese, jonegociuse në shumën e aksioneve të Shteteve të tilla Palë të huave pa interes mbi bazën e nënparagrafit (b).

(ii) Bordi do të prëegatisë, në datën më të parë praktike pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe si rrjedhim në intervale vjetore ose përkatësisht në intervale të tjera, një program të magnitudës dhe kohës për kërkesat e saj për financim për shpenzimet e saj administrative dhe për veprimtaritë e kryera nga ndërmarrja në përputhje me nenin 170 dhe nenin 12 të këtij aneksi.

(iii) Shtete Palë menjëherë, do të njoftohen nga ndërmarrja, nëpërmjet Autoritetit, për aksionet respektive të tyre të fondeve në përputhje me nënparagrafin (b), të kërkuar për këto shpenzime. Ndërmarrja do t'i arkëtojë shumat e tilla të notës premtuese siç mund të kërkohen për të mbuluar shpenzimet e referuara në program në lidhje me huatë pa interes.

(iv) Shtetet Palë, me marrjen e njoftimit, do të bëjnë të vlefshme aksionet e tyre të vlefshme të garancive të debituara për ndërmarrjen në përputhje me nënparagrafin (b).

(e) (i) Në qoftë se ndërmarrja e kërkon, Shtetet Palë mund të parashikojnë garanci debie në plotësim të atyre të parashikuara në përputhje me shkallën e referuar në nënparagrafin (b).

(ii) Në pasqyrën e garancive të debive, një Shtet Palë mund të bëjë një kontribut vullnetar ndërmarrjes në një shumë ekuivalente me këtë porcion të debisë, të cilën ndryshe të duhet të përgjigjet për të garantuar.

(f) Ripagimi i huave me interes do të ketë prioritet mbi të gjitha ripagimet e huave pa interes. Repagimi i huave pa interes do të jetë në përputhje me programin e adaptuar nga Asambleja, me rekomandimin e Këshillit dhe konculencën e bordit. Në ushtrimin e këtyre funksioneve të bordit do të udhëhiqet me parashikimet përkatëse të rregullave, rregulloreve dhe procedurave të Autoritetit, i cili do të marrë në konsideratë rëndësinë prioritare të sigurimit të funksionimit efektiv të ndërmarrjes dhe të sigurimit të pavarësisë së saj financiare.

(g) Fondet e bëra të vlefshme për ndërmarrjen do të jenë në monedhë lirisht të perdorëshme ose monedha, të cilat janë lirisht në perdorim të vlefshme dhe efektiv në tregjet kryesore të shkëmbimit të monedhave të huaja. Këto monedha do të vendosen në rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit në përputhje me praktikat monetare mbizotëruese ndërkombëtare. Me përjashtim siç është parashikuar në paragrafin 2, asnjë Shtet Palë nuk do të mbajë ose imponojë kufizime në mbajtjen, përdorimin ose shkëmbimin nga ndërmarrja të këtyre fondeve.

(h) "Garancia e Debisë" nënkupton një premtim të një Shteti Palë ndaj kreditorëve të Ndërmarrjes për të paguar, pro rata në përputhje me një shkallë të caktuar, detyrimet financiare të ndërmarrjes të mbuluara nga garancia mbi bazën e njoftimit nga kreditorët e Shtetit Palë të papërcaktuar nga ndërmarrja. Procedurat për pagesat e këtyre detyrimeve do të jenë konform me rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit.

4. Fondet, asetet dhe shpenzimet e ndërmarrjes duhet të mbahen të ndara nga ato të Autoritetit. Ky nen nuk do të pengojë ndërmarrjen nga bërja e marrëveshjeve me Autoritetin përsa i përket pajisjeve, personelit dhe shërbimeve dhe marrëveshjeve për rimbursim të shpenzimeve administrative të paguara ose dhe në emër të të tjerëve.

5. Shënimet, librat dhe llogaritë e ndërmarrjes, duke përfshirë dhe deklarimin finaciar të saj vjetor, do të auditohet çdo vit nga një auditor i pavarur i caktuar nga Këshilli.

Neni 12

Operacionet

1. Ndërmarrja do t'i propozojë Këshillit, projekte për kryerjen e veprimtarive në përputhje me nenin 170. Propozime të tilla do të përfshijnë një plan pune formal me shkrim të veprimtarisë në zonë në përputhje me nenin 153, paragrafi 3 dhe informacione të tjera të tilla dhe të dhëna siç mund të kërkohet herë pas here për vlerësimin e tyre nga komisioni ligjor dhe teknik dhe miratim nga Këshilli.

2. Me miratimin nga Këshilli, ndërmarrja do të ekzekutojë projektin mbi bazat e planit të punës formal me shkrim referuar paragrafit 1.

3. (a) Nëse Ndërmarrja nuk zotëron mallrat dhe shërbimet e kërkuara për operimet e saj ajo mund t'i prokurojë ato. Për këtë qëllim, ajo do të lëshojë ftesa për tender dhe caktojë kontratën për konkurruesit duke ju ofruar kombinimin më të mirë të cilësisë, çmimit dhe kohës së dorëzimit.

(b) Në qoftë se janë më shumë se një garë që ofron kombinime të tilla, kontratat do t'i caktohet në përputhje me:

(i) Parimi i jodiskriminimit mbi konsideratat politke ose konsideratave të tjera që nuk kanë lidhje me kryerjen e operacioneve me aftësinë dhe eficensën e duhur;

(ii) Udhëzuesin e miratuar nga Këshilli në lidhje me preferencat që do t'i akordohen mallrave dhe shërbimeve që rrjedhin nga shtetet në zhvillim, duke përfshirë shtetet pa bregdet dhe ato me disavantazh gjeografik ndë shtetet pa bregdet dhe ato me disavantazh gjeografik ndërmjet tyre.

(c) Bordi drejtues mund të adaptojë rregulla që përcaktojnë rrethanat speciale në të cilat kërkesat e ftesave për garë mund të disponohen, për interesat më të mira të ndërmarrjes.

4. Ndërmarrja do të ketë një zotësi mbi të gjitha mineralet dhe materialet e prodhuara nga ajo.

5. Ndërmarrja do t'i shesë produktet e saj mbi baza jodiskriminuese. Ajo nuk do të bëjë zbritje jokomerciale.

6. Pa paragjykim të ndonjë fuqie të përgjithshme ose të veçantë të garantuar mbi ndërmarrjen sipas çdo parashikimi tjetër të kësaj Konvente, ndërmarrja do të ushtrojë fuqi të tilla të rastësishme për biznesin e saj siç mund të jetë e nevojshme.

7. Ndërmarrja nuk do të ndërhyjë në çështjet politike të çdo Shteti Palë dhe as do të influencohet në vendimet e saj nga karakteri politik i Shtetit Palë të interesuar. Vetëm konsideratat komerciale do të jenë prioritare në vendimet e saj dhe këto konsiderata do të merren në konsideratë në mënyrë që të realizohen qëllimet e specifikuara në nenin 1 të këtij aneksi.

Neni 13

Statusi ligjor, privilegjet dhe imunitetet

1. Për të bërë në gjendje ndërmarrjen të ushtrojë funskionet e saj, statusin, privilegjet dhe imunitetet e vendosura në këtë nen do t'i akordohen ndërmarrjes në territoret e Shteteve Palë. Për t'i dhënë fuqi këtyre parimeve ndërmarrja dhe Shtetet Palë, kur është e nevojshme, mundet të hyjnë në marrëveshje speciale.

2. Ndërmarrja do të ketë fuqi të tilla ligjore siç janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj dhe përmbushjes së qëllimeve të saj, në veçanti, të fuqive:

(a) për të hyrë në kontrata, marrëveshje të përbashkëta ose marrëveshje të tjera, duke përfshirë marrëveshjet me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare;

(b) të fitojë, japë me qira, mbajë dhe disponojë prona të lëvizshme ose të palëvizshme;

(c) Të jetë një Palë në procedurat ligjore;

3.(a) Veprime mund të ngrihen kundër ndërmarrjes vetëm në një Gjykatë të jurdiksionit kompetent në territorin e Shtetit Palë në të cilin ndërmarrja:

(i) ka një zyrë ose pajisje;

(ii) kanë caktuar një axhent për qëllimet e shërbimeve të pranuara ose njoftimet e prodhimit;

(iii) kanë hyrë në kontratë për mallrat ose shërbimet;

(iii) ka lëshuar siguri;

(iv) është ndryshe i okupuar në veprimtaritë tregtare.

(v) pronat e asetet e ndërmarrjes, kudoqofshin të lokalizuara dhe nga kushdoqoftë që i mban, do të jetë imune nga të gjitha format e arrestimit, të bashkimit ose ekzekutimit përpara dorëzimit ose gjykimit final kundër ndërmarrjes.

4. (a) Pronat dhe asetet e ndërmarrjes kuqoqofshin lokalizuar dhe kushdoqoftë që i mban ato, do të jenë imune nga shpronësimi, konfiskimi, rrëmbimi ose çdo formë tjetër arrestimi nga një veprim legjislativ ose ekzekutiv.

(b) Pronat dhe asetet e ndërmarrjes kuqoqofshin lokalizuar dhe kushdoqoftë që i mban ato, do të jenë të lira nga kufizimet diskriminuese, rregullat, kontrolli dhe moratoriumi i çdo natyre.

(c) Ndërmarrja dhe punonjësit e saj do të respektojnë ligjet lokale dhe rregulloret në çdo shtet ose territor në të cilin ndërmarrja ose punonjësit e saj mund të kryejnë biznes ose të veprojnë ndryshe.

(d) Shtetet Palë do të sigurohen që ndërmarrja gëzon të gjitha të drejtat, privilegjet dhe imunitetet e akorduara nga ato të enteve që drejtojnë veprimtaritë komerciale në territoret e tyre. Këto të drejta, privilegje dhe imunitete do t'i akordohen ndërmarrjes në jo më pak baza të favorshme sesa ato të cilat ato i akordojnë enteve të përfshira në veprimtari të njëjta komerciale. Nëse parashikohen privilegje të veçanta nga Shtetet Palë për shtetet në zhvillim ose entetet komerciale të tyre, ndërmarrja do t'i gëzojë këto privilegje në baza të njëjta preferenciale.

(e) Shtetet Palë mund të parashikojnë të drejta, privilegje dhe imunitete të veçanta nxitëse,

ndërmarrjes pa detyrimin e parashikimit të të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të tilla nxitëse eneteve të tjera komerciale.

5. Ndërmarrja do të negociojë me vendet miq ku janë vendosur zyrat dhe pajisjet për përjashtimin nga taksat direkte ose indirekte.

6. Secili Shtet Palë do të marrë veprime të tilla siç mund të jenë të nevojshme për t'i dhënë fuqi në legjislacionet e tyre parimeve të vendosura në këtë aneks dhe do të njoftojnë ndërmarrjen për veprimin specifik, i cili është marrë.

7. Ndërmarrja mund të mos e pranojë ndonjë nga privilegjet dhe imunitetet e paraqitura në këtë nen ose në marrëveshje speciale referuar në paragrafin 1 për zgjerime të tilla dhe mbi kondita të tilla që ajo mund t'i përcaktojë.

ANEKSI V. KËSHILLIMI
SEKSIONI 1. PROCEDURAT E KËSHILLIM MBI BAZËN E SEKSIONIT 1 TË PJESËS XV

Neni 1
Institucionalizimi i provedurave

Në qoftë se Palët në një diskutim bien dakord, në përputhje me nenin 284, për t'i paraqitur ato sipas një këshillimi sipas këtij seksioni, çdo Palë e tillë mund të institucionalizojë procedurat me një njoftim me shkrim adresuar Palëvë ose Palës tjetër në diskutim.

Neni 2
Lista e këshilltarëve

Një listë këshilltarësh do të përgatitet dhe do të mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Secili Shtet Palë do të ketë të drejtën të emërojë katër këshilltarë, secili nga ata do të jetë një person që gëzon reputacion të lartë për drejtësi, kompetencë dhe integritet. Emrat e personave të emëruar në këtë mënyrë do të përbëjnë një listë. Në qoftë se në çdo kohë këshilltarët e emëruar nga një Shtet Palë në listën e formuar do të jetë i ndryshëm nga katër, ky Shtet Palë do të ketë të drejtën për të bërë emërime të tjera që mund të jenë të nevojshme. Emri i një këshilltari do të mbetet në listë derisa të hiqet nga Shteti Palë, i cili ka bërë emërimin, me kusht që një këshilltar i tillë do të vazhdojë të shërbejë në çdo komision këshillimi në të cilin ky këshilltar ka qënë caktuar deri në përfundimin e procedurave përpara këtij komisioni.

Neni 3
Formimi i komisionit të këshillimit

Komisioni i këshillimit, përveçse kur Palët kanë rënë dakord ndryshe, do të formohet si vijon:

(a) Mbi bazën e nënparagrafit (g), komisioni i këshillimit do të konsistojë në pesë anëtarë.

(b) Palët që institucionalizojnë procedurat do të caktojnë dy këshilltarë të zgjedhur preferohet nga lista e referuar në nenin 2 të këtij aneksi, një nga të cilët mund të jetë shtetas i tij, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe. Caktimet e tilla do të përfshihen në njoftimin e referuar në nenin 1 të këtij aneksi.

(c) Pala tjetër në diskutim do të caktojë dy këshilltarë në mënyrën e vendosur në nënparagrafin (b) brenda 21 ditëve të marrjes së njoftimit referuar në nenin 1 të këtij aneksi. Nëse nuk janë bërë caktimet brenda kësaj periudhe, Pala që institucionalizon procedimin, brenda një jave të përfundimit të kësaj periudhe, mundet ose të përfundojë procedimet me një njoftim adresuar Palës tjetër ose t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të bëjë caktimet në përputhje me nënparagrafin (e).

(d) Brenda 30 ditëve pasi të katër këshilltarët caktohen, ata do të caktojnë një të pestën e zgjedhur nga lista e referuar në nenin 2 të këtij aneksi, i cili do të jetë Kryetar. Nëse caktimi nuk bëhet brenda kësaj periudhe, secila Palë, brenda një jave nga përfundimi i kësaj periudhe, mundet t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të bëjë caktimin në përputhje me nënparagrafin (e).

(e) Brenda 30 ditëve të marrjes së një kërkese sipas nënparagrafit (c) ose (d), Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të bëjë caktimet e nevojshme nga lista e referuar në nenin 2 të këtij aneksi në konsultim me Palët në diskutim.

(f) Çdo vend vakant do të plotësohet në mënyrën e përshkruar për caktimet fillestare.

(g) Dy ose më shumë Palë, të cilat përcaktojnë me marrëveshje që ato kanë të njëjtat interesa do të caktojnë dy këshilltarë së bashku. Kur dy ose më shumë Palë kanë interesa të ndryshme të ndara ose kur ka ndonjë mosmarrëveshje sikur ata të kishin interes të njëjtë, ata do të caktojnë këshilltarë të ndarë.

(h) Në diskutimet që përfshijnë më shumë se dy Palë që kanë interesa të ndara ose kur ka një mosmarrëveshje sikur ajo të ishin të të njëjtave interesa, Palët do të zbatojnë nënparagrafin (a) deri në (f) sa më shumë të jetë e mundur.

Neni 4
Procedura

Komisioni i këshillimit, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe, do të përcaktojë procedurat e tij. Komisioni, me konsensusin e Palëve në diskutim, mundet të ftojnë çdo Shtet Palë të parashtrojnë mendimet e tij me shkrim ose gojarisht. Vendimet e komisionit përsa i përket çështjeve proceduriale, raportet dhe rekomandimet do të bëhen nga një mazhorancë vote e anëtarëve të tij.

Neni 5
Zgjidhjet miqësore

Komisioni mund të tërheqë vëmendjen e Palëve për çdo masë, e cila mund të lehtësojë çdo zgjidhje miqësore në diskutim.

Neni 6
Funksionet e komisionit

Komisioni do të dëgjojë Palët, do të shqyrtojë reklamimet e tyre dhe kundërshtimet dhe do t'u bëjë propozimet Palëve me qëllimin e arritjes së një zgjidhjeje miqësore.

Neni 7
Raporti

1. Komisioni do të raportojë brenda 12 muajve të formimit të tij. Raporti i rij do të shënojë çdo marrëveshje të arritur dhe marrëveshjet e dështuara, konkluzionet e tij mbi të gjitha çështjet e fakteve ose ligjeve përkatëse për të gjitha çështjet në diskutim dhe rekomandimet e tilla që komisioni mund t'i konsiderojë të përshtatshme për një zgjidhje miqësore. Raporti do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe menjëherë do t'i transmetohet nga ai Palëve në diskutim.

2. Raporti i komisionit, duke përfshirë konkluzionet ose rekomandimet e tij, nuk do të jetë pengues mbi Palët.

Neni 8
Përfundimi

Procedimet e këshillimit përfundojnë kur arrihet një zgjidhje, kur Palët kanë pranuar ose një Palë ka hedhur poshtë rekomandimet e raportit me njoftim me shkrim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose kur ka kaluar një periudhë tre mujore nga data e transmetimit të raportit për Palët.

Neni 9
Pagesat dhe shpenzimet

Pagesat dhe shpenzimet e komisionit do të përballohen nga Palët në diskutim.

Neni 10
E drejta e Palëve për modifikimin e procedurave

Palët në diskutim me anën e një marrëveshjeje të zbatueshme vetëm për këtë diskutim mundet të modifikojnë çdo parashikim të këtij aneksi.

SEKSIONI 2. PARASHTRIMI I DETYRUAR PËR PROCEDURAT E KËSHILLIMIT MBI BAZËN E SEKSIONIT 3 TË PJESËS XV

Neni 11
Institucionalizimi i procedimeve

1. Secila Palë në diskutim e cila, në përputhje me Pjesën XV, seksioni 3, mund t'i parashtrohet për këshillim sipas këtij seksioni, mund të ngrejë procedura me njoftim me shkrim adresuar Palës ose Palëve të tjera në diskutim.

2. Secila Palë në diskutim, e njoftuar sipas paragrafit 1, do të jetë e detyruar të paraqitet në procedura të tilla.

Neni 12
Gabimi për t'ju përgjigjur ose për parashtrim për këshillim

Gabimi i një Pale ose Palëve në një diskutim për lajmërimin e institucioneve të procedurave ose të parashtrojë procedura të tilla nuk do të përbëjë një përgjegjësi për procedim.

Neni 13
Kompetenca

Një mosmarrëveshje sipas të cilës një komision këshillimi që vepron sipas këtij seksioni ka kompetencën të vendoset nga komisioni.

Neni 14
Zbatimi i seksionit 1

Neni 2 deri 10 i seksionit i të ketij aneksi zbatohet në mbështetje të këtij seksioni.

ANEKSI VI. STATUTI I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE " MBI TË DREJTËN E DETIT"

Neni 1
Parashikime të përgjithshme

1. Gjykata Ndërkombëtare e ligjit të detit formohet dhe funksionon në përputhje me këtë Konventë dhe këtë statut.

2. Selia e Gjykatës do të jetë në Qytetin e Lirë dhe Hanseatik të Hamburgut në Republikën Federale të Gjermanisë.

3. Gjykata mund të krijojë dhe ushtrojë funksionet e saj kudo, kurdoherë që ajo e konsideron këtë të dëshirueshme.

4. Një referencë për një diskutim në gjykatë do të udhëhiqet nga parashikimet e Pjesës XI dhe XV.

SEKSIONI 1. ORGANIZIMI I GJYKATËS

Neni 2
Përbërja

1. Gjykata do të përbëhet nga një trup e përbërë nga 21 anëtarë të pavarur, të zgjedhur ndërmjet personave që gëzojnë reputacionin më të lartë për drejtësi dhe integritet dhe kompetencave të njohura në fushën e ligjit të detit.

2. Në gjykatë si e tërë do të sigurohet përfaqësimi i sistemeve kryesore ligjore të botës dhe shpërndarjes së barabartë gjeografike.

Neni 3
Anëtarësia

1. Asnjë nga dy anëtarët e Gjykatës nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet. Një person, i cili për qëllimet e anëtarësisë në gjykatë mundet të konsiderohet si një shtetas i më shumë se një shteti do të konsiderohet si një shtetas i atij shteti në të cilin ai ushtron thjesht të drejtat civile dhe politike.

2. Do të ketë jo me shumë se tre anëtarë nga secili grup gjeografik siç është vendosur në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 4
Emërimi dhe zgjedhjet

1. Secili Shtet Palë mund të emërojë jo mëshumë se dy persona që kanë kualifikimet e përshkruara në nenin 2 të këtij aneksi. Anëtarët e Gjykatës do të zgjidhen nga lista e personave të emëruar në këtë mënyrë.

2. Së paku tre muaj përpara datës së zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në rastin e zgjedhjeve të para dhe regjistruesi i gjykatës në rastin e zgjedhjeve të mëtejshme do t'i adresojnë një njoftim ftesë me shkrim Shteteve Palë për të parashtruar emërimet e tyre për anëtarët e gjykatës brenda dy muajve. Ai do të përgatisë një listë alfabetike të të gjithë personave të emëruar kështu, me një indikim për Shtetet Palë, të cilat i kanë emëruar ato dhe do t'i parashtrojnë ate Shteteve Palë përpara ditës së shtatëmbëdhjetë të muajit të fundit, përpara datës të secilës zgjedhje.

3. Zgjedhjet e para do të mbahen brenda gjashtë muajve të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

4. Anëtarët e gjykatës do të zgjidhen me votim sekret. Zgjedhjet do të mbahen në një mbledhje të Shteteve Palë të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në rastin e zgjedhjeve të para dhe nga një procedurë e rënë dakord nga Shtetet Palë në rastin e zgjedhjevet të tjera. Dy të tretat e Shteteve Palë do të përbëjnë një quorum në mbledhje. Personat e zgjedhur për Gjykatën do të jenë ata të emëruar të cilët fitojnë numrin më të madh të votave dhe dy të tretat e mazhorancës së Shteteve Palë që janë present dhe votojnë, me kusht që kjo mazhorancë e tillë të përfshijë mazhorancën e Shteteve Palë.

Neni 5
Termat e zyrave

1. Anëtarët e Gjykatës do të zgjidhen për nëntë vjet dhe mund të rizgjidhen, me kusht megjithatë, që për anëtarët e zgjehur për herë të parë, kushtet për shtatë anëtarë do të skadojnë në fund të tre vjetëve dhe kushtet për shtatë anëtarë të tjerë do të përfundojnë në fund të gjashtë vjetëve.

2. Anëtarët e Gjykatës kushtet e të cilëve skadojnë në përfundim të periudhave të fillimit të përmedura më sipër prej tre dhe gjashtë vjetëve do të zgjidhen me short,i cili do të hidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Anëtarët e Gjykatës do të vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre derisa të plotësohet vendi i tyre. Megjithëse të zëvedësuar, ata do të përfundojnë çdo procdurë të cilën mund ta kenë filluar përpara datës së zëvedësimit të tyre.

4. Në rastin e dorëheqjes së një anëtari të Gjykatës, shkresa e dorëheqjes do t'i drejtohet Presidentit të gjykatës. Vendi bëhet vakant me marrjen e kësaj letre.

Neni 6
Vendet vakant

1. Vendet vakant do të mbushen me të njëjtën metodë siç veprohet për zgjedhjet e para, në mbështetje të parashikimeve që vijojnë: regjistruesi, brenda një muaji të lirimit të vendit vakant, do të procedojë për lëshimin e ftesave të parashikuara në nenin 4 të këtij aneksi dhe data e zgjedhjeve do të fiksohet nga Presidenti i Gjykatës pas konsultimeve me Shtetet Palë.

2. Një anëtar i Gjykatës i zgjedhur për të zëvendësuar një anëtar, të cilit nuk i kanë skaduar termat e punësimit, do të vazhdojë të punojë deri në ardhjen e zëvendësuesit.

Neni 7
Veprimtaritë inkompatibël

1. Asnjë anëtar i gjykatës nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion politik ose administrativ ose t'i bashkëngjitet aktivisht ose të jetë i interesuar financiarisht në secilin prej operacioneve të çdo ndërmarrjeje të interesuar për eksplorimin ose shfrytëzimin e burimeve të detit ose të shtratit të detit ose për përdorime të tjera komerciale të detit ose shtratit të detit.

2. Asnjë anëtar i gjykatës nuk mund të veprojë si axhent, konsull ose avokat në çdo rast.

3. Çdo dyshim mbi këto pika do të zgjidhen me vendim të mazhorancës së anëtarëve të tjerë të gjykatës që janë prezent.

Neni 8
Kushtet në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve në raste të veçanta

1. Asnjë anëtar i Gjykatës mund të marrë pjesë në vendime të çdo rasti në të cilat ai ka marrë pjesë përpara si axhent, konsull ose avokat për një nga palët , ose si anëtar i një gjykate kombëtare ose ndërkombëtare, ose me çdo kapacitet tjetër.

2. Nëse për disa arsye speciale, një anëtar i Gjykatës e konsideron që ai nuk duhet të marrë pjesë në një vendim të rastit të veçantë, ai do të informojë Presidentin e Gjykatës.

3. Nëse Presidenti e konsideron që për disa arsye speciale një nga anëtarët e Gjykatës nuk duhet të punojë në raste të veçanta, ai do t'i japë atij njoftim respektivisht.

4. Çdo dyshim në këto pika do të zigjidhet me vendim nga mazhoranca e anëtarëve të tjerë të gjykatës prezent.

Neni 9
Konseguencat e pushimit të përmbushjes së kushteve të kërkuara

Nëse në mendimin unanim të anëtarëve të tjerë të gjykatës, një anëtar ka pushuar së përmbushur kushtet e kërkuara, Presidenti i Gjykatës do të deklarojë vendin vakant.

Neni 10
Privilegjet dhe imunitetet

Anëtarët e gjykatës, kur janë të përfshirë në biznes të Gjykatës do të gëzojnë, privilegje dhe imunitete diplomatike.

Neni 11
Deklarimi solemn i anëtarëve

Secili anëtar i Gjykatës, përpara marrjes së detyrave të tij, do të bëjë një deklaratë solemne në sesionin e hapur që do të ushtrojë fuqitë e tij i pavarur dhe me kujdes.

Neni 12
Presidenti, zv-Presidenti dhe regjistruesi

1. Gjykata do të zgjedhë Presidentin zv.Presidentin e tij për tre vjet; ata mund të rizgjidhen.

2. Gjykata do të caktojë regjistruesin e tij dhe mund të parashikojë për caktim nëpunës të tjerë siç mund të jetë e nevojshme.

3. Presidenti dhe regjistruesi do të kenë rezidencën në selinë e gjykatës.

Neni 13
Kuorumi

1. Të gjithë anëtarët e vlefshëm të gjykatës do të bëjnë një kuorum prej 11 anëtarësh të zgjedhur do të kërkohen të formojnë gjykatën.

2. Mbi bazën e nenit 17 të këtij aneksi, Gjykata do të përcaktojë cili anëtar është i vlefshëm për të formuar gjykatën për konsideratat e një diskutimi të veçantë, duke pasur parasysh funksionimin efektiv të dhomave siç parashikohet në nenet 14 dhe 15 të këtij aneksi.

3. Të gjitha diskutimet dhe kërkesat që i parashtrohen gjykatës do të dëgjohen dhe do të përcaktohen nga gjykata, përveçse kur zbatohet neni 14 i këtij aneksi ose palët kërkojnë që ajo duhet të merret në përputhje me nenin 15 të këtij aneksi.

Neni 14
Dhoma e diskutimeve të shtrarit të detit

Një Dhomë e diskutimeve të shtratit të detit do të formohet në përputhje me parashikimet e seksionit 4 të këtij aneksi. Juridiksioni, fuqitë dhe funksionet e saj do të jenë siç parashikohet në Pjesën XI, seksioni 5.

Neni 15
Dhomat speciale

1. Gjykata mund të formojë dhoma të tilla, të përbëra nga tre ose më shumë anëtarë të saj të zgjedhur, siç ajo mund ta konsiderojë të nevojshme për t'u marrë me kategori të veçantatë të diskutimeve.

2. Gjykata do të formojë një dhomë për t'u marrë me një diskutim të veçantë parashtruar asaj nëse Palët e kërkojnë kështu. Përbërja e një dhome të tillë do të përcaktohet nga Gjykata me miratimin e Palëve.

3. Me qëllimin e përfundimit sa më të shpejtë të biznesit, Gjykata do të formojë çdo vit një dhomë të përbërë nga pesë prej anëtarëve të saj të zgjedhur, të cilët mund të dëgjojnë dhe përcaktojnë diskutimet me një procedurë përmbledhëse. Dy anëtarë alternativë do të zgjidhen për qëllimet e zëvendësimit të anëtarëve, të cilët janë të pamundur të marrin pjesë në një procedurë të veçantë.

4. Diskutimet do të dëgjohen dhe përcaktohen nga dhoma siç është parashikuar në këtë nen nëse e kërkojnë kështu Palët.

5. Një gjykim i dhënë nga çdo dhomë e parashikuar në këtë nen dhe në nenin 14 të këtij aneksi do të konsiderohet sikur është dhënë nga gjykata.

Neni 16
Rregullat e gjykatës

Gjyakata do të përcaktojë rregulla për kryerjen e funskioneve të saj. Në mënyrë të veçantë ajo do të paraqesë rregullat e procedimit.

Neni 17
Shtetësia e anëtarëve

1. Anëtarët e gjykatës të shtetësisë të secilës nga Palët në një diskutim do të mbajnë të drejtat e tyre të marrin pjesë si anëtarë të gjykatës.

2. Nëse gjykata, kur dëgjon një diskutim, përfshin në bango një anëtar të shtetësisë së njërës nga Palët, secila Palë tjetër mund të zgjedhë një person të marrë pjesë si një anëtar i gjykatës.

3. Nëse gjykata, gjatë dëgjimit të një diskutimi, nuk përfshin në bangon një anëtar të shtetësisë së Palëve, secila nga këto Palë mund të zgjedhë një person të marrë pjesë si një anëtar i gjykatës.

4. Ky nen zbatohet nga dhomat e referuara në nenet 14 dhe15 të këtij aneksi. Në këto raste, Presidenti, në konsultim me Palët, do t'i kërkojë anëtarëve specifik të gjykatës që formojnë një dhomë, siç mund të duket e nevojshme, për t'i dhënë vende anëtarëve të gjykatës me shtetësinë e Palëve të interesuara dhe nëse dështojnë të tillë ose nëse ata janë të pamundur të jenë prezent, anëtarë specialë të zgjedhur nga Palët.

5. Nëse do të jenë disa Palë me interesa të njëjta, për qëllimet e parashikimeve të procedimit, ato do të konsiderohen si një Palë vetëm. Çdo dyshim mbi këtë pikë do të vendoset me vendim të Gjykatës.

6. Anëtarët e zgjedhur në përputhje me paragrafet 2, 3 dhe 4 do të përmbushin kushtet e kërkuara në nenet 2, 8 dhe 11 të këtij aneksi. Ato do të marrin pjesë në vendimet me terma komplet të barabarta me kolegët e tyre.

Neni 18
Të ardhurat e anëtarëve

1. Secili anëtar i zgjedhur i gjykatë do të marrë një shpërblim vjetor dhe për secilën ditë gjatë të cilës ai ushtron funksionet e tij, një shpërblim special, me kusht që në çdo vit shuma totale e pagueshme për secilin anëtar si shpërblim special nuk do të kalojë shumën e shpërblimit vjetor.

2. Presidenti do të marrë një shpërblim special vjetor.

3. Zv.Presidenti do të marrë një shpërblim special për secilën ditë që ai vepron si President.

4. Anëtarët e zgjedhur sipas nenit 17 të këtij aneksi, përveçse anëtarëve të zgjedhur të gjykatës, do të marrin kompensim për secilën ditë gjatë së cilës ata ushtrojnë funksionet e tyre.

5. Rrogat, shpërblimet dhe kompensimet do të përcaktohen herë pas here në takimet e Shteteve Palë, duke marrë në konsideratë ngarkesën e punës së gjykatës. Ato nuk mundet të ulen gjatë kohës së punësimit.

6. Rroga e regjistruesit do të përcaktohet në mbledhjen e Shteteve Palë, me propozim të Gjykatës.

7. Regulloret e adaptuara në mbledhjet e Shteteve Palë do të përcaktojnë kushtet sipas të cilave mund t'i jepet tërheqja në pension anëtarëve të gjykatës dhe regjistruesit, dhe konditat sipas të cilave anëtarët e gjykatës dhe regjistruesi do të kenë shpenzimet e udhëtimit të rimbursuara.

8. Rrogat, shpërblimet dhe kompensimet do të jenë të lira nga të gjithë taksat.

Neni 19
Shpenzimet e gjykatës

1. Shpenzimet e Gjykatës do të përballohen nga Shtetet Palë dhe nga Autoriteti në terma të tilla dhe në mënyrë të tillë siç do të vendoset në mbledhjet e Shteteve Palë.

2. Kur një ent përveçse një Shtet Palë ose Autoriteti është një palë në një rast parshtruar asaj, Gjykata do të fiksojë shumën të cilën kjo palë duhet te kontribuojë në lidhje me shpenzimet e Gjykatës.

SEKSIONI 2. KOMPETENCA

Neni 20
Hyrja në gjykatë

1. Gjykata do të jetë e hapur për të gjitha Shtetet Palë.

2. Gjykata do të jetë e hapur për entet përveçse Shteteve Palë në çdo rast shprehimisht të parashikuar në Pjesën XI ose në çdo rast të parashtruar mbi bazën e çdo marrëveshjeje që mban juridiksionin mbi Gjykatën, e cila është pranuar nga të gjitha Palët për këtë rast.

Neni 21
Juridiksioni

Juridiksioni i gjykatës që përfshin të gjithë diskutimet dhe të gjitha kërkesat e parashtruara asaj në përputhje me këtë Konventë dhe të gjitha çështjet e parashikuara veçanërisht në çdo marrëveshje tjetër, e cila mban juridiksionin mbi Gjykatën.

Neni 22
Referenca e diskutimeve mbi bazën e marrëveshjeve të tjera

Nëse të gjitha Palët në një traktat ose Konventë tashmë në fuqi dhe që lidhet me çështjet bazë te mbuluara nga kjo Konventë të rëna dakord kështu, çdo diskutim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e një traktati të tillë ose Konvente, në përputhje me marrëveshje të tilla, mundet t'i parashtrohet Gjykatës.

Neni 23
Ligji i zbatueshëm

Gjykata do të vendosë të gjitha diskutimet dhe kërkesat në përputhje me nenin 293.

SEKSIONI 3. PROCEDURAT

Neni 24
Institucionalizimi i procedimeve

1. Diskutimet e parashtruara Gjykatës, sipas rastit, edhe me një njoftim të një marrëveshjeje speciale ose me një kërkesë me shkrim, mund t'i adresohen regjistruesit. Në secilin rast, subjekti i diskutimit dhe Palët do të tregohen.
2. Regjistruesi duke vazhduar do të njoftojë marrëveshjen speciale ose kërkesën tek të gjithë të interesuarit .
3. Regjistruesi gjithashtu do të njoftojë të gjitha Shtetet Palë.

Neni 25
Masat e përkohshme

1. Në përputhje me nenin 290, gjykata dhe Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit do të kenë fuqinë të përgatisin masat e përkohshme.
2. Në qoftë se gjykata nuk është në sesion ose një numër i mjaftueshëm i anëtarëve nuk është i vlefshëm për të përbërë një kuorum, masat e përkohshme do të përshkruhen nga dhoma e procedurave përmbledhëse të formuar sipas nenit 15, paragrafi 3 i këtij aneksi. Pa marrë parasysh nenin 15, paragrafi 4 të këtij Aneksi, masa të tilla të përkohshme mund të adaptohen me kërkesën e çdo Pale në diskutim. Ato do të jenë subjekt për rishikim dhe rinovim nga gjykata.

Neni 26
Dëgjimi

1. Dëgjimi do të jetë nën kontrollin e Presidentit ose nëse ai nuk është në gjendje të kryesojë, të zv.Presidentit. Nëse asnjëri nuk është në gjendje të kryesojë, atëhere gjyqtari më i vjetër që është prezent në Gjykatë do të kryesojë.
2. Dëgjimi do të jetë publik, përderisa Gjykata të vendosë ndryshe ose përveçse kur Palët kërkojnë që të mos lejohet publiku.

Neni 27
Udhëheqja e rastit

Gjykata do të bëjë urdhëra për drejtimin e rastit, të vendosë formën dhe kohën në të cilën secila Palë mund të përfundojë argumentat e saj dhe të bëjë të gjitha rregullimet që lidhen me marrjen e evidencave.

Neni 28
Gabimi për mosparaqitje

Kur njëra nga Palët nuk paraqitet përpara gjykatës ose dështon të mbrojë rastin e saj, Pala tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të vazhdojë procedurat dhe të japë vendimin e saj. Mungesa e një Pale ose gabimi i një Pale për të mbrojtur rastin e saj nuk do të bëjë ndonjë pengesë për procedurat. Përpara marrjes së vendimit të saj, gjykata mund të kënaq vetveten jo vetëm me atë që ajo ka juridiksionin mbi diskutimin, por gjithashtu që reklamimi gjendet i mbështetur në fakte dhe ligje.

Neni 29
Mazhoranca për vendim

1. Të gjitha çështjet do të vendosen me mazhorancën e anëtarëve të Gjykatës, të cilët janë present.
2. Në rastet e barasizë së votave, Presidenti ose anëtari i Gjykatës, i cili vepron në vendin e tij do të ketë votën vendimtare.

Neni 30
Gjykimi

1. Gjykimi do të deklarojë arsyen mbi të cilën ai bazohet.
2. Ai duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të gjykatës, të cilët kanë marrë pjesë në vendim.
3. Nëse gjykimi nuk përfaqëson në përgjithësi ose pjesërisht opinionin unanim të anëtarëve të Gjykatës, çdo anëtar do të ketë të drejtën për të dhënë një mendim të ndarë.
4. Gjykimi do të firmoset nga Presidenti dhe nga regjistruesi. Ai do të lexohet në gjykatë të hapur, pasi të jetë dhënë njoftimi i duhur Palëve në diskutim.

Neni 31
Kërkesa për të ndërhyrë

1. Nëse një Shtet Palë konsideron që ai ka një interes të natyrës ligjore, i cili mund të preket nga një vendim në çdo diskutim, ai mund të parashtrojë një kërkesë Gjykatës për t'u lejuar që të ndërhyjë.
2. Ajo do të varet nga gjykata për të vendosur mbi këtë kërkesë.
3. Nëse një kërkesë për të ndërhyrë garantohet, vendimi i gjykatës në lidhje me diskutimin do t'i bashkëngjitet mbi ndërhyrjen e Shtetit Palë përsa kohë ajo lidhet me çështjet për të cilat ky Shtet Palë ndërhyri.

Neni 32
E drejta për të ndërhyrë në rastet e interpretimit ose zbatimit

1. Kurdoherë që interpretimi ose zbatimi i kësaj Konvente është në diskutim, regjistruesi do të njoftojë të gjitha Shtetet Palë të përmendura.
2. Kurdoherë mbi bazën e neneve 21 ose 22 të këtij aneksi interpretimi ose zbatimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare është në diskutim, regjistruesi do të njoftojë të gjitha Palët e marrëveshjes.
3. Secila Palë e referuar në paragrafët 1 dhe 2 ka të drejtën të ndërhyjë në procedurat, nëse ajo përdor këto të drejta, interpretimi i dhënë nga gjykimi do të jetë i barabartë me bashkëlidhjen me të.

Neni 33
Finaliteti dhe fuqia bashkëlidhëse e vendimit

1. Vendimi i Gjykatës është përfundimtar dhe do të njihet nga të gjitha Palët në diskutim.

2. Vendimi do të ketë fuqi vepruese me përjashtim të Palëve në lidhje me një diskutim të veçantë.

3. Në rastet e diskutimit përsa i përket kuptimit ose qëllimit të vendimit, gjykata do ta shpjegojë atë me kërkesën e çdo Pale.

Neni 34
Kosto

Përveçse kur vendoset ndryshe nga Gjykata, secila Palë do të përballojë koston e saj.

SEKSIONI 4. DHOMA E DISKUTIMEVE TË SHTRATIT TË DETIT

Neni 35
Përbërja

1. Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit referuar në nenin 14 të këtij aneksi do të përbëhet prej 11 anëtarësh, të zgjedhur nga një mazhorancë të anëtarëve të zgjedhur të gjykatës ndërmjet tyre.

2. Në zgjedhjen e anëtarëve të Dhomës, përfaqësimi i sistemeve kryesore ligjore të botës dhe duhet të sigurohet shpërndarja e barabartë gjeografike. Asambleja e Autoritetit mund të adaptojë rekomandimet e një natyre të përgjithshme për një shpërndarje të tillë dhe përfaqësim.

3. Anëtarët e dhomës do të zgjidhen çdo tre vjet dhe mund të zgjidhen për një periudhë tjetër.

4. Dhoma do të zgjedhë Presidentin e saj ndërmjet anëtarëve të saj, i cili do të shërbejë për një periudhë për të cilën Dhoma është zgjedhur.

5. Nëse ndonjë procedurë është akoma duke pritur në fund të periudhës 3-vjeçare për të cilën Dhoma është zgjedhur, Dhoma do të përfundojë procedurat me përbërjen e saj origjinale.

6. Nëse në Dhomë ndodh një vend vakant, Gjykata do të zgjedhë vazhduesin nga anëtarët e saj të zgjedhur, i cili do të punojë në zyrë për periudhën e mbetur të parardhësit të tij.

7. Një kuorum prej shtatë anëtarësh të zgjedhur nga gjykata do të kërkohet të formojnë Dhomën.

Neni 36
Dhomat Ad hoc

1. Dhomat e diskutimeve të shtratit të detit do të formojnë dhoma ad hoc, të përbëra nga tre prej anëtarëve të saj, për t'u marrë me diskutime të veçanta të parashtruara në përputhje me nenin 188, paragrafi 1 (b). Përbërja e një dhome të tillë do të përcaktohet nga Dhoma e diskutimeve të shtratit të detit me miratimin e Palëve.

2. Nëse Palët nuk bien dakord mbi përbërjen e një dhome ad hoc, secila Palë në diskutim do të caktojë një anëtar dhe një anëtar i tretë do të caktohet nga ata në marrëveshje. Nëse ata nuk bien dakord ose nëse çdo Palë nuk arrin të caktojë njeri, Presidenti i Dhomës së diskutimeve për shtratin e detit duhet menjëherë të bëjë caktimin ose caktimet ndërmjet anëtarëve të saj, pas konsultimeve me Palët.

3. Anëtarët e dhomës ad hoc nuk duhet të jenë në shërbim ose shtetasit, të çdo Pale në diskutim.

Neni 37
Hyrja

Dhoma do të jetë e hapur për çdo Shtet Palë, Autoritetin dhe çdo ent tjetër referuar në Pjesën

XI, seksioni 5.

Neni 38
Ligji i zbatueshëm

Në plotësim të parashikimeve të nenit 293, Dhoma do të zbatojë:
Rregullat, rregulloret dhe procedurat e Autoritetit të adaptuara në përputhje me këtë Konventë;
Termat e kontratës në lidhje me veprimtaritë në Zonë në çështjet që lidhen me këto kontrata.

Neni 39
Zbatimi me forcë i vendimeve të Dhomës

Vendimet e Dhomës do të zbatohen me forcë në territoret e Shteteve Palë në të njëjtën mënyrë si gjykimet ose urdhërat të gjykatës më të lartë të Shtetit Palë në territoret e të cilave kërkohet kjo.

Neni 40
Zbatimi i seksioneve të tjera të këtij aneksi

1. Seksionet e tjera të këtij aneksi, të cilat nuk janë inkompatibël me këtë seksion zbatohen nga Dhoma.
2. Në ushtrimin e funskioneve përsa i përket opinioneve këshilluese të Dhomave do të udhëhiqen nga parashikimet e këtij aneksi në lidhje me procedurat përpara Gjykatës në zgjerim të të cilave ato njohin atyre zbatueshmërinë.

SEKSIONI 5. AMENDAMENTET

Neni 41
Amendamentet

1. Amendamentet e këtij aneksi, përveçse amendamentet e seksionit 4, mund të adaptohen vetëm në përputhje me nenin 313 ose me konsensus në një konferencë të mbledhur në përputhje me këtë Konventë.
2. Amendamentet për seksionin 4 mund të adaptohen vetëm në përputhje me nenin 314.
3. Gjykata mund të propozojë amendamente të tilla në këtë status siç ajo mund ta konsiderojë të nevojshme, me komunikim me shkrim për Shtetet Palë për konsideratat e tyre në përputhje me paragrafët 1 dhe 2.

ANEKSI VII. ARBITRAZHI

Neni 1
Institucionalizimi i procedurave

Në mbështetje të parashikimeve të Pjesës XV, çdo Palë në një diskutim mund të parashtrojë diskutimin në procedurat arbitrare të parashikuara në këtë aneks me një njoftim me shkrim adresuar Palëve të tjera në diskutim. Njoftimi duhet të shoqërohet me një deklaratë të reklmamimit dhe faktet mbi të cilat ajo bazohet .

Neni 2
Lista e arbitrave

1. Një listë artbitrash duhet paraqitur dhe mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Secili Shtet Palë do të jetë i ngarkuar që të emërojë katër arbitra, secili nga ata do të jetë një person me eksperiencë në çështjet detare dhe që gëzon reputacionin më të lartë për drejtësi, kompetencë dhe integritet. Emrat e personave të emëruar në këtë mënyrë do të formojnë listën.
2. Nëse në çdo kohë arbitratrat e emëruar nga Shtetet Palë në listën e formuar do të jenë disa

nga katër, ky Shtet Palë do të ketë të drejtën e emërtimeve të mëtejshme sipas nevojës.

3. Emri i një arbitri do të mbetet në listë derisa të hidhet poshtë nga Shteti Palë, i cili ka bërë emërimin, me kusht që një arbitër i tillë do të vazhdojë të shërbejë në çdo gjykatë arbitrazhi në të cilën arbitri ka qënë caktuar derisa të përfundojnë procedurat përpara kësaj gjykate arbitrazhi.

Neni 3

Formimi i Gjykatës së Arbitrazhit

Për qëllimet e procedurave sipas këtij aneksi, Gjykata e Arbitrazhit, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe, do të formohet si vijon:

Mbi bazën e nënparagrafit (g), gjykata e arbitrazhit do të konsistojë në pesë anëtarë.

Pala që institucionalizon procedurat do të caktojë një anëtar të zgjidhet duke preferuar nga lista e referuar në nenin 2 të këtij aneksi, i cili mund të jetë shtetasi i saj. Caktimet do të përfshihen në njoftimin e referuar në nenin 1 të këtij aneksi.

Palët e tjera në diskutim, brenda 30 ditëve të marrjes së njoftimit të referuar në nenin 1 të këtij aneksi, do të caktojë një anëtar i zgjedhur mundësisht nga lista, i cili mund të jetë dhe shtetasi i saj. Nëse caktimi nuk bëhet brenda kësaj periudhe, Pala që institucionalizon procedurat, brenda dy javësh nga skadimi i kësaj periudhe, mund të kërkojë që caktimi të bëhet në përputhje me nënparagrafin (e).

Tre anëtarët e tjerë do të caktohen me marrëveshje ndërmjet Palëve. Ata do të zgjidhen mundësisht nga lista dhe do të jenë shtetas të shteteve të treta, përve se kur Palët bien dakord ndryshe. Palët në diskutim do të caktojnë Presidentin e Gjykatës së Arbitrazhit ndërmjet këtyre tre anëtarëve. Nëse, brenda 60 ditëve të marrjes së njoftimit referuar në nenin 1 të këtij aneksi, Palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi caktimin e një ose më shumë anëtarëve të Gjykatës, të cilët duheshin të caktoheshin me marrëveshje ose me caktimin e Presidentit, caktimi që mbetet ose caktimet do të bëhen në përputhje me nënparagrafin (e), me kërkesën e një Pale në diskutim. Kërkesa e tillë do të bëhet brenda dy javëve pas skadimit të periudhës 60 ditëshe të përmendur më sipër.

Përveçse kur Palët bien dakord se çdo caktim sipas nënparagrafëve (c) dhe (d) do të bëhet nga një person i një shteti të tretë i zgjedhur nga Palët, Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit do të bëjë caktimet e nevojshme. Nëse Presideni nuk është në gjendje të veprojë sipas këtij nënparagrafi ose është një shtetas i njërës nga Palët në diskutim, caktimi duhet bërë nga anëtari tjetër më i vjetër i Gjykatës Ndërkombëtare për ligjin e detit, i cili është i vlefshëm dhe nuk është shtetas i njërës nga Palët. Caktimet e referuara në këtë nënparagraf do të bëhen nga lista e referuar në nenin 2 të këtij aneksi brenda një periudhe prej 30 ditësh nga marrja e kërkesës dhe në konsultim me Palët. Anëtarët e caktuar kështu do të kenë shtetësi të ndryshme dhe nuk mund të jenë në shërbim, me rezidencë të zakonshme në territor ose shtetas të çdo Palë në diskutim.

Çdo vend vakant do të plotësohet në mënyrën e përshkruar për caktimet fillestare. Palët me të njëjtin interes do të caktojnë një anëtar të gjykatës së bashku me marrëveshje. Kur janë disa Palë që kanë interesa të ndara ose kur ka një mosmarrëveshje nëse janë apo jo të të njëjtit interes, secila nga ato do të caktojë një anëtar të gjykatës. Numri i anëtarëve të gjykatës të caktuar në mënyrë të ndarë nga Palët duhet gjithmon të jetë më i vogël sesa numri i anëtarëve të gjykatës që duhet të caktohet së bashku nga Palët.

Në diskutimet që përfshijnë më shumë se dy Palë, parashikimet e nënparagrafeve (a) deri (f) do të zbatohen në shtrirjen maksimale të mundshme.

Neni 4

Funksionet Gjykatës së Arbitrazhit

Një Gjykatë Arbitrazhi e përbërë sipas nenit 3 të këtij aneksi do të funksionojë në përputhje me këtë aneks dhe parashikimet e tjera të kësaj Konvente.

Neni 5

Procedura

Përveçse kur Palët në diskutim bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë procedurat e saj, duke siguruar secilës Palë mundësi të plota për t'u dëgjuar dhe të paraqesin rastin e

tyre.

Neni 6
Detyrimet e Palëve në diskutim

Palët në diskutim duhet të lehtësojnë punën e Gjykatës së Arbitrazhit dhe në veçanti, në përputhje me ligjet e tyre dhe duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre do të:

Të furnizojnë atë me të gjitha dokumentat përkatëse, pajisjet dhe informacion;

Të bëjnë të aftë atë kur është e nevojëshme për të thirur dëshm,imtarë ose ekspert dhe të marrin evidencat e tyre dhe të vizitojnë lokalitetet, të cilëve u përket rasti përkatës.

Neni 7
Shpenzimet

Përveçse kur Gjykata e Arbitrazhit vendos ndryshe për arsye të rrethanave të veçanta të rastit, shpenzimet e Gjykatës, duke përfshirë dhe të ardhurat e anëtarëve të saj, do të përballohen nga Palët në diskutim në mënyrë të barabartë.

Neni 8
Mazhoranca e kërkuar për vendimet

Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me mazhorancën e votave të anëtarëve të saj. Mungesa ose abstenimi i më pak se gjysmës së anëtarëve nuk do të përbëjë një pengesë për gjykatën që të arrijë vendimin. Në raste e barazisë së votave, Presidenti do të ketë votën determinuese.

Neni 9
Faji i mosparaqitjes

Në se njëra nga Palët në diskutim nuk paraqitet përpara Gjykatës së Arbitrazhit ose dështon për të mbrojtur rastin e saj, Pala tjetër mund t'i kerkojë gjykatës të vazhdojë procedurat dhe të shpallë vendimin e saj. Mungesa e një Pale ose dështimi i një Pale për të mbrojtur rastin e saj, nuk do të përbëjë një pengesë për procedurat. Përpara dhënies së mendimit të saj, Gjykata e Arbitrazhit duhet të bindë veten e saj jo vetëm që ajo ka juridiksionin e saj mbi diskutimin, por edhe që reklamimi është i mbështetur në fakte dhe ligje.

Neni 10
Marrja e vendimit

Marrja e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit do të kufizohet në çështjet e diskutimit dhe në gjendjen e arsyeve në të cilat ajo bazohet. Ai duhet të përmbajë emrat e anëtarëve, të cilët kanë marrë pjesë dhe datën e vendimit. Çdo anëtar i gjykatës mund t'i bashkëlidhë opinionin kundërshtues ose të vetin vendimit.

Neni 11
Finalizimi i vendimit

Vendimi duhet të jetë përfundimtar dhe pa apelim, përveçse kur Palët në diskutim kanë rënë dakord që përpara për një procedurë apelimi. Ai duhet të pranohet nga Palët në diskutim.

Neni 12
Interpretimi ose zbatimi i vendimit

1. Çdo kundërshtim që mund të lindë ndërmjet Palëve në diskutim përsa i përket interpretimit ose mënyrës së zbatimit të vendimit mund t'i parashtrohet nga secila Palë për vendim nga Gjykata e Arbitrazhit, e cila merr vendimin. Për këtë qëllim, çdo vend vakant në gjykatë do të plotësohet në

mënyrën e parashikuar në caktimet origjinale të anëtarëve të gjykatës.

2. Çdo kundërshtim, i tillë mund t'i parashtrohet një gjykate tjetër ose gjykate sipas nenit 287 me marrëveshje ndërmjet Palëve në diskutim.

Neni 13
Zbatimi kundrejt enteve përveçse Shteteve Palë

Parashikimet e këtij Aneksi do të zbatohen mutatis mutandis në çdo diskutim që përfshin entetet përveçse Shteteve Palë.

ANEKSI VIII. ARBITRAZHI SPECIAL

Neni 1
Institucionalizimi i procedurave

Në mbështetje të Pjesës XV, çdo Palë në një diskutim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e neneve të kësaj Konvente në lidhje me (1) peshkimin, (2) mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit detar, (3) kërkimet detare shkencore ose (4) lundrimin, duke përfshirë ndotjen nga anijet dhe nga transporti mund të parashtrojë diskutimin për procedura të veçanta arbitrazhi të parashikuara në këtë aneks me një njoftim me shkrim adresuar Palëve të tjera ose Palëve në diskutim. Njoftimi duhet të jetë i shoqëruar me një deklaratë reklamimi dhe faktet mbi të cilat ai bazohet.

Neni 2
Lista e ekspertëve

1. Një listë ekspertësh do të formohet dhe mbahet në lidhje me secilën fushë të (1) peshkimit, (2) mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit detar (3), kërkimeve shkencore detare dhe (4) lundrimit, duke përfshirë ndotjen nga anijet ose transporti.

2. Lista e ekspertëve do të krijohet dhe mbahet në fushën e peshkimit nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, në ruajtjen e mbrojtjen e ambientit nga programi i Kombeve të Bashkuara për ambientin, në fushën e kërkimeve shkencore detare nga komisioni ndërqeveritar oqeanografik, në fushën e lundrimit, duke përfshirë ndotjen nga anijet dhe transporti, nga organizata detare ndërkombëtare ose në secilin rast nga institucionet përkatëse sponsorizuese në lidhje me të cilat organizata të tilla, programe ose komisioni i ka deleguar këtë funksion.

3. Secili Shtet Palë do të ketë të drejtën e emërimit të dy ekspertëve në secilën fushë, kompetenca e të cilëve në aspektet ligjore, shkencore ose teknike të fushave të tilla është krijuar dhe e njohur në përgjithësi dhe të cilët zotërojnë reputacionin më të lartë për drejtësi dhe integritet. Emrat e personave të emëruar në këtë mënyrë në secilën fushë do të përbëjnë listën përkatëse.

4. Në rast se në çdo kohë ekspertët e emëruar në këtë mënyrë nga Shtetet Palë në listën e formuar do të jenë të ndryshëm nga dy, ky Shtet Palë do të ketë të drejtën të bëjë emërime të mëtejshme sipas nevojës.

5. Emrat e ekspertëve do të mbeten në listë derisa të mos pranohen nga Shteti Palë, i cili ka bërë emërimin, me kusht që një ekspert i tillë do të vazhdojë të shërbejë në çdo Gjykatë speciale Arbitrazhi në të cilën ky ekspert ka qënë caktuar derisa të përfundojnë procedurat përpara kësaj Gjykate speciale të Arbitrazhit.

Neni 3
Përbërja e Gjykatave speciale të Arbitrazhit

Për qëllimet e procedurave sipas këtij aneksi, Gjykata speciale e Arbitrazhit, përveçse kur është vendosur ndryshe nga palët, do të përbëhet si vijon:

Mbështetur në nënparagrafin (g), Gjykata speciale e Arbitrazhit do të përbëhet nga pesë anëtarë.

Pala që institucionalizon procedurat do të caktojë dy anëtarë mundësisht të zgjedhur nga lista përkatëse ose listat e referuara në nenin 2 të këtij aneksi në lidhje me çështjet në diskutim, një nga të

cilët mund të jetë shtetas i tij. Caktimet do të përfshihen në njoftimet e referuara në nenin 1 të këtij aneksi.

Palët e tjera në diskutim, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit referuar në nenin 1 të ketij aneksi, do të caktojnë dy anëtarë të zgjedhur mundësisht nga lista ose listat përkatëse për çështjet e diskutimit, një nga të cilët mund të jetë shtetas i tij. Nëse caktimet nuk janë bërë brenda kësaj periudhe, Pala që institucionalizon procedurat, brenda dy javëve nga skadimi i kësaj periudhe, mund të kërkojë që caktimet të bëhen në përputhje me nënparagrafin (e).

Palët në diskutim me anën e një marrëveshjeje do të caktojnë Presidentin e Gjykatës speciale të Arbitrazhit, të zgjedhur mundësisht nga listat përkatëse, të cilët do të jenë shtetas të një shteti të tretë, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe. Nëse, brenda 30 ditëve të marrjes së njoftimit të referuar në nenin 1 të këtij aneksi, Palët nuk janë në gjendje të arrijnë marrëveshje mbi caktimin e Presidentit. Caktimi duhet të bëhet në përputhje me nënparagrafin (e), me kërkesën e një Pale në diskutim. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet brenda dy javëve nga skadimi i periudhës 30 ditore të përmendur më sipër.

Përveçse kur Palët bien dakort që caktimi të bëhet nga një person ose një shtet i tretë i zgjedhur nga Palët, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të bëjë caktimet e nevojshme brenda 30 ditëve të marrjes së një kërkese sipas nënparagrafit (c) dhe (d). Caktimet e referuara në këtë nënparagraf do të bëhen nga lista perkatëse ose listat e ekspertëve të referuar në nenin 2 të këtij aneksi dhe në konsultim me Palët në diskutim dhe organizatat ndërkombëtare respektive. Anëtarët e caktuar në këtë mënyrë do të jenë të shtetësive të ndryshme dhe mund të mos jenë në shërbim, rezident të zakonshëm në territor ose shtetas, të secilës Palë në diskutim.

Çdo vend vakant do të plotësohet në mënyrën e përshkruar për caktimet fillestare.

Palët me të njëjtin interes do të caktojnë dy anëtarë të Gjykatës së bashku me marrëveshje. Kur janë disa Palë që kanë interesa të ndara ose kur kanë mosmarrëveshje përsa i përket nëse janë me interesa të njëjta, secili nga ata do të caktojnë një anëtar të gjykatës.

Në diskutimet që përfshijnë më shumë se dy Palë, parashikimet e nënparagrafëve (a) deri (f) do të zbatohen në hapësirën maksimale të mundshme.

Neni 4
Parashikime të përgjithshme

Aneksi VII, nenet 4 deri 13, zbatohen mutatis mutandis në procedura të arbitrazheve speciale në përputhje me këtë aneks.

Neni 5
Gjetja e fakteve

1. Palët në një diskutim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e parashikimeve të kësaj Konvente në lidhje me (1) peshkimin, (2) mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit detar, (3) kërkimeve shkencore detare ose (4) lundrimit, duke përfshirë ndotjen nga anijet dhe transporti, mundet në çdo kohë të bien dakord të kërkojnë një gjykatë speciale arbitrazhi të përbërë në përputhje me nenin 3 të këtij aneksi të kryejë një hetim dhe të gjejë faktet për të dhënë fuqi një diskutimi.

2. Përveçse kur Palët bien dakord ndryshe, gjetja e fakteve të gjykatës speciale të arbitrazhit që vepron në përputhje me paragrafin 1, do të konsiderohet si përfundimtare ndërmjet Palëve.

3. Nëse të gjitha Palët në një diskutim kërkojnë, që Gjykata speciale e Arbitrazhit të formulojë rekomandime, të cilat pa pasur fuqinë e një vendimi, do të përbëjnë vetëm bazën për një rishikim nga Palët të çështjeve që bëhen shkak për një diskutim.

4. Në mbështetje të paragrafit 2, Gjykata speciale e Arbitrazhit do të veprojë në përputhje me parashikimet e këtij aneksi, përveçse kur Palët bien dakord ndryshe.

ANEKSI IX. PJESËMARRJA NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Neni 1
Përdorimi i termave

Për qëllimet e nenit 305 dhe të këtij Aneksi, "organizatë ndërkombëtare" nënkupton një organizatë ndërqeveritare të përbërë nga shtetet në të cilan shtetet anëtare të saj kanë transferuar kompetencat mbi të gjitha çështjet e udhëhequra nga kjo konventë, duke përfshirë kompetencat për të hyrë në traktate në lidhje me këto çështje.

Neni 2
Firmosja

Një organizatë ndërkombëtare mund të firmosë këtë Konventë nëse mazhoranca e shteteve anëtare te saj janë firmosëse të kësaj Konvente. Në kohën e firmosjes, një organizatë ndërkombetare do të bëjë një deklarim duke specifikuar çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në lidhje me të cilën kompetencat janë transferuar kësaj organizate nga shtetet e saj anëtare të cilët janë firmosës, dhe natyrën dhe hapësirën e shtrirjes së këtyre kompetencave.

Neni 3
Konfirmimi formal dhe bashkimi

1. Një organizatë ndërkombëtare mund të depozitojë instrumentat e saj të konfirmimit formal ose të bashkimit nëse mazhoranca e shteteve anëtare të saj depoziton ose ka depozituar instrumentat e tyre të ratifikimit ose bashkimit.
2. Instrumentat e depozituara nga organizatat ndërkombëtare do të përmbajnë ndërmarrjet dhe deklarimet e kërkuara nga nenet 4 dhe 5 të këtij aneksi.

Neni 4
Shtrirja e pjesëmarrjes dhe të drejtat e detyrimet

1. Instrumenti i konfirmimit formal ose i bashkimit i një organizate ndërkombëtare do të përmbajë një ndërmarrje për të pranuar të drejta dhe detyrimet e shteteve sipas kësaj Konvente në lidhje me çështjet që lidhen me të cilat kompetencat i janë transferuar asaj nga shtetet anëtare të cilat janë Palë në këtë Konventë .
2. Një organizatë ndërkombëtare do të jetë një Palë në këtë Konventë në hapësirën që ajo ka kompetenca në përputhje me deklaratat, komunikimet e informatave ose njoftimeve të referuara në nenin 5 të këtij aneksi.
3. Një organizatë ndërkombëtare e tillë do të ushtrojë të drejtat dhe do të ekzekutojë detyrimet të cilat shtetet anëtare të saj të cilat janë Palë ndryshe do të kishin ndryshe sipas kësaj Konvente, mbi çështjet që lidhen se cilat kompetenca kanë qënë transferuar asaj nga këta shtete anëtarë. Shtetet anëtare të kësaj organizate ndërkombëtare nuk do të ushtrojnë kompetencën të cilën ato ia kanë transferuar asaj.
4. Pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare të tilla në asnjë rast nuk do të krijojë një rritje të përfaqësimit në të cilën shtetet anëtare të cilat janë Shtete Palë do të ishin ndryshe të ngarkuara, duke përfshirë të drejtat në marrje vendimesh.
5. Pjesëmarrja e organizatave të tilla ndërkombëtare në asnjë rast nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë sipas kësaj Konvente mbi shtetet anëtare të organizatës, të cilët nuk janë Shtete Palë të kësaj Konvente.
6. Në rastet e një konflikti ndërmjet detyrimeve të një organizate ndërkombëtare sipas kësaj Konvente dhe detyrimeve të saj sipas marrëveshjes së krijimit të organizatës ose çdo akti në lidhje me të, detyrimet sipas kësaj Konvente do të mbizotërojnë.

Neni 5
Deklarimet, njoftimet dhe komunikimet

1. Instrumenti i konfirmimit formal ose i bashkimit të një organizate ndërkombëtare do të përmbajë një deklaratë që specifikon çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në lidhje të cilat kompetencat janë transferuar organizatës nga shtetet anëtare të saj, të cilat janë Palë në këtë Konventë.
2. Një shtet anëtar i një organizate ndërkombëtare, në kohën e ratifikimit të tij ose bashkimit

në këtë Konventë ose në kohën kur organizata depoziton instrumentat e konfirmimit formal ose të bashkimit, kushdoqoftë më vonë, do të bëjë një deklaratë që specifikon çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në lidhje me cilat ajo i ka transferuar kompetenca organizatës.

3. Shtetet Palë, të cilat janë shtete anëtare të një organizate ndërkombëtare, e cila është një Palë në këtë Konvente do të presupozohen që kanë kompetenca mbi të gjitha çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në lidhje me cilat transferim kompetencash organizatës nuk janë deklaruar specifikisht, njoftuar ose komunikuar nga këto Shtete sipas këtij neni.

4. Organizata ndërkombëtare dhe shtetet anëtare të saj, të cilat janë Shtete Palë menjëherë do të njoftojnë depozitimin e kësaj Konvente për çdo ndryshim në shpërndarjen e kompetencave, duke përfshirë transferimet e reja të kompetencave, të specifikuara në deklarimet sipas paragrafit 1 dhe 2.

5. Çdo Shtet Palë mund t'i kërkojë një organizate ndërkombetare dhe shteteve të saj anëtare, të cilat janë Shtete Palë për furnizim me informacion, sikur të ishte ndërmjet organizatës dhe shteteve të saj anëtare, sikur ai të kishte kompetencën në lidhje me çdo çështje specifike që është ngritur. Organizata dhe shtetet anëtare të interesuara do të japin informacione të tilla brenda një kohe të arsyeshme. Organizata ndërkombëtare dhe shtetet anëtare gjithashtu, me iniciativën e tyre, mund të japin këto informacione.

6. Deklarimet, njoftimet dhe komunikimet e informatave sipas këtij neni do të specifikojnë natyrën dhe hapësirën e kompetencave të transferuara.

Neni 6
Përgjegjësia dhe detyrimi

1. Palët, të cilat kanë kompetenca sipas nenit 5 të këtij aneksi do të kenë përgjegjësinë për faje për moszbatim me detyrimet ose për çdo thyerje tjetër të kësaj Konvente.

2. Çdo Shtet Palë mund t'i kërkojë një organizate ndërkombëtare pse shteteve anëtare të saj, të cilat janë Shtete Palë informacione se kush e ka përgjegjësinë përsa i përket çështjeve të veçanta. Organizatat dhe shtetet anëtare të interesuara do të japin këtë informacion. Faji për furnizimin me informacion brenda një periudhe kohe të arsyeshme ose parashikimin e informacioneve kondradiktore do të rezultojnë në një përgjegjësi të ashpër dhe të përbashkët.

Neni 7
Zgjidhja e diskutimeve

1. Në kohën e depozitimit të instrumentave të saj të konfirmimit formal ose të bashkimit, ose në çdo kohë më vonë, një organizatë ndërkombëtare do të jetë e lirë të zgjedhë, me mjetin e deklarimit me shkrim, një ose më shumë mjete për zgjidhjen e diskutimeve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, referuar në nenin 287, paragrafi 1 (a), (c) ose (d).

2. Pjesa XV zbatohet mutatis mutandis në çdo diskutim ndërmjet Palëve të kësaj Konvente, të cilat njëra ose më shumë janë anëtare të organizatave ndërkombëtare.

3. Kur një organizatë ndërkombëtare dhe një ose disa shtete anëtare të saj janë Palë të përbashkëta në një diskutim ose Palë me interesa të njëjta, organizata do të konsiderohet që ka pranuar procedura të njëjta për zgjidhjen e diskutimeve si shtetet anëtare. Kur, megjithatë, një shtet anëtar ka zgjedhur vetëm Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë sipas nenit 287, organizata dhe shteti anëtar i interesuar do të konsiderohen që kanë pranuar arbitrazhin në përputhje me aneksin VII, përderisa Palët në diskutim të bien dakord ndryshe.

Neni 8
Zbatimi i Pjesës XVII

Pjesa XVII zbatohet mutatis mutandis nga një organizatë ndërkombëtare, me përjashtim përsa i përket sa vijon:

(a) Instrumenti i konfirmimit formal ose i bashkimit të një organizate ndërkombëtare nuk do të merret në konsideratë në zbatimin e nenit 308, paragrafi 1.

(b) (i) Një organizatë ndërkombëtare do të ketë fuqinë ekskluzive përsa i përket zbatimit të neneve 312 deri 315, në vazhdim të asaj që ajo ka kompetenca sipas nenit 5 të këtij aneksi mbi të

gjithë çështjet e amendamentit.

(ii) Instrumenti i konfirmimit formal ose i bashkimit të një organizate ndërkombëtare për një amendament, të gjitha çështjet mbi të cilat organizata ndërkombëtare i ka kompetencë sipas nenit 5 të këtij aneksi, do të konsiderohen që janë instrument i ratifikimit ose bashkimit për secilin shtet anëtar, të cilat janë Shtete Palë, për qëllimet e zbatimit të nenit 316, paragrafi 1, 2 dhe 3.

(iii) Instrumenti i konfirmimit formal ose i bashkimit të organizatës ndërkombëtare nuk do të merret në konsideratë në zbatimin e nenit 316, paragrafi 1 dhe 2, përsa i përket të gjitha amendamenteve të tjera.

(c) (i) Një organizatë ndërkombëtare mund të mos denoncojë këtë Konventë në përputhje me nenin 317 nëse secili nga shtetet e saj anëtare janë Shtete Palë dhe nëse ajo vazhdon të përmbushë të gjitha cilësitë e specifikuara në nenin 1 të këtij aneksi.

(ii) Një organizatë ndërkombëtare do të denoncojë këtë Konventë kur asnjë nga shtetet e saj anëtare nuk është Shtet Palë ose nëse organizata ndërkombëtare nuk i përmbush më cilësitë e specifikuara në nenin 1 të këtij aneksi. Denoncime të tilla hyjnë në fuqi menjëherë.